



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

RAPORT PERFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim i Përputhshmërisë)

Instituti e Monumenteve të Kulturës

(IMK)

Tiranë, MAJ 2020



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
(MBI PËRPUTHSHMËRINË)

I. PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE.	<i>Faqe</i>
II HYRJA	2-5
a. Qëllimi dhe Objektivat	2-2
b. Identifikimi i çështjes	2-2
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	3-3
d. Përgjegjësitë e audituesve	3-4
e. Kriteret e vlerësimit	4-4
f. Standardet e auditimit	4-5
IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	5-6
V. GJETJET DHE REKOMANDIMET	6-143
Drejtimi 1: <i>Mbi hartimin e zbatimin e Buxhetit.</i>	6-15
Drejtimi 2: <i>Zbatimi i dispozitave ligjore për mardhëniet e punës dhe pagave.</i>	15-29
Drejtimi 3: <i>Auditim i llogarive vjetore dhe zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin e vlerave materiale dhe monetare.</i>	29-42
Drejtimi 4: <i>Auditim mbi procedurat e prokurimit publik.</i>	42-113
Drejtimi 5: <i>Auditimii objektit të veprimtarisë funksionale të institucionit.</i>	113-143
Drejtimi 6: <i>zbatimi i rekomandime të lëna nga auditimi i mëparshëm.</i>	143-143
VI. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	143-158
VII. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES	158-179



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

I.a.-Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit 66/2 prot, datë 21.01.2020, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 21.01.2020 deri më 13.03.2020, në subjektin “në Institutit të Monumenteve të Kulturës”, (në vijim ish-IMK), sot IKTK, për periudhën nga 01.01.2017 deri në datën 31.12.2019, u krye auditimi i Përputhshmërisë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë dhe rregullshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e këtij institucioni, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me llogaridhënien vjetore, administrimin e fondeve buxhetore dhe zbatimin e procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të arsimtarëve, aspektet e menaxhimit financiar dhe të vlerësimit të sistemeve të kontrollit, etj.

I.b-Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi:

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>Në bazë të PBA për cdo vit si dhe realizimit të buxhetit të cilat po auditohen nga ana jonë, konstatohet se fondet në dispozicion të IMK janë kryesisht në zërin shpenzime personeli, mallra dhe shërbime si dhe Artikulli 604 Projekte në fushën e trashëgimisë. Të tre këto zëra përbëjnë buxhetin e IMK, i cili si institucion varësie i Ministrisë së Kulturës, kushtëzohet nga tavanet e limituara që i vendos kjo Ministri. Pra praktikisht IMK nuk përgatit PBA të orientuara drejt nevojave reale të Institucionit. Lidhur me projektet e trashëgimisë kulturore , pavarësisht se në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve miratohen shumë projekte dhe domosdoshmëria e restaurimit të tyre është e lartë, përgjithsisht ato mbeten në letër të përcaktuara. Kështu për vitin 2017 nuk ka pasur investime për restaurim, përjashtim ben viti 2018 në kuadër të “vitit të Skënderbeut” që IMK ka realizuar 9 projekte në vlerën total 125,393,484 lekë. Si dhe viti 2019 një projekt në vlerën 29,216,828 lekë për shak të emergjencës së tërmetit në zonën e Korçës.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se projekt buxhetet e hartuara dhe zbatuara nuk janë në korelacion të drejtë me nevojat reale të Institucionit, për përmbushjen e objektivave dhe detyrave themelore të tij. Buxhetet e mësipërme përmbshin nevojat elementare te funksionimit të institucionit, por jo përmbushjen e veprimtarisë së tij. PBA e hartuara janë thjesht një parashikim minimal në përputhje me tavanet e vendosura nga Ministria e Kulturës.</p> <p>Kështu nga auditimi konstatohet se vetë IMK harton dhe miraton projekte në fushën e trashëgimisë kulturore mesatarisht në vit 60-70 pa përfshirë Drejtoritë Rajonale të cilat pothuajse nuk realizohen , përjashtuar projektet e inicuar nga investitorë jashtë fondeve buhetore.</p> <p>Përpunimi i projektve kryhet me teknika të cilat nuk mbështeten nga një infrastrukturë IT moderne e cila do kursente kohë, energji dhe përmirësonte cilësinë pamore të tyre.</p>	<p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet 10-19 të Raportit përfundimtar të Auditimit).</i></p>	E LARTE	<p>“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve për buxhetet vjetore(2017-2018-2019) dhe Udhëzimet plotësuese për përgatitjen e buxhetit të shtetit</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
2.	<p>-IKTK aktualisht përfshin dy institucionet e ristrukturuara (IMK dhe ASHA) gjendet në ambientet e godinës së Ministrinë e Kulturës, në strukturën e saj ka të përfshirë në funksionet mbështetëse 11 nga 58 punonjës pra rreth 20% të personelit gjithsej. Përfshirja në strukturë e një numri të lartë pozicioneve si roje, punonjës pastrimi, punonjës mirëmbajtje, nëpunës informacioni më vete, veç atyre të Ministrisë së Kulturës e cila ndodhet po në të njëjtën godinë, nuk paraqet skenarin më të mirë për menaxhimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike. Me një qasje më të kujdesshme nga ana e instancave përkatëse gjatë procesit të ristrukturimit rreth ½ e këtyre pozicioneve pune mund të të konvertoheshin në funksionet bazë çka dhe është dhe objektivi kryesor i institucionit.</p>	<p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet 15-29 të Raportit përfundimtar të Auditimit).</i></p>	E LARTE	IKTK në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të rishikoj strukturën organizative për konvertimin e funksioneve mbështetëse të panevojshme në funksione bazë duke mundësuar përbushjen sa më të plotë të objektivave institucional.
3.	<p>Nga auditimi rezultoi se, për periudhën nën auditim Janar 2017 - Dhjetor 2019 janë kryer rreth 15 emërime nga ana e institucionit. Në të gjitha rastet për procedurat e ndjekura në rekrutimin e punonjësve nuk është dërguar njoftim për shpalljen e vendeve vakantë dhe botimin e shpalljes në buletin dhe njoftimeve të APP.. Njoftimet nuk rezultojnë të publikuara as në portalin e institucionit, çka evidenton një proces rekrutimi plotësisht të mbyllur dhe me mungesë të theksuar transparence. Rregullisht institucioni duhet të dërgonte pranë APP njoftimin përkatës dhe të zhvillonte procedurat e rregullta të konkurimit mbi bazën e kritereve të përcaktuara, gjë e cila nuk rezulton. Mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr. 176, datë 29.3.2006 “Për Botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike” pika 1 dhe 2 e tij.</p>	<p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet 15-29 të Raportit përfundimtar të Auditimit).</i></p>	E LARTE	IKTK, të marrë nismat e nevojshme administrative duke përcaktuar dhe modalitetet e publikimit në aktet e brendshme rregullativë në mënyrë që kjo problematikë të mos jetë prezente në të ardhmen.
4.	<p>Aplikimet për leje zhvillimi për hidrocentrale nuk bazohen në një instrument planifikimi në fuqi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi nga KKT dhe KKR si dhe vendimet miratuese të marra nga ky i fundit, nuk janë bazuar në detyrimin e përputhshmërisë së projekteve të hidrocentraleve me dokumentat e planifikimit ku në këtë rast aplikimet për leje zhvillimi duhet të bëheshin vetëm bazuar në një Plan Kombëtar Sektorial referuar VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” seksioni 4, neni 22.</p> <p>Pasi në çdo rast autoriteti që shqyrton kërkesat për leje zhvillimi Bazuar në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, neni 10/1 ka detyrimin që të shprehet, nëse projektideja është hartuar në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe rregullat e projektimit.</p> <p>Sa më sipër miratimi i këtyre projekteve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve është në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, duke bërë që këto leje të jenë dhënë në kushtet e mungesës së zonave të përcaktuara të zhvillimit të sektorit.</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 113-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></p>		Ministri i Kulturës në cilësinë e Kryetarit të KKR si dhe Znj. A.D, drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së të marrin masa për të mos miratuar leje zhvillimi për hidrocentrale, në kushtet e mungesës së instrumenteve të planifikimit ku të jenë të përcaktuara zonat kryesore të zhvillimit të sektorit, plani i shërbimeve dhe infrastrukturave të sektorit si dhe plani i mbrojtjes së mjedisit dhe rregullat për ruajtjen e mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore dhe objekteve të trashëgimisë kulturore.
5.	<p>Me vendim nr. 195, datë 06.06.2019 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretariati Teknik, Institutit i Monumenteve të Kulturës pas diskutimit paraprak në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, ka miratuar projektin “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin</p>	<p><i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 113-143 të</i></p>		Ministri i Kulturës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve si dhe Znj. A.D, drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
	<p><i>Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Sh. H. shpk”.</i></p> <p>Nga auditimi rezulton se kjo leje nuk është e bazuar në një instrument planifikimi në fuqi, Plan Kombëtar Sektorial, Plan të Përgjithshëm Vendor apo Plan të Detajuar Vendor, në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar</p> <p>Nga verifikimi i përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, si instrumenti më i lartë i planifikimit të territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë, rezulton se në lumin Shushicë nuk është parashikuar ndërtim hidrocentralesh.</p> <p>Në miratimin e këtij projekti Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe Këshilli Shkencor i Institutit të Monumenteve të Kulturës kanë vepruar në kundërshtim dhe me Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” pika 67 si dhe masave të mbrojtjes indirekte, të përcaktuara në nenin 96, pasi projekti i ndërtimit të këtij HEC-i çënon perspektivën, peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit.</p>	<p><i>Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></p>		<p>të marrin masa për të anuluar Vendimin nr. 195, datë 06.06.2019, për miratimin e projektit “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Sh. H. shpk” si një vendim i dhënë në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe që çënon perspektivën, peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit.</p>
6.	<p>Nga auditimi rezultoi se, Rregullja e Brendshme mbi të cilën është bazuar veprimtaria e IMK është hartuar nga vet institucioni ndërkohë që miratimi është bërë nga Drejtuesi i tij. Ky dokument është mbështetur në nenin 11 pika 3 të Statutit të IMK miratuar me Urdhër të Ministrisë të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017.</p> <p>Pavarësisht referimit në dispozitat e statutit, miratimi i rregullores nga vet institucioni bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. Nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” pika 2 e tij. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale nga vet institucioni përbën në parim një “konflikt interesi” i cili ka ndikuar ose mund të ketë ndikuar edhe në paanshmërinë ose objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës zyrtare referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9131, date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” por jo vetëm.</p> <p>-Deri në hartimin e këtij materiali auditimi institucioni nuk disponon ende Statutin dhe Rregulloren e re referuar ndryshimeve të fundit ligjore, të cilët megjithëse janë hartuar prej IKTK dhe dërguar në Ministrinë e Kulturës me shkresën nr. 142 datë 17.01.2019, nuk janë miratuar ende prej saj, vonesë e cila veç aspekteve ligjore ngre pikëpyetje për vet projektin e ristrukturimit.</p>	<p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr15 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></p>	E LARTE	<p>Ministria e Kulturës, të vlerësojë situatën dhe të marrë masat e nevojshme administrative për miratimin e akteve të reja rregullativ duke verifikuar me kujdes përputhshmërinë e tyre me aktet më të larta në hierarkinë ligjore, ndarjen e qartë dhe të drejtë të kompetencave për çdo funksion, për të garantuar ecurinë e veprimtarisë institucionale si dhe funksionimin efikas të sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion.</p>
7.	<p>Miratimet e legalizimeve të objekteve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretaria Teknike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, marrë mbi bazën e diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, si dhe mendimet institucionale të dhëna për këto objekte nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare K. kanë cënuar detyrimet për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Korçës, pasi për të gjithë rastet e audituara rezulton se miratimet e legalizimeve janë bërë në kundërshtim me</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 113-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i></p>	E LARTE	<p>Ministri i Kulturës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve si dhe Znj. A.D. drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së të marrin masa për të anuluar Vendimin nr. 195, datë 06.06.2019, për miratimin e projektit “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Sh. H.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËN DËSIA	REKOMANDIMI
	<p>Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2 ku përcaktohet se në këto zona është i ndaluar ç’do lloj ndërtimi i ri;</p> <p>Të gjitha vendimet e audituara të miratimeve të legalizimeve nga KKR dhe mendimet institucionale të DRKK Korçë, janë dhënë për objekte të cilat nuk plotësojnë kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, nuk ruajnë kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, nuk i përshtaten karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale. Objektet paraqesin mungesë identiteti arkitektonik duke mos qenë në harmoni me vetëveten dhe aq më pak me karakterin e objekteve të zonës së mbrojtur.</p> <p>Në 4 prej rasteve të miratimit të legalizimeve të audituara, rezultojnë se janë bërë miratime për objekte 4 kate brenda zonës së mbrojtur së qytetit të Korçës, në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit nr. 207, datë 15.3.2017 dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë e Rregullores së tij ku përcaktohet qartë se lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve në zonën e mbrojtur, përveç rasteve kur për to ka studime të vecanta, nuk duhet t’i kalojë 3 katet.</p> <p>Në tre raste rezultojnë se lartësia maksimale e ndërtimit i kalon 3 katet pasi kati podrum është më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemit dhe lartësia e çatisë e lejon shfrytëzimin e hapsirës nën të duke bërë që ajo të vlerësohet si një kat.</p> <p>Ne një rast, rezultojnë se në kundërshtim me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë K., të miratuar nga KKT me vendim nr. 7, datë 08.02.2017, neni 75, pika 3 dhe 4, gjurma e ndërtimit është më e madhe se 150 m² dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit e intensiteti i ndërtimit i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar prej 75% dhe intensitet 2.8. (</p>			<p><i>shpk</i>” si një vendim i dhënë në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe që cënon perspektivën, peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës U. e Bratit.</p>

A. OPINIONI I AUDITIMIT:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000¹).

Në vlerësimin tonë ne mbështetemi në faktin se gjatë auditimit në terren, janë marrë të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të jepet një opinion, pavarësisht se për shkak të gjendjes së fatkeqsisë natyrore të shpallur në vend nga pandemia COVID19, auditimi në terren u krye deri në datë 13.03.2020, dhe nuk u bë i mundur Auditimi i veprimtarisë në Drejtoritë Rajonale si dhe nuk u audituan plotësisht praktikat e vendimarrjes nga KKMT për shpalljen e qendrave historike të qyteteve si dhe shumë projekteve të miratuara nga institucioni, në zonat e mbrojtura. Cështje të cilat do të jene objekt i një auditimi i cili do të parashikohet të ushtrohet brenda vitit.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë², i ushtruar në IMK, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon ruajtjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe vlerësimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë, (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi.

Baza për opinionin e përputhshmërisë:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve, duke vlerësuar materialitetin, risqet dhe kampionin e transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti IKTK (ISH-IMK) të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), Sipas opinionit të audituesve, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin “IMK” sot IKTK, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë***³.

HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Institutin e Monumenteve të Kulturës”, më poshtë e emërtuar IMK (ne vijim IKTK), në bazë të programit të auditimit të

¹ ISSAI 4000 – Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë.

² Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

³ Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë një *opinion të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

miratuar nga Zv.Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 66/2 prot. datë 21.01.2020, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2017 deri në 31.12.2019, me afat auditimi nga data 21.01.2020 deri më 20.03.2020, dhe lloj auditimi “Auditim mbi Përputhshmërinë” i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. Ll. (përgjegjës grupi),
- 2.K. Xh.
3. A. K.
- 4.E.S

a) Titulli:

Auditimit I Përputhshmërisë në IMK (ne vijim IKTK).

b) Marrësi:

Ky Raport i adresohet Drejtorit të IKTK-s (ISH-IMK)Znj.A. D

Shënim: *Theksojmë se për shak të gjendjes së fatkeqsisë natyrore të shpallur në vend nga pandemia COVID19, auditimi në terren u krye deri në datë 13.03.2020, dhe nuk u bë i mundur ballafaqimi i problematikës së konstatuar me gjithë punonjësit që atakohen në këtë raport auditimi, pavarësisht se është kryer komunikim i vazhdueshëm me drejtuesit e Institucionit. Aktet e konstatimit nga ana e grupit të auditimit u përcollën në IKTK(ish-IMK), nëpërmjet emailit zyrtar të institucionit, dhe brenda afatit të parashikuar nuk u paraqitën observime nga subjekti, por u kërkuar shtyrja e afatit të paraqitjes së tyre.të cilat u paraqitën me postë elektornike dhe në vijim u trajtuan në këtë në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është, dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e te cilave ushtron veprimtarinë “Instituti i Monumenteve të Kulturës”. Auditimi i përputhshmërisë së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, dhënia e opinionit për shkallën e ndjekjes së tyre si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Objektivat e auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga “Instituti i Monumenteve të Kulturës”, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi: Vlerësimi i saktësisë së informacioneve në aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

Identifikimi i çështjes:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Institutit të Monumenteve të Kulturës” sot IKTK, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri më 31.12.2019, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e IMK-s e cila ka si detyrë themelore e IKTK-së, është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Në funksion të përmbushjes së Misionit të tij, IKTK merr të gjitha masat që sigurojnë gjurmimin, evidentimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK, aktivitetin e tij e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e tij.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:

Është detyrimi i menaxherëve të njëjësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

-Drejtori i Përgjithshëm si (*Nëpunësi autorizues*) është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale .

-Përgjegjësi i Sektorit të Financës (*Nëpunësi zbatues*) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për Auditimin e Përputhshmërisë

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (*INTOSAI*), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500, ISA 300*).

-Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve të mbajtura si dhe observacioneve të paraqitura për këto akte u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

- -Urdhër i Kryeministrit nr. 14 datë 22.01.2014 “Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Monumenteve të Kulturës, G.S. dhe D. R. K.K”;
- -Urdhër i Kryeministrit nr. 114 datë 22.01.2014 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.14 datë 22.01.2014, Për miratimin e Strukturës dhe të organikës së Institutit të Monumenteve të Kulturës G. S dhe D. R. K.K”;
- -Urdhër i Kryeministrit nr. 137 datë 21.10.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
- -Urdhër i Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017, “Për miratimin e statutit të Institutit të Monumenteve të Kulturës G. S”;
- -VKM nr. 364 datë 29.05.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së IKTK”.
- -Statuti i Institutit të Monumenteve të Kulturës “G. S” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017.
- -Rregullore e Brendshme e Institucionit miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 128 datë 24.01.2017.
- -Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.
- Ligji 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" i ndryshuar.
- Ligji nr.9482 datë 03.04.2006“Për legalizimin,urbanizimin dhe intekrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar si dhe VKM përkatëse.
- Ligji nr. 9048/2003 i ndryshuar, ne ni 17 pika 2 dhe Rregullores për Organizimin dhe funksionimin e KKR, miratuar me Urdher te Ministrit te Kultures, nr. 8 date 14.1.2014
- VKM Nr. 207., datë 15.03.2017 “Për miratimin e qendrës Historike për Qytetin e Korcës dhe rregullorja përkatëse;
- VKM Nr. 582, datë 03.10.2018 “Për miratimin e qendrës Historike për Qytetin të Tiranës dhe rregullorja përkatëse;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre.

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, i ndryshuar, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:

-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

Praktikat e ndjekura në krverjen e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:

(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1. *Kontroll aritmetik* që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

1. *Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

2. *Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

4-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.

5-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

6-*Pyetësorë* për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacioni i përgjithshëm.

IMK (sot IKTK) është institucion vartësie i MK dhe detyra themelore e IKTK-së, është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Në funksion të përmbushjes së Misionit të tij, IKTK merr të gjitha masat që sigurojnë gjurmimin, evidentimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK, aktivitetin e tij e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të T. K, të cilat bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e tij.

Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni të cilat lidhen drejtpërdrejt me drejtimit e këtij auditimi janë: ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Në funksion të përmbushjes së Misionit të tij, IKTK merr të gjitha masat që sigurojnë gjurmimin, evidentimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK, aktivitetin e tij e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të T. K, të cilat bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e tij.

Struktura e IMK për periudhën nën auditim ka pësuar disa ndryshime të cilat janë miratuar prej Ministrisë përgjegjëse.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

Në këtë angazhim auditimi të Kontrollit të Lartë i Shtetit, fokusi kryesor është vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së subjektit “IMK”:

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT:

- a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.*
- b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.*
- c. Realizimi i planit të buxhetit.*
- d. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.*

Nga kontrolli i dokumentacionit të paraqitur për hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të Shtetit, për vitin 2017, vitin 2018 dhe vitin 2019 dhe rezultoi se:

Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK) ka për detyrë të menaxhojë veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit, të administrojë me efikasitet dhe efektivitet vlerat materiale dhe monetare të vëna në dispozicion bazuar në rregullat dhe standardet buxhetore, merr masa për programimin, sigurimin dhe realizimin e të ardhurave, organizon dhe realizon kontrole për respektimin e disiplinës financiare dhe buxhetore në drejtim të përdorimit të tyre dhe konkretisht:

Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit për vitet 2017, 2018 dhe 2019, është mbështetur në udhëzimet respektive vjetore të Ministrisë së Financave referuar Udhëzimeve të Ministrisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Financave “Për përgatitjen e buxhetit” hartimin dhe detajimin e planit të shpenzimeve në zbatimin e buxhetit të shtetit”.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve për buxhetet vjetore (2017-2018-2019) dhe Udhëzimet plotësuese për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale, për të përballuar nevojat e tij me fonde, ka hartuar Programet Buxhetore Afatmesme dhe Projektbuxhetin për vitin 2017, 2018 dhe 2019, si dhe i ka dërguar në Ministrinë e Kulturës brenda afatit të parashikur për paraqitjen e Projekt Buxheteve (PBA) për IMK-n.

Instituti i Monumenteve të Kulturës në hartimin e projekt buxhetit të çdo viti dhe të PBA-ve është mbështetur në realizimin e buxhetit të viteve të kaluara, në nevojat për rritjen e aktivitetit për ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve të kultures duke ruajtur shifrat tavan të tërguara nga MTKRS-ja.

Detajimi i Buxhetit.

IMK – ja ka hartuar Projekt Buxhetet Afatmesme (PBA) dhe i ka dërguar në MTKRS respektivisht sipas viteve, për PBA e vitit 2018- 2020 i ka dërguar me shkresën nr. 1396/1, datë 08.08.2017, për PBA e vitit 2019- 2021 i ka dërguar me shkresën nr. 1748/1, datë 17.08.2018 dhe për PBA e vitit 2020- 2022 i ka dërguar me shkresën nr. 774/1, datë 18.04.2019. MK nga ana e saj me shkresën përkatëse i ka dërguar Institutit të Monumenteve të Kulturës Buxhetin e vitit 2017;2018 dhe 2019 ku Buxheti është i detajuar për kapituj dhe programe, si dhe i detajuar në muaj.

Për vitin 2017 IMK për vitin ka pasur si prioritet;

- Hartimin e projekteve restauruese të ndërhyrjeve në objektet monument Kulture.
- Përgatitjen e programeve afatgjata të politikave për mbrojtjen e monumenteve.
- Dixhitalizimin i vend-ndodhjes së monumente dhe pasqyrimi i tyre në Hartën I.G.
- Përditësimi i listës kombëtare të monumenteve 100 %, dhe verifikimi në vend i gjendjes fizike të tyre.
- Të përmirësojë (PPP) dhe me donatorët në zbatimin e projekteve rijetëzuese në qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare.
- Angazhim në rritje (dhe për shkak të shtimit të problematikës) për restaurimin dhe ndërhyrjet konservuese ne Afreske, Mozaik, Ikona dhe Ikonostas.
- Pjesmarrjen në takimet dhe aktivitetet vjetore të UNESCO-os, dhe organizma të tjera ndërkombëtare partnere.

Dinamika dhe ecuria e buxhetit sipas PBA, planit të akorduar me ndryshimet, planit përfundimtar, krahasimi me faktin rezulton për vitin 2017 e në tabelat si më poshtë:

A.Tab.1. Për vitin 2017

Në 000/lekë

			PBA	Plani akorduar	Plani perf.	Fakti	Ne	
Tit	Art	Emërtimi	2017	2017	2017		%	Dif.
8220	600	Paga	33.484.000	31.786.889	31.910.934	30.987.618	97%	923.316
8220	601	Sigurimet Shoqërore	5.592.000	5.520.000	5.323.470	5.171.664	97%	151.806
8220	602	Mallra e shërbi të tjer	18.100.000	7.750.000	13.660.000	13.604.039	100%	55.961
8220	604	Transferta. Projekte	360.000	500.000	474.133	474.133	100%	-
8220	605	Transferime korrente per organizatat nderkombetare	98.000	98.000	54.766	54.766	100%	-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

8220	606	Shpenzime per situata te veshitura dhe per fatekeqesi, etj.	-		50.000	50.000	100%	-
8220	602+231	Sponsorizime		1.007.868	1.314.564		0%	1.314.564
8220	466	Garanci punimesh			-			-
8220	231	Investime	2.910.000		-			-
		Totali	60.544.000	46.662.757	52.787.867	50.342.220	95%	2.445.647

Burimi /IMK

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në tabelën e mësipërme, ndërmjet PBA, planit të akorduar me ndryshimet, planit përfundimtar, fondet buxhetore kanë pësuar ndryshime. Kështu plani i akorduar krahasuar me PBA është i barabartë në vlerën 46.662 mijë lekë, plani përfundimtar rritet nga 52.787 mijë lekë në ... mijë lekë, ndërsa realizimi faktik është 50.342 mijë lekë ose më pak se PBA-ja në vlerën 2.445 mijë lekë.

Për vitin 2018.

B.Tab.2. Për vitin 2018

Në 000/lekë

			PBA	Plani akorduar	Plani perf.	Fakti	Ne	
Tit	Art	Emërtimi	2018	2018	2018	2018	%	Dif.
8220	600	Paga	36.107.000	32.115.000	33.661.098	33.048.052	98%	613.046
8220	601	Sigurimet Shoqërore	6.000.000	6.508.000	5.542.402	5.505.711	99%	36.691
8220	602	Mallra e shërbi të tjer	19.170.000	8.750.000	14.650.000	14.649.698	100%	302
8220	604	Transferta. Projekte	1.000.000	-	-	-		-
8220	605	Transferime korrente per organizatat nderkombetare	100.000	98.000	53.500	53.426	100%	74
8220	606	Shpenzime per situata te veshitura dhe per fatekeqesi, etj.	-	-	175.965	175.965	100%	-
8220	602+231	Sponsorizime		1.314.564	2.813.497	1.593.747	57%	1.219.750
8220	466	Garanci punimesh		-	-			-
8220	231	Investime	2.910.000	126.200.000	125.614.432	125.393.484	100%	220.948
		Totali	65.287.000	174.985.564	182.510.894	180.420.083	99%	2.090.811

Burimi/Financa IMK

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në tabelën e mësipërme, ndërmjet PBA, planit të akorduar me ndryshimet, planit përfundimtar, fondet buxhetore kanë pësuar ndryshime. Kështu plani i akorduar krahasuar me PBA është rritur nga 65.287 mijë lekë PBA në 174.985 mijë lekë plani i akorduar. Plani përfundimtar është ulur nga 182.510 mijë lekë në 180.420 mijë lekë, pra është pakësuar në vlerën 2.090 mijë lekë ndërsa realizimi faktik është 180.420 mijë lekë ose më shumë se PBA-ja në vlerën 115 133 mijë lekë, ose është rritur për 60 %.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Kjo për shkak të investimeve të celura nga MK për vitin e Skënderbeut, të cilat janë realizuar nga IMK.

C.Tab.3Për vitin 2019

në 000/lekë

			PBA	Plani akorduar	Plani perf.	Fakti	Ne	
Tit	Art	Emërtimi	2019	2019	2019	2019	%	Dif.
8220	600	Paga	35.305.000	34.948.000	31.929.082	31.929.082	100%	-
8220	601	Sigurimet Shoqërore	5.866.000	5.750.000	5.325.214	5.325.214	100%	-
8220	602	Mallra e shërbi të tjer	11.000.000	11.000.000	10.407.709	10.313.536	99%	94.173
8220	604	Transferata. Projekte	-	-	495.622	495.622	100%	-
8220	605	Transferime korrente per organizatat nderkombetare	100.000	100.000	49.723	49.723	100%	-
8220	606	Shpenzime per situata te veshitura dhe per fatekeqesi, etj.	-	-	60.000	60.000	100%	-
8220	602+231	Sponsorizime		1.219.750	1.219.750		0%	1.219.750
8220	466	Garanci punimesh		6.269.643	6.269.643	373.756	6%	5.895.887
8220	231	Investime	541.991			-	0%	-
		Totali	52.812.991	59.287.393	55.756.743	48.546.933	87%	7.209.810

Burimi /Financa IMK

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në tabelën e mësipërme për vitin 2019, ndërmjet PBA, planit të akorduar me ndryshimet, planit përfundimtar, fondet buxhetore kanë pësuar ndryshime. Kështu plani i akorduar krahasuar me PBA është rritur në vlerën 6 475 mijë lekë nga 52.812.991 mijë lekë PBA në 59.287 mijë lekë plani i akorduar. Plani përfundimtar është ulur nga 59.287 mijë lekë në 55 756 mijë lekë, pra është pakësuar në vlerën 3 531 mijë lekë ndërsa realizimi faktik është 48 546 mijë lekë ose më pak se PBA-ja në vlerën 4 266 mijë lekë, dhe realizuar në total 87%, pasi nuk janë akorduar sponsorizimet e parashikuara si dhe garancia e punimeve e parashikuar për tu realizuar.

Zbatimi i kriterëve ligjore në Çeljen e Buxhetit të vitit 2017,2018 dhe 2019 detajimi i planit fillestar, transferimi i fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor konform dispozitave ligjore.

Instituti të Monumenteve të Kulturës në mbështetje të ligjit nr. 9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjeve për buxhetet vjetore(2017-2018-2019) dhe Udhëzimet plotësuese për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale, për të përballuar nevojat e tij me fonde, ka hartuar Programet Buxhetore Afatmesme dhe Projektbuxhetin për vitin 2017, 2018 dhe 2019, IMK-s i janë vënë fonde në dispozicion nga buxheti i shtetit nëpërmjet MTKRS-së, detajuar si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Në tabelën mëposhtme paraqitet buxheti dhe realizimi i tij për vitet 2017, 2018 dhe 2019:

Viti 2017

Në 000/lekë

Art	Emërtimi	Plani Fillestar	Ndryshimet	Plani Përfund.	Fakti	%
600	Paga	31.786.889	124.045	31.910.934	30.987.618	97%
601	Sigurimet Shoqërore	5.520.000	(196.530)	5.323.470	5.171.664	97%
602	Mallra e shërbi të tjer	7.750.000	5.910.000	13.660.000	13.604.039	100%
604	Transferta. Projekte	500.000	(25.867)	474.133	474.133	100%
605	Transferime korrente per organizatat nderkombetare	98.000	(43.234)	54.766	54.766	100%
606	Shpenzime per situata te veshtira dhe per fatekeqesi, etj.	-	50.000	50.000	50.000	100%
602	Sponsorizime	1.007.868	306.696	1.314.564	-	0%
466	Garanci punimesh		-			
231	Investime		-			
	Totali	46.662.757	6.125.110	52.787.867	50.342.220	95%

Viti 2018

Në 000/lekë

Art	Emërtimi	Plani Fillestar	Ndryshimet	Plani Përfund.	Fakti	%
600	Paga	32.115.000	1.546.098	33.661.098	33.048.052	98%
601	Sigurimet Shoqërore	6.508.000	(965.598)	5.542.402	5.505.711	99%
602	Mallra e shërbi të tjer	8.750.000	5.900.000	14.650.000	14.649.698	100%
604	Transferta. Projekte		-			
605	Transferime korrente per organizatat nderkombetare	98.000	(44.500)	53.500	53.426	100%
606	Shpenzime per situata te veshtira dhe per fatekeqesi, etj.	-	175.965	175.965	175.965	100%
602	Sponsorizime	1.314.564	1.498.933	2.813.497	1.593.747	57%
466	Garanci punimesh		-			
231	Investime	126.200.000	(585.568)	125.614.432	125.393.484	100%
	Totali	174.985.564	7.525.330	182.510.894	180.420.083	99%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Viti 2019,

Në 000/lekë

Art	Emërtimi	Plani Fillestar	Ndryshimet	Plani Përfund.	Fakti	%
600	Paga	34.948.000	(3.018.918)	31.929.082	31.929.082	100%
601	Sigurimet Shoqërore	5.750.000	(424.786)	5.325.214	5.325.214	100%
602	Mallra e shërbi të tjer	11.000.000	(592.291)	10.407.709	10.313.536	99%
604	Transferta. Projekte		495.622	495.622	495.622	100%
605	Transferime korrente per organizatat nderkombetare	100.000	(50.277)	49.723	49.723	100%
606	Shpenzime per situata te veshtira dhe per fatekeqesi, etj.	-	60.000	60.000	60.000	100%
602	Sponsorizime	1.219.750	-	1.219.750	-	0%
466	Garanci punimesh	6.269.643	-	6.269.643	373.756	6%
231	Investime	30.000.000	(30.000.000)	-	-	0%
	Totali	89.287.393	(33.530.650)	55.756.743	48.546.933	87%

Nga treguesit e mësipërm rezulton se, zbatimi i planit të buxhetit të shtetit për vitin 2017,2018 dhe vitin 2019 është realizuar përkatësisht në masën 99 %, 95.5 % dhe 87 %.

Peshën më të madhe specifike të shpenzimeve e zë respektivisht zëri i pagave, i cili sipas viteve është realizuar respektivisht 97 %, 98 % dhe 100%.

Ndryshimet e kryera si për vitin 2017, 2018 dhe 2019 për shtesa dhe pakësime, janë kryer në zbatim të udhëzimit përkatës mbi Buxhetin e Rishikuar për shtesa dhe pakësime në Art. 602,603,604,605 dhe 606.

Nga kontrolli për zbatimin e kritereve dhe kompetencave për transferimin e fondeve buxhetore rezultoi se, transferimi i tyre në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, është bërë në përputhje me dispozitat ligjore.

Spektori i Financës, ka bërë rakordimin për planin fillestar me ndryshimet dhe planin përfundimtar të buxhetit për vitin 2017, 2018 dhe 2019 me MTKRS, për të cilat janë përpiluar dhe Akt-rakordimet me Drejtorinë Qëndrore në vartësi të cilës janë mbajtur aktrakordimet me këtë institucion, për planin fillestar me ndryshimet për vitet respektive.

Realizimi i shpenzimeve për “Mallra e materiale të tjera” llog. 602 për vitin 2017 paraqitet në tabelën më poshtë:

Viti 2017

Në 000/ lekë

Nr.	Llog	Emërtimi mallra e sherbime te tjera	Plani	Fakti	%
1	602	Kancelari per vitin ushtrimor	803.000	802.362	100%
2	602	Mat.për pastrim dhe shërb.	74.000	62.399	84%
3	602	Libra dhe abonime per v.ushtrimor	238.000	237.600	100%
4	602	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	1.500	1.500	100%
5	602	Energji per v.ushtrimor	2.821.542	2.767.923	98%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

6	602	Uje per v.ushtrimimor	330.000	299.332	91%
7	602	Telefon,internet per v.ushtrimor	148.000	76.547	52%
8	602	Posta	150.000	189.924	127%
9	602	Karburant dhe vaj	1.200.000	1.199.851	100%
10	602	Mirëmb.e mjeteve transp.	395.000	373.928	95%
11	602	Kosto e sigur.mjeteve transp.	112.000	111.502	100%
12	602	Udhëtim I brënd	2.500.000	2.438.770	98%
13	602	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike	119.000	118.000	99%
14	602	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	199.000	125.668	63%
15	602	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	800.000	770.880	96%
16	602	Shpenzime per ekzekutim te vendimeve gjyqesore per largim nga puna	3.268.958	3.615.555	111%
17	602	Shpenzime per honorare	125.000	37.298	30%
18	602	Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga institucioni.	15.000	15.000	100%
19	602	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative(ËEBGIS)	360.000	360.000	100%
		Totali	13.660.000	13.604.039	100%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se, realizimi është në masën 100 %. Por brenda artikujve kemi tejkallim në realizimin e tyre zyre dhe shpenzime gjyqësore në masën 127% dhe posta në masën 111% të parashikimit të saj, por kjo nuk ka cënuar totalin e parashikuar për shpenzime në llogarinë 602.

Realizimi i shpenzimeve për “Mallra e materiale të tjera” llog. 602 për vitin 2018 paraqiten në tabelën më poshtë:

Viti 2018

Në 000/lekë

Nr.	Llog	Emërtimi mallra e sherbime te tjera	Plani	Fakti	%
1	602	Kancelari per vitin ushtrimor	684.000	684.000,00	100%
2	602	Mat.për pastrim dhe shërb.	119.680	119.671,00	100%
3	602	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyrës.(Bojra)	761.050	761.040,00	100%
4	602	Libra dhe abonime per v.ushtrimor	504.000	503.280,00	100%
5	602	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	46.500	46.500,00	100%
6	602	Energji per v.ushtrimor	2.871.000	2.870.069,00	100%
7	602	Uje per v.ushtrimimor	172.000	171.440,00	100%
8	602	Telefon,internet per v.ushtrimor	95.700	95.611,00	100%
9	602	Posta	172.000	171.497,00	100%
10	602	Sherbime te Tjera (vidio)	120.000	119.976,00	100%
11	602	Shërbime të tjera(njoftim ne media)	167.000	166.950,00	100%
12	602	Karburant dhe vaj	1.200.000	1.199.996,00	100%
13	602	Mirëmb.e mjeteve transp.	473.000	472.188,00	100%
14	602	Kosto e sigur.mjeteve transp.	97.000	96.638,00	100%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

15	602	Shpenz te tjera te mjeteve transp.(taksa, kolaudim)	18.900	18.876,00	100%
16	602	Udhëtim I brënd	4.792.000	4.791.640,00	100%
17	602	Udhëtim I jasht.	305.300	305.205,00	100%
18	602	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike(ËEBGIS)	360.000	360.000,00	100%
19	602	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve kompjuterike	725.100	724.080,00	100%
20	602	Shpenz.per miremb.,rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	120.000	119.932,00	100%
21	602	Shpenzime per mirembajtjen e mobiljeve te zyrave (riparim karrige)	100.000	99.840,00	100%
22	602	Shpenzime per ekzekutim te vendimeve gjyqesore per largim nga puna	706.470	712.000,00	101%
23	602	Shpenzime per honorare	18.300	18.269,00	100%
24	602	Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga institucioni.	15.000	15.000,00	100%
25	602	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	6.000	6.000,00	100%
		Totali	14.650.000	14.649.698	100%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezultojnë se, të gjithë zërat e shpenzimeve janë realizuar në masën 100 %. Peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve e zënë zërat dieta ,zëri shpenzime energjie , shpenzime gjyqësore. Në krahasim me vitin 2017 shpenzimet për dieta janë rritur në përqindje janë rritur gati me 50 %, kjo për shkak të angazhimit të specialistëve në mbikqyrjen e projekteve me financime si nga privati por dhe projekteve të Fondit të zhvillimit Shqiptar.

Viti 2019 *në /000 leke*

Nr.	Llog	Emërtimi mallra e sherbime te tjera	Plani	Fakti	%
1	602	Kancelari per vitin ushtrimor	649.200	649.200,00	100%
2	602	Mat.për pastrim dhe shërb.	119.500	119.500,00	100%
3	602	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres.(Bojra)	267.960	267.960,00	100%
4	602	Energji per v.ushtrimor	2.631.000	2.630.939,00	100%
5	602	Uje per v.ushtrimor	154.000	153.940,00	100%
6	602	Telefon,internet per v.ushtrimor	82.000	81.232,00	99%
7	602	Posta	120.000	119.725,00	100%
8	602	Sherbime te Tjera(NJ.M prok.)	29.600	29.600,00	100%
9	602	Karburant dhe vaj	1.200.000	1.199.980,00	100%
10	602	Mirëmb.e mjeteve transp.	667.000	666.984,00	100%
11	602	Kosto e sigur.mjeteve transp.	90.781	90.781,00	100%
12	602	Shpenz te tjera te mjeteve transp.(taksa, kolaudim)	20.000	19.950,00	100%
13	602	Udhëtim I brënd	2.436.811	2.355.160,00	97%
14	602	Udhëtim I jasht.	430.000	429.658,00	100%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

15	602	Udhëtim I jasht.(bileta avioni)	170.000	161.002,00	95%
16	602	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike(ËEBGIS)	270.000	270.000,00	100%
17	602	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve kompjuterike	885.857	885.857,00	100%
18	602	Shpenzime per mirembajtjen e mobiljeve te zyrave (riparim karrige)	100.000	99.780,00	100%
20	602	Shpenzime per honorare	4.000	2.308,00	58%
21	602	Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga institucioni.	15.000	15.000,00	100%
22	602	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	65.000	64.980,00	100%
		Totali	10.407.709	10.313.536	99%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se, të gjithë zërat e shpenzimeve janë realizuar në masën 99 %. Peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve e sërisht e zënë zërat dieta dhe zëri shpenzime energjie ndërkohë që shpenzimet etjera janë në trendin e tyre të zakonshëm. Në krahasim me vitin 2018 shpenzimet për dieta janë ulur në përqindje me gati me 50 % dhe kanë renë në situatën e tyre të zakonshme.

Si konkluzion Nga auditimi i Planifikimit të buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar konstatohet se;

Në bazë të PBA për cdo vit si dhe realizimit të buxhetit të cilat po auditohen nga ana jonë, konstatohet se fondet në dispozicion të IMK janë kryesisht në zërin shpenzime personeli, mallra dhe shërbime si dhe Artikulli 604 Projekte në fushën e trashëgimisë. Të tre këto zëra përbëjnë buxhetin e IMK, i cili si institucion varësie i Ministrisë së Kulturës, kushtëzohet nga tavanet e limituara që i vendos kjo Ministri. Pra praktikisht IMK nuk përgatit PBA të orientuara drejt nevojave reale të Institucionit. Lidhur me projektet e trashëgimisë kulturore, pavarësisht se në KKR miratohen shumë projekte dhe domosdoshmëria e restaurimit të tyre është e lartë, përgjithsisht ato mbeten në letër të përealizuara. Kështu për vitin 2017 nuk ka pasur investime për restaurim, përjashtim ben viti 2018 në kuadër të “vitit të S.” që IMK ka realizuar 9 projekte në vlerën total 125,393,484 lekë, si dhe viti 2019 një projekt në vlerën 29,216,828 lekë për shak të emergjencës së tërmetit në zonën e Korçës.

Nga auditimi konstatohet se projekt buxhetet e hartuara dhe zbatuara nuk janë në korelacion të drejtë me nevojat reale të Institucionit, për përmbushjen e objektivave dhe detyrave themelore të tij. Buxhetet e mësipërme përmbushin nevojat elementare të funksionimit të institucionit, por jo përmbushjen e veprimtarisë së tij. PBA e hartuara janë thjesht një parashikim minimal në përputhje me tavanet e vendosura nga Ministria e Kulturës.

Kështu nga auditimi konstatohet se vetë IMK harton dhe miraton projekte në fushën e trashëgimisë kulturore mesatarisht në vit 60-70 pa përfshirë Drejtoritë Rajonale të cilat pothuajse nuk realizohen, përjashtuar projektet e inicuar nga investitorë jashtë fondeve buhetore.

Përpunimi i projekteve kryhet me teknika të cilat nuk mbështeten nga një infrastrukturë IT moderne e cila do kursente kohë, energji dhe përmirësonte cilësinë e tyre.

Drejtimi 1: Titulli i Gjetjes 1

Mungesë planifikimit të buxhetit, në përputhje me nevojat dhe objektivat themelore të IKTK-s



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Situata:	<p>Në bazë të PBA për cdo vit si dhe realizimit të buxhetit të cilat po auditohen nga ana jonë, konstatohet se fondet në dispozicion të IMK janë kryesisht në zërin shpenzime personeli, mallra dhe shërbime si dhe Artikulli 604 Projekte në fushën e trashëgimisë. Të tre këto zëra përbëjnë buxhetin e IMK, i cili si institucion varësie i M së K, kushtëzohet nga tavanet e limituara që i vendos kjo Ministri. Pra praktikisht IMK nuk pregatit PBA të orientuara drejt nevojave reale të Institucionit. Lidhur me projektet e trashëgimisë kulturore, pavarësisht se në KKR miratohen shumë projekte dhe domosdoshmëria e restaurimit të tyre është e lartë, përgjithsisht ato mbeten në letër të parealizuara. Kështu për vitin 2017 nuk ka pasur investime për restaurim, përjashtim ben viti 2018 në kuadër të “vitit të Skëbderbeut” që IMK ka realizuar 9 projekte në vlerën total 125,393,484 lekë. Si dhe viti 2019 një projekt në vlerën 29,216,828 lekë për shak të emergjencës së tërmetit në zonën e Korcës.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se projekt buxhetet e hartuara dhe zbatuara nuk janë në korelacion të drejtë me nevojat reale të Institucionit, për përmbushjen e objektivave dhe detyrave themelore të tij. Buxhetet e mësipërme përmbushin nevojat elementare të funksionimit të institucionit, por jo përmbushjen e veprimtarisë së tij. PBA e hartuara janë thjesht një parashikim minimal në përputhje me tavanet e vendosura nga Ministria e Kulturës.</p> <p>Kështu nga auditimi konstatohet se vetë IMK harton dhe miraton projekte në fushën e trashëgimisë kulturore mesatarisht në vit 60-70 pa përfshirë Drejtoritë Rajonale të cilat pothuajse nuk realizohen, përjashtuar projektet e inicuar nga investitorë jashtë fondeve buhetore.</p> <p>Përpunimi i projektve kryhet me teknika të cilat nuk mbështeten nga një infrastrukturë IT moderne e cila do kursente kohë, energji dhe përmirësonte cilësinë pamore të tyre.</p>
Kriteri :	“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve për buxhetet vjetore(2017-2018-2019) dhe Udhëzimet plotësuese për përgatitjen e buxhetit të shtetit
Ndikimi/Efekti	Ulje e efektivitetit të njësisë publike në zbatimin e objektivave themelore të veprimtarisë së saj
Shkaku:	Vendosja e tavanëve të hartimit nga MK jo në përputhje me nevojat e IKTK-s si institucion varësie i saj
Rëndësia	E lartë

2: ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE:

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Në zbatim të këtij drejtimi nga ana e grupit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhër i Kryeministrit nr. 14 datë 22.01.2014 “Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Monumenteve të Kulturës, G. S. dhe DRKK”;

-Urdhër i Kryeministrit nr. 114 datë 22.01.2014 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.14 datë 22.01.2014, Për miratimin e Strukturës dhe të organikës së Institutit të Monumenteve të Kulturës G. S. dhe DRKK”;

-Urdhër i Kryeministrit nr. 137 datë 21.10.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së ITKT”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

-Urdhër i Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017, “Për miratimin e statutit të Institutit të Monumenteve të Kulturës G. S”;

-VKM nr. 364 datë 29.05.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së ITKT”.

-Statuti i Institutit të Monumenteve të Kulturës “G. S” miratuar me Urdhërin e Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017.

-Rregullore e Brendshme e Institucionit miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 128 datë 24.01.2017.

-Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.

❖ **Struktura e institucionit për periudhën nën auditim 01.01.2017 - 31.12.2019**

Për periudhën Janar 2017 - Korrik 2018 institucioni ka operuar sipas strukturës së miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 14 datë 22.01.2014 ku parashikohen 6 sektorë me një numër prej 42 punonjësish.

Në vijim me Urdhërin e Kryeministrit nr. 114 datë 31.07.2018 janë kryer ndryshime në strukturë ku numri gjithsej i personelit pas këtij ndryshimi mbetet 41 punonjës. Zvogëlim ka pësuar numri i punonjësve në Sektorin e financës dhe shërbimeve mbështetëse nga 10 punonjës është bërë 9 të tillë si dhe janë rikategorizuar nivelet e pagave.

Më tej struktura ka ndryshuar sërisht sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 137 datë 21.10.2019, pas shkrirjes së dy institucioneve, (ASHA) dhe (IMK) dhe formimit (IKTK), kjo sipas VKM nr. 364 datë 29.05.2019, botuar në F. Z nr. 80 viti 2019. Pas këtyre ndryshimeve struktura organizohet në 2 (dy) drejtori dhe 10 (dhjetë) sektorë me një personel prej 58 punonjës gjithsej.

Ndryshimet strukturore janë shoqëruar gjithashtu edhe me ndryshime në kategorizimin e pagave të cilat i paraqesim më poshtë:

	IKTK Struktura sipas Urdhrit nr 137 datë 21.10.2019	IMK Struktura sipas Urdhrit nr 114 datë 31.07.2018	IMK Struktura sipas Urdhrit nr 14 datë 22.01.2014
Emërtimi	Kategoria e pagës	Kategoria e pagës	Kategoria e pagës
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	II-b	II-b
Drejtor Drejtorie	III-a		
Përgjegjës Sektori	III-a/1, III-b	III-a/1	III-a/1
Specialist	IV-a, IV-b	IV-a, IV-b	IV-a, IV-b
Numri i punonjësve Funks. mbështetës	11	7	7
Numri gjithsej i punonjësve	58	41	42

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit

Për funksionet bazë në llogaritjen e pagave janë ndjekur përcaktimet në VKM nr. 187 datë 08.03.2017, i ndryshuar, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve,, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” me ndryshimet e fundit të strukturës të vitit 2019, ndryshuar me VKM nr. 549, datë 31.7.2019 sipas të cilit janë miratuar kategoritë e reja të pagave për institucionin e ri të krijuar IKTK, nga bashkimi i IMK dhe ASHA.

Për funksionet mbështetëse për llogaritjen e pagës janë ndjekur përcaktimet në VKM nr. 717 datë 23.06.2009, i ndryshuar, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”.

Më poshtë paraqesim pozicionet e punës për punonjësit mbështetës në strukturën e re të miratuar për IKTK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Emërtimi i pozicionit "Punonjës Mbështetës" në structure	Numri i punonjësve
Protokollist/Arkivist	1
Magazinjier Teknik i mesëm	1
Shofer	2
Nëpunës informacioni	1
Roje	1
Punonjës pastrami	3
Punonjës mirëmbajtje	2
Gjithsej	11

Sa më lartë vihet re se, IKTK e cila aktualisht përfshin dy institucionet e ristrukturuara (IMK dhe ASHA) gjendet në ambientet e godinës së Ministrinë e Kulturës, në strukturën e saj ka të përfshirë në funksionet mbështetëse 11 nga 58 punonjës pra rreth 20% të personelit gjithsej. Përfshirja në strukturë e një numri të lartë pozicionesh si roje, punonjës pastrimi, punonjës mirëmbajtje, nëpunës informacioni më vete, veç atyre të Ministrisë së Kulturës e cila ndodhet po në të njëjtën godinë, nuk paraqet skenarin më të mirë për menaxhimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike. Me një qasje më të kujdesshme nga ana e instancave përkatëse gjatë procesit të ristrukturimit rreth ½ e këtyre pozicioneve pune mund të të konvertoheshin në funksionet bazë çka dhe është objektivi kryesor i institucionit.

Fondi i pagave dhe kontributeve Viti 2017

Fondi i pagave dhe kontributeve për vitin 2017 është planifikuar gjithsej në shumën 37,234,404 lekë. Kjo sipas shkresës për çeljen buxhetore nga Ministria e Kulturës regjistruar në IMK me nr. 156 prot, datë 26.01.2017 dhe ndryshimeve buxhetore të ndodhura me shkresat nr. 846 prot, datë 09.05.2017 dhe nr. 1785 prot, datë 24.10.2017.

Realizimi i fondit për këtë periudhë paraqitet në shumën 36,122,525 lekë ose 97% e planit të rishikuar.

Artikulli	Emërtimi	Plani Vjetor	Fakti progresiv
600	Pagat	31,910,934	30,950,861
6001000	Pagat bazë		30,811,031
6002900	Personel i përkohshëm		139,830
601	Sigurime Shoqërore	5,323,470	5,171,664
6010100	Kontribut për pension		4,644,993
6011100	Kontribut shëndetësor		526,671
	Gjithsej llog. 600 + 601	37,234,404	36,122,525

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit

Fondi i pagave referuar planifikimit dhe ndryshimeve në të për vitin 2017 zë rreth 72% të shpenzimeve vjetore të planifikuara të institucionit ku fondi i pagave është parashikuar për (42+1) punonjës referuar strukturë së miratuar. Në terma faktikë zëri paga dhe kontribute zë gjithashtu rreth 72 % të shpenzimeve gjithsej të realizuara prej institucionit, për të njëjtin numër personeli.

Ndryshimet e personelit referuar deklaratimit sipas formularit E.-027/A paraqitet për periudhën si më poshtë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Numri	Periudha	Data e deklarimit	Punonjësit e Shtuar	Punonjësit e Larguar
57	2017 Dhjetor (1712)	04.01.2018	0	1
56	2017 Dhjetor (1712)	01.12.2017	1	0
55	2017 Gusht (1708)	22.08.2017	0	1
54	2017 Gusht (1708)	14.08.2017	1	0
53	2017 Gusht (1708)	11.08.2017	0	1
52	2017 Gusht (1708)	02.08.2017	1	0
51	2017 Qershor (1706)	28.06.2017	1	0
50	2017 Maj (1705)	01.06.2017	0	1
49	2017 Maj (1705)	19.05.2017	1	0
48	2017 Maj (1705)	03.05.2017	1	0
47	2017 Shkurt (1702)	21.02.2017	1	0
46	2017 Shkurt (1702)	08.02.2017	0	1
45	2017 Janar (1701)	26.01.2017	0	1
			7	6

Viti 2018

Fondi i pagave dhe kontributeve për vitin 2018 është planifikuar gjithsej në shumën 39,203,500 lekë. Kjo sipas shkresës për çeljen buxhetore nga Ministria e Kulturës regjistruar në IMK me nr. 175 prot, datë 29.01.2018 dhe ndryshimeve buxhetore të ndodhura me shkresat nr. 1819 prot, datë 29.08.2018, nr. 2217 prot, datë 29.10.2018 dhe nr. 2442 prot, datë 26.11.2018.

Realizimi i fondit për këtë periudhë paraqitet në shumën 38,553,763 lekë ose 98.3% e planit të rishikuar.

Artikulli	Emërtimi	Plani Vjetor	Fakti progresiv
600	Pagat	33,661,098	33,048,052
6001000	Pagat bazë		33,048,052
6003000	Fondi veçantë		
601	Sigurime Shoqërore	5,542,402	5,505,711
6010100	Kontribut për pension		4,943,522
6011100	Kontribut shëndetësor		562,189
	Gjithse 600 +601	39,203,500	38,553,763

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit

Fondi i pagave referuar planifikimit dhe ndryshimeve në të për vitin 2018 zë rreth 22% të shpenzimeve vjetore të planifikuara të institucionit ku fondi i pagave është parashikuar për 41 punonjës referuar strukturë së miratuar. Në terma faktikë zëri paga dhe kontribute zë rreth 21 % të shpenzimeve gjithsej të realizuara prej institucionit, kjo për një personel prej 39 punonjësish.

Ndryshimet e personelit referuar deklarimit sipas formularit Esig-027/A paraqitet për periudhën si më poshtë.

Numri	Periudha	Data e deklarimit	Punonjësit e Shtuar	Punonjësit e Larguar
70	2018 Dhjetor (1812)	03.12.2018	0	1
69	2018 Tetor (1810)	01.10.2018	0	1
68	2018 Tetor (1810)	26.09.2018	1	0
67	2018 Shtator (1809)	20.09.2018	0	1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

66	2018 Shtator (1809)	20.09.2018	0	1
65	2018 Shtator (1809)	06.09.2018	0	1
64	2018 Shtator (1809)	31.08.2018	1	0
63	2018 Korrik (1807)	01.08.2018	0	1
62	2018 Qershor (1806)	12.06.2018	1	0
61	2018 Maj (1805)	05.05.2018	0	1
60	2018 Prill (1804)	10.04.2018	0	1
59	2018 Shkurt (1802)	29.01.2018	1	0
58	2018 Janar (1801)	08.01.2018	1	0
			5	8

Viti 2019

Pas ndryshimeve strukturore të parashikuara nga VKM nr. 364 datë 29.05.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së IKTK”, dhe bashkimit të dy institucioneve, Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” dhe Agjencisë së Shërbimeve Arkeologjike, ndryshimet janë pasuar edhe në llogaritë përkatëse në thesar ku prej muajit Nëntor 2019 institucioni i ri ka ndryshuar kodin buxhetor të IMK nga ai me nr.1012060 në kodin e ri të IKTK nr.1012101.

Fondi i pagave dhe kontributeve për vitin 2019 është planifikuar gjithsej në shumën 31,929,082 lekë. Kjo sipas shkresës për çeljen buxhetore nga Ministria e Kulturës regjistruar në IMK me nr. 110 prot, datë 17.01.2019 dhe ndryshimeve buxhetore të ndodhura me shkresat nr. 1692 prot, datë 08.08.2019, nr. 1865 prot, datë 12.09.2019, nr. 2111 prot, datë 16.10.2019 dhe nr. 2478 prot, datë 02.12.2019, nr. 2153/3 prot, datë 11.12.2019 dhe nr. 18 prot, datë 27.12.2019.

Kodi: 1012060

Artikulli	Emërtimi	Plani Vjetor	Fakti progresiv
600	Pagat	31,929,082	31,929,082
6001000	Pagat bazë		31,929,082
6002900	Personel i përkohshëm		
601	Sigurime Shoqërore	5,325,214	5,325,214
6010100	Kontribut për pension		4,782,410
6011100	Kontribut shendetësor		542,804
Gjithsej llog. 600 + 601		37,254,296	37,254,296

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit

Kodi: 1012101

Artikulli	Emërtimi	Plani Vjetor	Fakti progresiv
600	Pagat	190,715	0
6001000	Pagat bazë	190,715	
6002900	Personel i përkohshëm		
601	Sigurime Shoqërore	33,080	0
6010100	Kontribut për pension	33,080	
6011100	Kontribut shendetësor		
Gjithsej llog. 600 + 601		223,795	0

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Realizimi i fondit për këtë periudhë paraqitet ne masën 100 % e planit të rishkuar. Fondi i pagave referuar planifikimit dhe ndryshimeve në të për vitin 2019 zë rreth 77 % të shpenzimeve vjetore të planifikuara të institucionit.

Ndryshimet e personelit referuar deklaramit sipas formularit E.-027/A paraqitet për periudhën si më poshtë.

Numri	Periudha	Data e deklaramit	Punonjësit e Shtuar	Punonjësit e Larguar
78	2019 Dhjetor (1912)	12.12.2019	1	0
77	2019 Dhjetor (1912)	11.12.2019	1	0
76	2019 Dhjetor (1912)	09.12.2019	1	0
75	2019 Dhjetor (1912)	04.12.2019	12	0
74	2019 Gusht (1908)	02.08.2019	0	1
73	2019 Mars (1903)	25.03.2019	1	0
72	2019 Mars (1903)	25.03.2019	2	0
71	2019 Mars (1903)	06.03.2019	1	0
			19	1

Shtimi i numrit të punonjësve kryesisht gjatë muajit Dhjetor 2019 ka të bëjë me procesin e ristrukturimit pas shkrirjes së dy institucioneve, (ASHA) dhe (IMK) dhe formimit (IKTK), kjo sipas VKM nr. 364 datë 29.05.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 80 viti 2019. Pas këtyre ndryshimeve struktura organizohet me një personel prej 58 punonjës gjithsej.

-U audituan me zgjedhje rastësore një grup prej 13 dosje të personelit lidhur me plotësinë e tyre sa i përket dokumentacionit të detyrueshëm dhe rezultoi se, përgjithësisht dosjet mbaheshin në mënyrë të organizuar, ato përmbanin dokumentacione të parashikuara në VKM nr. 117 datë 05.03.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". Dokumentacioni paraqitej në formë origjinal ose në kopje të njehsuara me të. Dosjet dispononin fletën e inventarit të nënshkruar nga punonjësi dhe drejtuesi i personelit. Mangësi në to evidentohet formulari i performancës së punonjësve për vitin 2019 i cili mungonte në të gjitha dosjet, ndonëse ky është një detyrim i përcaktuar në nenin 19 të Rregullores së Brendshme të institucionit miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të IMK nr.128 datë 24.01.2017.

❖ **Mbi ristrukturimin dhe riorganizimin e kryer**

Mbi bazën e të dhënave të marra nga auditimi paralel i kryer nga KLSH pranë Ministrisë së Kulturës mbi procedurat e ndjekura nga komisioni i ngarkuar për ristrukturimin e IMK dhe ASHA në përputhje me VKM nr. 364 datë 29.05.2019, rezulton si më poshtë vijon:

Me Urdhrin e Ministrit nr. 629 datë 29.10.2019 është ngritur komisioni për mbikëqyrjen e procesit të ristrukturimit në të cilin janë caktuar 5 anëtarë, i cili drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm.

Me shkresën nr. 6407 prot, datë 29.10.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë znj. E Ç i është drejtuar IMK ku i kërkon drejtuesit të institucionit informimin e punonjësve mbi ndryshimet dhe zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në vendim mbi krijimin e komisionit me urdhër të përbashkët për realizimin e ristrukturimit, si dhe çështje të tjera organizative. Me shkresën nr. 6466 prot, datë 31.10.2019 dhe të njëjtën përmbajtje është njoftuar edhe ASHA mbi këtë proces.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Nga komisioni janë mbajtur procesverbalet datë 31.10.2019, 04.11.2019, 07.11.2019 mes anëtarëve të komisionit me drejtuesit e institucioneve të prekur nga ristrukturimi, IMK dhe ASHA të cilët janë dhe anëtar të tij.

Me vendimin nr. 659/1 prot datë 08.11.2019 komisioni ka vendosur që ri-sistemimi të kryhet bazuar në ruajtjen e pozicioneve të së njëjtës kategori për pagat dhe përputhshmërinë e kriterëve të përgjithshme të punës së punonjësve ekzistues.

Me Urdhrin e Ministrit nr. 6673 prot, datë 11.11.2019 “Për lirim dhe emërim në detyrë” znj. A D është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i IKTK, i përcjellë me shkresën nr. 6673/1 prot, datë 11.11.2019.

Në vijim, në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të IKTK, me shkresën nr. 2495 prot, datë 03.12.2019 znj. D. ka përcjell për zbatim pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse strukturën organike për secilin pozicion pune. Në këtë shkresë të hartuar nuk përfshihet asnjë bazë administrative/ligjore ku mbështetet kjo vendimmarrje, pasi VKM nr. 364, në pjesën e IV “Dispozita Kalimtare” pika 2 e tij përcakton se,

2. Drejtuesit e institucioneve aktuale që ristrukturohen në funksion të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore”, me urdhër të përbashkët, krijojnë një komision për realizimin e procesit të ristrukturimit dhe të riorganizimit të punonjësve aktualë të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe A. Sh A, sipas strukturës dhe organikës së re. Ky proces udhëhiqet nga drejtues të lartë të M. së K, nën mbikëqyrjen e ministrit të Kulturës.

Sa më lartë rezultoi se, nuk është ngritur komisioni i parashikuar në VKM nr. 364, lidhur me pozicionimin e punonjësve të dy institucioneve, por ky proces është ndjekur i njëanshëm, vetëm nga Drejtori i ri i IKTK dhe jo nga komisioni i përbashkët midis dy institucioneve në kundërshtim me përcaktimet në vendim. Po kështu në urdhrat e emërimit individualë për punonjësit të firmosur nga titullari nuk pasqyrohet shkresa cituar më sipër e cila detyronte Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e organikës, çka tregon për veprime të cinguara në përmbylljen e këtij procesi. Mangësitë e mësipërme nuk rezultojnë të jenë evidentuar e më pas korrigjuar prej komisionit të posaçëm për mbikëqyrjen e procesit të ristrukturimit dhe riorganizimit.

❖ Marrëdhëniet juridike të punës

Për periudhën nën auditim Janar 2017 - Dhjetor 2019, veprimtaria administrative e institucionit është bazuar në Statutin e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017. Në këtë statut përcaktohen veç të tjerash dhe marrëdhëniet e punësimit dhe posaçërisht në nenet, 11/f dhe nenin 14 të tij.

Referuar nenit 11/f të statutit përcaktohet qartë se Drejtori i IMK ka kompetencën për emërimin dhe shkarkimin e punonjësve të IMK në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit. Rregullorja rezulton e miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 128 datë 24.01.2017 dhe në Kreun II të saj përkatësisht nenet 9 deri 11 të saj si dhe pikën 14 të nenit 12 ku përcaktohet procedura që duhet të ndiqet për punësimin dhe lëvizjet brenda strukturës.

Punësimi në institucion kryhet me kontratë individuale pune në duke u mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës. Institucioni operon me dy tipe kontratash, kontrata individuale me afat të pacaktuar si dhe kohëzgjatje të caktuar, kjo sipas kërkesave institucionale. Po kështu IMK ka lidhur kontratë vjetore me kohë të pjesëshme për punonjësit e miratuar nga VKM-ja vjetore “Për përcaktimin e numrit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin në njësitë e qeverisjes qendrore” për periudhë vjetore.

❖ **Mbi procedurat e emërimit në institucion gjatë periudhës nën auditim**

Gjatë periudhës nën auditim janë kryer 31 emërime të cilat janë pasuar me lidhje kontrate pune nga të cilat:

-02 kontrata njëvjeçare janë lidhur me studentët e ekselencës të cilët janë përzgjedhur nga DAP sipas përcaktimeve referuar VKM nr. 812 datë 26.12.2018;

-12 kontrata janë kontrata të lidhura me punonjësit e ASHA si rrjedhojë e riorganizimit të kryer;

-02 emërime janë për Drejtorin të kryera nga Ministri i Kulturës dhe në

-15 raste janë emërime të vet institucionit;

Nga auditimi rezultoi se, në të gjitha rastet e procedurave të rekrutimit nuk rezulton të jetë dërguar njoftim për shpalljen e vendeve vakantë në institucion dhe botim në buletin e njoftimeve të APP. Njoftimet nuk rezultojnë të publikuara as në portalin e institucionit, çka tregon për një proces rekrutimi të tërësisht të mbyllur dhe me mungesë transparence. Rregullisht institucioni duhet të dërgonte pranë APP njoftimin përkatës dhe të zhvillonte procedurat e rregullta të konkurimit mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, gjë e cila nuk rezulton. Mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr. 176, datë 29.3.2006 “Për Botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike” pika 1 dhe 2 e tij.

1. Botimi i njoftimeve publike të bëhet në "Buletini i njoftimeve publike", një buletin periodik, që botohet nga Agjencia e Prokurimit Publik, çdo 5 ditë.

Në

"Buletini i njoftimeve publike" të botohen, pa përjashtim, njoftimet publike, të përcaktuara në pikën 3.i të këtij vendimi, si dhe çdo njoftim tjetër i Këshillit të Ministrave, ministrive, prefektëve, institucioneve qendrore në varësi të tyre, shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror dhe organizatave jofitimprurëse, të krijuara dhe të financuara nga shteti. Në buletin të botohen edhe njoftime të shkollave të larta publike.

2. Në

njoftimet publike përfshihet çdo komunikim drejtuar publikut të gjerë apo një grupi të caktuar shoqëror, profesional apo tregtar ekonomik, i cili përmban të dhëna nga institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, për nevoja, kërkesa a oferta dhe që nuk përbëjnë lajm.

❖ **Vendimet gjyqësore për largime të padrejta nga puna**

Për periudhën nën auditim u kërkuan dhe u paraqitën nga institucioni treguesit e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të cilët paraqiten si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Periudha viti 2017

Nr	Institucioni	Padiçesi	Zyra Përmbarimore	Vendimi gjyqësor i apelit		Permbajtja e Vendimit Demshperblimi ne paga etj.	Detyrimi në total	Detyrime shlyer IMK me 2016	Detyrime shlyer IMK me 2017	Detyrime shlyer Ministria e Kultures me	Rekurs nr. date
				Nr. vendimit	Data e vendimit						Po / jo / nese jo arsyet
											Rekurs nr.2011/1 dt. 29.12.2016 nga IMK
TOTALI							5,857,502	502,000	3,615,555	1,739,947	

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit

Gjatë vitit 2017 sipas vendimeve të gjykatave institucioni në të tre rastet është penalizuar në vlerën 2,639,812 lekë. Gjatë këtij viti janë paguar dhe fatura financiare të tre vendimeve të formës së prerë të shpalluar nga gjykatat gjatë vitit 2016. Këto çështje përfaqësojnë padi për largime të padrejta nga puna, të cilat në të gjitha rastet janë fituar nga punonjësit e larguar. Vlera financiare e paguar për këto vendime paraqitet **5,355,502 lekë** [3,615,555+1,739,947].

Periudha vitet 2018-2019

Nr	Institucioni	Padiçesi	Zyra Përmbarimore	Vendimi gjyqësor i apelit		Permbajtja e Vendimit Demshperblimi ne paga etj.	Detyrimi në total	Detyrime shlyer IMK me 2018	Detyrime shlyer IMK me 2019	Rekurs nr. date
				Nr. vendimit	Data e vendimit					Po / jo / nese jo
TOTALI							1,295,885	712,000	583,885	

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitet 2018 dhe 2019 rezulton vetëm një vendim gjyqësor i formës së prerë dhe është zbatuar prej institucionit. Vlera financiare e paguar për këto vendime paraqitet **1,295,885 lekë**.

Vendime në proces:

Nr	Institucioni	Padiçesi	Vendimi gjyqësor i Shkalla e I-rë	Vendimi gjyqësor i apelit		Permbajtja e Vendimit Demshperblimi ne paga etj.	Detyrimi në total sipas vendimit	Ankim
			Nr. / data	Nr. vendimit	Data e vendimit			Po / jo / nese jo arsyet

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Aktualisht, veç rekurseve të bëra për vendimet e cituara më lartë për periudhat vitet 2016-2019, institucioni ndodhet në proces edhe për një tjetër çështje gjyqësore, paraqitur në tabelën më sipër.

Largimet e padrejta i përkasin në një rast vitit 2013 dhe në gjithë rastet e tjera vitit 2014.

- ✓ Gjithsej vlera financiare e paguar si rrjedhojë e veprimeve të padrejta të administrative ka rënduar financat publike për vitet 2017-2019 në shumën **6,651,387 lekë**.

Emërimi i drejtuesit të institucionit

-Drejtues i institucionit për periudhën nën auditim është Znj. A. D, e cila ka filluar në këtë detyrë sipas Urdhrit të Ministrit i cili mban nr. 243 datë 21.10.2013 “Emërim i përkohshëm deri në përfundim të procedurave të konkurimit”.

-Në vijim, me urdhrin nr.263 datë 07.11.2013 është kryer emërimi në përfundim të konkursit.

-Me shkresën e DAP nr. 7696/3 prot. datë 23.12.2016 znj. D është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë Kulturore në Ministrinë e Kulturës.

Me urdhrin nr. 413/1 datë 30.12.2016 të Ministrit të Kulturës znj. M. K. F me objekt, “Për lirim nga detyra e Drejtorit të Institutit të Monumenteve të Kulturës G. S”, regjistruar pranë IMK me nr. 130 prot, datë 24.01.2017 është urdhëruar lrimi nga detyra i znj. A. D, drejtor i këtij institucioni.

Me urdhrin nr. 413 datë 30.12.2016 të Ministrit të Kulturës znj. M. K. F me objekt, “Për delegim kompetence për mbikëqyrjen e veprimtarisë administrative të Institutit të Monumenteve të Kulturës G. S”, regjistruar pranë IMK me nr. 130/1 prot, datë 24.01.2017 është urdhëruar delegimi i kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm të IMK për znj. A.D e cila sipas shkresës së DAP ishte emëruar në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës.

Çregjistrimi i znj. D nga regjistri i punëmarrësve të IMK është kryer me formularin E./027-A, nr. 45 datë 26.01.2017 me datë ndërprerje të marrëdhënieve të punës data 24.01.2017, ndërkohë që dy urdhrat e Ministrit kanë hyrë në fuqi më datë 30.12.2016, pra me rreth 25 ditë më vonë. Kjo si pasojë e vonesave në përcjelljen e urdhrave nga Ministria e Kulturës në IMK, ndërkohë që dy institucionet ndodhen nën të njëjtën godinë. Për periudhën 25 ditore nëreflektimit urdhër shpenzime janë kaluar vetëm shpenzimet e pagave, kontributeve energji, shpenzime postare, taksa makinash dhe disa shpenzime të tjera në vlera të vogla.

Në muajin Nëntor 2017, znj. M. K. F, Ministër, me urdhrin nr. 737 datë 15.11.2017, ka emëruar znj. A.D në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të IMK duke shfuqizuar urdhrin e mëparshëm mbi delegimin e kompetencave nr. 413/1 datë 30.12.2016. Vendimmarrja është arsyetuar me domosdoshmërinë e emërimit në vlerësim të eksperiencës dhe profesionalizmit.

Lidhur sa më lartë evidentohet se, rikthimi i znj. D e cila ishte larguar nga ky institucion për rreth 11 muaj dhe ri-emërimi i saj në pozicionin e drejtuesit të institucionit të IMK nuk rezulton të jetë kryer nëpërmjet një procesi të hapur dhe publik në të cilin përcaktoheshin kriteret e vendit të punës për përfshirjen e kandidatëve në garë. Po kështu procesi i përzgjedhjes përbën një hap mbrapa me mënyrën e përzgjedhjes të ndjekur në muajin Nëntor 2013. Mënyra e përzgjedhjes dhe procedura e muajit Nëntor 2017 bie ndesh me përcaktimet e VKM nr.173, date 07.03.2003 “Për emërimin, lirim ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit” pika 1, 2 dhe 4 e tij ku përcaktohet se:

1. Drejtuesit e institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra, përkatësisht nga Kryeministri ose ministri



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

përkatës, ne rast se dispozita te tjera, te veçanta, ligjore dhe nënligjore, nuk parashikojnë ndryshe.

2. Emërimi i drejtuesve te institucioneve te treguara ne piken 1 behet sipas kërkesave dhe procedurave te mëposhtme:

- Kryeministri ose ministri përkatës urdhërojnë, te paktën 15 dite përpara datës se emërimit, shpalljen ne media te vendit te lire.

- Kandidatet e paraqitur, krahas kërkesave te përgjithshme për t'u punësuar ne shërbimin civil, sipas nenit 12 te ligjit nr. 2549, date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", duhet te plotësojnë edhe kërkesat e veçanta, te cilat jepen ne shpalljen ne media te vendit te lire.

- Kryeministri ose ministri përkatës përzgjedh dhe emëron njëzën nga kandidaturat e paraqitura qe plotëson kërkesat e mësipërme.

4. Kur ne dispozita te tjera, te veçanta, ligjore dhe nënligjore, është përcaktuar organi i emërtesës për drejtuesit e institucioneve, ne varësi te Këshillit te Ministrave, Kryeministrit ose te ministrit, por nuk përcaktohen kërkesat dhe procedurat për emërimin, lirimn ose shkarkimin e tyre, ne këto raste zbatohen pikat 2 dhe 3 te këtij vendimi.

✓ Pavarësisht kualifikimit dhe profesionalizmit të znj. D, organi i cili ka kryer emërimin duhet të kryente një procedurë përzgjedhëse transparente dhe objektive pa cënuar detyrimin i cili rrjedh nga VKM e sipërcituar.

❖ Nga auditimi mbi aktet nënligjore mbi të cilat është bazuar veprimtaria institucionale rezultoi se, hartimi i rregullores së brendshme është bërë nga IMK dhe miratimi është bërë nga Drejtuesi i saj. Ky akt është mbështetur në nenin 11 pika 3 të Statutit të IMK miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017.

Pavarësisht mbështetjes në dispozitat e statutit, miratimi nga vet institucioni i rregullores së brendshme të funksionimit nuk gjendej në përputhje përcaktimet e Ligjit nr. Nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” pika 2 e tij përcakton se;

2. Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.

Pra për periudhën nën auditim, hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale është kryer nga vet institucioni çka ka ndikuar ose mund të ketë ndikuar në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës zyrtare referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9131, date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” por jo vetëm.

-Deri në hartimin e këtij materiali auditimi institucioni nuk disponon ende Statutin dhe Rregulloren e re, të cilët megjithëse janë hartuar prej IKTK dhe dërguar në Ministrinë e Kulturës me shkresën nr. 142 datë 17.01.2019 nuk janë miratuar ende prej saj, vonesë e cila veç aspekteve ligjore ngre pikëpyetje për vet projektin e këtij ristrukturimi.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Problematikat e trajtuara më sipër kanë ekspozuar njësinë publike drejt riskut në përmbushjen e detyrimeve institucionale lidhur me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së saj.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Mangësi në ndërtimin e strukturës institucionale të IKTK.
Situata:	-IKTK aktualisht përfshin dy institucionet e ristrukturuara (IMK dhe ASHA)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

	<p>gjendet në ambientet e godinës së Ministrinë e Kulturës, në strukturën e saj ka të përfshirë në funksionet mbështetëse 11 nga 58 punonjës pra rreth 20% të personelit gjithsej. Përfshirja në strukturë e një numri të lartë pozicionesh si roje, punonjës pastrimi, punonjës mirëmbajtje, nëpunës informacioni më vete, veç atyre të Ministrisë së Kulturës e cila ndodhet po në të njëjtën godinë, nuk paraqet skenarin më të mirë për menaxhimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike. Me një qasje më të kujdesshme nga ana e instancave përkatëse gjatë procesit të ristrukturimit rreth ½ e këtyre pozicioneve pune mund të të konvertoheshin në funksionet bazë çka dhe është dhe objektivi kryesor i institucionit.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në - Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 4 “Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor”, pika ç).</p> <p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Neni 8 pika 1 dhe neni 9 pika 1 e tij.</p>
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në përmbushjen e detyrimeve institucionale
Shkaku:	Mungesë e vëmendjes nga hallkat përgjegjëse mbi ristrukturimin.
Rëndësia:	E mesme

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Mungesë transparence në procesin e rekrutimit të punonjësve.
Situata:	<p>Nga auditimi rezultoi se, për periudhën nën auditim Janar 2017 - Dhjetor 2019 janë kryer rreth 15 emërimet nga ana e institucionit. Në të gjitha rastet për procedurat e ndjekura në rekrutimin e punonjësve nuk është dërguar njoftim për shpalljen e vendeve vakantë dhe botimin e shpalljes në buletin e njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Njoftimet nuk rezultojnë të publikuara as në portalin e institucionit, çka evidenton një proces rekrutimi plotësisht të mbyllur dhe me mungesë të theksuar transparence. Rregullisht institucioni duhet të dërgonte pranë APP njoftimin përkatës dhe të zhvillonte procedurat e rregullta të konkurimit mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, gjë e cila nuk rezulton. Mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr. 176, datë 29.3.2006 “Për Botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike” pika 1 dhe 2 e tij.</p>
Kriteri:	<p>- VKM nr. 176, datë 29.3.2006 “Për Botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike” pika 1 dhe 2 e tij.</p> <p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 2, neni 4 pika 9, neni 8 pika 1 dhe neni 9 pika 1 e tij.</p>
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në transparencën institucionale dhe cilësinë e burimeve njerëzore.
Shkaku:	Mospërmbushjen e detyrimeve mbi transparencën institucionale.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 3:	Mungesë transparence në procesin e rekrutimit të Drejtuesit të Institucionit.
Situata:	<p>Në muajin Nëntor 2017, me urdhrin nr. 737 datë 15.11.2017 Ministri i Kulturës, ka emëruar Drejtorin e Përgjithshëm të IMK si dhe ka shfuqizuar urdhrin mbi delegimin e kompetencave nr. 413/1 datë 30.12.2016. <u>Vendimmarrja për</u></p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

	<p>emërimin e drejtuesit të IMK është arsyetuar me domosdoshmërinë në vlerësim të eksperiencës dhe profesionalizmit. Rikthimi i drejtuesit sërish në rolin e drejtuesit të IMK, nga i cili ishte larguar për rreth 11 muaj më parë, dhe ri-emërimi në pozicionin e drejtuesit të IMK rezultojnë të jetë kryer në mungesë të një procesi të hapur dhe publik ku të përcaktoheshin kriteret e vendit të punës dhe të mundësonin përfshirjen e kandidatëve të tjerë në garë. <u>Procesi i përzgjedhjes përbën një hap mbrapa me mënyrën e përzgjedhjes me garë të ndjekur në muajin Nëntor 2013 në të cilin ishte përzgjedhur ky drejtues si dhe bie ndesh me përcaktimet e VKM nr.173, date 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Keshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit” pika 1, 2 dhe 4 e tij.</u></p>
Kriteri:	<p>- VKM nr.173, date 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Keshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit” pika 1, 2 dhe 4 e tij.</p> <p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 2, neni 4 pika 9, neni 8 pika 1 dhe neni 9 pika 1 e tij.</p>
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në transparencën institucionale dhe cilësinë e burimeve njerëzore.
Shkaku:	Mospërbushjen e detyrimeve mbi transparencën institucionale.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 4:	Problematika të akteve nënligjore mbi të cilën zhvillohet veprimtaria administrative.
Situata:	<p>Nga auditimi rezultoi se, Rregullja e Brendshme mbi të cilën është bazuar veprimtaria e IMK është hartuar nga vet institucioni ndërkohë që miratimi është bërë nga Drejtuesi i tij. Ky dokument është mbështetur në nenin 11 pika 3 të Statutit të IMK miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017. Pavarësisht referimit në dispozitat e statutit, miratimi i rregullores nga vet institucioni bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. Nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” pika 2 e tij. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale nga vet institucioni përbën në parim një “konflikt interesi” i cili ka ndikuar ose mund të ketë ndikuar edhe në paanshmërinë ose objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës zyrtare referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9131, date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” por jo vetëm.</p> <p>-Deri në hartimin e këtij materiali auditimi institucioni nuk disponon ende Statutin dhe Rregulloren e re referuar ndryshimeve të fundit ligjore, të cilët megjithëse janë hartuar prej IKTK dhe dërguar në Ministrinë e Kulturës me shkresën nr. 142 datë 17.01.2019, nuk janë miratuar ende prej saj, vonesë e cila veç aspekteve ligjore ngre pikëpyetje për vet projektin e ristrukturimit.</p>
Kriteri:	<p>- Ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” pika 2 e tij.</p> <p>- Ligjit nr. 9131, date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ i mundshëm në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës shtetërore.
Shkaku:	Dispozita të statutit të cilat bien ndesh me ligjet bazë mbi organizimin dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

	funksionimin e administrates shtetërore.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 5:	Largime të padrejta nga puna me ksoto në buxhetin e shtetit
Situata:	<p>Nga auditimi rezultoi se, për periudhën nën auditim Janar 2017-Dhjetor 2019 institucioni ka paguar për vendime gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të punonjësve , të cilat thuajse në të gjitha rastet janë fituar nga punonjësit e dhe përkatësisht:Për tre vendime të formës së prerë të dhëna nga gjykatat për vitin 2017 dhe tre vendime të paguara gjatë këtij viti por që përkasin vendimeve të shpalluar gjatë vitit 2016 vlera financiare kap shumën 5,355,502 lekë. Për vitet 2018 dhe 2019 rezulton vetëm një vendim gjyqësor i formës së prerë dhe është zbatuar prej institucionit. Vlera financiare e paguar për këto vendime paraqitet 1,295,885 lekë.</p> <p>Aktualisht, institucioni ndodhet në proces edhe për një tjetër çështje gjyqësore, paraqitur në tabelën. Largimet e padrejta i përkasin në një rast vitit 2013 dhe në gjithë rastet e tjera vitit 2014.</p> <p>Vlera financiare gjithsej, e paguar si rrjedhojë e largimeve të padrejta nga puna ka rënduar financat publike për vitet 2017-2019 në shumën 6,651,387 lekë.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në - Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 4 “Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor”, pika ç).</p> <p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Neni 8 pika 1 dhe neni 9 pika 1 e tij.</p> <p>-Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,</p> <p>-Kontrata individuale e punës.</p>
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në financat publike në vlerën 6,651,387 lekë ..
Shkaku:	Largim nga puna në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë marrëdhënie.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 6:	Procesi i ristrukturimit paraqet të meta dhe mangësi
Situata:	<p>Nga auditimi mbi procesin e ristrukturimit të kryer gjatë vitit 2019 referuar VKM nr. 364 datë 29.05.2019, i cili ka riorganizuar Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK) dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) nën një institucion të vetëm Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) rezultoi se,</p> <p>-Me urdhrin e Ministrit nr. 629 datë 29.10.2019 është ngritur komisioni për mbikëqyrjen e procesit të ristrukturimit në të cilin janë caktuar 5 anëtarë, i cili drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës.</p> <p>-Me Urdhrin e Ministrit nr. 6673 prot, datë 11.11.2019 “Për lirim dhe emërim në</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

	<p>detyrë” është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i IKTK, i cili më parë ushtronte funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të IMK.</p> <p>-Në vijim, Drejtori i Përgjithshëm i IKTK, me shkresën nr. 2495 prot, datë 03.12.2019 ka përcjell për zbatim pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse strukturën organike për secilin pozicion pune por në këtë dokument të hartuar nuk përfshihet asnjë bazë administrative/ligjore ku mbështetet kjo vendimmarrje në kundërshtim me VKM nr. 364, në pjesën e IV “Dispozita Kalimtare” pika 2 e tij.</p> <p>Sa më sipër evdientohet se, nuk është ngritur komisioni i parashikuar në VKM nr. 364, lidhur me pozicionimin e punonjësve të dy institucioneve, i cili obligon drejtuesit e institucioneve aktuale që ristrukturohen në funksion të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore”, me urdhër të përbashkët, krijojnë një komision për realizimin e procesit të ristrukturimit dhe të riorganizimit të punonjësve aktualë të IMK dhe ASHA, sipas strukturës dhe organikës së re. Ky proces duhet të udhëhiqej nga drejtues të lartë të Ministrisë së Kulturës, nën mbikëqyrjen e Ministrit të Kulturës. Ky proces është ndjekur i njëanshëm, vetëm nga Drejtori i ri i IKTK në kundërshtim me përcaktimet e mëspërme çka tregon për veprime të cunguara në përmbylljen e këtij procesi. Mangësitë nuk rezultojnë të jenë evidentuar e më pas korrigjuar as prej komisionit të posaçëm për mbikëqyrjen e procesit të ristrukturimit dhe riorganizimit.</p>
Kriteri:	-VKM nr. 364 datë 29.05.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, pjesa IV “Dispozita Kalimtare” pika 2 e saj.
Ndikimi/Efekti:	Proces i paplotë ristrukturimi të cilat ndikojnë në mirëadministrimin dhe ecurinë institucionale
Shkaku:	Mosngritje e komisionit dypalësh për riorganizimin.
Rëndësia:	E lartë

3. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE DHE ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE;

Baza ligjore mbi të cilën bazohet veprimtaria e subjektit të audituar.

- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Dhqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar);
- Ligji nr. 9228 datë 24.04.2008 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, (i ndryshuar);
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”
- Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar);
- Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.14 date 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit te projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 23 datë 22.12.2017 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017 pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 08 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzim Nr.21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”
- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullativë.

a.1.Hartimi i Pasqyrat Financiare

Nga ana e grupit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2017;

Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2018;

Akt-Rakordime me Drejtorinë e Thesarit për totalin progresiv vitet 2017,2018,2019.

Mbi bazën e dokumentacionit të disponuar rezultoi se,

Për vitin ushtrimor 2017

Pasqyrat Financiare janë hartuar dhe janë dërguar Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 368 prot, datë 22.02.2018. Këto pasqyra janë hartuar nga Nëpunësi Zbatues dhe janë miratuar nga Titullari i Institucionit. Ato janë të vulosur nga Dega e Thesarit vetëm për pasqyrën e Aktivitet dhe Pasivitet por jo për pasqyrat e tjera.

Për hartimin e tyre janë ndjekur përcaktimet e UMF nr.14 date 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar dhe UMF nr. 23 datë 22.12.2017 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017 pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

- Bilanci kontabel (aktivi dhe pasivi sipas formateve nr. 1 e nr.2).
- Pasqyrat e shpenzimeve dhe të ardhurave të ushtrimit (Formatet nr. 3/1 e nr.3/2).
- Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (Formati nr. 4).
- Pasqyra mbi levizjen “CASH” (Formati nr. 5).
- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivitet e Qendrueshme si dhe amortizimin e tyre (Formatet nr. 6 e nr. 7).
- Pasqyra e levizjes së fondeve (Formati nr. 8).
- Pasqyre mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (Formati nr. 9).
- Pytesor me të dhëna e shënime shpjeguese për hartimin e Pasqyrave Financiare (Formati nr.10).

IMK sipas procedurave ka rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet.

Në hartimin e pasqyrave Financiare është ndjekur rregulli mbi njohjen e shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me:

- ✓ njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; si dhe
- ✓ njohjen e të ardhurave në çastin e arkëtimit të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Të ardhurat e vitit ushtrimor janë realizuar për shumën 49,960,935 lekë dhe paraqiten si më poshtë vijon.

Në lekë

Nr.llog.	PERSHKRIMI I TE ARDHURAVE TE USHTRIMIT	Viti Ushtrimor
Klasa 7	A. TE ARDHURA TE SHFRYTEZIMIT(I - VI)	49,960,935
71	III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)	1,500,564
711	b) Sherbime administ.e ardhura sekondare	186,000
719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore	1,314,564
720	a) Grant korent I brendeshem	48,460,371
Klasa 7	TOTALI I TE ARDHURAVE	49,960,935

Të ardhurat dyësore përfaqësojnë tarifën për dhënien e 17 liçencave, të cilat janë derdhur 100% në Buxhet. Këto të ardhura vjetore janë rakorduar me degën e thesarit sipas akt-rakordimit përkatës. Llog. 719 përfaqëson rezultatin e ushtrimit vjetor, ndërsa G. korent i brendshëm paraqitet në shumën 48,460,371 lekë.

Shpenzimet e vitit ushtrimor janë realizuar për shumën 48,646,371 lekë dhe paraqiten si më poshtë vijon:

Në lekë

Nr.llog.	PERSHKRIMI I SHPENZIMEVE TE USHTRIMIT	Viti Ushtrimor
Klasa 6	A. SHPENZIMET SHFRYTEZIMI (I - III)	48,118,839
60	I. Shpenzime Korrente	48,460,371
600	Paga,shperblime e te tjera personeli	31,317,257
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	5,236,447
602	Mallra dhe sherbime te tjera	11,327,768
604	Transferime korrente te brendshme	474,133
605	Transferime korrente me jashte	54,766
606	Transferta per buxh.familjare e individe	50,000
63	II. Ndryshimi I gjendjeve te inventarit (+ -)	(341,532)
Klasa 6	TOTALI I SHPENZIMEVE	48,118,839
82,83,84	D. OPERAC.KORIGJ.REZULTATIT	527,532
8420	Derdhje te ardhura ne buxhet (Tarifa)	186,000
8423	Transferime per ndrysh gjendje	341,532
Klasa 6 e 8	TOTALI OPERACIONEVE	48,646,371
85	REZULTATI NGA FUNKSIONIMI	1,314,564
X	TOTALI	49,960,935

Zëri kryesor në shpenzime janë paga e kontribute (llog. 600 + llog.601) në shumën 36,553,704 lekë ose 73.2% të shpenzimeve gjithsej të analizuar edhe në drejtimin nr.2 të programit të auditimit. Shpenzime për mallra e shërbime 22.7 % dhe të tjerat zënë 4.1% të tyre.

“Mallra e shërbime të tjera”

11,327,768 lekë

-Materiale zyre e te pergjitheshme

864.761

-Materiale dhe sherbime special

239.100

-Sherbime nga te trete

3.442.990



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

-Shpenzime transporti	1.685.281
-Shpenzime udhetimi	2.451.770
-Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1.014.548
-Shpenzime per detyrime per kompesime legale	1.219.703
-Shpenzime te tjera operative	409.615

“Transferime korrente të brendshme” **474,133 lekë**

-Projekt perkujtimor "V. P"	49,500
-Promovimi i "Z e Sh"	270,145
- Projekt FAU	154,488

Në këtë grup janë paraqitur shpenzimet për projektet e ndjekura nga IMK, pasi fondet janë çelur në këtë zë nga MK.

“Transferime korrente të jashtme” **54,766 lekë**

Në këtë grup janë paraqitur shpenzimet që paguhen nga IMK për kutot vjetore për kuotizcionin në Organizatën Ndërkombëtare, ICCROM.

“Transferime për buxhetet familjare e individe” **50,000 lekë**

Në këtë grup janë paraqitur shpenzimet që paguhen nga Fondi i Veçantë i IMK-së, për raste sëmundje.

“Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”, rezulton në shumën (- **341,532 lekë**)

Mbi Pasqyrat Financiare për vitin 2018

Për vitin ushtrimor 2017 Pasqyrat Financiare i janë dërguar Degës së Thesarit, Tiranë me shkresën nr. 463 datë 28.02.2019 dhe Ministrisë së Kulturës me shkresën nr. 463/1 prot, datë 12.04.2019. Këto pasqyra janë hartuar nga Nëpunësi Zbatues dhe janë miratuar nga Titullari i Institucionit.

Pasqyrat Financiare janë hartuar Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 08 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe përmbajnë pasqyrat mbi;

- Pozicionin Financiar;
- Peformancën Financiare;
- Flukset Monetare (Cash Floë)
- Ndryshimet në Aktivitet neto/Fondet neto
- Shënimet Spjeguese

Pasqyrat statistikore të cilat janë pjesë përbërëse e tyre janë:

- Investimet dhe burimet e investimet
- Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Kosto historike)
- Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera neto)
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave

IMK sipas procedurave ka rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet.

Pasqyra e performancës financiare vjetore të IMK praqitet si më poshtë:

Në lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Nr. Lloga.	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR
A	TE ARDHURAT	56,505,281
72	V.GRANTE KORENTE	56,505,281
720	1.Grant korent i Brendshem	55,285,531
721	2.Grant korent i Huaj	1,219,750
B	SHPENZIMET	55,469,623
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	32,817,866
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	5,463,671
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	16,774,603
	V.TRANSFERIME KORENTE	229,391
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	0
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	184,092
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati i Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	1,035,658

Të ardhurat paraqiten 56,505,281 lekë ndërsa shpenzimet 55,469,623 leke. Rezultati i ushtrimit paraqitet pozitiv në shumën 1,035,658 lekë.

Të ardhurat vjetore përbëhen prej granteve të brendshëm dhe Grantit të jashtëm që IMK ka përfituar nga UNESCO dhe organizata të tjera, për realizimin e Kurseve të Trajnimit dhe ka përfituar fonde ndër vite.

Zëri kryesor në shpenzime janë paga e kontribute (llog. 600 + llog.601) në shumën 38,281,537 lekë ose 69% të shpenzimeve gjithsej të analizuar edhe në drejtimin nr.2 të programit të auditimit. Shpenzime për mallra e shërbime zënë rreth 30 % dhe të tjerat rreth 0.1% të tyre.

Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar në PF për vitin ushtrimor 2018 rezultoi se, vlera në Aktiv e llog. 231 “Shpenzime proces per rritjen e AQT” dhe kundërpartia në pasiv llog. 14 “Të tjera” në pot ë njëjtën vlerë përfaqësojnë vlera riparimesh/restaurimesh të kryera në objektet monument kulture të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të IMK por institucioni ka zhvilluar procedurat prokurorese, mbikëqyrëse dhe marrjes në dorëzim të punimeve për to. Vlera e punimeve/restaurimeve paraqitet si më poshtë vion:

LLogaria 231

Në lekë

Emërtimi	Shuma
Krijuar gjate vitit 2012	
M.	20,791,212
Mbartur nga vitit 2015	
P i Gj	37,725,298
B. K	7,481,645
B. e M te Tiranes	5,384,314
Rr. E.	981,684
Godina e IMK tek ish p l p.	1,343,498
Krijuar gjate vitit 2018	
Restaurim në objektin "U. e Ks 4 km në juglindje të Gj" - Lazarat.	4,979,877
Restaurim "B e V. F"- Përmet.	5,990,824
Restaurim "M i S" - Dibër.	1,484,309
Restaurimi "Kisha Sh. M. P. e Sipërme" Gjirokastrër.	24,113,635



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Restaurim në objektin "Kisha e Sh. A", Hoshtevë - Zagori.	19,194,739
Restaurim i "Kishës së Sh. N. (Vend – V.i i S)" - Lezhë.	33,240,595
Restaurim në objektin "Kisha e Sh. Th"- Leshnicë-Sarandë.	10,045,540
Restaurim "Kisha e M të Sh.M. M" Faza I -Sarandë.	23,987,722
Restaurimi "Ura e N." - Nivan - Nderan, Zagori, Gjirokastër.	2,356,243
SHUMA	199,101,135

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit

Vlera “*e mbetur*” në PF të institucionit prej rreth **199.1 milion lekë** rregullisht duhet të ishte transferuar drejt institucionit përgjegjës, i cili zotëron gjithashtu administrimin e tij. Çdo riparim apo mirëmbajtje e aktivitetit i cili e përmirëson gjendjen e tij rregullisht duhet të regjistrohej në kartelën përkatëse të aktivitetit.

Aktualisht vlerat e riparimeve paraqiten nga IMK, gjë e cila denatyrton treguesit e saj financiarë, dhe ndikon negativisht në pasqyrimin e ecures historike mbi secilin monument edhe shpenzimeve financiare të bëra për restaurimin e tyre përgjatë periudhave. Aktualisht institucioni gjendet në mungesë të akteve rregullative mbi këtë problematikë çka kërkon një vëmendje të shtuar nga Ministria e Kulturës si hallkë më e lartë institucionale.

Të ardhurat detyësore nga tarifat e shërbimeve që ofron IKTK

Të ardhurat detyësore për periudhën nën auditim vitet 2017-2019 përbëhen nga tarifat e veprimtarisë së IMK në dhënien e licencave në fushën e restaurimit të monumenteve. Për periudhën nën auditim të ardhurat nga tarifat paraqiten si më poshtë:

Viti	LICENCA			Tarifë e Arkëtuar
	Individuale	Shoqërie	Gjithsej	
2017	11	6	17	186,000
2018	3	2	5	58,000
2019	1	6	7	126,000
Gjithsej	15	14	29	370,000

Burimi: IKTK përpunuar nga grupi i auditimit

Caktimi i tarifave është bërë me urdhër të Ministrit të Kulturës znj. M.K.F nr. 426 datë 01.12.2015 regjistruar dhe mban nr. 1772 prot, datë 01.12.2015 i cili në bazën e tij ligjore mbështetet në pikën 4 të nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndërkohë që arsyetimi për nxjerrjen e tij citon mungesën e bazës ligjore specifike për të hartuar një projektvendim për miratim tarifash dhe kostatton nevojën për nxjerrjen e këtij urdhri.

Ky arsyetim në vlerësimin tonë nuk qendron pasi, VKM nr. 432 datë 28.06.2006 përcakton qartë hartimin e një udhëzimi të përbashkët me Ministrin e Financave për caktimin e tarifave dhe kategorizimin e tyre. Gjithashtu në dispozitat ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e IMK dhe konkretisht statutin e institucionit miratuar po me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017, Neni 15 “Të ardhurat buxhetore”, pika 4 e tij përcaktohet se,

5. Të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga I.M.K-ja sipas legjislacionit në fuqi, VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore” si dhe Udhëzimit të Ministrit të Kulturës dhe Ministrin të Financës.

Pra vihet re qartë që dispozitat ligjore datojnë prej të paktën prej vitit 2006, por udhëzimi i përbashkët ende mungon.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore”, botuar në fletoren zyrtare nr. 86 datë 17.05.2018 i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në FZ, në nenin 29 pika



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

10 të tij përcakton detyrimin e IKTK, pra institucionit të ri për mbledhjen e tarifave sipas parashikimeve të udhëzimit të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat. Sipas nenit 265 pika 1 e këtij ligji, udhëzimi i përbashkët ende nuk është miratuar megjithëse duhet të ishte bërë efektiv brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pra prej muajit qershor 2019. Vet institucioni e ka evidentuar boshllëkun e krijuar dhe ka kërkuar plotësimin e bazës ligjore. Megjithatë, prej rreth 8 muajsh ky udhëzim mungon, duke mospërmbushur dukshëm kërkesat e ligjit.

a.2. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet, bankës dhe arkës, në lekë dhe valutë.

U audituan veprimet e kryera me arkë dhe bankë për periudhën nën auditim prej nga rezultoi se, veprimet e kryera me arkën në valutë (Euro dhe USD) ishin regjistruar kronologjikisht në llogaritë respektive. Veprimet e kryera u përkisnin vetëm në pak rasteve për udhëtimet jashtë vendit.

Nga auditimi mbi pagesat e kryera nga institucioni për periudhën nën auditim vitet 2017-2019 rezultoi se, gjatë kësaj periudhë janë paguar shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve informatikë W. G, sistem i cili përdoret për inventarizimin dhe paraqitjen në hartë të monumenteve të kulturës në shumën 360,000 lekë/vit.

-Referuar ndryshimeve ligjore të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, nga ana e IMK dhe AKSHI-t është ngritur grupi i përbashkët i punës regjistruar në IMK nr. 408 prot. datë 20.02.2019, për kalimin kapital të sistemit pranë AKSHI. Me urdhrin e brendshëm të IMK nr. 408/1 datë 20.02.2019, është përcaktuar komisioni për dorëzimin e aktiveve.

Në kontratën e mirëmbajtjes të lidhura midis IMK dhe operatorit ekonomik fitues nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar, ku përcaktohet se,

18. Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018.

19. Për sistemet dhe infrastrukturat TIK të cilat kalojnë në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe që zhvillohen ose mirëmbahen nëpërmjet marrëveshjeve ose kontratave të nënshkruara nga institucionet me palë të treta, të reflektohen ndryshimet përkatëse në këto akte.

24. Fondet buxhetore për shërbimet sipas shkronjës “i”, të pikës 6, të këtij vendimi, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, do të parashikohen në buxhetin vjetor të AKSHI-t. Për të gjitha institucionet jobuxhetore, AKSHI do t'i ofrojë shërbimet kundrejt tarifave. Efektet financiare të kësaj pike fillojnë më 1 janar 2019.

6. AKSHI, në ushtrim të veprimtarisë së saj, kryen edhe këto detyra e përgjegjësi të veçanta, si më poshtë vijon:

i) Përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

*infrastrukturën TIK, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Ai organizon prokurimin e përqendruar për pajisjet TIK, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, dhe për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të cilat, **jo më vonë se data 30 qershor, i dërgojnë kërkesë me shkrim AKSHI-t për nevojat e tyre për projektet dhe pajisjet TIK për vitin pasardhës.***

Procedura e dorëzimit është përfunduar më datë 17 Tetor 2019 ku dhe janë mbajtur akti dorëzimit si dhe procesverbali përkatës. Vlera e sistemit është nxjerrë nga kontabiliteti i IMK me vlerën e mbetur 3,853,200 lekë.

Si konkluzion: Mos përfundimi i procesit të transferimit të sistemeve pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve ligjore në fuqi e kanë ekspozuar institucionin drejt shpenzimeve të panevojshme nga buxheti i vet lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për këto sisteme në shumën **360,000 lekë.**

c. Inventarizimi i pronës shtetërore

Nga ana e subjektit të audituar u vu në dispozicion praktikat e inventarizimit të kryer për vitet 2017 dhe 2018, ndërsa për vitin 2019 vetëm urdhri i nxjerrë nga titullari mbi këtë proces. Në dispozitat ligjore të cilat rregullojnë këtë proces dhe konkretisht Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar) përcaktohet se,

26. Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

27. Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e rregjistrit.

74. Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

83. Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material

85. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:

*a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe **pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proceverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.***

*b. **Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.***

Lidhur sa më sipër, por jo vetëm, nga ana e grupit të auditimit u trajtuan veprimet administrative të ndërmarra nga IMK mbi inventarizimin e aktiveve.

Për vitin 2017

Me Urdhrin nr. 2123 prot, datë 13.12.2017 Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin “Për ngritjen e Komisionit të Inventarizimit të Vlerave Materiale”. Në këtë urdhër janë caktuar tre punonjës dhe afati për përfundimin e është datat 18.12.2017 deri më 18.01.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Nga ana e komisionit janë kryer verifikimet e kartelave individuale të aktiveve të marra në dorëzim të cilat më pas janë firmosur prej komisionit dhe personit përgjegjës.

Për këtë procedurë komisioni nuk rezulton të ketë mbajtur procesverbal për verifikimin e kryer si dhe raport me inventarizimin fizik të aktiveve në kundërshtim me pikën 85/a,b më sipër.

Gjatë vitit 2017 janë kryer kalime kapitale të aktiveve drejt dy institucioneve dhe konkretisht:

- Në zbatim të Urdhrit nr. 103 datë 13.03.2017 është kryer kalim kapital i disa paisjeve zyre drejt Ministrisë së Kulturës në shumën kontabël 121,500 lekë.

- Në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 458 datë 06.07.2017 është kryer kalim kapital i disa paisjeve zyre drejt Muzeut K. të Gj. në shumën kontabël 156,000 lekë.

Praktikat përmbajnë urdhrin e sipërcituar, në rastin e parë urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të IMK për zbatimin e tij si dhe fletë daljet e IMK dhe kopjet e fletë hyrjeve të institucionit përfitues.

Vlera totale e aktiveve të transferuara paraqitet **277,500 lekë**.

Procesverbalet mbi dorëzimin e inventarit.

Nr. 175/2 prot, datë 28.12.2017 dorëzim aktivesh në përdorim nga A.N vlera 70,718 lekë ku gjendja e tyre përshkruhet tejet e amortizuar dhe jashtë funksionit.

Nr. 175/3 prot, datë 29.12.2017 dorëzim aktivesh në përdorim nga A.N vlera 578,022 lekë ku gjendja e tyre përshkruhet tejet e amorizuar dhe jashtë funksionit.

Për punonjësin z. Z.M është bërë njoftimi për dorëzimin e aktiveve në dorëzim por nuk disponohet dokumentacion mbi dorëzimin.

Për vitin 2017 janë bërë hyrje aktivesh nga Shkolla e Restaurimit në shumën 1,345,494 lekë të cilat i janë shpërndarë sipas 19 fletë daljeve Sektorit të Veprave të Artit. Fletë-daljet nuk përmbajnë nr. rendor dhe datë si dhe në 11 raste nuk janë të firmosura çka bie ndesh me përcaktimet e UMF nr.30 pika 35/b, 53, 60, 83 i tij, por jo vetëm, ku përcaktohet detyrimi për regjistrimin kronologjik të dokumentacionit. Mungon paktika e pranimit dhe marrjes në dorëzim nga institucioni për këto aktive.

Nga auditimi rezultoi se, vlerat gjithsej e **llog. 218, llog. 327, llog. 214 dhe 215** në kartelat individuale të inventarizuara nuk përkon me vlerat e llogarive në Pasqyrat Financiare për vitin 2017, për të cilën nuk janë paraqitur ende shpjegime prej subjektit të audituar. Ndërkohë që **llog. 312** “Materiale” rezulton e njëjta vlerë.

Për vitin 2018

Me Urdhrin nr. 2605 prot, datë 19.12.2018 Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin “Për ngritjen e Komisionit të Inventarizimit të Vlerave Materiale”. Në këtë urdhër janë caktuar tre punonjës dhe afati për përfundimin e tij është datat 20.12.2018 deri më 22.01.2019.

Nga ana e komisionit janë kryer verifikimet e kartelave individuale të aktiveve të marra në dorëzim të cilat më pas janë firmosur prej komisionit dhe personit përgjegjës më datë 31.12.2018.

Për këtë procedurë komisioni nuk rezulton të ketë mbajtur procesverbal për verifikimin e kryer si dhe raport mbi inventarizimin fizik të aktiveve.

- Në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 2009/1 datë 02.10.2018 është kryer kalim kapital i disa paisjeve zyre drejt Muzeut K. të Gj. në shumën kontabël 111,730 lekë.

Edhe për këtë periudhë evidentohet i njëjti fenomen ku vlerat gjithsej të aktiveve të inventarizuara, **llog. 218, llog. 327, llog. 214, dhe 215**, nuk përkon me vlerat e llogarive në Pasqyrat Financiare për vitin 2018, për të cilën nuk janë paraqitur ende shpjegime prej subjektit të audituar. Ndërkohë që **llog. 312** “Materiale” rezulton e njëjta vlerë.

Për vitin 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Me Urdhrin nr. 2605 prot, datë 12.12.2019 Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin “Për ngritjen e Komisionit të Inventarizimit të Vlerave Materiale”. Në këtë urdhër janë caktuar tre punonjës ndërkohë që nuk është vendosur afat për përfundimin e tij, ndryshe nga vitet e mëparshme. Mosvendosja e afateve për përfundimin e detyrës ka ndikime në ecurinë e kryerjes së inventarizimit për aq kohë sa ky proces ende nuk rezulton i përfunduar megjithëse kanë kaluar mbi dy muaj nga hyrja në fuqi e urdhrin. Theksojmë se, në këtë proces inventarizimi përfshihen aktivitetet e të dy institucioneve IMK dhe ASHA të cilët pas ristrukturimit gjenden nën emërtimin IKTK.

- ❖ Në përputhje me terminologjinë aktuale, “*Nëpunës autorizues i nivelit të dytë*” është nëpunësi i administratës publike në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues.

Për periudhën nën auditim vitet 2017-2019 Nëpunës Autorizues kanë qenë si më7 poshtë:

-Me shkresën nr. 5387/1 prot, datë 09.12.2013, Ministria e Kulturës ka njoftuar IMK mbi konfirmimin e Ministrisë së Financave të znj. A.D si Nëpunës Autorizues.

-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 12031/1 prot, datë 28.06.2018 është konfirmuar si NA i përkohshëm znj. D.P.

-Me shkresën nr. 7229 prot, datë 18.09.2018 nga Ministria e Kulturës është kërkuar pranë MFE caktimi i znj. . A.D si Nëpunës Autorizues. Nuk disponohet shkresë konfirmuese prej saj.

-Me shkresën nr. 6757 prot, datë 13.11.2019 nga Ministria e Kulturës, si rrjedhojë e ristrukturimit është kërkuar pranë MFE caktimi znj. . A.D si Nëpunës Autorizues. Nuk disponohet shkresë konfirmuese prej saj.

“*Nëpunës zbatues*” është punonjësi i administratës publike në njësinë e qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues të nivelit përkatës.

Për periudhën nën auditim vitet 2017-2019 Nëpunësi Zbatues kanë qenë si më poshtë:

-Me shkresën e Ministrisë së Kulturës nr. 323 prot, datë 04.03.2016 është konfirmuar Nëpunës Zbatues znj. M.R, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, miratuar prej Ministrisë së Financave me nr. 2299/1 prot, datë 16.02.2016.

-Me shkresën e IMK nr. 210/1 prot, datë 07.02.2018 është kërkuar konfirmim nga Ministria e Kulturës për znj. M.R si Nëpunës Zbatues. Nuk disponohet shkresë konfirmuese prej saj apo nga MFE.

-Me shkresën nr. 7182 prot, datë 11.12.2019 nga Ministria e Kulturës është kërkuar caktimi i Nëpunësit Zbatues pranë MFE por ende nuk disponohet shkresë konfirmuese prej saj.

- ❖ Për periudhën nën auditim menaxhimi i burimeve njerëzore nuk gjendet si pozicion i dedikuar në strukturën e mëparshme të institucionit, referuar kjo VKM nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve vendihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore,” e cila në pikën 8 të saj përcakton se,

Në institucionet, që kanë të paktën 30(tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore. Në varësi të madhësisë së institucionit ky pozicion mund të jetë i dedikuar ose të ketë përgjegjësinë edhe për kryerjen e funksioneve të tjera.

Pavarësisht kësaj mangësie në strukturë, dokumenti “Përshkrimet e punës” pjesë e Rregullores së Brendshme dhe konkretisht Aneksit III, Lidhja nr.4, detyrat e këtij funksioni ja ka ngarkuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Përgjegjësit të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i cili është caktuar njëkohësisht edhe “Nëpunësi Zbatues” i institucionit për këtë periudhë, çka bie ndesh me përcaktimet ligjore përkatësisht Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 21 datë 25.10.2016 pika 2.3 e tij ku përcaktohet se;

2.3 ...Brenda strukturës së financës i njëjti person nuk mund të angazhohet në më shumë se një proces pune....

si dhe neni 12 pika 3/ç e Ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) ku përcaktohet se,

3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:

ç) mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve në varësi funksionale të tij, si dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional;

Caktimi i punonjësit i cili duhet të kryente detyrën e për burimeve njerëzore të institucionit sipas dispozitave të lartpërmendura nuk duhet të ishte pjesë e stafit të financës e aq më pak e nëpunësit zbatues i cili ka funksion mbikëqyrës dhe jo hartuesi si në rastin konkret. Sa më lartë tregon që institucioni për periudhën nën auditim nuk ka një ndarje të detyra të drejtë të detyrave dhe sistemi i kontrollit të brendshëm paraqitet me mangësi.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Problematikat e trajtuara më sipër kanë ekspozuar njësinë publike drejt riskut në përmbushjen e detyrimeve institucionale lidhur me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së saj.

U shqyrtua observacioni nr.prot 1441/14 datë 30.04.2020, lidhur me Projektraportin e auditimit, ku në mënyrë të përmbledhur parashtrohet se:

1-Mbi strukturën e institucionit

Nga ana e Titullarit të IKTK-së, u morrën masat masat për të kërkuar dhe propozuar pranë Ministrisë së Kulturës, rishikim të Strukturës së miratuarKërkesë propozimi ynë mori parasysh reduktimin e disa prej funksioneve mbështetëse dhe krijimin e një sektori të ri, i cili të mbulojë burimet njerëzore të institucionit. Në këtë mënyrë, do të mund të kemi një ndarje të drejtë të detyrave dhe sistem të drejtë të kontrollit të brendshëm.

2-Mbi performancën e punonjësve

...U morën masat për të plotësuar dosjet me formularin e performancës së punonjësve për periudhën 01 Janar deri në 02 Dhjetor 2019...

3- Në zbatim të VKM-së Nr. 364 datë 29.05.2019..... ku përcaktohet se Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së ka kompetencat dhe përgjegjësitë, mbi emërimet dhe shkarkimet e punonjësve të IKTK-së, në bazë të Kodit të Punës dhe të rregullores së brendshme, shkresës së Ministrisë së Kulturës me Nr. 6407 Prot, datë 29.10.2019 ku kërkohet që të transferohen të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës me IMK-në,... si dhe Urdhrit të Ministrit të Kulturës Nr. 6673 Prot, datë 11.11.2019 “Për lirim dhe emërim në detyrë” të znj. A. D si Drejtor i Përgjithshëm i IKTK, janë ...përcjellë për zbatim pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, strukturën organike për secilin pozicion pune, me shkresën Nr. 2495 Prot, datë 03.12.2019..

... siç citohet edhe në VKM Nr. 364, datë 29.05.2019 është një proces, i cili udhëhiqet nga drejtues të lartë të Ministrisë së Kulturës, nën mbikëqyrjen e Ministrit.

4- ...Në lidhje me emërimet është ndjekur marrja në konsideratë e kërkesave për punësim, të drejtuar pranë IMK-së, të cilat janë analizuar nga ana e Titullarit, duke u mbështetur në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

kriteret e tyre dhe sipas nevojave të institucionit për funksionimin normal të punës.... Një pjesë e emerimeve të punonjësve janë bërë duke kryer lëvizje të brendshme brenda sektorëve... Në lidhje me deklaratimet e vendeve vakante të IMK - së është bërë.... Raportohet në Platformën Administrata.al ... Raportohet në Regjistrin Qendror të Personelit,.... Raportohet në Ministrinë e Kulturës sipas kërkesës së tyre...Ju bëjmë me dije se është realizuar nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së, “Harta e Proçesit të Rekrutimeve të Burimeve Njerëzore”, e cila parashikon marrjen e masave sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH, mbi mënyrën e rekrutimit.

5- *..Në lidhje me vendimet gjyqësore mbi largimet nga puna të punonjësve, të cilat janë shlyer nga ana e IMK-së, ju bëj me dije se këto largime të punonjësve, i përkasin kryesisht vitit 2014.... Largimet nga puna janë kryer si rezultat i proceseve të ristrukturimi të IMK-së.*

6- *..Sqarojmë se: Emërimet e Titullarit të IMK-së janë kryer me Urdhër të Ministrit të Kulturës.*

Znj. A.D ka kryer detyrën e titullarit të IMK-së, në zbatim të emërimit të drejtpërdrejtë, apo nëpërmjet delegimit të kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm të IMK...

7-*... Miratimi i Rregullores së Brendshme është mbështetur duke respektuar aktet ligjore në fuqi, dhe në rastin konkret nenin 11/pika 3 të Statutit të IMK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës Nr. 9 datë 23.01.2017..*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Lidhur me sa trajtohet në observacioni tuaj sqarojmë se,

1- Referuar përshkrimit tuaj dhe në mungesë të dokumentacioneve përkatës, ajo çfarë vlerësohet nga ana jonë si është zbatimi i dispozitave ligjore mbi dedikimin e një punonjësi sa i përket burimeve njerëzore i cili nuk duhet të jetë NZ i institucionit.

Sa i përket konvertimit të disa funksioneve, nisur nga numri i ulët i punonjësve të institucionit numri i ulët i rekrutimeve vjetore, si dhe veprimtaria e deritanishme e institucionit mbi detyrat e burimeve njerëzore pavarësisht mangësive të përmendura, qëndrimi ynë mbetet i njëjtë, për rishikimin e strukturës duke patur si objektivi kryesor forcimin e kapaciteteve në veprimtarinë e trashëgimisë kulturore dhe asaj arkeologjike dhe jo krijimin e sektorëve.

2- Marrja e masave të menjëhershme për plotësimin e formularit të punonjësve përbën reflektim të shpejtë dhe pozitiv nga ana e institucionit.

3- Lidhur me procesin e ristrukturimit, VKM nr. 364, në pjesën e IV “Dispozita Kalimtare” pika 2 e tij sqaron në mënyrë shteruese procedura që duhet të ndiqet. Veprimet administrative të ndërmarra për përmbylljen e procesit janë në mospërputhje të qartë me përcaktimet e VKM. Komisioni për mbikëqyrjen e procesit të ristrukturimit nuk rezulton të ketë përmbushur gjithashtu detyrimet e tij.

4- Lidhur me publikimin e vendeve vakantë pavarësisht raportimeve të kryera në platformat që ju paraqesni, qëndrimi ynë mbetet i njëjtë, pasi vendet vakantë duhet të publikohen në mënyrë të detyrueshme pranë buletinit zyrtar si dhe faqes zyrtare të institucionit, për të garantuar një procedurë rekrutimi transparente dhe përfitimin e burimeve njerëzore sa më të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

kualifikuara. Reflektimi për përmirësim të procedurës përbën hap pozitiv drejt transparencës publike.

5- Pavarësisht ndryshimeve strukturore të institucionit, vendimet gjyqësore i referohen procedurave jo të rregullta të ndjekura nga menaxhimi i lartë për largimet nga puna, të cilat i japin efektet gjithmonë në periudha të mëvonshme pasi merret vendimi i formës së prerë nga gjykatat. Veprimet e parregullta të ndërmarra janë bërë shkak për pagesa të konsiderueshme nga buxheti i shtetit.

6- Lidhur me emërimin e drejtuesit të institucionit, qëndrimi ynë mbetet i njëjtë, procedura e ndjekur është në kundërshtim me dispozitat e VKM nr.173, date 07.03.2003 pika 1, 2 dhe 4 e tij si dhe në mungesë të transparencës publike.

7-Lidhur me hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme nga vet institucioni, përbën në thelb një lloj “konflikti interesi” i cili mund të ketë ndikuar në kryerjen e detyrës shtetërore.

Sa më lartë observacioni merret në konsideratë pjesërisht.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Problematikat e trajtuara më sipër e kanë ekspozuar njësinë publike drejt një risku në përmbushjen e detyrimeve institucionale lidhur me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së saj.

-U shqyrtua observacioni nr.prot (e-mail) datë 28.04.2020, lidhur me Projektraportin e auditimit, ku në mënyrë të përmbledhur parashtrohet se:

1- ...Vlera “e mbetur” në PF të institucionit prej rreth 199.1 milionë duhej rregullisht të ishte transferuar drejt institucionit përgjegjës, i cili zotëron gjithashtu administrimin e tij, por nuk është arritur të realizohet nga ana e IMK-së, në mungesë të akteve rregullativë mbi këtë problematikë. IGTK ka bërë kërkesë drejtuar Ministrisë së Kulturës, si organ epror për të marrë masat për aktet rregullative, në mënyrë që të sistemohet kjo vlerë

2- IMK ka hartuar drafte për rregullimin e bazës ligjore të Tarifave të aplikuara mbi veprimtarinë e saj, të cilat i ka dërguar pranë Ministrisë së Kulturës, në mënyrë të përsëritur për të rregulluar këtë mungesë ligjore. Jemi në pritje të miratimit të bazës ligjore mbi aplikimet e tarifave të veprimtarisë së IGTK-së dhe na është konfirmuar nga ana e Ministrisë së Kulturës, për sa më sipër, se deri në miratimin e udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat, me qëllim për të mos bllokuar punën për një kohë të gjatë.

3- Procesi i transferimit të sistemeve pranë AKSHI-t, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi ka përfunduar në tetor të vitit 2019, edhe pse nga ana e IMK-së janë vënë në dispozicion, të gjithë të dhënat e kërkuara, si dhe kontrata e lidhur mbi shpenzimet e mirëmbajtjes.... Kjo kontratë nuk është marrë përsipër për t’u vazhduar dhe përmbushur nga ana e AKSH-it, por duke pasur parasysh që ishte një kontratë e lidhur që nga viti 2015... ashtu sic është konfirmuar edhe në Aktin e Dorëzimit të mbajtur ndërmjet 2 institucioneve... është përcaktuar



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

që mirëmbajtja e saj duhet përballohej nga fondet publike të akorduar nga buxheti i shtetit, për IMK....

4-Për vitin 2017,....Konstatimi Juaj se: për këtë procedurë komisioni nuk rezultoi të ketë mbajtur procesverbal për verifikimin e kryer si dhe raport me inventarizimin fizik të aktiveve, qëndron, por sqarojmë se nga verifikimi i kartelave të inventarit është lehtësisht e verifikueshme, që nuk ka pasur teprica apo mungesa ndërmjet sasisë kontabël të paraqitur për inventarizim dhe sasisë fizike të konstatuar nga komisioni i inventarizimit. Kjo mangësi do të mbahet në vëmendje dhe do të sistemohet në vazhdim....Proces Verbal Nr. 175/3 prot, datë 29.12.2017 është mbi dorëzimin e aktiveve në përdorim nga Z.M...

Edhe për vitin 2018 janë problematikat dhe shpjegimet sipas vitit 2017 dhe do të merren masat për të zgjidhur mangësitë dhe problematikat e konstatuara.

Për vitin 2019, ...Mosvendosja e afateve për përfundimin e detyrës, ka ardhur si rezultat i procedurave të bashkimit të 2 institucioneve. Do të merren masat për të zgjidhur mangësitë dhe problematikat e konstatuara, në vitet 2017 dhe 2018...

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Lidhur me sa trajtohet në observacioni tuaj sqarojmë se,

1- Nisja e menjëherëshme e procedurave mbi këtë çështje përbën një hap pozitiv drejt adresimit dhe zgjidhjes së çështjes e cila mbartet prej vitesh në llogaritë kontabël të institucionit.

2-Caktimi i tarifave bëhet vetëm në mënyrën e shprehur nga aktet ligjore dhe çdo formë tjetër e ndryshme gjendet e papajtueshme pavarësisht qëllimit. Nga ana e institucionit duhet të ishte konstatuar menjëherë kjo mospërputhje ligjore megjithëse fillesa është prej organit epror.

3-Procesi i transferimit të sistemeve dhe të drejtave *juridiko-civile* është kryer jashtë afateve referuar VKM nr. 673, datë 22.11.2017 pasi ai duhet të përmbylej brenda dates 30 shtator 2018,

ndërkoh grupi i përbashkët i punës regjistruar në IMK nr. 408 prot. datë 20.02.2019. Përfundimi i transferimit ka përfunduar më datë 17.10.2019 pra me rreth 12 muaj vonesë. Marrëveshja midis dy institucioneve për vijimin e pagesës deri në përfundim të kontratës nga IMK gjendet e papajtueshme ligjërisht.

4- Lidhur me mangësitë e vërejtura pavarësisht punës së kryer dhe ngarkesës në detyrat funksionale nevojitet që pasuria shtetërore të jetë e verifikuar në të gjithë dimensionet fizike dhe kontable. Lidhur me dorëzimin Nr. 175/3 pranohet observimi dhe u kryen ndryshimet përkatëse në raport.

Në procedurën e inventarizimit të vitit 2019 kërkohet një rakordim i detajuar mbi ecurinë e cdo aktivi Brenda një afati të arsyeshëm.

Sa më lartë observacioni merret në konsideratë pjesërisht.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Punime të kryera si investime mbi monunumentet e kulturë mbetur në konabilitetin e IMK
Situata:	Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar në PF për vitin ushtrimor 2018 rezultoi se, vlera në Aktiv e llog. 231 “Shpenzime proces per rritjen e AQT” dhe kundërpartia në pasiv llog. 14 “Të tjera” në po të njëjtën vlerë përfaqësojnë vlera riparimesh/restaurimesh të kryera në objektet monument kulture të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të IMK por për këto objekte institucioni ka zhvilluar procedurat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

	<p>prokuruese, mbikëqyrëse dhe marrjes në dorëzim të punimeve.</p> <p>Vlera “e mbetur” në PF të institucionit prej rreth 199.1 milionë lekë rregullisht duhet të ishte transferuar drejt institucionit përgjegjës, i cili zotëron gjithashtu administrimin e aktivitetit. Çdo riparim apo mirëmbajtje e aktivitetit i cili e përmirëson gjendjen e tij rregullisht duhet të regjistrohej në kartelën përkatëse të aktivitetit e cila nuk zotërohet prej IMK sot IKTK.</p> <p>Aktualisht vlerat e riparimeve paraqiten nga IKTK, gjë e cila jo vetëm denatyrton treguesit e saj financiarë por ndikon negativisht në pasqyrimin e ecures historike mbi secilin monument edhe shpenzimeve financiare të bëra për restaurimin e tyre përgjatë periudhave. Aktualisht institucioni gjendet në mungesë të akteve rregullative mbi këtë problematikë çka kërkon një vëmendje të shtuar nga Ministria e Kulturës si institucion epror.</p>
Kriteri:	-Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 08 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
Ndikimi/Efekti:	Pasqyrim i “mbetur” i kësaj vlere në PF e IMK
Shkaku:	Mungesë e akteve rregullative dhe përpjekjeve institucionale për sistemimin e kësaj vlere.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Mungon udhëzimi i përbashkët për tarifën e licensimit.
Situata:	<p>Nga auditimi rezultoi se, institucioni llogaritjen dhe mbajtjen e tarifave në dhënie e licensave në fushën e restaurimit të monumenteve për periudhën nën auditim vitet 2017-2019 e ka kryer referuar urdhrin të Ministrit të Kulturës nr. 426 datë 01.12.2015. Ky urdhër bie në kundërshtim me VKM nr. 432 datë 28.06.2006 i cili përcakton qartë hartimin e një udhëzimi të përbashkët me Ministrin e Financave për caktimin e tarifave dhe kategorizimin e tyre. Gjithashtu në vet dispozitat ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e IMK dhe konkretisht statutin e institucionit miratuar po me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017, Neni 15 “Të ardhurat buxhetore”, pika 4 e tij përcaktohet se, të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga I.M.K-ja sipas legjislacionit në fuqi, VKM nr. 432, datë 28.06.2006 si dhe Udhëzimit të Ministrit të Kulturës dhe Ministrit të Financës, gjë e cila nuk rezulton.</p> <p>Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore në nenin 29 pika 10 të tij përcakton detyrimin e IKTK, pra institucionit të ri për mbledhjen e tarifave sipas parashikimeve të udhëzimit të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat. Udhëzimi i përbashkët ende nuk është miratuar megjithëse ai duhet të ishte bërë efektiv brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pra prej muajit qershor 2019. Vet institucioni e ka evidentuar boshllëkun e krijuar dhe ka kërkuar plotësimin e bazës ligjore. Megjithatë, prej rreth 8 muajsh ky udhëzim mungon, duke mospërbushur dukshëm kërkesat e përcaktuara nga ligjvënësi.</p>
Kriteri:	-Urdhrin i Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017, Neni 15 “Të ardhurat buxhetore”, pika 4 e tij , - VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë institucionale.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Shkaku:	Mungesë e udhëzimit të përbashkët MK-MFE
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 3:	Ka vijuar pagesa e sistemeve tej afateve të përcaktuara
Situata:	<p>Nga auditimi mbi pagesat e kryera nga institucioni për periudhën nën auditim vitet 2017-2019 rezultoi se, gjatë kësaj periudhë janë paguar shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve informatikë W. G, sistem i cili përdoret për inventarizimin dhe paraqitjen në hartë të monumenteve të kulturës.</p> <p>-Referuar ndryshimeve ligjore të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, nga ana e IMK dhe AKSHI-t është ngritur grupi i përbashkët i punës regjistruar në IMK nr. 408 prot. datë 20.02.2019, për kalimin kapital të sistemit pranë AKSHI. Me urdhrin e brendshëm të IMK nr. 408/1 datë 20.02.2019, është përcaktuar komisioni për dorëzimin e aktiveve. Vonesat në fillimin dhe përfundimin e procedurës së dorëzimit të sistemit si dhe vonesat në reflektimin e ndryshimeve të kontratës së mirëmbajtjes lidhur midis IMK dhe operatorit ekonomik fitues referuar pikës 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar, e kanë ekspozuar institucionin drejt shpenzimeve të panevojshme nga buxheti i vet lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për këto sisteme në shumën 360,000 lekë.</p>
Kriteri:	VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, pika 18 dhe 19, dhe 24 e tij.
Ndikimi/Efekti:	Shpenzime të kryera në shumën 360,000 lekë pa efektivitetin e pritshëm
Shkaku:	Mospërmbushje në kohë e detyrimeve ligjore
Rëndësia:	E mesme

Titulli i Gjetjes nr. 4:	Në strukturë mungon pozicioni i punës për menaxhimin e burimeve njerëzore
Situata:	<p>Për periudhën nën auditim menaxhimi i burimeve njerëzore nuk gjendet si pozicion i dedikuar në strukturën e mëparshme të institucionit, referuar kjo VKM nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabinetit vendihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore,” e cila në pikën 8 të saj përcakton se,</p> <p><i>Në institucionet, që kanë të paktën 30(tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore. Në varësi të madhësisë së institucionit ky pozicion mund të jetë i dedikuar ose të ketë përgjegjësinë edhe për kryerjen e funksioneve të tjera.</i></p> <p>Pavarësisht kësaj mangësie në strukturë, dokumenti “Përshkrimet e punës” pjesë e Rregullores së Brendshme, detyrat e këtij funksioni ja ka ngarkuar Përgjegjësit të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i cili është caktuar njëkohësisht edhe “Nëpunësi Zbatues” i institucionit për këtë periudhë çka bie ndesh me përcaktimet ligjore përkatësisht Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 21 datë 25.10.2016 pika 2.3 e tij, Ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) neni 12 pika 3/ç, e tij.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

	Caktimi i punonjësit i cili duhet të kryente detyrën e burimeve njerëzore të institucionit sipas dispozitave të lartëpërmendura nuk duhet të ishte pjesë e stafit të financës e aq më pak e nëpunësit zbatues i cili ka funksion mbikëqyrës dhe jo hartuesi si në rastin konkret. Sa më lartë tregon që institucioni për periudhën nën auditim nuk ka një ndarje të detyra të drejtë të detyrave dhe sistemi i kontrollit të brendshëm paraqitet me mangësi.
Kriteri:	-VKM nr. 893, datë 17.12.2014 pika 8. -Ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) neni 12 pika 3/ç, e tij. - UMF nr. 21 datë 25.10.2016 pika 2.3 e tij,
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në përmbushjen e detyrave funksionale të NZ.
Shkaku:	Mangësia në structure e pozicionit të dedikuar për BNJ
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 5:	Problematika lidhur me procesin e inventarizimit dhe regjistrimit të aktiveve.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, institucioni për vitet 2017 dhe 2018 ka kryer procedurën e inventarizimit të aktiveve, ndërsa për vitin 2019 megjithëse është nxjerrë urdhri nga titullari i institucionit nr. 2605 prot, datë 12.12.2019 procesi deri në këtë fazë të auditimit ende nuk ka përfunduar. Kjo edhe për shkak të mungesës të një afati të shkruar për përfundimin e procesit. Për inventarizimet e mbyllura për vitet 2017-2018 komisionet përkatës nuk rezultojn të kenë mbajtur procesverbal për verifikimet e kryera si dhe raport të shkruar mbi inventarizimin fizik të aktiveve në kundërshtim me pikën 85/a,b të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Vlerat përmbledhëse të kartelave të inventarizuara dhe firmosura nuk përkojnë me vlerat totale të pasqyruara në kontabilitet, çka tregon mangësi në përfundimin e plotë të këtij procesi. Të meta në dokumentacion evidentohen edhe në regjistrimin e aktiveve të hyra pa pagesë si dhe marrjen në dorëzim të tyre nga institucioni për të cilat kërkohet një vëmendje më e madhe nga institucioni.
Kriteri:	-Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/b, 53, 60, 83, 85, i tij,
Ndikimi/Efekti:	Risk për administrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve
Shkaku:	Mospërmbushje e plotë e procesit si dhe mangësi mbikëqyrëse institucionale
Rëndësia:	E mesme

4. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE:

- a. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.
- b. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave punëve dhe shërbimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për "*Restaurim i Objektivit “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)” Lezhë*" 2018, konstatohet:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Restaurim i Objektivit “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)” Lezhë 2018		
1. Urdhër Prokurimi Nr 911 Datë 09.05.2018	3.1 Njësia e Prokurimit L.B O.B E.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave A.I N.N L.D E.P A.B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 27,750,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 27,700,539 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 49,461 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 01.06.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 18.06.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 33,240,646 lekë	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me Vendimin nr. 1886 datë 10.06.1973 i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut) shpallet monument kulture kategoria e II. Me Vendimin e KKR-së nr. 39 datë 10.01.2018, miratohet projekti “Restaurim i Kishës së Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut).

- Me procesverbalin nr. 565/1 prot. Datë 30.04.2018, të Këshillit Kombëtar i Arkeologjisë miratohet projekti i restaurimit të Vendvarrimi i Skëndërbeut, Lezhë, bazuar VKM nr. 493 datë 13.09.2018 i përcaktuar si “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skëndërbeut. Miratimi i KKA është me kushtin që punimet e zbatimit të jenë në monitorim të vazhdueshëm.

- Me kërkesën për autorizim të titullarit të IMK nr. 743/2 prot. Datë 23.04.2018, drejtuar Ministrisë së Kulturës, kërkohet autorizim për fillimin e procedurave të prokurimit dhe me autorizimin e Ministrit të Kulturës nr. 2796/1 datë 25.04.2018, lejohen të fillojnë procedurat prokuruese.

- Me kontratën për njoftime nr. 849/1 prot. Datë 03.05.2018, nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me RTVSH, për transmetimin në TVSH të njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit. Me kontratën për reklamë në botim në gazetë nr. 850/1 prot. Datë 03.05.2018 nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me Gazetën M., për publikimin e njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të IMK nr. 911 datë 09.05.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 27,750,000 lekë pa TVSH, me objekt "Restaurim i Objektivit “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)” Lezhë”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga L.B, O.B dhe E.M. Ngarkohet edhe njësia e vlerësimit e përbërë nga A. I, N. N, L.D, E.P dhe A.B.

Urdhri i prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007.

- Me procesverbalin nr. 911/1 prot. Datë 10.05.2018 përcaktohen kërkesat kualifikuese dhe kriteret e kualifikimit.

Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese janë bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret të vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Në pikën 2.2.kërkohej nga Ak bazuar kushteve restauruese që, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës.

“CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.

Drejtuesi teknik/ restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës.

“AZ/1. Zbatim në konservimin e restaurimin e rrënojave arkeologjike”

“AZ/2. Zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4)”;

Gjithashtu në pikën 3.2. Ak ka kërkuar Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me listëpagesa dhe diplomë për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 specialistë të fushës si më poshtë vijon: Restaurator, Inxhinier ndërtimi

3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar ne listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e konkurimit publik (për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës), diplomë dhe liçence, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon: Inxhinier Elektrik, Arkeolog, Specialist në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale (të zotërojë liçensë B1,B2 të sipërcituar).

Pranë Ak kanë bërë kërkesë për terheqje dokumentacioni tenderi 4 kompani. Me procesverbali e hapjes së ofertave nr. 911/3 prot. Datë 01.06.2018 në procedurë kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik si më poshtë :

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“K” sh.p.k & “M/S”shpk	27,700,539	Kualifikuar
2	“A-S” sh.p.k	27,726,125	S'kualifikuar

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Sipas procesverbalit të shqyrtimit të ofertave nr. 911/4 datë 04.06.2018, KVO bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se:

1. Nga vlerësimi i ofertës Njësia e Vlerësimit konstatoi se Bashkimi i përkohëshëm i operatorëve “K. shpk & M/S” shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë BOE.

2. Nga vlerësimi i ofertës Njësia e Vlerësimit konstatoi se shoqëria “A-S” shpk ka dorëzuar ofertën me mangësi dhe konkretisht, lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 3.3 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik.

3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar ne listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e konkurimit publik (për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës), diplomë dhe liçence, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon: Inxhinier Elektrik, Arkeolog, Specialist në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale (të zotërojë licensë B1, B2 të sipërcituar).

- Shoqëria “A-S” sh.p.k nuk plotëson kushtin 3.3. Dëshmi për fuqinë punëtore, Specialist në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale (të zotërojë licensë **B1, B2** të sipërcituar). Licensa R.P.45 e specialistit M. A. është për kategori B/2 dhe B/3, ndërkohë që në DSR kërkohet B/1 , B/2, përse më sipër vijon shoqëria “A-S” sh.p.k nuk e plotëson kushtin që specialisti në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale të zotërojë licensë Kat. **B/1**.

Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika 19. Shqyrtimi paraprak i ofertave, Institucioni publik do të shqyrtojë çdo oferte për të konfirmuar se të gjitha dokumentat dhe dokumentacioni i kërkuar në dokumentat e restaurimit është siguruar dhe për të përcaktuar plotshmërinë e çdo dokumenti të paraqitur. Nëse ndonjë prej dokumentave të kërkuar mungon ose është i paplotë, oferta do të refuzohet.

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi, Njësia e Vlerësimit vendosi të refuzojë ofertën e shoqërisë “A-S” shpk.

-Me raportin përmbledhës nr. 1244 prot. Datë 11.06.2018, miratohet nga titullari i IMK, procedura e prokurimit. Me shkresën nr. 1244/2 datë 11.06.2018 drejtuar APP, njoftohet fituesi i restaurimit.

c. Mbi zbatimin e Restaurimit.

- Kontrata e restaurimit për “Restaurim i Objektivit “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)” Lezhë” nënshkruhet me nr. 1292 prot. Datë 18.06.2018, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D.P dhe operatorit ekonomik K. shpk, përfaqësuar nga administratori z. K.C.

- Vlera e kontratës është 27,700,539 lekë pa TVSH me afat zbatimit 180 ditë nga lidhja e kontratës, sipas grafikut të punimeve. Lloji i kontratës është kontratë me çmim njësie të bazuar në çmimet e njësisë, të shprehura në preventivin në njësi, bazuar nën 10 të kontratës.

- Për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës bazuar në nenin 8 të kontratës “Drejtuesi – Mbikëqyrësi i Projektit” përcaktohet se drejtuesi i projektit është mbikëqyrësi i punimeve të restaurimit i autorizuar me shkrim nga IMK. Drejtuesi i projektit (mbikëqyrësi) do të vendos çështjet e kontratës midis kontraktuesit dhe AK, i cili mban korrespondencë të datuar me shkrim. Gjithashtu drejtuesi i projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrëveshje.

Referuar përcaktimeve në kontratë për drejtuesin e projektit, nuk është përcaktuar me përgjegjësitë e tij në përputhje me nenin 7 ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, ku citohet në mënyrë eksplicite:

Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, **gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse.**

- Me shkresën nr. 1286 prot. Datë 14.06.2018, caktohen personat përgjegjës për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, si më poshtë:

A.V, si mbikëqyrës i punimeve të restaurimit

P. B, si mbikëqyrës i punimeve të restaurimit të pikturës

Ll.B, si kolaudator i punimeve të restaurimit.

Në zbatim të ligjit 27/2018 "Për trashëgimime kulturore dhe muzete" Neni 72 Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja, kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse

1. Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim ose institucionet shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e pasurive të trashëgimisë kulturore.

2. Zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre u nënshtrohen vetëm parashikimeve të këtij ligji dhe për aq sa është e mundur, legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

3. Projektimi, zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30, pika 10 “Kompetencat e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i po këtij ligji, parashikon si kompetencë Kryerjen e kontrollin teknik, mbikëqyr dhe kolaudon punimet në pasuritë kulturore material. Pojektaktet për rregullimin e kësaj veprimtarie nuk janë miratuar ende nga Instutucionet përgjegjëse.

"Regullorja mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit", miratuar me Vendim KKR nr. 75 date 3.4.2015 dhe ndryshuar me Vendim KKR nr. 58 date 10.1.2018, përcakton kriteret dhe llojet e licencave vetëm në projektim dhe zbatim. Pra nuk përcaktohet mbi mbikëqyrjen dhe kolaudimin e restaurimit.

Në nenin 83 Llojet e licencave përcaktohet se Licencat për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë licencat për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim. Këto licenca miratohen me vendim të KKTKM-së për subjektet që plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, të parashikuar në pikën 4, të nenit 82, të këtij ligji.

Bazuar në preventivin dhe kontratën e “Restaurim i Objektivit “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)” Lezhë, në situacionin përfundimtar punimet e restaurimit, mozaikëve dhe pikturës rezultojnë në vlerën prej 4.6 milion lekë pa tvsh ose 20 %, ku punimeve e tjera të prishje, pastrimit, rikonstruksionit dhe elektriket rezultojnë në vlerën 23.1 milion lekë.

Ndërkohë, asnjë nga personat e caktuar si mbikëqyrës dhe kolaudator, nuk disponojnë licensën përkatëse të restaurimit, cka do të thotë se mbikqyrja dhe kolaudimi i punimeve të restaurimit nuk është në përputhje me lagjislacionin e disiplinimit të ndërtimit dhe trashëgimisë kulturore.

Bazuar në Ligjin 27/2018 "Per trashëgimime kulturore dhe muzete" neni 278 “Shfuqizime”, pika 3 dhe 4 citon se Aktet nënligjore të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, ***do të zbatohen*** derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

datë 4.5.2005, “Për muzetë”, *mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore*, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Vlen të theksohet se në IMK ka të punësuar specialist të cilët disponojnë licensa përkatëse të restaurimit si Z.L, A.S dhe M.M, por që nuk janë përcaktuar për mbikëqyrje dhe kolaudim të objektit, të cilët nuk janë shfrytëzuar për kapacitetet e tyre.

- Akti i dorëzimit të sheshit të punimeve është realizuar më datë 18.06.2018 dhe njoftimi i fillimit të punimeve, procesverbali i fillimit të punimeve, nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi janë realizuar me shkresën nr. 1292/1 datë 18.06.2018.

- Me memon nr. 1633 prot. Datë 30.07.2018 të mbikëqyrësit të punimeve, u konstatua se gjatë zbatimit të punimeve restauruese dhe gjatë azhurnimit të gjendjes faktike të objektit “*Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)*” Lezhë, ku nuk janë parashikuar disa zëra punimesh si prishja e shtresave betoni, bojë hidroplastike, pastrimi i fasadës nga pluhuri, thellimi i fugave ekzistuese, pastrim nga bimësia, pastrimi i njollave nga cimcakizët dhe pastrimi i dyshemesë me metodën e lucidimit, ku kërkohet të mos tejkalojë vlerë e fondit, duke rishikuar preventivin. Me urdhërin nr. 1633/1 datë 31.07.2018, ngrihet grupi i punës për testimin e tregut dhe përlllogaritjen e cmimeve për zërat e rinj, i cili përbëhet nga L. B, O. B dhe .M. Grupi i studimit të tregut me shkresën nr. 1633/2 datë 01.08.2018, i dërgon kërkesë për ofertë shoqërive “M/S”shpk, “*K*”shpk dhe “A-S”. Ofertat ekonomike të shoqërive janë pathuasje të njëjta në vlerat 3 milion lekë me diferenca shumë të vogla, me pothuajse në të njëjtin format dhe shkrim oferte, ku kompanive “M/S”shpk dhe “A-S”, i mungojnë edhe logot e kompanive. Me procesverbalin nr. 1680/1 prot. Datë 06.08.2018, miratohen cmimet njësi me diferenca shumë të vogla. Në preventivin e projektit është parashikuar fondi rezervë prej 5 % dhe në ofertën ekonomike të OE parashikohet në vlerën 1,319,073 lekë pa TVSH.

- Me këkesën e operatorit ekonomik “K”shpk nr. 1948/1 prot. Datë 20.09.2018, kërkohet përdorimi i fondit rezervë, në 2 zëra punimesh, për pastrim të njollave të zeza të cimcakizave dhe lucidimin e dyshemesë me pllaka. Sasia e pastrimit e cimcakizave është 200,8 m² dhe lucidimi në sasinë 694 m². Me procesverbalin datës 20.09.2018, miratohet përdorimi i fondit rezervë nga mbikëqyrësi i punimeve. Me këkesën e operatorit ekonomik “K”shpk nr. 1948 prot. Datë 20.09.2018, kërkohet miratimi i preventivit të rishikuar bashkë me tabelën e levizjes së volumeve.

-Kontrata përbëhet prej 4 situacione pjesore progresive të kontratës bazë, *të cilat nuk janë shoqëruar me librezë masash pjesore*, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, *Kreu II, pika 8.1* “*Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës*” dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se:

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- Me shkresën nr. 2356 prot. Datë 14.11.2018, njoftohet përfundimi i punimeve nga kontraktori dhe më datë 14.11.2018 është mbajtur procerverbali i përfundimit të punimeve, ku kontrata është realizuar brenda afateve kontaktuale.

Nga auditimi situacionit përfundimtar të kontratës, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave konstatohet disa pasaktësi si më poshtë vijon:

- Zëri nr. 12 i kapitullit të restaurimit “Pastrim i njollave të zeza të cimcakëzave dhe ndotjeve të tjera në dysheme me presion uji të ngrohtë, më pas heqja me spatul metalike dhe furcë teli, duke ruajtur sipërfaqen e plakës” me cmim njesie prej 500 lek/m², ku analiza e paraqitur është vendosur me makineri pastrimi, ndryshe nga specifikimi i vetë zërit. Nga kërkesa e operatorit ekonomik nr. 1948/1 prot. Datë 20.09.2018, ku kërkohet përdorimi i fondit rezervë, në 2 zëra punimesh, për pastrim të njollave të zeza të cimcakëzave dhe lucidimin e dyshemesë me pllaka. Sasia e pastrimit e cimcakëzave në situacionin përfundimtar është 600 m² dhe lucidimi në sasinë 694 m². Në fakt, zëri i lucidimit të dyshemesë me pllaka e **përfshin** në vetvete zërin e pastrimit të njollave të zeza dhe më pas duke e luciduar atë. Makineria e lucidimit e realizon më së miri dhe pastrimin e dyshemesë ku zëri i pastrimit të njollave të zeza është i mbivendosur zërit të punës. Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sipërfaqen 600 m² me cmimin prej 500 lek/m² rezulton vlera prej **300,000 lekë pa TVSH**.

- Zëri nr. 1 i kapitullit të rikonstruksionit të mbulimit “Mbulesë me strukturë alumini me xham (xham triplex 8x2x8 mm), me cmim njësi 20,398 lek/m².

Në libezat e masave bashkëlidhur skicat e dimensioneve konstatohen mospërputhje të sasive. Cm montimi i kapriadës metalike me HD 22m, mbuluar me plasmas të valëzuar paraqet dimensionet 32.4 m x 17.7 m, në total 573,5 m², ndërsa “Mbulesë me strukturë alumini me xham (xham triplex 8x2x8 mm)” paraqet dimensionet 32.55 m x 17.95 m, në total 584,2 m². Nga verifikimi i planimetrive të kapriadës së valëzuar dhe mbulesë me xham triples, konstatohet se dimensionet duhet të jenë të njëjta ose më të vogla për xhamin triples pasi montohen në kolonat e strukturës ndryshe nga kapriada. Rrjedhimisht siërmarrësi ka përfituar padrejtësisht diferencën e sasisë prej 584,2 m² - 573,5 m² = 10.7 m², ku me cmimin përkatës prej 20,398 lek/m², rezulton vlera prej **218,258 lek pa TVSH**.

Sa më sipër, vlera këtyre zërave prej 518,258 lekë pa TVSH ose 621,909 lekë me TVSH, përbën dëm ekonomik i përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për "**Restaurim Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastrë**" 2018, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Restaurim Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastrë" 2018		
1. Urdhër Prokurimi Nr 899 Datë 09.05.2018	3.1 Njësia e Prokurimit L.B O.B E.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave A.I N.N L.D E.P A.B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 18,750,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 17,489,216 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,260,784 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 30.05.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 b) S'kualifikuar 1 OE,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

		c) Kualifikuar 3 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 18.06.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 20,987,059 lekë	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me Vendimin nr. 1886 datë 10.06.1973 i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Kisha Peshkëpisë e Sipërme, Gjirokastrë shpallet monument kulture kategoria e I. Me Vendimin e KKR-së nr. 220 datë 18.04.2018, miratohet projekti “Restaurim Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastrë.

- Miratim nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë nuk gjenden në dosjen e procedurës së prokurimit. Me kërkesën për autorizim të titullarit të IMK nr. 743/2 prot. Datë 23.04.2018, drejtuar Ministrisë së Kulturës, kërkohet autorizim për fillimin e procedurave të prokurimit dhe me autorizimin e Ministrit të Kulturës nr. 2796/1 datë 25.04.2018, lejohen të fillojnë procedurat prokuruese. Me kontratën për njoftime nr. 849/1 prot. Datë 03.05.2018, nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me RTVSH, për transmetimin në TVSH të njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit. Me kontratën për reklamë në botim në gazetë nr. 850/1 prot. Datë 03.05.2018 nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me Gazetën Mapo, për publikimin e njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të IMK nr. 899 datë 09.05.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 18,750,000 lekë pa TVSH, me objekt “Restaurim Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastrë” 2018, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga L.B, O.B dhe E.M. Ngarkohet edhe njësia e vlerësimit e përbërë nga A.I, N.N, L. D, E. P dhe A. B.

Urdhri i prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007.

- Me procesverbalin nr. 899/1 prot. Datë 10.05.2018 përcaktohen kërkesat kualifikuese dhe kriteret e kualifikimit. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese janë bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret e vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 date 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës“. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pika 4.ç), subjektet të cilat kualifikohen sipas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas rastit në dokumentet standarde të restaurimit, i nënshtrohen kriterëve vlerësues për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.

Oferta më e mirë ekonomike do të konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Oferta ekonomike me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë **85 pikë**, ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës.

b) Eksperienca e subjekteve konkurrues, që mund të jenë:

- shoqëri restauruese;
- shoqëri ndërtimi
- me nënkontraktorë restaurator;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- individë restaurues do të vlerësohet deri në 15 pikë. Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale *parashikohen në dokumentet standarde të konkurrimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.* Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e para më shumë se një ofertë, njësia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit të përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi. Vendimi i Komisionit për ofertën më të mirë ekonomike duhet të jetë i argumentuar.

- Në kërkesat e vecanta kualifikuese Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit ka përcaktuar bashkësi kërkesat si më poshtë :

2.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë license profesionale e cila të përmbajë kategoritë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MZHU:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

NP – 1 (A) Punime gjurmimi në tokë, NP – 2 (B) Ndërtime civile dhe industrial,

Punime speciale ndërtimi:

NS – 1 (A) Punime për prishjen e ndërtimeve, NS – 4 (A) Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese, NS – 8/b (A) Struktura metalike, **NS – 14 (A)** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

2.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës.

“**CZ.** Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.

Drejtuuesi teknik/ restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës.

“**AZ/2.** Zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4)”;

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës “B. Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale”. B/2. *Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve*; B/3. *Projektim dhe zbatim në restaurimin e veprave të artit në dru ose të ketë të kontraktuar një restaurator me licensë profesionale individuale në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës: B/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve; B/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin e veprave të artit në dru.* Kjo të vërtetohet me një kontratë bashkëpunimi me emërtim objektin qëllim i konkurrimit publik. Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

3. Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

3.2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me listëpagesa dhe diplomë për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 specialistë të fushës si më poshtë vijon:

- Restaurator
- Inxhinier ndërtimi

3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar në listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

konkurrimit publik (*për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës*), diplomë dhe liçence, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon:

- Inxhinier Elektrik
- Inxhinier Gjeolog
- Specialist në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale (*të zotërojë licensë B2,B3 të sipërcituar*)

Kërkesa e mësipërme për NS – 14 (A) Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj dhe Inxhinier Elektrik, janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 26** "Kontrata për punë publike" pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Sipas projekt-preventivit të punimeve konstatohet se nuk ekzistojnë punime Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, që të kërkohej si kriter kualifikues, pra nuk është në përputhje me natyrën e kontratës.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Pranë Ak kanë bërë kërkesë për terheqje dokumentacioni tenderi 6 kompani.

Me procesverbali e hapjes së ofertave nr. 899/3 prot. Datë 30.05.2018 në procedurë kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	"J"shpk	16,654,279	Kualifikuar
2	"M/S" sh.p.k	18,715,771	Kualifikuar
3	"A-S" sh.p.k	17,489,216	Kualifikuar
4	"L. K" shpk	16,311,846	S'kualifikuar

Me procesverbalin nr. 899/4 prot. Datë 07.06.2018 shqyrtuan ofertat, ku i vetmi operator i s'kualifikuar është "L. K" shp.k i cili ka dorëzuar ofertën me mangësi si më poshtë:

- Shoqëria "L. k" shpk, nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika 4. Nuk disponon mjetin Autobot Uji të kërkuar në DSR për realizimin e kontratës.

- Shoqëria "L. k" shpk nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika dh. Nuk ka dorëzuar deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8.

- Shoqëria "L. k" shpk nuk plotëson kushtin 3.3. Dëshmi për fuqinë punëtore, Specialist në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale (të zotërojë licensë B2,B3).

- Shoqëria "L. k" shpk, dokumentacioni i dorëzuar rezulton për specialisten E.C e cila nuk është pjesë e stafit të shoqërisë por e kontraktuar. Shoqëria ka dorëzuar kontratën e bashkëpunimit dhe licensën por nuk ka dorëzuar diplomën e specialistes, sic kërkohet në DSR. Përsa më sipër vijon shoqëria "L. k" shpk nuk e plotëson kushtin e vërtetësisë me Diplomë për Specialistin në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale.

Sipas procesverbalit në vlerësimin e ofertës më të mirë ekonomike nr. 899/5 datë 07.06.2018, KVO vijon të vlerësojë ofetat më të mira ekonomike për OE si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	Pikët nga oferta më e ulët	Pikët nga vlerësimi KVO	Pikët Total
1	"J"shpk	16,654,279	85	6.86	91.86
2	"A-S" sh.p.k	17,489,216	80	14.1	94.1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

3	“M/S” sh.p.k	18,715,771	75	15	90
---	--------------	------------	----	----	----

Në zbatim të pikës 3, b të Udhëzimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve Nr. 446, datë 05.07.2007 “Për miratimin e dokumentave standarte të konkurimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, në të cilën citohet se: b) *Eksperienca e subjekteve konkurruese mund të jetë:-Shoqëri restauruese; -Shoqëri ndërtimi, -me nënkontraktor restaurator; - Individë restaurues të cilat do të provohen me kontrata të ngjashme, a vërtetime të punimeve të restaurimit, referenca, patenta, eksperienca të vlerësuara, specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmërinë në fushën e restaurimeve apo dokumenta të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë. Do të vlerësohet deri në 15 pikë. Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale parashikohen në dokumentat standarte të konkurimit në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.*

I. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “J” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën kontratat të ngjashme ka dorëzuar 3 (tre) kontratë të ngjashme; në rubrikën Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria nuk ka dorëzuar asnjë dokument justifikues, në rubrikën patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015; ndërsa në rubrikën specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumete të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator znj. P.Bme License Restaurimi R.P.69 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në zbatim, inxhinier ndërtimi, profili Civile industriale ura Z. 1633/5, Specializim nga CH –Trashëgimia kulturore pa kufije (S.S).

Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operatorët e tjerë në krahasim OE me të suksesshëm) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperiencat e subjekteve konkurruese si kritere vlerësuese, rezulton që shoqëria “J” shpk të vlerësohet me **6.86 pikë**.

II. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “A-S” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën a. kontratat të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të ngjashme, përkatësisht *R i M të Shën Mërise dhe peisazhit ne Apolloni, Date 30.03.2018, Vlera 695.034 euro (87.448.284 leke)*; në rubrikën b. Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria “A-S” shpk ka dorëzuar 6 kontrata restaurimi (të detajuara në matricën bashkëlidhur), në rubrikën d. patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2008; në rubrikën e. Eksperienca të vlerësuara shoqëria “A-S” shpk ka dorëzuar Vërtetim nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, date 19.07.2016 Per projektet e zbatuar nga Shoqëria "A-S" shpk, ndërsa në rubrikën f. specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumete të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator z: P. Th, Licence Restaurimi R.P.40 (Kat.AZ/1- AZ/4).

Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operatorët e tjerë në krahasim OE me të suksesshëm) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperiencat e subjekteve konkurruese si kritere vlerësuese, rezulton që shoqëria “A-S” shpk shpk të vlerësohet me **14.1 pikë**.

III. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “M/S” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën kontratat të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të ngjashme, përkatësisht “Restaurimi i godines se Ish Selise se drejtorise se Sigurimit te Shtetit, Gjethi,” realizuar në vitin 2015 me vlerë 13.544.611 lekë; në rubrikën Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

“M/S” shpk ka dorëzuar 9 kontrata restaurimi (të detajuara në matricën bashkëlidhur), në rubrikën patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015; në rubrikën e Eksperiencës të vlerësuar shoqëria “M/S” shpk ka dorëzuar Shkresë nga Departamenti i Inxhinierise Strukturale, Universiteti P. i M., ndërsa në rubrikën specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumente të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezultojnë që shoqëria ka Restaurator z. B.M me License Restaurimi R.P.72 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në projektim, inxhinier ndërtimi, profili strukturist, K.1011/1 dhe Licensë K.1011/2, Licensë profesionale individuale, Nr. 1. datë 13.5.2013 “Për vlerësim të pasurive të paluajtshme”, Licensë personale në zbatim, inxhinier Ndërtimi, profili strukturist, Licensë Z.4587/1.

Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operatorët e tjerë në krahasim OE me të suksesshëm) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperiencat e subjekteve konkures si kritere vlerësuese, rezultojnë që shoqëria “M/S” shpk shpk të vlerësohet me 15 pikë.

Referuar sistemit të pikëzimit nga KVO, konstatohen interpretime në kundërshtime me parimet e barazisë në tendera dhe trjatime jo të njëjta në garë si më poshtë:

a. Për kontratat e ngjashme është vlerësuar me 100 pikë shoqëria “A-S”sh.p.k, me kontratë të ngjashme “Rehabilitimi i Manastirit të Shën marisë dhe peisazhit në Apolloni” me AK B. E në vlerën 87,448,284 lekë. Pra 87,448,284 lekë është marrë **100 pikë** dhe këtu nis referenca për operatorët e tjerë.

- OE “J”shpk ka paraqitur 3 kontrata në vlerë 13,136,090 lekë dhe referuar krahasimit me OE “A-S” i cili mori 100 pikë për vlerën 87,448,284 lekë, rezultojnë se OE duhet ti jepet **15.02 pikë**.

- OE “M/S”shpk ka paraqitur 1 kontrata në vlerë 13,544,611 lekë dhe referuar krahasimit me OE “A-S” i cili mori 100 pikë për vlerën 87,448,284 lekë, rezultojnë se OE duhet ti jepet **15.48 pikë**.

Pra sa më sipër rezultojnë një sistem vlerësimi i pabarabartë dhe jo i drejtë pasi pikët maximale fitohen nga OE që ka paraqitur kontratën të ngjashme me vlerë më të madhe, duke mos i vënë në kushte të barabarta OE e tjerë pjesëmarrës, në kundërshtim me parimin e kushteve të njëjta dhe të barazisë në një garë. Vlen të theksohet se trajtimi i barabartë krijohet nga interpretimet e KVO, ku në asnjë një faqe të DST, nuk përmendet sistemi i vlerësimit dhe ky lloj kushti garimi. Në DST kërkohet vetëm punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej **50% e vlerës** së përlogaritur të kontratës së konkurrimit publik dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, të jetë sa **dyfishi** i vlerës limit së kontratës së konkurrimit publik, i cili plotësohet nga të gjithë konkurentët.

-Cdo konkurent sipas LPP vlerësohet në bazë të kritereve të përcaktuara nga enti prokurues ose enti publik për të cilat është i detyruar ti plotësojë ose jo dhe në asnjë rast nuk mund të bëhet vlerësim mbi kritere të cilat asnjëherë nuk janë kërkuar dhe aq më pak nuk janë bërë publike për të gjithë konkurentët duke shkelur parimin e barazisë në konkurim dhe vendosjen në kushte të njëjta konkurimi dhe jo diskriminues për konkurentët e mundshëm.

- Paraqitja e një dokumenti ekstra të pakërkuar nga E. Prokurues nuk e ndalon konkurentin ti paraqesë ato, por nuk përbën kriter favorizimi për të.

- Vlerësimi me pikë i kryer dhe raporti i pikëzimit bazuar në kritere të pakërkuar dhe të vlerësuar maksimalisht, cili për rrjedhojë ka sjellë renditje jo të drejtë të konkurentëve jo vetëm nuk ka asnjë mbështetje ligjore Udhëzimin MTKRS, Nr. 446, datë 05.07.2007, por ka bërë që të kemi dhe diferenca financiare, midis ofertave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

b. Për vërtetimet të punimeve të restaurimit, të cilat jepen kryesisht nga vetë IMK, shoqëria “J” ka marrë 0 pikë, pasi nuk ka marrë asnjë punë. Shoqëria “M/s” ka 9 vërtetim dhe ka marrë 100 pikë (Pra nga ky OE nis referenca për të vlerësuar të tjerët). Shoqëria “A-s” ka paraqitur 6 vërtetime dhe nga përpjestimi i rezultojnë 66.6 pikë.

c. Referenca të tre OE nuk kanë paraqitur dhe kanë marrë 0 pikë të tre, pasi normalisht nuk është kërkuar në DST.

d. Patenta të 3 kanë paraqitur ISO 9001:2015 dhe të tre OE kanë marrë 100 pikë, pasi vetëm kjo ishte kërkuar në DST. Pra sipas vlerësimit të pikëzimit nga KVO, nëse një OE do të paraqiste 30 certifikata ose patenta do të merrte 100 pikë, atëherë OE të tjerë ekonomik do ti rezultonin nga 3.3 pikë, do të përmbyseshin përsëri rezultati i vlerësimit. Por, OE paraqesin në tender vetëm kërkesat e kërkuara nga E. Prokurues, pasi cdo dokument kërkohej i noterizuar dhe përbën kosto shtesë për OE dhe nuk ka nevojë të dorëzojë dokumente shtesë pasi nuk janë kërkuar.

e,f. Eksperinca të vlerësuar, specializime apo trajnime të tjera, rezultoi se shoqëria “M/S” ka paraqitur 4 licensa shtesë (Për vlerësimin pasurive paluajtshme, licensë strukturisti etj, që nuk janë kërkuar në dst) dhe është vlerësuar me 100 pikë. Shoqëria “A-S” vetëm licensën e restauratori dhe në përpjestim rezulton 25 pikë (referuar “M/s). Shoqëria “J” ka paraqitur 3 licensa dhe referuar OE “M/s” përpjestimi i bie me 75 pikë.

- Në total nga KVO citohet se për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomike më të suksesshem dhe X pikë për operatorët e tjerë në krahasim me OE më të suksesshem) e për 6 variablat e përcaktuara në pikën b rezulton totali si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Pikët nga vlerësimi KVO	Pikët Total, në përpjestim më OE që ka më shumë pikë
1	“J”shpk	190	6.85
2	“A-S” sh.p.k	391	14.1
3	“M/S” sh.p.k	415.48 (100% ose 15 pikë)	15 pikë

Si përfundim me raportin përmbledhës nr. 1250 prot. Datë 12.06.2018 miratohet përfundimi i procedurës ku shpallet fitues shoqëria “A-S” me vlerë 17,489,216 pa TVSH. Me urdhërin nr. 1250/1 datë 12.06.2018 të Drejtorit Përgjithshëm A.D, shpallet fituesi dhe urdhërohet publikimi i tij. Me shkresën nr. 1250/2 datë 12.06.2018 drejtuar APP, njoftohet fituesi i restaurimit.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, nga sistemi i vlerësimit të pikëve nga KVO, janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **neni 1** ku përcaktohet: “*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public*”. **Neni 2** të LPP “*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit*”.

Për sa trajtuar më sipër, Oferta e “Jogi” sh.p.k”, me vlerë 16,654,279 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për IMK, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar legjislacionit të LPP dhe Udhëzimeve apo VKM të trashëgimisë kulturore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Interpretimet e sistemit të pikëzimit janë të kundraligjshme duke i trajtuar jo në mënyrë të barabartë OE.

Pra sistemi i vlerësimit ka krijuar efekte financiare negative, si pasojë konstatohet diferencë në vlerë prej **1,001,924 lekë me TVSH** (17,489,216 lekë - 16,654,279 lekë = 834,937 lekë x 20% TVSH), midis ofertës së “J” sh.p.k”, “ shpk dhe ofertën e Operatorit Ekonomik “A-S” shpk, të shkaktuar nga vlerësimi i ofertave me sistemin e pikëzimit për ofertën më të mirë, të cilat nuk janë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit.

c. Mbi zbatimin e Restaurimit.

- Kontrata e restaurimit për “Restaurim Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër” nënshkruhet me nr. 1293 prot. Datë 18.06.2018, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D.P dhe operatorit ekonomik A-S shpk, përfaqësuar nga administratori z. A.C. Vlera e kontratës është 17,489,216 lekë pa TVSH me afat zbatimit 180 ditë nga lidhja e kontratës, sipas grafikut të punimeve. Lloji i kontratës është kontratë me çmim njësie të bazuar në çmimet e njësisë, të shprehura në preventivin në njësi, bazuar nën 10 të kontratës.

- Për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës bazuar në nenin 8 të kontratës “Drejtuesi – Mbikëqyrësi i Projektit” përcaktohet se drejtuesi i projektit është mbikëqyrësi i punimeve të restaurimit i autorizuar me shkrim nga IMK. Drejtuesi i projektit (mbikëqyrësi) do të vendos çështjet e kontratës midis kontraktuesit dhe AK, i cili mban korrespondencë të datuar me shkrim.

Referuar nenit 12 ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.

- Me shkresën nr. 1285 prot. Datë 14.06.2018, caktohen personat përgjegjës për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, si më poshtë:

M.M, si mbikëqyrës i punimeve të restaurimit (disponon licensë)

G.T, si mbikëqyrës i punimeve të restaurimit të drurit

G.V, si mbikëqyrës i punimeve të restaurimit të pikturës

L.D, si kolaudator i punimeve të restaurimit. (Nuk disponon licensë)

Në zbatim të ligjit 27/2018 "Për trashëgimime kulturore dhe muzete" Neni 72 Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja, kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse

1. Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim ose institucionet shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e pasurive të trashëgimisë kulturore.

2. Zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre u nënshtrohen vetëm parashikimeve të këtij ligji dhe për aq sa është e mundur, legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

3. Projektimi, zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Neni 30, pika 10 “Kompetencat e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i po këtij ligji, parashikon si kompetencë Kryerjen e kontrollin teknik, mbikëqyr dhe kolaudon punimet në pasuritë kulturore material. Pojektaktet për rregullimin e kësaj veprimtarie nuk janë miratuar ende nga Instutucionet përgjegjëse.

"Regullorja mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit", miratuar me Vendim KKR nr. 75 date 3.4.2015 dhe ndryshuar me Vendim KKR nr. 58 date 10.1.2018, përcakton kriteret dhe llojet e licencave vetëm në projektim dhe zbatim. Pra nuk përcaktohet mbi mbikëqyrjen dhe kolaudimin e restaurimit.

Në nenin 83 Llojet e licencave përcaktohet se Licencat për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë licencat për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim. Këto licenca miratohen me vendim të KKTKM-së për subjektet që plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, të parashikuar në pikën 4, të nenit 82, të këtij ligji.

Ndërkohë, kolaudatori i punimeve nuk disponon licensën përkatëse të restaurimit, cka do të thotë se kolaudimi i punimeve të restaurimit nuk është në përputhje me legjislacionin e disiplinimit të ndërtimit dhe trashëgimisë kulturore.

Bazuar në Ligjin 27/2018 "Per trashëgimime kulturore dhe muzete" neni 278 “Shfuqizime”, pika 3 dhe 4 citon se Aktet nënligjore të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, **do të zbatohen** derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, **mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore**, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Vlen të theksohet se në IMK ka të punësuar specialist të cilët disponojnë licensa përkatëse të restaurimit si Z.L, A.S, por që nuk janë përcaktuar për kolaudim të objektit, të cilët nuk janë shfrytëzuar për kapacitetet e tyre.

- Njoftimi i fillimit të punimeve, procesverbali i fillimit të punimeve, nga sipërmarrësi dhe është realizuar me shkresën nr. 1293/1 datë 18.06.2018.

Studimi gjeologjik i karakteristikave fiziki-mekanike të dherave dhe shkëmbinjve në vendin që është ndërtuar kisha e “Shën Mërisë” në Peshkëpi, është realizuar nga shoqëri private “A. G. 2000”, e kontraktuar nga kontraktuesi “A-S”. Vlen të theksohet se në pikën 3.3 të DST është kërkuar se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar ne listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e konkurrimit publik (për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës), diplomë dhe liçence, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon:

Inxhinier Elektrik

Inxhinier Gjeolog (vendosur nga njësia e DT për hartuar studimin gjeologjik)

Specialist në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale (të zotërojë licensë B2,B3 të sipërcituar).

Operatori “A-S” në dokumentet e tij ka dorëzuar kontratë pune me Gjeolog (L Gj), Diplomë Nr.B-3677, Licensë GJ.0587, të noterizuar. Ndërkohë, në realizimin e kontratës ka kontraktuar shoqëri tjetër për kryerjen e studimit gjeologjik. Pra, paraqitja e kontratës së pune me Gjeolog (L Gj), Diplomë Nr.B-3677, Licensë GJ.0587, është paraqitur vetëm për efekt të procedurës pasi nuk ka realizuar punë për studimin gjeologjik.

- Me shkresën e sipërmarrësit nr. 1843 prot. Datë 03.09.2018, drejtuar mbikëqyrësit të punimeve konstaton se gjatë punimeve për pastrimin e mbushjeve u gjendën një sasi Qypash. Me shkresën e mbikëqyrësit nr. 158 prot. Datë 03.009.2018, njoftohet titullari i IMK, se duhet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

të njoftohet menjëherë shërbimi Arkeologjik Shqiptar dhe Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore që të vlerësojnë gjetjet dhe të gjykojnë bashkëpunimin me IMK. Me shkresën nr. 1843/1 prot. Datë 03.09.2018 njoftohet Agjensia e Shërbimit Arkeologjik për bashkëpunim në kishën e Shën Mërisë. *Veprimet e mësipërme tregojnë mosrespektim të procedurave pasi në fillim të projektit nga IMK nuk është kërkuar miratim nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë. Për objektin e restaurimit të “Shën Mërisë” nuk është kërkuar nga Ak në DST, që Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale për shoqëri sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës “A. Për veprimtari arkeologjike” A1. Vëzhgim arkeologjik (S); Ose Të ketë të kontraktuar një restaurator me licensë profesionale individuale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës A. “Për veprimtari arkeologjike” : A1. Vëzhgim arkeologjik (S), ndryshe nga projekti i “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut).*

- Me vendimin e KKR nr. 401, datë 26.09.2018, miratohet preventivi i rishikuar “Restaurimi i Shën Mërisë, Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër”. Me relacionin teknik datë 17.11.2018, deklarohet se nxjerrë nga matjet faktike, miratohet nga AK përdorimi i fondit rezervë. Volumet që shohen janë 5,291,272 lekë dhe zbriten 2,378,642 lekë me diferencë 2,912,629 lekë, i cili kërkohet përballohet nga fondi rezervë.

- Me shkresën nr.2045 prot. Datë 02.10.2018 të mbikëqyrësve të punimeve, drejtuar titullarit të AK, kërkohet zhvillimi i procedurave ligjore për zbatimin e disa punimeve shtesë të pa llogaritura në projekt-preventiv të cilat nuk mundën të përfshiheshin në fondin rezervë të kontratës bazë.

- Me urdhin e titullarit nr. 2071 datë 05.10.2018, ngrihet grupi i punës për testimin e tregut dhe përllogaritjen e cmimeve të rinj, i përbërë nga A.K, O.B, E.M.

- Me shkresë të titullarit nr. 2071/1 prot. Datë 05.10.2018, i kërkohet ftesë për ofertë shoqërive “M/S”shpk, “K”shpk dhe “A-S”. Ofertat ekonomike të shoqërive janë pathuasje të njëjta me diferenca shumë të vogla. Me shkresën nr. 2107 prot. Datë 10.10.2018 i kërkohet OE “A-S”, për negocim oferte dhe me procesverbalin nr. 2107/1 prot. Datë 12.10.2018 miratohet cmimet njësi, ku vlera e kontratës shtesë rezulton në vlerën 2,609,637 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr.2374/2 prot. Datë 20.11.2018 të mbikëqyrësve të punimeve, drejtuar titullarit të AK, sqarohet nevoja për projekt-preventiv shtesë të punimeve pasi kanë rezultuar elementë të rinj, të cilët nuk realizohet brenda fondit limit të kontratës nr. 1293 prot. Datë 18.06.2018. Punimet shtesë realizohen pjesërisht nga fondi rezervë dhe është nevoja për fond shtesë.

-Sipërmarrësi ka njoftuar përfundimin e punimeve (kontratë bazë) me shkresën nr. 2522 prot. Datë 12.12.2018 dhe mbikëqyrësi njofton përfundimin e punimeve me shkresën nr. 2536 prot. Datë 13.12.2018, brenda afateve të kontratës. Procesverbali i përfundimit të punimeve (për kontratën bazë), mbahet midis palëve datë 13.12.2018. Akt kolaudimi dhe certifikata marrjes përkohshme në dorëzim (për kontratën bazë) realizohet më 18.12.2018.

- Kontrata shtesë e restaurimit për “Restaurim Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër” nënshkruhet me nr. 1293/4 prot. Datë 03.12.2018, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori dhe operatorit ekonomik A-S shpk, me afat zbatimi 25 ditë. Njoftimi i përfundimit të punimeve është realizuar me shkresën nr. 2622 prot. Datë 21.12.2018, brenda afateve. Akt kolaudimi dhe certifikata marrjes përkohshme në dorëzim (për kontratën shtesë) realizohet më 26.12.2018.

-Kontrata përbëhet prej 3 situacione pjesore progresive të kontratës bazë, të cilat nuk janë shoqëruar me librezë masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1” Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

investitori. Zërat, sasishtë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se:

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

- Me shkresën nr. 2356 prot. Datë 14.11.2018, njoftohet përfundimi i punimeve nga kontraktori dhe më datë 14.11.2018 është mbajtur procerverbali i përfundimit të punimeve, ku kontrata është realizuar brenda afateve kontaktuale.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për "**Restaurim Kisha "Manastiri Shën Mërisë" Mesopotam Faza I, Sarande**" 2018, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Restaurim Kisha "Manastiri Shën Mërisë" Mesopotam Faza I, Sarande" 2018		
1. Urdhër Prokurimi 903 datë 09.05.2018	3.1 Njësia e Prokurimit L.B O.B E.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave A.I N.N L.D E.P A.B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "I hapur"		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 22,416,667 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 20,100,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,316,667 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 31.05.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 2 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 25.06.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 24,120,000 lekë	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me Vendimin nr. 1886 datë 10.06.1973 i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Kisha Manastiri Shën Mërisë" Mesopotam, Sarande, shpallet monument kulture kategoria e I. Me Vendimin e KKR-së nr. 204 datë 18.04.2018, miratohet projekti "Restaurim Kisha "Manastiri Shën Mërisë" Mesopotam Faza I, Sarande" 2018. Me vendimin e KKA nr. 73. Datë 23.06.2015, miratohet projekti shkencor në vazhdimësi në kuadër të shkollës së doktoraturës "Sondazhe arkeologjike në Manastirin e Shën Kollit-Mesopotam.

Me kërkesën për autorizim të titullarit të IMK nr. 743/2 prot. Datë 23.04.2018, drejtuar Ministrisë së Kulturës, kërkohet autorizim për fillimin e procedurave të prokurimit dhe me autorizimin e Ministrit të Kulturës nr. 2796/1 datë 25.04.2018, lejohen të fillojnë procedurat prokuruese. Me kontratën për njoftime nr. 849/1 prot. Datë 03.05.2018, nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me RTVSH, për transmetimin në TVSH të njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit. Me kontratën për reklamë në botim në gazetë nr. 850/1 prot. Datë 03.05.2018 nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me Gaz. M, për publikimin e njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të IMK nr. 903 datë 09.05.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 22,416,667 lekë pa TVSH, me objekt Restaurim Kisha "Manastiri Shën Mërisë" Mesopotam Faza I, Sarande" 2018, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

nga L.B, O.Bdhe E.M. Ngarkohet edhe njësisia e vlerësimit e përbërë nga A.I, N.N, L. D, E.P. dhe A.B.

Urdhri i prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007.

- Me procesverbalin nr. 903/1 prot. Datë 10.05.2018 përcaktohen kërkesat kualifikuese dhe kriteret e kualifikimit. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese janë bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret të vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësisia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 date 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik per restaurimin e monumenteve te kultures“. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pika 4.ç), subjektet të cilat kualifikohen sipas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas rastit në dokumentet standarde të restaurimit, i nënshtrohen kriterëve vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.

Oferta më e mirë ekonomike do të konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Oferta ekonomike me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë **85 pikë**, ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës.

b) Eksperienca e subjekteve konkurrues, që mund të jenë:

- shoqëri restauruese;

- shoqëri ndërtimi

- me nënkontraktorë restaurator;

- individë restaurues do të vlerësohet deri në 15 pikë. Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale **parashikohen në dokumentet standarde të konkurrimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.** Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e para më shumë se një ofertë, njësisia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit të përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi. Vendimi i Komisionit për ofertën më të mirë ekonomike duhet të jetë i argumentuar.

- Në kërkesat e vecanta kualifikuese Njësisia e hartimit të dokumentave të tenderit ka përcaktuar bashkësi kërkesat si më poshtë:

1. Punë të ngjashme

1.a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës së konkurrimit publik dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose 1.b. Punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, të jetë sa dyfishi i vlerës limit së kontratës së konkurrimit publik. Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

2.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë license profesionale e cila të përmbajë kategoritë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MZHU:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

NP – 1 (A) Punime gërmimi në tokë, NP – 2 (B) Ndërtime civile dhe industrial,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Punime speciale ndërtimi:

NS – 1 (A) Punime për prishjen e ndërtimeve, NS – 4 (A) Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese, NS – 8/b (A) Struktura metalike, NS – 14 (A) Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

2.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës. “**CZ.** Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.

Drejtuuesi teknik/ restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. “**AZ/2.** Zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4)”;

Drejtuuesi teknik i paraqitur në licensën e shoqërise duhet të rezultojë i siguar në listëpagesat përkatëse të sigurimeve shoqërore (për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018) dhe të paraqitet si pjesë e dokumentacionit.

2.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës “**B.** Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale” B/2. *Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve*; Ose Të ketë të kontraktuar një restaurator me licensë profesionale individuale në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës: B/2. *Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve*. Kjo të vërtetohet me një kontratë bashkëpunimi me emërtim objektin qëllim i konkurrimit publik. Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale për shoqëri sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës “**A.** Për veprimtari arkeologjike” A1. Vëzhgim arkeologjik (S) ose të ketë të kontraktuar një restaurator me licensë profesionale individuale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës “**A.** Për veprimtari arkeologjike” A1. Vëzhgim arkeologjik (S); Kjo të vërtetohet me një kontratë bashkëpunimi me emërtim objektin qëllim i konkurrimit publik.

3.2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me listëpagesa dhe diplomë për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 specialistë të fushës si më Restaurator dhe Inxhinier ndërtimi.

3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar ne listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e konkurrimit publik (për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës), diplomë dhe licençe, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon:

- Inxhinier Elektrik
- Arkeolog
- Inxhinier Gjeolog
- Specialist në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale (të zotërojë licensë B2 të sipërcituar)

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Pranë Ak kanë bërë kërkesë për terheqje dokumentacioni tenderi 4 kompani.

Me procesverbali e hapjes së ofertave nr. 903/3 prot. Datë 31.05.2018 në procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“J”shpk & “L. K”	20,493,960	S’Kualifikuar
2	K	22,366,728	S’Kualifikuar
3	“A-S” sh.p.k	18,836,677 korrigjuar në 20,100,000	Kualifikuar

1. Sipas proceverbalit nr. 903/6 prot. Datë 06.06.2018, gjatë procesit të vlerësimit të ofertës Njësia e Vlerësimit konstatoi se Bashkimi i operatoreve “J” shpk dhe “L.” shpk ka dorëzuar ofertën me mangësi dhe konkretisht:

Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika 4. Kualifikimi i ofertave, Pika 4.6. Një bashkim i perkohshëm shoqërisht mund të marrë pjesë në konkurrim në se plotëson kushtet e mëposhtme:

- Ekziston një kontratë, e noterizuar midis të gjithë personave fizikë dhe/ose juridikë të bashkimit të perkohshëm të shoqërive e firmosur nga të gjithë anëtarët përpara afatit të fundit të paraqitjes të ofertave që përcakton detyrimet e secilit anëtar në zbatimin e kontratës dhe thotë se secili anëtar është dakort t’i permbahet ofertes bashkarisht dhe vec e vec.

-Oferta firmoset nga një përfaqësues i bashkimit të perkohshëm të shoqërive që është autorizuar shprehimisht me shkrim nga të gjithë anëtarët e këtij bashkimi, të urdhërojë këte bashkim dhe gjithë anëtarët e saj.

-Çdo anëtar i bashkimit të perkohshëm të shoqërive duhet të plotësojë kërkesat e kualifikimit të konkurrimit dhe duhet të paraqesë të gjitha dokumentat e kërkuara administrative dhe ligjore.

A. Bashkimi i operatoreve “J” shpk dhe “L. K” shpk ka hartuar deklaratën e bashkëpunimit Nr.1084 Rep, Nr. 414 kol. ku përcaktojnë detyrimet e secilit anëtar në zbatimin e kontratës, perkatesisht 51% Shoqëria “J” sh.p.k. dhe 49% Shoqëria “L.K” sh.p.k. Në përmbajtje të deklaratës citohet që bashkëngjitur ndodhet preventivi detajuar i ndarjes së punimeve për secilin operator, por në fakt nuk ka një ndarje që përcakton detyrimet e secilit anëtar në zbatimin e kontratës.

B. Lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1. dh. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8.

- Shoqëria “L.K” sh.p.k nuk plotëson kushtin pika 1. dh. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8. Nuk ka paraqitur Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8. Për më tepër, referuar përqindjes së pjesëmarrjes në bashkëpunim, përkatësisht 51% Shoqëria “J” sh.p.k. dhe 49% Shoqëria “L K” sh.p.k., përvec se Shoqëria “L K” sh.p.k nuk ka paraqitur Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1.Për kapacitetin teknik.

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
Kamion transporti me kapacitet 1 deri në 6 ton	copë 2	në pronësi ose me qera
Autobot Uji	copë 1	në pronësi ose me qera
Gjenerator	copë 1	në pronësi ose me qera
Mikser	copë 1	në pronësi ose me qera
Skeleri	300 m2	në pronësi ose me qera
Pompë presioni me ujë	copë 1	në pronësi ose me qera



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Për disponimin e mjeteve të mësipërme ofertuesit duhet të paraqesin një deklaratë mbi disponimin e makinerive sipas shtojcës bashkëngjitur.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Për mjetet e siguruar me qera dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerave/ furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

- Shoqëria “L K” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika 4.b. **Nuk disponon asnjë dokumentacion për mjetet.**

Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika 19. Shqyrtimi paraprak i ofertave, Institucioni publik do të shqyrtojë çdo oferte për të konfirmuar se të gjitha dokumentat dhe dokumentacioni i kërkuar në dokumentat e restaurimit është siguruar dhe për të përcaktuar plotshmërinë e çdo dokumenti të paraqitur. Në se ndonjë prej dokumentave të kërkuar **mungon ose është i paplotë, oferta do të refuzohet.**

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi. Njësia e Vlerësimit vendosi të **skualifikojë** ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “J” shpk dhe “L K” shpk.

2. A. Shoqëria “K” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika 4.b. Nuk disponon dokumentacion për mjetin, Autobot uji.

B. Shoqëria “K” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika 4.b. Nuk disponon dokumentacion për piken NS – 14 (A) Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj. Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi. Njësia e Vlerësimit vendosi të **skualifikojë** ofertën e paraqitur nga shoqëria “K” sh.p.k.

3. Nga kontrolli i ofertës ekonomike me zëra (preventivi) rezultoi që kishtë gabime aritmetike. Njësia e vlerësimi e njoftoi shoqërinë A-S shpk me shkresën nr.903/4 prot., datë 05.06.2018 “Njoftim për korrigjim oferte”. Shoqëria A-S shpk konfirmoi korrigjimin e gabimit aritmetik me shkresën, protokolluar me tonën nr.903/5 prot., datë 06.06.2018 dhe bashkëlidhur shkresës dërgoi preventivin e ofertës të nënshkruar dhe vulosur. Brenda zarfit ndodheshin dokumentat si më poshtë:

Shkresa nr.40 prot., datë 29.05.2018 për konfirmimin e korrigjimit të gabimit aritmetik. Oferta ekonomike me zëra e korrigjuar, në vlerë 20.100.000 lekë pa TVSH.

Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Pika 21,c Shpjegimi dhe Korrigjimi i Gabimeve Aritmetike dhe Formaliteteve të Vogla, në të cilën citohet se:

c. Gabimet aritmetike do të ndreqen në mënyrën e mëposhtme. Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë do të mbizotërojë dhe çmimi total do të korrigohet në bazë të tij. Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma në fjalë do mbizotërojë. Nëse ofertuesi nuk pranon korrigjimin e gabimeve, oferta e tij do të refuzohet dhe sigurimi i ofertes do të konfiskohet.

- Gjatë procesit të vlerësimit të ofertës Njësia e Vlerësimit konstatoi se, shoqëria “A-S” shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë shoqërinë “A-S” shpk.

- Me procesverbalin nr. 903/7 prot. Datë 06.06.2018, për vlerësimit të ofertës më të mirë renditen pikët si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	Pikët nga oferta më e ulët	Pikët nga vlerësimi KVO	Pikët Total
1	A-S” sh.p.k	20,100,000	85	15	100
2	K	S’Kualifikuar	0	0	0
3	“J” & “L K”	S’Kualifikuar	0	0	0

- Me shkresën nr. 1233 prot. Datë 08.06.2018, shoqëria “J”shpk kërkon sqarime për klasifikimin me pikë për objektet “Restaurimi kisha “Shën Apostujve” Hoshteve zagori, Restaurimin kisha e shën Thanasi, leshnice, sarandë dhe Restaurimi i kishës Manastiri Mesopotam. Në fund të ankesës shoqëria “J” shpk, se në rast se shoqërisë nuk i kthehet përgjigje do të vazhdojë ankimimet, sepse pasi në 6 tendera të cilët morën pjesë ne IMK, shume procedura i ka fituar e njëjta kompani. Gjithashtu vazhdon që kjo shoqëri e cili ka marrë më shumë tendera, si mund të zbatohet me sukses shum kontrata restaurimi, të shpërndarë në shpate malesh në Përmet, Gjirokastër, Sarandë etj, me një restaurator të vetëm, me të njëjtat mjete dhe pajisje, në të njëjtën kohë, në objekte kaq delikate, me grafike punimeve në të njëjtën kohë zbatimi.

- Me urdhërin e titullarit nr. 1233/2 datë 08.06.2018, pezullohet procedura deri në shqyrtimin e ankesës. Me shkresën nr. 1233/5 prot. Datë 11.06.2018 të titullarit IMK A.D, dërgohet vendimi nr. 1233/5 prot. Datë 11.06.2018 i cili nuk merr parasysh ankesën e OE “J” shpk.

- Me raportin përfundimtar nr. 1243 prot. Datë 11.06.2018, miratohet procedura e prokurimit. Me urdhërin nr. 11243/2 datë 19.06.2018 të Drejtorit Përgjithshëm A.D, shpallet fituesi dhe urdhërohet publikimi i tij. Me shkresën nr. 1243/3 datë 19.06.2018 drejtuar APP, njoftohet fituesi i restaurimit.

Operatori i shpallur fitues “A-S” sh.p.k, ka korrigjuar ofertën nga 18,836,677 lekë pa TVSH në 20,100,000 lekë pa TVSH me diferencë **1,263,323 lekë** ose i rritur me **6.2 %**.

Nisur nga veprimet e mësipërme referuar VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar **neni 66** “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4 citohet :

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigojnë në mënyrën e mëposhtme:

Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

korrigjohet në bazë të tij. “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.

Nga sa më sipër konstatohet:

Për procedurën "**Restaurim Kisha “Manastiri Shën Mërisë” Mesopotam Faza I, Sarande**" shpallet fitues shoqëria “A-S” .

Për procedurën "**Restaurim Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër**" shpallet fitues shoqëria “A-S”

1. Kontrata e restaurimit për “**Restaurim Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër**” nënshkruhet me nr. 1293 prot. Datë 18.06.2018, midis Institutit Monumenteve të Kulturë dhe operatorit ekonomik A-S shpk. Vlera e kontratës është 17,489,216 lekë pa TVSH me afat zbatimit 180 ditë nga lidhja e kontratës, sipas grafikut të punimeve.

2. Kontrata e restaurimit për "**Restaurim Kisha “Manastiri Shën Mërisë” Mesopotam Faza I, Sarande**" nënshkruhet me nr. 1342 prot. Datë 25.06.2018, midis Institutit Monumenteve të Kulturë dhe operatorit ekonomik A-S shpk. Vlera e kontratës është 20,100,000 lekë pa TVSH me afat zbatimit 210 ditë nga lidhja e kontratës, sipas grafikut të punimeve.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, nga sistemi i vlerësimit nga KVO, janë trajtuar në mënyrë jo të barabartë operatorët ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **neni 1** ku përcaktohet: “*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public*”. **Neni 2** të LPP “*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit*”.

Për sa trajtuar më sipër, konstatohet se në procedurën "**Restaurim Kisha “Manastiri Shën Mërisë” Mesopotam Faza I, Sarande**", OE “A-S” shpk, duhej të skualifikohej pasi ka paraqitur në të njëjtën kohë të njëjtin dokumentacion për stafin teknik (restaurator etj), të njëjtat mjete me të cilat do të kryheshin punimet në kontrata të tjera, me shpërndarje gjeografike të largët nga njëra-tjetra dhe me të njëjtë grafik punimesh.

- Me shkresën e Prokurorisë pranë Shkallës së Parë Tiranë nr. 11123 prot. Datë 16.07.2018, depozituar në IMK me nr. 1529 prot. Datë 16.07.2018, kërkohen dokumentacione shkresore, pasi është realizuar kallëzim penal nr. 8653 rregjistruar në prokurori në datën 05.07.2018, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”. Prokuroria kërkon ti vihet në dispozicion e gjithë praktika dokumentare që është përdorur për tenderin Restaurim Kisha “Manastiri Shën Mërisë” Mesopotam Faza I, Sarande".

- Me shkresën e IMK nr. 15299/1 prot. Datë 16.07.2018, i kthehet përgjigje Prokurorisë pranë Shkallës së Parë Tiranë, ku sqarohet edhe ndryshimi i emërimit të objektit dhe bashkëlidhur dërgohet praktika e plotë e të gjithë procedurës prokuruese.

- Nga Prokurorisë pranë Shkallës së Parë Tiranë, nuk është marrë ende një vendim apo informacion për gjykimin e procedurës së prokurimit.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për "**Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori 2018**, konstatohet:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori 2018		
1. Urdhër Prokurimi 840 datë 03.05.2018	3.1 Njësia e Prokurimit L.B O.B E.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave A.I N.N L.D E.P A.B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 16,666,667 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 15,999,442 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 667,225 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 25.05.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 25.06.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 24,120,000 lekë	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me Urdhëresën datë 08.01.1977 Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori, shpallet monument kulture kategoria e I. Me Vendimin e KKR-së nr. 207 datë 18.04.2018, miratohet projekti “Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori 2018.

Me kërkesën për autorizim të titullarit të IMK nr. 743/2 prot. Datë 23.04.2018, drejtuar Ministrisë së Kulturës, kërkohet autorizim për fillimin e procedurave të prokurimit dhe me autorizimin e Ministrit të Kulturës nr. 2796/1 datë 25.04.2018, lejohen të fillojnë procedurat prokuruese. Me kontratën për njoftime nr. 849/1 prot. Datë 03.05.2018, nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me RTVSH, për transmetimin në TVSH të njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit. Me kontratën për reklamë në botim në gazetë nr. 850/1 prot. Datë 03.05.2018 nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me Gaz. M, për publikimin e njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të IMK nr. 840 datë 03.05.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 16,666,667 lekë pa TVSH, me objekt Restaurim “Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori 2018, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga L.B, O.B dhe E.M. Ngarkohet edhe njësia e vlerësimit e përbërë nga A.I, N.N, L.D, E. P dhe A.B. Urdhri i prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007.

- Me procesverbalin nr. 840/1 prot. Datë 03.05.2018 përcaktohen kërkesat kualifikuese dhe kriteret e kualifikimit. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese janë bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret të vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 date 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës“. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pika 4.ç), subjektet të cilat kualifikohen sipas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas rastit në dokumentet standarde të restaurimit, i nënshtrohen kriterëve vlerësues për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Oferta më e mirë ekonomike do të konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Oferta ekonomike me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë **85 pikë**, ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës.

b) Eksperienca e subjekteve konkurrues, që mund të jenë:

- shoqëri restauruese;

- shoqëri ndërtimi

- me nënkontraktorë restaurator;

- individë restaurues do të vlerësohet deri në 15 pikë. Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale *parashikohen në dokumentet standarde të konkurrimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.* Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e para më shumë se një ofertë, njësia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit të përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi. Vendimi i Komisionit për ofertën më të mirë ekonomike duhet të jetë i argumentuar.

- Në kërkesat e vecanta kualifikuese Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit ka përcaktuar bashkësi kërkesat si më poshtë :

1.Punë të ngjashme

1.a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës së konkurrimit publik dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit;

ose 1.b. Punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, të jetë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës së konkurrimit publik.

2. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

2.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë license profesionale e cila të përmbajë kategoritë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MZHU:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

NP – 1 (A) Punime gërmimi në tokë, NP – 2 (A) Ndërtime civile dhe industriale.

Punime speciale ndërtimi:

NS – 1 (A) Punime për prishjen e ndërtimeve, NS – 4 (A) Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. NS – 8/b (A), Struktura metalike, NS – 14 (A) Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

2.2.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës. “CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.

Drejtuesi teknik/ restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. “AZ/2. Zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4)”;

2.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës “B. Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale” B/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve, B/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin e veprave të artit në dru ose Të ketë të kontraktuar një restaurator me licensë profesionale individuale në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

muzeale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës: B/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve, B/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin e veprave të artit në dru.

3. Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

3.1. OE duhet të ketë numërin e nevojshem të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numëri i punonjësve për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 duhet të jetë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës.

3.2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me listëpagesa dhe diplomë për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 specialistë të fushës si më poshtë vijon: Restaurator, Inxhinier ndërtimi

3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar ne listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e konkurrimit publik (*për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës*), diplomë dhe liçence, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon: Inxhinier Elektrik, Specialist në projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale (*të zotërojë liçensë B2,B3 të sipërcituar*).

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Pranë Ak kanë bërë kërkesë për terheqje dokumentacioni tenderi 5 kompani.

Me procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 840/3 prot. Datë 25.05.2018 në procedurë kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik si më poshtë

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“J”shpk	16,263,429	Kualifikuar
2	A-S	16,660,006	S’Kualifikuar
3	“M/S sh.p.k	13,314,006 korigjuar në 15,999,442	Kualifikuar
4	L K	16,333,946	S’Kualifikuar

1. Sipas proceverbalit nr. 940/6 prot. Datë 04.06.2018, gjatë procesit të vlerësimit të ofertës Nga kontrolli i ofertës ekonomike të shoqërisë M/S shpk me zëra (preventivi) rezultoi që kishtë gabime aritmetike. Njësia e vlerësimi e njoftoi shoqërinë M/S shpk me shkresën nr.840/4 prot., datë 28.05.2018 “Njoftim për korigjim oferte”. Shoqëria M/S shpk konfirmoi korigjimin e gabimit aritmetik me shkresën nr.840/5 prot., datë 29.05.2018 dhe bashkëlidhur shkresës dërgoi preventivin e ofertës të nënshkruar dhe vulosur. Brenda zarfit ndodheshin dokumentat si më poshtë:

- Shkresën nr.840/5 prot., datë 29.05.2018 për konfirmimin e korigjimit të gabimit aritmetik.

- Oferta ekonomike me zëra e korigjuar, në vlerë **15.999.442 lekë pa tvsh.**

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi, KVO-ja vendosi të pranojë ofertën e shoqërisë “M/S” shpk.

A. Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika 21,c Shpjegimi dhe Korigjimi i Gabimeve Aritmetike dhe Formaliteteve të Vogla, në të cilën citohet se:

c. Gabimet aritmetike do të ndreqen në mënyrën e mëposhtme. Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njesise dhe çmimit total që del nga shumëzimi i çmimit të njesise me sasinë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

çmimi i njesise do të mbizotërojë dhe çmimi total do të korrigohet në bazë të tij. Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma në fjalë do mbizotërojë. Nëse ofertuesi nuk pranon korrigjimin e gabimeve, oferta e tij do të refuzohet dhe sigurimi i ofertes do të konfiskohet.

Gjatë procesit të vlerësimit të ofertës Njësia e Vlerësimit konstatoi se, shoqëria “M/S” shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë shoqërinë “M/S” shpk.

2. Shoqëria “J” shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë shoqërinë “J” shpk.

3. Gjatë procesit të vlerësimit të ofertës KVO-ja konstatoi se shoqëria “A-S” shpk ka dorëzuar ofertën me mangësi dhe konkretisht:

- Shoqëria “A-S” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika 4.b. Nuk disponon asnjë dokument për mjetin, Autobot uji.

4. Kutia me dokumentat e subjektit “L k”, me adresë: Rruga “Tish Dahia”, kompleksi Kika 2, Pallati nr. 9, kati 8, Tiranë, nuk ishte e mbyllur nga ofertuesi.

Brenda kutsisë ndodheshin dokumentacioni ligjor. Zarf i ofertës ekonomike ishte i hapur dhe bosh. Oferta ekonomike ishte vendosur në kuti me dokumentacionin ligjor. Njësia e Vlerësimit vendosi të lexojë ofertën ekonomike, e cila është në shumën prej 16.333.946 lekë.

Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika15. Vulosja dhe Shënimi i Zarfave

- Oferta do të futet në një zarf të madh të vulosur, firmosur dhe mbyllur nga ofertuesi.

- Brenda tij në një zarf më vetë dhe të mbyllur, futet oferta ekonomike e firmosur dhe vulosur.

- Mënyra e paraqitjes së tyre, mbishkrimet e duhura përcaktohen në Të dhënat për Restaurim, ku të evidentohet gjithashtu shënimi “Të mos hapet para sesionit të hapjes së ofertes.”

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi, Njësia e Vlerësimit vendosi të refuzojë ofertën e shoqërisë “L k” shpk.

- Me procesverbalin nr. 903/7 prot. Datë 04.06.2018, për vlerësimit të ofertës më të mirë renditen pikët si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	Pikët nga oferta më e ulët	Pikët nga vleresimi KVO	Pikët Total
“M/S” shpk	15.999.442 lekë	85	15	100
“J” shpk	16.263.429 lekë	80	8.16	88.16
“A-S” shpk	Skualifikuar	0		
“L K”	Skualifikuar	0		

Në zbatim të pikës 3, b të Udhëzimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve Nr. 446, datë 05.07.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, në të cilën citohet se

b) *Eksperiencia e subjekteve konkurruese mund të jetë -Shoqëri restauruese; -Shoqëri ndërtimi me nënkontraktor restaurator; -Individë*

restaurues të cilat do të provohen me kontrata të ngjashme, a vërtetime të punimeve të restaurimit, referenca, patenta, eksperiencia të vlerësuara, specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmërinë në fushën e restaurimeve apo dokumenta të tjera të cilat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

provojnë këtë eksperiencë. Do të vlerësohet deri në 15 pikë. *Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale parashikohen në dokumentat standarte të konkurrimit në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.*

I. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “M/S” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën a. kontratat të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të ngjashme, përkatësisht “*Restaurimi i godines se Ish Selise se drejtorise se Sigurimit te Shtetit, Gjethi,*” realizuar në vitin 2015 me vlerë 13.544.611 lekë; në rubrikën b. Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria “MANE/S” shpk ka dorëzuar 9 kontrata restaurimi (të detajuara në matricën bashkëlidhur), në rubrikën d. patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015; në rubrikën e. Eksperienca të vlerësuara shoqëria “M/S” shpk ka dorëzuar Vleresimin nga Departamenti i Inxhinierise Strukturale, Universiteti Politeknik i Milanos, Profesor i restauros, Prof. Arch. L B. Restaurimi i Kishes se Shen Nikolles, ndërsa në rubrikën f. specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumete të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator z. B M me License Restaurimi R.P.72 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në projektim, inxhinier ndërtimi, profili strukturist, K.1011/1 dhe Licensë K.1011/2, Licensë profesionale individuale, Nr. 1. datë 13.5.2013 “*Për vlerësim të pasurive të paluajtshme*”, Licensë personale në zbatim, inxhinier Ndërtimi, profili strukturist, Licensë Z.4587/1.

Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operatorët e tjerë në krahasim OE me të suksesshem) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperienat e subjekteve konkurues si kritere vlerësuese, rezulton që shoqëria “M/S” shpk shpk të vlerësohet me **15 pikë**.

II. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “J” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën a. kontratat të ngjashme ka dorëzuar tre kontrata të ngjashme, përkatësisht: “Ndertimi i qendres se kontrollit, biletarise dhe infrastruktures se Parkut arkeologjik te Finiqit” date 29.09.2016, vlera 6.142.764 leke, “*Restaurim i “Kishës së Shën Spiridhonit”, Vuno*”, realizuar me dt.26.08.2015, vlerë 3.898.466 lekë, Rikonstruksion i catise se muzeu Etnografik, date 17.03.2017, vlera 3.094.860 leke; në rubrikën b. Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria nuk ka dorëzuar asnjë dokument justifikues, në rubrikën d. patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015; ndërsa në rubrikën f. specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumete të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator znj. P. B me License Restaurimi R.P.69 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në zbatim, inxhinier ndërtimi, profili Civile industriale ura Z. 1633/5 dhe nje Specializim nga CHËB – Trashegimia kulturore pa kufij, i Z. S S, ndihmes mjeshter.

Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operatorët e tjerë në krahasim OE me të suksesshem) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperienat e subjekteve konkurues si kritere vlerësuese, rezulton që shoqëria “J” shpk të vlerësohet me **8.16 pikë**.

-Cdo konkurent sipas LPP vlerësohet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga enti prokurues ose enti publik për të cilat është detyruar ti plotësojë ose jo dhe në asnjë rast nuk mund të bëhet vlerësim mbi kritere të cilat asnjëherë nuk janë kërkuar dhe aq më pak nuk janë bërë publike për të gjithë konkurentët duke shkelur paraimin e barazisë në konkurim dhe vendosjen në kushte të njëjta konkurrimi dhe jo diskriminues për konkurentët e mundshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- Paraqitja e një dokumenti ekstra të pakërkuar nga Enti Prokurues nuk e ndalon konkurentin ti paraqesë ato, por nuk përbën kriter favorizimi për të. Interpretimet e sistemit të pikëzimit janë të kundraligjshme duke i trajtuar jo në mënyrë të barabartë OE.

- Vlerësimi me pikë i kryer dhe raporti i pikëzimit bazuar në kriteret të pakërkua dhe të vlerësuara maksimalisht, cili për rrjedhojë ka sjellë renditje jo të drejtë të konkurentëve jo vetëm nuk ka asnjë mbështetje ligjore Udhëzimin MTKRS, Nr. 446, datë 05.07.2007, **por përdoret për favorizuar operatorë të caktuar.**

Si përfundim me raportin përmbledhës nr. 1242 prot. Datë 11.06.2018 miratohet përfundimi i procedurës ku shpallet fitues shoqëria “M/s” me vlerë 15.999.442 pa TVSH. Me urdhërin nr. 1242/2 datë 19.06.2018 të Drejtorit Përgjithshëm A D shpallet fituesi dhe urdhërohet publikimi i tij. Me shkresën nr. 1243/3 datë 19.06.2018 drejtuar APP, njoftohet fituesi i restaurimit.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, nga sistemi i vlerësimit të pikëve nga KVO, janë trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **neni 1** ku përcaktohet: *“të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public”*. **Neni 2** të LPP “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit”.

Për sa trajtuar më sipër, nga realizimi i prokurimve mbështetur në ligjin nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe në Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, konstatohet një mungesë transparence në komunikimin midis AK dhe subjekteve kontraktuese përpos faktit që.

Në dy raste konstatohen korigjime ofertash mbi pragun e llogaritur nga Ligji i prokurimit Publik , i cili në fakt do të ishte baza e aplikimit të standarteve të VKM-s “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës”; është korigjuar oferta e OE fitues “Mani/s” nga 13,314,006 lekë pa TVSH në 15,999,442 lekë pa TVSH me diferencë **2,685,436 lekë** ose i rritur me **16.7 %** është përsëritur edhe në procedurën e prokurimit “Restaurim Kisha “Manastiri Shën Mërisë” Mesopotam Faza I, Sarande, ku operatori i shpallur fitues “AD-Star” sh.p.k, ka korigjuar ofertën nga 18,836,677 lekë pa TVSH në 20,100,000 lekë pa TVSH me diferencë **1,263,323 lekë** ose i rritur me **6.2 %**.

Nisur nga veprimet e mësipërme referuar VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar **neni 66** “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4 citohet :

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korigjohen në mënyrën e mëposhtme:

Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij. “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Sa më sipër bazuar në dokumentacionin në dispozicion konstatohetse AK nuk ka garantuar trajtim të njejte për OE, duke mos garantuar ofetën ekonomike më të mira, transparencë dhe siguri në procedurën e prokurimit.

- Kontrata e restaurimit për “Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori” nënshkruhet me nr. 1340 prot. Datë 25.06.2018, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 15,999,442 lekë pa TVSH me afat zbatimit 180 ditë nga lidhja e kontratës.

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për “Restaurim Kisha “Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë 2018, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Restaurim Kisha Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë 2018		
1. Urdhër Prokurimi 895 datë 09.05.2018	3.1 Njësia e Prokurimit L.B O.B E.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave A.I N.N L.D E.I.P J.V
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 9,166,667 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 8,427,623 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 739,044 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 29.05.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 25.06.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 10,113,147 lekë	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me Urdhëresën nr. 1886 datë 10.06.1973 të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Kisha “Shën Thanasi” Leshnicë, Sarandë, shpallet monument kulture kategoria e I. Me Vendimin e KKR-së nr. 226 datë 26.07.2007, miratohet projekti “Restaurim Kisha “Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë.

Me kërkesën për autorizim të titullarit të IMK nr. 743/2 prot. Datë 23.04.2018, drejtuar Ministrisë së Kulturës, kërkohet autorizim për fillimin e procedurave të prokurimit dhe me autorizimin e Ministrit të Kulturës nr. 2796/1 datë 25.04.2018, lejohen të fillojnë procedurat prokuruese. Me shkresën nr. 771 prot. Datë 24.04.2018 drejtuar Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK), kërkohet pajisja me pasaportë dhe kthimi i përgjigjes për pasaportën me shkresën nr. 155/1 datë 24.04.2018. Me kontratën për njoftime nr. 849/1 prot. Datë 03.05.2018, nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me RTVSH, për transmetimin në TVSH të njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit. Me kontratën për reklamë në botim në gazetë nr. 850/1 prot. Datë 03.05.2018 nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me Gaz. M, për publikimin e njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të IMK nr. 895 datë 09.05.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 9,166,667 lekë pa TVSH, me objekt “Restaurim Kisha Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga L.B, O.B dhe E. M. Ngarkohet edhe njësia e vlerësimit e përbërë nga A I, N N, L D, E P dhe J V.

Urdhri i prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- Me procesverbalin nr. 895/1 prot. Datë 10.05.2018 përcaktohen kërkesat kualifikuese dhe kriteret e kualifikimit. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese janë bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kritere të vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 date 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik per restaurimin e monumenteve te kultures“. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pika 4.ç), subjektet të cilat kualifikohen sipas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas rastit në dokumentet standarde të restaurimit, i nënshtrohen kriterëve vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.

Oferta më e mirë ekonomike do të konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Oferta ekonomike me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë **85 pikë**, ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës.

b) Eksperienca e subjekteve konkurrues, që mund të jenë:

- shoqëri restauruese;

- shoqëri ndërtimi

- me nënkontraktorë restaurator;

- individë restaurues do të vlerësohet deri në 15 pikë. Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale *parashikohen në dokumentet standarde të konkurrimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.*

Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e para më shumë se një ofertë, njësia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit të përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi. Vendimi i Komisionit për ofertën më të mirë ekonomike duhet të jetë i argumentuar.

- Në kërkesat e vecanta kualifikuese Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit ka përcaktuar bashkësi kërkesat si më poshtë:

1.Punë të ngjashme

1.a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlloritur të kontratës së konkurrimit publik dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit;

ose 1.b. Punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, të jetë sa dyfishi i vlerës limit së kontratës së konkurrimit publik.

2. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

2.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë license profesionale e cila të përmbajë kategoritë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MZHU:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

NP – 1 (A) Punime gërmimi në tokë, NP – 2 (A) Ndërtime civile dhe industriale.

Punime speciale ndërtimi:

NS – 1 (A) Punime për prishjen e ndërtimeve, NS – 4 (A) Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. NS – 8/b (A), Struktura metalike, NS – 14 (A) Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

2.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës. “CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.

Drejtuuesi teknik/ restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. “AZ/2. Zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4)”;

3. Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

3.1. OE duhet të ketë numërin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numëri i punonjësve për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 duhet të jetë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës.

3.2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me listëpagesa dhe diplomë për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 specialistë të fushës si më poshtë vijon: Restaurator, Inxhinier ndërtimi dhe Inxhinier Elektrik.

3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar në listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e konkurrimit publik (*për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës*), diplomë dhe liçence, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon: Inxhinier Elektrik.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Pranë Ak kanë bërë kërkesë për terheqje dokumentacioni tenderi 5 kompani.

Me procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 895/3 prot. Datë 29.05.2018 në procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“J”shpk	8,332,190	S’Kualifikuar
2	A-S	9,140,916	S’Kualifikuar
3	“M/S sh.p.k	8,427,623	Kualifikuar

Me procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 895/4 prot. Datë 04.06.2018, kryet vlerësimi si më poshtë:

I. Njësia e Vlerësimit lexoi subjektin “M/S” shpk. Zarf i shoqërisë është protokolluar me nr. 1077 prot., datë 25.05.2018 dhe mbi të është shkruar informacioni me të dhënat e përcaktuara në dokumentacionin standart të restaurimit “Të dhënat e restaurimit A” Të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës pika 3. U hap zarfi me dokumentat e subjektit “M/S” shpk. Brenda zarfit të madh ndodheshin dokumentacioni ligjor dhe një zarf me ofertën ekonomike. Dokumentacioni ligjor i paraqitur nga ana e shoqërisë “M/S” shpk .

Njësia e Vlerësimit pasi lexoi dokumentacionin ligjor shoqërisë “M/S” shpk vendosi të hapi ofertën ekonomike mbi zarfin e të cilës ishte shkruar informacioni me të dhënat e përcaktuara në dokumentacionin standart “Të dhënat e restaurimit A” Të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertes pika 3.

Gjatë procesit të vlerësimit të ofertës KVO-ja konstatoi se, shoqëria “M/S” shpk. plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. **Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë shoqërinë “M/S” shpk.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi, Njësia e Vlerësimit vendosi të pranojë ofertën e shoqërisë “M/S” shpk.

II. Njësia e Vlerësimit lexoi zarfin e shoqërisë “J” shpk. Zarfi i shoqërisë është protokolluar me nr. 1122, datë 29.05.2018 dhe mbi të është shkruar informacioni me të dhënat e përcaktuara në dokumentacionin standart të restaurimit “Të dhënat e restaurimit A” Të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës pika 3. U hap zarfi me dokumentat e subjektit “J” shpk. Brenda zarfit ndodheshin dokumentacioni ligjor dhe një zarf me ofertën ekonomike, i cili nuk ishte e mbyllur nga ofertuesi. Zarfi i ofertës ekonomike të subjektit “J” shpk ishte i hapur.

Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika 15. Vulosja dhe Shënimi i Zarfave

1. Oferta do të futet në një zarf të madh të vulosur, firmosur dhe mbyllur nga ofertuesi.
2. Brenda tij në një zarf më vetë dhe të mbyllur, futet oferta ekonomike e firmosur dhe vulosur.
3. Mënyra e paraqitjes së tyre, mbishkrimet e duhura përcaktohen në Të dhënat për Restaurim, ku të evidentohet gjithashtu shënimi “Të mos hapet para sesionit të hapjes së ofertes.”

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi, Njësia e Vlerësimit vendosi të refuzojë ofertën e shoqërisë “J” shpk dhe vendosi të **skualifikojë** ofertën e paraqitur nga shoqëria “J” shpk.

III. Njësia e Vlerësimit lexoi me zë të lartë zarfin e subjektit “A-S” shpk. Zarfi i shoqërisë është protokolluar me nr. 1119 prot., datë 29.05.2018 dhe mbi të është shkruar informacioni me të dhënat e përcaktuara në dokumentacionin standart të restaurimit “Të dhënat e restaurimit A” Të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës pika 3. Gjatë procesit të vlerësimit të ofertës, Njësia e Vlerësimit konstatoi se shoqëria “A-S” shpk ka dorëzuar ofertën me mangësi dhe konkretisht: Lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1.Për kapacitetin teknik, ku pika 4. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Shoqëria “A-S” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika 4.b. Nuk disponon asnjë dokument për mjetin, **Autobot uji**.

Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika 19. Shqyrtimi paraprak i ofertave, Institucioni publik do të shqyrtojë çdo oferte për të konfirmuar se të gjitha dokumentat dhe dokumentacioni i kërkuar në dokumentat e restaurimit është siguruar dhe për të përcaktuar plotshmërinë e çdo dokumenti të paraqitur. Në se ndonjë prej dokumentave të kërkuar mungon ose është i paplotë, oferta do të refuzohet.

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi, Njësia e Vlerësimit vendosi të refuzojë ofertën e shoqërisë “A-S” shpk dhe vendosi të **s’kualifikojë ofertën** e paraqitur nga shoqëria “A-S” sh.p.k.

- Me procesverbalin nr. 895/5 prot. Datë 04.06.2018 për vlerësimin të ofertës më të mirë dhe 895/6 prot. Datë 04.06.2018 për klasifikimin përfundimtar renditen pikët si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	Pikët nga oferta më e ulët	Pikët nga vlerësimi KVO	Pikët Total
“M/S” shpk	8,427,623 lekë	85	15	100
“J” shpk	Skualifikuar	0	0	0
“A-S” shpk	Skualifikuar	0	0	0

I. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “M/S” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën a. kontratat të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të ngjashme, përkatësisht “*Restaurimi i godines se Ish Selise se drejtorise se Sigurimit te Shtetit, Gjethi,*” realizuar në vitin 2015 me vlerë 13.544.611 lekë; në rubrikën b. Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria “M/S” shpk ka dorëzuar 9 kontrata restaurimi (të detajuara në matricën bashkëlidhur), në rubrikën d. patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015; në rubrikën e. Eksperienca të vlerësuar shoqëria “M/S” shpk ka dorëzuar Vlerësimin nga Departamenti i Inxhinierise Strukturale, Universiteti Politeknik i Milanos, Profesor i restauros, Prof. Arch. L. B. Restaurimi i Kishes se Shen Nikolles, ndërsa në rubrikën f. specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumente të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator z. B M me License Restaurimi R.P.72 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në projektim, inxhinier ndërtimi, profili strukturist, K.1011/1 dhe Licensë K.1011/2, Licensë profesionale individuale, Nr. 1. datë 13.5.2013 “*Për vlerësim të pasurive të paluajtshme*”, Licensë personale në zbatim, inxhinier Ndërtimi, profili strukturist, Licensë Z.4587/1.

- Me shkresën nr. 1233 prot. Datë 08.06.2018, shoqëria “J”shpk kërkon sqarime për klasifikimin me pikë për objektet “Restaurimi kisha “Shën Apostujve” Hoshteve zagori, Restaurimin kisha e shën Thanasi, leshnice, sarandë dhe Restaurimi i kishës Manastiri Mesopotam. Në fund të ankesës shoqëria “J” shpk, se në rast se shoqërisë nuk i kthehet përgjigje do të vazhdojë ankimimet, sepse pasi në 6 tendera të cilët morën pjesë ne IMK, shum procedura i ka fituar e njëjta kompani. Gjithashtu vazhdon që kjo shoqëri i cili ka marrë më shumë tendera, si mund të zbatohet me sukses shum kontrata restaurimi, të shpërndarë në shpate malesh në Përmet, Gjirokastër, Sarandë etj, me një restaurator të vetëm, me të njëjtat mjete dhe pajisje, në të njëjtën kohë, në objekte kaq delikate, me grafike punimeve në të njëjtën kohë zbatimi.

- Me urdhërin e titullarit nr. 1233/3 datë 08.06.2018, pezullohet procedura deri në shqyrtimin e ankesës. Me shkresën nr. 1233/5 prot. Datë 11.06.2018 të titullarit IMK A D, dërgohet vendimi nr. 1233/5 prot. Datë 11.06.2018 i cili nuk merr parasysh ankesën e OE “J” shpk.

- Me raportin përfundimtar nr. 1241 prot. Datë 19.06.2018, miratohet procedura e prokurimit. Me urdhërin nr. 11241/2 datë 19.06.2018 të Drejtorit Përgjithshëm A D, shpallet fituesi dhe urdhërohet publikimi i tij. Me shkresën nr. 1243/4 datë 19.06.2018 drejtuar APP, njoftohet fituesi i restaurimit.

Nga sa më sipër konstatohet:

1. Për procedurën “*Restaurim Kisha “Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë*” shpallet fitues shoqëria “M/s” me dokumenta të sipërcituara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

2. Për procedurën "*Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori*" shpallet fitues shoqëria “M/s” me Dokumentacion ligjor i paraqitur nga ana e shoqërisë “M/S” shpk.

- Kontrata e restaurimit për “*Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori*” nënshkruhet me nr. 1340 prot. Datë **25.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 15,999,442 lekë pa TVSH me afat zbatimit **180** ditë nga lidhja e kontratës.

- Kontrata e restaurimit për “*Restaurim Kisha “Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë*” nënshkruhet me nr. 1341 prot. Datë **25.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 8,427,623 lekë pa TVSH me afat zbatimit **150** ditë nga lidhja e kontratës, sipas grafikut të punimeve.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, nga sistemi i vlerësimit nga KVO, janë trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **neni 1** ku përcaktohet: “*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public*”. **Neni 2** të LPP “*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit*”.

Për sa trajtuar më sipër, konstatohet se në procedurën “*Restaurim Kisha “Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë*”, OE “M/s” shpk, duhej të skualifikohej pasi ka paraqitur në të njëjtën kohë të njëjtin dokumentacion për stafin teknik (restaurator etj), të njëjtat mjete me të cilat do të kryheshin punimet në kontrata të tjera, me shpërndarje gjeografike të largët nga njëra-tjetra dhe me të njëjtë grafik punimesh.

Sa më sipër konstatohen bazuar dokumentacioneve diskriminime të OE, dhe favorizime të operatorëve të caktuar duke mos garantuar ofetën ekonomike, transparencë dhe siguri në procedurën e prokurimit.

Ofertat e “J” sh.p.k”, me vlerë 8,332,190 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për IMK, në përputhje me parimet e economicitetit dhe eficensës, bazuar legjislacionit të LPP dhe Udhëzimeve apo VKM të trashëgimisë kulturore. Sistemit me zarfe, nuk ka garantuar transparencë por diskriminime dhe favorizime të caktuara.

Pra sistemi i prokurimit, njësia e vlerësimit të ofertave duke për mos trajtime të pabarabarta, ka krijuar **efekte negative financiare** midis diferencës së vlerës prej **114,519 lekë me TVSH** (8,427,623 lekë - 8,332,190 lekë = 95,433 lekë x 20% TVSH), midis ofertës së “J” sh.p.k”, " shpk dhe ofertën e Operatorit Ekonomik "M/S" shpk.

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për "*Restaurim Banesa e Vëllezërve Frashëri, Përmet 2018*, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Restaurim Banesa e Vëllezërve Frashëri, Përmet 2018		
1. Urdhër Prokurimi 828 datë 03.05.2018	3.1 Njësia e Prokurimit L.B O.B	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave A.I N.N



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur”	E.M	L.D E.P A.B
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 4,995,049 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,951 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 23.05.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 11.06.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 5,994,058 lekë	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me Urdhëresën nr. 1886 datë 10.06.1973 të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Banesa e Vëllezërve Frashëri, shpallet monument kulture kategoria e I. Me Vendimin e KKR-së nr. 226 datë 26.07.2007, miratohet projekti "Restaurim Banesa e Vëllezërve Frashëri, Përmet".

Me kërkesën për autorizim të titullarit të IMK nr. 743/2 prot. Datë 23.04.2018, drejtuar Ministrisë së Kulturës, kërkohet autorizim për fillimin e procedurave të prokurimit dhe me autorizimin e Ministrit të Kulturës nr. 2796/1 datë 25.04.2018, lejohen të fillojnë procedurat prokuruese. Me shkresën nr. 771 prot. Datë 24.04.2018 drejtuar Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK), kërkohet pajisja me pasaportë dhe kthimi i përgjigjes për pasaportën me shkresën nr. 155/1 datë 24.04.2018. Me kontratën për njoftime nr. 849/1 prot. Datë 03.05.2018, nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me RTVSH, për transmetimin në TVSH të njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit. Me kontratën për reklamë në botim në gazetë nr. 850/1 prot. Datë 03.05.2018 nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me Gaz. M, për publikimin e njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të IMK nr. 828 datë 03.05.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 5,000,000 lekë pa TVSH, me objekt “Restaurim Banesa e Vëllezërve Frashëri, Përmet, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga L B, O B dhe E M. Ngarkohet edhe njësia e vlerësimit e përbërë nga A I, N N, L D, E P dhe A B.

Urdhri i prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007.

- Me procesverbalin nr. 828/1 prot. Datë 03.05.2018 përcaktohen kërkesat kualifikuese dhe kriteret e kualifikimit. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese janë bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret e vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 datë 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pika 4.ç), subjektet të cilat kualifikohen sipas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas rastit në dokumentet standarde të restaurimit, i nënshtrohen kriterëve vlerësues për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.

Oferta më e mirë ekonomike do të konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Oferta ekonomike me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë **85 pikë**, ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

b) Eksperienca e subjekteve konkurrues, që mund të jenë:

- shoqëri restauruese;
- shoqëri ndërtimi
- me nënkontraktorë restaurator;
- individë restaurues do të vlerësohet deri në 15 pikë. Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale ***parashikohen në dokumentet standarde të konkurrimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.*** Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e para më shumë se një ofertë, njësia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit të përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi. Vendimi i Komisionit për ofertën më të mirë ekonomike duhet të jetë i argumentuar.
- Në kërkesat e vecanta kualifikuese Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit ka përcaktuar bashkësi kërkesat si më poshtë :

1. Punë të ngjashme

1.a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përllorë të kontratës së konkurrimit publik dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit;

ose 1.b. Punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, të jetë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës së konkurrimit publik.

2. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

2.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë license profesionale e cila të përmbajë kategoritë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MZHU:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

NP – 1 (A) Punime gërmimi në tokë, NP – 2 (A) Ndërtime civile dhe industriale.

Punime speciale ndërtimi:

NS – 1 (A) Punime për prishjen e ndërtimeve, NS – 4 (A) Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese, NS – 14 (A) Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

2.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës. “CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.

Drejtuesi teknik/ restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. “AZ/3. Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së parë dhe të dytë”;

3. Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:

3.1. OE duhet të ketë numërin e nevojshëm të punonjesve për zbatimin e kontratës. Numëri i punonjësve për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 duhet të jetë jo më pak se 8 (tetë) punonjës.

3.2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me listëpagesa dhe diplomë për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 specialistë të fushës si më poshtë vijon: Restaurator, Inxhinier ndërtimi dhe Inxhinier Elektrik.

3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar në listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

konkurrimit publik (*për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës*), diplomë dhe liçence, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon: Inxhinier Elektrik.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Pranë Ak kanë berë kërkesë për terheqje dokumentacioni tenderi 5 kompani.

Me procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 828/3 prot. Datë 23.05.2018 në procedurë kanë marë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“J”shpk	4,650,905	Kualifikuar
2	N. Nr.1	4,939,661	S’Kualifikuar
3	“M/S sh.p.k	4,995,049	Kualifikuar

Me procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 828/6 prot. Datë 30.05.2018, kryet vlerësimi si më poshtë:

I. Njësia e Vlerësimit lexoi zarfin e subjektit “**M/S**” **shpk**. Zarfi i shoqërisë është protokolluar me nr. 1040 prot., datë 22.05.2018 dhe mbi të është shkruar informacioni me të dhënat e përcaktuara në dokumentacionin standart të restaurimit “Të dhënat e restaurimit A” Të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës pika 3. U hap zarfi me dokumentat e subjektit “M/S”. Brenda zarfit të madh ndodheshin dokumentacioni ligjor dhe një zarf me ofertën ekonomike. Dokumentacioni ligjor i paraqitur nga ana e shoqërisë “**M/S**” **shpk**.

Njësia e Vlerësimit pasi lexoi dokumentacionin ligjor shoqërisë “**M/S**” **shpk** vendosi të hapi ofertën ekonomike mbi zarfin e të cilës ishte shkruar informacioni me të dhënat e përcaktuara në dokumentacionin standart “Të dhënat e restaurimit A” Të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertes pika 3. Brenda zarfit ndodheshin dokumentat e ofertës së restaurimit në shumën prej **4.995.049** lekë pa TVSH.

Nga kontrolli i ofertës ekonomike me zëra (preventivi) rezultoi që kishitë gabime aritmetike. Njësia e vlerësimi e njoftoi shoqërinë M/S shpk me shkresën nr. 828/4 prot., datë 28.05.2018 “*Njoftim për korrigjim oferte*”. Shoqëria M/S shpk konfirmoi korrigjimin e gabimit aritmetik me shkresën nr.828/5 prot., datë 29.05.2018 dhe bashkëlidhur shkresës dërgoi preventivin e ofertës të nënshkruar dhe vulosur. Brenda zarfit ndodheshe Shkresa nr.828/5 prot., datë 29.05.2018 për konfirmimin e korrigjimit të gabimit

A. Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “*Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës*”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika 21,c Shpjegimi dhe Korrigjimi i Gabimeve Aritmetike dhe Formaliteteve të Vogla, në të cilën citohet se:

c. Gabimet aritmetike do të ndreqen në mënyrën e mëposhtme. Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit per njesise dhe çmimit total që del nga shumëzimi i çmimit të njesise me sasinë, çmimi i njesise do të mbizotërojë dhe çmimi total do të korrigjohet në bazë të tij. Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma në fjalë do mbizotërojë. Nëse ofertuesi nuk pranon korrigjimin e gabimeve, oferta e tij do të refuzohet dhe sigurimi i ofertes do të konfiskohet.

Gjatë procesit të vlerësimit të ofertës Njësia e Vlerësimit konstatoi se, shoqëria “M/S” shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë shoqërinë “M/S” shpk.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

II. Shoqëria “J” shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë shoqërinë “J” shpk.

III. Shoqëria “N Nr.1” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika 4. Nuk disponon asnjë nga mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit – 2. Kapaciteti teknik Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

dhe. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8

Shoqëria “N Nr.1” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika dh. Nuk ka dorëzuar deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8.

Referuar Udhëzimit Nr.446, datë 5.7.2007, “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Udhëzimit për kandidatët që marrin pjesë në konkurrimin publik për restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore”, Pika 19. Shqyrtimi paraprak i ofertave, Institucioni publik do të shqyrtojë çdo oferte për të konfirmuar se të gjitha dokumentat dhe dokumentacioni i kërkuar në dokumentat e restaurimit është siguruar dhe për të përcaktuar plotshmërinë e çdo dokumenti të paraqitur. Nëse ndonjë prej dokumentave të kërkuar mungon ose është i paplotë, oferta do të refuzohet.

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, A. Kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi, Njësia e Vlerësimit vendosi **të refuzojë ofertën** e shoqërisë “N Nr.1”

- Me procesverbalin nr. 828/7 prot. Datë 31.05.2018 për vlerësimin të ofertës për klasifikimin përfundimtar renditen pikët si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	Pikët nga oferta më e ulët	Pikët nga vlerësimi KVO	Pikët Total
“M/S” shpk	4,995,049 lekë	80	15	95
“J” shpk	4,650,905 lekë	85	5.37	90.37
“N Nr.1” shpk	Skualifikuar	0	0	0

I. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “J” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën kontratat të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të ngjashme, përkatësisht “Restaurim i “Kishës së Shën Spiridhonit”, V”, realizuar me dt.26.08.2015, vlerë 3.898.466 lekë; në rubrikën Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria nuk ka dorëzuar asnjë dokument justifikues, në rubrikën patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015; ndërsa në rubrikën specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumete të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator znj. P B me License Restaurimi R.P.69 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në zbatim, inxhinier ndërtimi, profili Civile industriale ura Z. 1633/5. Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operatoret e tjerë në krahasim OE me të suksesshem) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperiencat e subjekteve konkures si kriterë vlerësuese, rezulton që shoqëria “J” shpk të vlerësohet me **5.37 pikë.**

II. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “M/S” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën kontratat të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të ngjashme, përkatësisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

“Restaurimi i godines se Ish Selise se drejtorise se Sigurimit te Shtetit, Gjethi,” realizuar në vitin 2015 me vlerë 13.544.611 lekë; në rubrikën Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria “M/S” shpk ka dorëzuar 9 kontrta restaurimi (të detajuara në matricën bashkëlidhur), në rubrikën patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015; ndërsa në rubrikën specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumete të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator z. B M me License Restaurimi R.P.72 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në projektim, inxhinier ndërtimi, profili strukturist, K.1011/1 dhe Licensë K.1011/2, Licensë profesionale individuale, Nr. 1. datë 13.5.2013 “Për vlerësim të pasurive të paluajtshme”, Licensë personale në zbatim, inxhinier Ndërtimi, profili strukturist, Licensë Z.4587/1. Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operatorët e tjerë në krahasim OE me të suksesshem) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperiencat e subjekteve konkures si kriterë vlerësuesë, rezulton që shoqëria “M/S” shpk të vlerësohet me **15 pikë**.

Nga sa më sipër konstatohet:

Referuar sistemit të pikëzimit nga KVO, konstatohen interpretime në kundërshtime me parimet e barazisë në tendera dhe trjitime jo të njëjta në garë pasi:

-Cdo konkurent sipas LPP vlerësohet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga enti prokurues ose enti publik për të cilat është i detyruar ti plotësojë ose jo dhe në asnjë rast nuk mund të bëhet vlerësim mbi kriterë të cilat asnjëherë nuk janë kërkuar dhe aq më pak nuk janë bërë publike për të gjithë konkurentët duke shkelur paraimin e barazisë në konkurim dhe vendosjen në kushte të njëjta konkurrimi dhe jo diskriminues për konkurentët e mundshëm.

- Paraqitja e një dokumenti ekstra të pakërkuar nga E. Prokurues nuk e ndalon konkurentin ti paraqesë ato, por nuk përbën kriter favorizimi për të.

- Vlerësimi me pikë i kryer dhe raporti i pikëzimit bazuar në kriterë të pakërkuara dhe të vlerësuara maksimalisht, cili për rrjedhojë ka sjellë renditje jo të drejtë të konkurentëve jo vetëm nuk ka asnjë mbështetje ligjore Udhëzimin MTKRS, Nr. 446, datë 05.07.2007, por ka bërë që të kemi dhe diferenca me demë ekonomike për buxhetin e shtetit, midis ofertave.

Si përfundim me raportin përmbledhës nr. 1195 prot. Datë 06.06.2018 miratohet përfundimi i procedurës ku shpallet fitues shoqëria “M/S” me vlerë 4,995,049 pa TVSH. Me urdhërin nr. 1195/1 datë 06.06.2018 të Drejtorit Pëgjithshëm A D, shpallet fituesi dhe urdhërohet publikimi i tij. Me shkresën nr. 1195/2 datë 06.06.2018 drejtuar APP, njoftohet fituesi i restaurimit.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, nga sistemi i vlerësimit të pikëve nga KVO, janë trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **neni 1** ku përcaktohet: “*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public*”. **Neni 2** të LPP “*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit*”.

Ofertat e “J” sh.p.k”, me vlerë 4,650,905 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për IMK, në përputhje me parimet e economicitetit dhe eficensës, bazuar legjislacionit të LPP dhe Udhëzimeve apo VKM të trashëgimisë kulturore. Interpretimet e sistemit të pikëzimit janë të kundraligjshme duke i trajtuar jo në mënyrë të barabartë OE.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Pra sistemi i vlerësimit ka krijuar efekte financiare negative, midis diferencës së vlerës prej **412,972 lekë me TVSH** (4,995,049 lekë - 4,650,905 lekë = 344,144 lekë x 20% TVSH), midis ofertës së “J” sh.p.k”, " shpk dhe ofertën e Operatorit Ekonomik "M/S" shpk, *të shkaktuar nga vlerësimi i ofertave me sistemin e pikëzimit për ofertën më të mirë, të cilat nuk janë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit.*

- Kontrata e restaurimit për “*Restaurim Banesa Vëllezërve Frashëri*” nënshkruhet me nr. 1235 prot. Datë **11.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 4,995,049 lekë pa TVSH me afat zbatimit **60** ditë nga lidhja e kontratës, ku ky operator ekonomik është favorizuar me të njëjtën dokumentacion për kapacitetin ekonomik dhe teknik për kontratat si më poshtë vijon:

- Kontrata e restaurimit për “*Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori*” nënshkruhet me nr. 1340 prot. Datë **25.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 15,999,442 lekë pa TVSH me afat zbatimit **180** ditë nga lidhja e kontratës.

- Kontrata e restaurimit për “*Restaurim Kisha “Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë*” nënshkruhet me nr. 1341 prot. Datë **25.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 8,427,623 lekë pa TVSH me afat zbatimit **150** ditë nga lidhja e kontratës, sipas grafikut të punimeve.

Sa më sipër bazuar dokumentacioneve në dispozicion konstatohen trajtime jo të njëjta të OE, duke mos garantuar ofetën ekonomike më të leverdisshme, transparencë dhe siguri në prokururën e prokurimit.

7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për “*Restaurimi i objektit Ura e Kollorces 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat 2018*”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Restaurimi i objektit Ura e Kollorces 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat 2018		
1. Urdhër Prokurimi 836 datë 03.05.2018 Ndryshuar 836/1 datë 04.05.2018	3.1 Njësia e Prokurimit L.B O.B E.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave A.I N.N L.D A.V J.V
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,166,667 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 4,150,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 16,667 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 24.05.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 2 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 11.06.2018	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,980,000 lekë	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me Urdhëresën datë 08.01.1977 të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Ura e Kollorces, shpallet monument kulture kategoria e I. Me Vendimin e KKR-së nr. 208 datë 18.04.2018, miratohet projekti “Restaurimi i objektit Ura e Kollorces 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Me kërkesën për autorizim të titullarit të IMK nr. 743/2 prot. Datë 23.04.2018, drejtuar Ministrisë së Kulturës, kërkohet autorizim për fillimin e procedurave të prokurimit dhe me autorizimin e Ministrit të Kulturës nr. 2796/1 datë 25.04.2018, lejohen të fillojnë procedurat prokuruese. Me shkresën nr. 771 prot. Datë 24.04.2018 drejtuar Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK), kërkohet pajisja me pasaportë dhe kthimi i përgjigjes për pasaportën me shkresën nr. 155/1 datë 24.04.2018. Me kontratën për njoftime nr. 849/1 prot. Datë 03.05.2018, nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me RTVSH, për transmetimin në TVSH të njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit. Me kontratën për reklamë në botim në gazetë nr. 850/1 prot. Datë 03.05.2018 nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me Gaz. M, për publikimin e njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit.

-Me urdhrin e prokurimit e ndryshuar të titullarit të IMK nr. 836/1 datë 04.05.2018, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 4,166,667 lekë pa TVSH, me objekt “Restaurimi i objektit Ura e Kollorces 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga L B, O B dhe E M ngarkohet edhe njësia e vlerësimit e përbërë nga A I, N N, L D, A V dhe J V.

Urdhri i prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007.

- Me procesverbalin nr. 836/2 prot. Datë 04.05.2018 përcaktohen kërkesat kualifikuese dhe kriteret e kualifikimit. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese janë bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret e vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 datë 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës“. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, pika 4.ç), subjektet të cilat kualifikohen sipas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas rastit në dokumentet standarde të restaurimit, i nënshtrohen kriteret e vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike.

Oferta më e mirë ekonomike do të konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar sipas kriteret e mëposhtme:

a) Oferta ekonomike me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë **85 pikë**, ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës.

b) Eksperienca e subjekteve konkurrues, që mund të jenë:

- shoqëri restauruese;

- shoqëri ndërtimi

- me nënkontraktorë restaurator;

- individë restaurues do të vlerësohet deri në 15 pikë. Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale **parashikohen në dokumentet standarde të konkurrimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit.**

Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e para më shumë se një ofertë, njësia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit të përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi. Vendimi i Komisionit për ofertën më të mirë ekonomike duhet të jetë i argumentuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- Në kërkesat e vecanta kualifikuese Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit ka përcaktuar bashkësi kërkesat si më poshtë:

1. Punë të ngjashme

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës së konkurrimit publik dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose b. Punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, të jetë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës së konkurrimit publik. Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

2.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë license profesionale e cila të përmbajë kategoritë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MZHU:

Punime të përgjithshme ndërtimi: NP – 1 (A) Punime gërmimi në tokë, NP – 5 (A) Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti,

Punime speciale ndërtimi:

N.S – 4 (A) Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;

OE duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e ri të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar . Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër.

2.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës.

“**CZ.** Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.

Drejtuesi teknik / restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. AZ/2. Zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4).

3.1. OE duhet të ketë numërin e nevojshëm të punonjesve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjesve për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 duhet të jetë jo më pak se 8 punonjës.

3.2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me listëpagesa dhe diplomë për periudhën mars 2017 – dhjetor 2017 dhe janar 2018 – mars 2018 specialistë të fushës si më poshtë vijon, Restaurator, Inxhinier ndërtimi

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Pranë Ak kanë bërë kërkesë për terheqje dokumentacioni tenderi 4 kompani.

Me procesverbalin e hapjes së ofertave nr. 836/4 prot. Datë 24.05.2018 në procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“J”shpk	3,918,359	Kualifikuar
2	NNr.1	4,109,737	S’Kualifikuar
3	“A-S” & “M/S sh.p.k	4,150,000	Kualifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Me procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 836/5 prot. Datë 31.05.2018, kryet vlerësimi si më poshtë:

I. Shoqërinë “J” shpk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë shoqërinë “J” shpk.

II. Bashkimi i përkohëshëm i operatorëve ekonomikë “A-S” shpk dhe “M/S” shpk. Njësia e Vlerësimit lexoi zarfin e subjektit “A-S” shpk. Zarfi i shoqërisë është protokolluar me nr. 1046 prot., datë 23.05.2018 dhe mbi të është shkruar informacioni me të dhënat e përcaktuara në dokumentacionin standart të restaurimit “Të dhënat e restaurimit A” Të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës pika 3. U hap zarfi me dokumentat e subjektit “A-S”. Brenda zarfit të madh ndodheshin dokumentacioni ligjor i operatorëve ekonomikë “A-S” shpk dhe “M/S” shpk dhe një zarf me ofertën ekonomike. Dokumentacioni ligjor i paraqitur nga ana e shoqërisë “A-S”.

BOE “A-S shpk dhe M/S shpk” plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në DSR. Njësia e Vlerësimit vendosi të kualifikojë B. “A-S shpk dhe M/S shpk”.

III. Shoqëria “N Nr.1” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika 4. Nuk disponon asnjë nga mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. 2. Lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit – 2. Kapaciteti teknik: 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

dh. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8 Shoqëria “N Nr.1” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.1. Për kapacitetin teknik, pika dh. Nuk ka dorëzuar deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8.

Njësia e Vlerësimit vendosi të skualifikojë ofertën e paraqitur nga shoqëria “N Nr.1” sh.p.k.

- Me procesverbalin nr. 828/7 prot. Datë 31.05.2018 për vlerësimin të ofertës për klasifikimin përfundimtar renditen pikët si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	Pikët nga oferta më e ulët	Pikët nga vlerësimi KVO	Pikët Total
“A-S” & “M/S” shpk	4,150,000 lekë	80	15	95
“J” shpk	3,918,359 lekë	85	5.37	90.37
“N Nr.1” shpk	Skualifikuar	0	0	0

I. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “J” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën kontratat të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të ngjashme, përkatësisht “Restaurim i “Kishës së Shën Spiridhonit”, Vuno”, realizuar me dt.26.08.2015, vlerë 3.898.466 lekë; në rubrikën Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria nuk ka dorëzuar asnjë dokument justifikues, në rubrikën patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015; ndërsa në rubrikën specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumete të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator znj. Pellajia Basha me License Restaurimi R.P.69 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në zbatim, inxhinier ndërtimi, profili Civile industriale ura Z. 1633/5. Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operoret e tjerë në krahasim OE me të suksesshem) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperiencat e subjekteve konkruues si kritere vlerësuese, rezulton që shoqëria “J” shpk të vlerësohet me **2.95 pikë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

II. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria BOE “A-S” & “M/S” shpk rezulton se kjo shoqëri në rubrikën kontratat të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të ngjashme, përkatësisht “*Restaurimi i godines se Ish Selise se drejtorise se Sigurimit te Shtetit, Gjethi,*” realizuar në vitin 2015 me vlerë 13.544.611 lekë, ndërsa shoqëria “A-S” ka dorëzuar kontratë të ngjashme, përkatësisht “*Rehabilitimi i Manastirit të Shën Marisë dhe peisazhit Apolloni*” realizuar më datë 30.03.2018 me vlerë 87,448,284 lekë; në rubrikën Vërtetim të punimeve të restaurimit shoqëria “M/S” shpk ka dorëzuar 9 kontrata restaurimi (të detajuara në matricën bashkëlidhur), në rubrikën patenta shoqëria ka dorëzuar një certifikatë ISO 9001:2015, ndërsa shoqëria “A-S” ka dorëzuar certifikatë ISO 9001:2008; ndërsa në rubrikën specializime apo trajnime e të tjera të cilat provojnë besueshmëri në fushën e restaurimeve apo dokumete të tjera të cilat provojnë këtë eksperiencë, rezulton që shoqëria ka Restaurator z. B Mme License Restaurimi R.P.72 (Kat.AZ/1-AZ/4), Licensë personale në projektim, inxhinier ndërtimi, profili strukturist, K.1011/1 dhe Licensë K.1011/2, Licensë profesionale individuale, Nr. 1. datë 13.5.2013 “*Për vlerësim të pasurive të paluajtshme*”, Licensë personale në zbatim, inxhinier Ndërtimi, profili strukturist, Licensë Z.4587/1, ndërsa shoqëria “A-S”, ka restaurator P Th me licensë Restaurimi R.P.40 (Kat.AZ/1-AZ/4). Për këtë arsye për vlerësimin me pikë në vlerë absolute (100 pikë për operatorin ekonomik me të suksesshëm dhe x pikë për operatorët e tjerë në krahasim OE me të suksesshem) për 6 nga variablat e përcaktuara në pikën 3.b. të udhëzimit nr. 446, datë 05.07.2007, lidhur me Eksperiencat e subjekteve konkurrues si kriterë vlerësues, rezulton që shoqëria “A-S” & “M/S” shpk të vlerësohet me **15 pikë**.

Nga sa më sipër konstatohet:

Referuar sistemit të pikëzimit nga KVO, konstatohen interpretime në kundërshtime me parimet e barazisë në tendera dhe trjatime jo të njëjta në garë pasi:

-Cdo konkurent sipas LPP vlerësohet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga enti prokurues ose enti publik për të cilat është i detyruar ti plotësojë ose jo dhe në asnjë rast nuk mund të bëhet vlerësim mbi kriterë të cilat asnjëherë nuk janë kërkuar dhe aq më pak nuk janë bërë publike për të gjithë konkurentët duke shkelur paraimin e barazisë në konkurim dhe vendosjen në kushte të njëjta konkurrimi dhe jo diskriminues për konkurentët e mundshëm.

- Paraqitja e një dokumenti ekstra të pakërkuar nga Enti Prokurues nuk e ndalon konkurentin ti paraqesë ato, por nuk përbën kriter favorizimi për të.

- Vlerësimi me pikë i kryer dhe raporti i pikëzimit bazuar në kriterë të pakërkua dhe të vlerësuara maksimalisht, cili për rrjedhojë ka sjellë renditje jo të drejtë të konkurentëve jo vetëm nuk ka asnjë mbështetje ligjore Udhëzimin MTKRS, Nr. 446, datë 05.07.2007.

Si përfundim me raportin përmbledhës nr. 1196 prot. Datë 06.06.2018 miratohet përfundimi i procedurës ku shpallet fitues shoqëria “A-S” & “M/S” me vlerë 4,995,049 pa TVSH, ku me prokurën e posacme puna përfaqësohet nga shoqëria “Mane/S”. Me urdhërin nr. 1196/1 datë 06.06.2018 të Drejtorit Pëgjithshëm A D, shpallet fituesi dhe urdhërohet publikimi i tij. Me shkresën nr. 1196/2 datë 06.06.2018 drejtuar APP, njoftohet fituesi i restaurimit.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, nga sistemi i vlerësimit të pikëve nga KVO, janë trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **neni 1** ku përcaktohet: “*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public*”. **Neni 2** të LPP “*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit”.

Ofertat e “J” sh.p.k”, me vlerë 3,918,359 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për IMK, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, në referencë të legjislacionit të LPP dhe Udhëzimeve apo VKM të trashëgimisë kulturore. Interpretimet e sistemit të pikëzimit kanë cuar në trajtim jo të barabartë të OE.

Pra sistemi i vlerësimit ka krijuar efekte financiare negative, në vlerë prej **277,969 lekë me TVSH** (4,150,000 lekë - 3,918,359 lekë = 231,641 lekë x 20% TVSH), midis ofertës së “J” sh.p.k”, " shpk dhe ofertën e Operatorit Ekonomik "M/S" shpk, të shkaktuar nga vlerësimi i ofertave me sistemin e pikëzimit për ofertën më të mirë, të cilat nuk janë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit.

- Kontrata e restaurimit për “Restaurim i Objektivit Ura e Kollorcës 4 Km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat” nënshkruhet me nr. 1236 prot. Datë **11.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 4,150,000 lekë pa TVSH me afat zbatimit **120 ditë** ditë nga lidhja e kontratës.

- Kontrata e restaurimit për “Restaurim Banesa Vëllezërve Frashëri” nënshkruhet me nr. 1235 prot. Datë **11.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 4,995,049 lekë pa TVSH me afat zbatimit **60 ditë** nga lidhja e kontratës, ku ky operator ekonomik është favorizuar me të njëjtën dokumentacion për kapacitetin ekonomik dhe teknik për kontratat si më poshtë vijon:

- Kontrata e restaurimit për “Restaurim Kisha “Shën Apostuje” Hoshtevë, Zagori” nënshkruhet me nr. 1340 prot. Datë **25.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 15,999,442 lekë pa TVSH me afat zbatimit **180 ditë** nga lidhja e kontratës.

- Kontrata e restaurimit për “Restaurim Kisha “Shën Thanasi”, Leshnicë, Sarandë” nënshkruhet me nr. 1341 prot. Datë **25.06.2018**, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj. D P dhe operatorit ekonomik M/S shpk, përfaqësuar nga administratori z. M M. Vlera e kontratës është 8,427,623 lekë pa TVSH me afat zbatimit **150 ditë** nga lidhja e kontratës, sipas grafikut të punimeve.

Për sa trajtuar më sipër, konstatohet se BOE “A-S” & “M/S” shpk, duhej të skualifikohej pasi të dyja shoqëritë kanë paraqitur në të njëjtën kohë të njëjtin dokumentacion për stafin teknik (restaurator etj), të njëjtat mjete me të cilat do të kryheshin punimet në kontrata të tjera, me shpërndarje gjeografike të largët nga njëra-tjetra dhe me të njëjtë grafik punimesh.

Sa më sipër bazuar në dokumentacionin në dispozicion, konstatohet trajtime jo të barabarta të OE, duke mos garantuar ofetën ekonomike më të mirë, transparencë dhe siguri në proçedurën e prokurimit.

8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për “Restaurim i Objektivit “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” 2019, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Restaurim i Objektivit "Mësonjëtorja e Parë Shqipe 2019		
1. Urdhër Prokurimi 1592 datë 25.07.2019	3.1 Njësia e Prokurimit A.Z. L.D G.T	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave A.I N.N E.E G. B.K
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur”		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

5. Fondi Limit (pa tvsh) 25,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 24,706,032 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 293,968 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 13.08.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 26.08.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 29,647,238 lekë	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me vendimin nr. 1886 prot. Datë 10.06.1973 të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Mësonjtorja e parë, shpallet monument kulture kategoria e I. Me Vendimin e KKR-së nr. 27 datë 10.01.2018, miratohet projekti "Restaurim i Objektivit "Mësonjëtorja e Parë Shqipe".

Me kërkesën për autorizim të titullarit të IMK nr. 4591/2 prot. Datë 25.07.2018, drejtuar Ministrisë së Kulturës, kërkohet autorizim për fillimin e procedurave të prokurimit dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 496 datë 16.07.2018, shtohet fondi prej 30,000,000 lekë për Mësonjëtorja e Parë Shqipe. Me shkresën nr. 1587 prot. Datë 25.07.2019 drejtuar Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK), kërkohet pajisja me pasaportë dhe kthimi i përgjigjes për pasaportën me shkresën nr. 693/1 datë 25.07.2019. Me kontratën për njoftime nr. 1590 prot. Datë 25.07.2019, nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me RTVSH, për transmetimin në TVSH të njoftimeve të IMK për objektin e restaurimit. Me kontratën për reklamë në botim në gazetë nr. 1591/1 prot. Datë 25.07.2019 nënshkruhet marrëveshja me IMK dhe me Gaz.M, për publikimin e njoftimeve të IMK për objektet e restaurimit.

-Me urdhrin e prokurimit e ndryshuar të titullarit të IMK nr. 1592 datë 25.07.2019, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 25,000,000 lekë pa TVSH, me objekt “Restaurim i Objektivit "Mësonjëtorja e Parë Shqipe”, ku ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga A Z, L D dhe G T. Ngarkohet edhe njësia e vlerësimit e përbërë nga A I, N N, E M, G V dhe B K.

Urdhri i prokurimit është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007.

- Me procesverbalin nr. 1592/1 prot. Datë 25.07.2019 përcaktohen kërkesat kualifikuese dhe kriteret e kualifikimit. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese janë bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret e vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 date 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës“. Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”.

-Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

-U konstatuan se DT, janë në kundërshtim të legjislacionit të prokurimit publik **nenin 46**, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik*. Sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 26** "Kontrata për punë publike" pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si më poshtë vijon:*

Janë kërkuar shumë kriteret të sforcuara ku OE duhet të disponojë shum staf inxhinierik dhe teknik **ndryshe nga prokurimet e realizuara për vitin 2018.**

Në pikën 2.3.5 Drejtuesi teknik / restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. "A Z/3. Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së parë dhe të dytë".

2.3.7. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me listëpagesa dhe diplomë për periudhën janar 2019 – qershor 2019 specialistë të fushës si më poshtë vijon Restaurator, Inxhinier ndërtimi.

2.3.8 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk i kanë pjesë të stafit të tyre të vërtetuar në listëpagesë, duhet ti kontraktojnë dhe të vërtetojnë me kontratë pune për objektin e konkurrimit publik (për të gjithë periudhën e zhvillimit të kontratës), diplomë dhe liçence, të paktën specialistë të fushës si më poshtë vijon, Inxhinier Hidroteknik 1 (nje), Inxhinier Mekanik 1 (një), Inxhinier Topograf 1 (një), Inxhinier Elektrik 1 (një), **Inxhinier Mjedisi 1 (një), Arkitekt 1 (një).**

2.3.9. OE duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjesve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën janar 2019 – qershor 2019 duhet të jetë **jo më pak se 50 punonjës.**

2.3.10. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që zotëron personel teknik të kualifikuar për specialistët e disiplinave të poshtëshënuara dhe të figurojnë në listpagesë, 1 (një) teknik ndërtimi, **1 (një) elektroteknikë, 3 (tre) punonjës elektrikistë, 3 (tre) punonjës hidraulike, 1 (një) punonjës mekanik.**

2.3.11. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë Janar 2019 – Qershor 2019 të paktën;

-2 (dy) punonjës specialistë të certifikuar për punime që do të kryhen në lartësi

-2 (dy) punonjës Specialist ndërtimi, Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë një dokument certifikate nga *organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë që të vërtetojnë kualifikimin e mësipërm.*

Sa më sipër, lidhur me kapacitetin teknik është kërkuar që OE të kenë shumë staf në lidhje me volumin, projekt-preventivin e objektit. Numri i stafit dhe specialistët personave nuk janë argumentuar nga NJP vendosja e tyre. Konstatohen ekzagjerime dhe mbivendosje të punonjësve e specialistëve, ku kërkohet resaturator dhe më pas arkitekt, ku restauratori është i mjaftueshëm për realizim e punës.

Kërkesa që OE duhet të ketë në stafin e tij Inxh Mjedisi, nuk ka asnjë lloj lidhje me objektin e prokurimit pasi në projekt-preventiv nuk ekziston asnjë punim mbi mjedisin, ku nuk është përpjesëtim, natyrën dhe vlerën e kontratës. Numri prej 50 punonjës nuk është argumentuar vendosja e tyre në përpjetim me volumin e punës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- Gjithashtu kërkesa për specialistët 1 (një) elektroteknikë, 3 (tre) punonjës elektrikistë, 3 (tre) punonjës hidraulike, 1 (një) punonjës mekanik, përsëri nuk është në përputhje dhe në përpjestim me volumin e objektit të prokurimit, ku nuk është argumentuar nuk kaq i lartë i specialistëve në lidhje me preventivin e punimeve, pasi preventivi dhe projekti nuk ka aq shumë punime për kaq shumë specialist.

- Në DST vazhdohet përsëri me pikën 2.3.11. ku kërkohet që OE ofertues duhet të ketë të punësuar te vertetur me kontrate pune të vlefshme të paktën, 2 (dy) punonjës specialistë të çertifikuar për punime që do të kryhen në lartësi, 2 (dy) punonjës Specialist ndërtimi, të cilët përsëri janë të tepruar, ku nuk argumentohet në lidhje me volumin e objektit, pasi 8 Inxhinier e restaurator, 9 specialistë të tjerë vazhdon kërkohen edhe më shumë, ngushtojnë shumë konkurrencën e operatorëve ekonomik.

Në pikën **2.3.12**, kërkohet që OE të ketë në listëpagesë *mjekun e shoqërisë* të ketë kontratë pune, diplomë, licensë, Urdhër Mjeku. Mjeku i punës duhet të figurojë në listapagesa, në referencë të numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër. *Në rast bashkimi operatorësh ekonomik, secili nga operatorët ekonomik duhet ta plotësojë këtë kusht.*

- Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte vendosur si kriter kualifikues. *Kërkesa e mjekut të ndërmarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë" konstatohet se:*

Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet.

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".

- Në lidhje me kërkesën për anëtar i bashkimit të OE, të ketë secili Mjek në ndërmarrje është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 74 pika 3 ku citohet "secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë, kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje *me % e pjesëmarrjes në punë*, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje".

Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme sforcon kërkesat kualifikuese dhe zvogëlon konkurrencën, ku

një operator, i cilit nuk disponon **Mjek** nuk mund të kryej bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, pra përjashtohen OE, *duke i mohuar mundësinë e bashkimit të OE.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Në pikën **2.3.13**, kërkohet që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën drejtuesin teknik të shoqërisë (një person) që të disponojë certifikata e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Kërkesa e mësipërme është detyrim ligjor përse i përket legjislacionit të disiplinimit të punimeve dhe nuk është e nevojshme kërkesat me certifica të stafit të operatorit ekonomik, pasi veshitësojnë pjesmarrjen dhe ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën.

Në pikën **2.3.14** Për kryerjen e shërbimit të instalimit dhe konfigurimit të paisjeve elektronike, operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij ose me kontratë për gjithë kohën e kryerjes së punimeve një ekspert, *1(një) specialist inxhinier që të jetë i pajisur me certifikatë trajnimi PLC për pajisjet inverter të kontrollit të sistemeve industriale, automatike dhe mekanike.*

Në preventiv nuk ekziston asnjë pajisje për kontrollin e pajisjeve industriale mekanike, por vetëm ngrohja-ftohja (HVAC), e cila nuk është sistem industrial. Për më tepër vendosja e specializimeve apo trajnimeve të stafit tregon deri diku paracaktim të procedurës prokuruese.

1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, (kërkesë e cila është e mbivendosur 2.3.13 dhe 2.3.16, duke përsëritur kërkesa kualifikuese).

Në pikën **2.3.15** është kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë në staf të punësuar si më poshtë si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë:

Inxhinier mjedisi i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për “*Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Audit mjedisor.* Pra është kërkuar që Inxhinieri i mjedisit i OE duhet të disponojë VNM dhe auditimin mjedisor, e cila nuk ka asnjë arsye apo përgjithësim me zbatimin e projektit, pasi Vlerësimi i Ndikimit në mjedis, realizohet në fazë projekti dhe nuk ka asnjë arsye ti kërkohet OE që do zbatojë restaurimin, veprim cili ngushton shumë konkurrencën pa arsye.

2.3.16. Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij **1 (një)** specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin. *Në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Detyrimisht të paraqitet kontrate pune dhe certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria e MZSH.*

2.3.17. Operatori ekonomik të ketë Liçensë profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi 1.2.A.për Mbrojtjen nga Zjarri.

Kërkesat e mësipërme janë detyrime ligjore përse i përket legjislacionit të disiplinimit të punimeve dhe nuk është e nevojshme kërkesat me certifica të stafit të operatorit ekonomik, pasi veshitësojnë pjesmarrjen dhe ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën.

2.3.18. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B“Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane.

Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25. Përsëri kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me objektin, natyrën e prokurimit. Me veprimet e mësipërme nga AK krijohet konfuzin duke mos



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

argumentuar dhe mbivendosur kërkesat kualifikuese, veprime të cilat nuk nxisin konkurrencën në procedurën e prokurimit.

Në pikë **2.3.19** është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata. Nga Ak është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate **ISO/IEC 27001:2013** (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit), e cila është e paargumentuar nga AK. Kjo certifikatë specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ai gjithashtu përfshin kërkesa për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës. Pra, sic shikohet kjo certifikatë nuk ka asnjë llojë lidhje me objektin e prokurimit, duke krijuar konfuzion dhe zvogëlim shumë të ndjeshëm të konkurrencës, pasi një OE që merret me ndërtime, rikonstrukcion, restaurim kjo certifikatë në mënyrë absolute nuk i nevojitet.

- Certifikata **ISO 3834-2:2005**, e cila është e paargumentuar nga AK. Kjo certifikatë është e përgatitur e tillë që është e pavarur nga lloji i konstruksionit të salduar që do të prodhohet; ai përcakton kërkesat e cilësisë për saldimitin si në punëtori ashtu edhe në vend; ai ofron udhëzime për përshkrimin e aftësisë së një prodhuesi për të prodhuar ndërtime të salduara për të përmbushur kërkesat e specifikuar; mund të përdoret gjithashtu si bazë për vlerësimin e prodhuesit në lidhje me aftësinë e tij të saldimit. Pra, kjo certifikatë është për prodhuesit e konstruksioneve metalike të cilët duhet të jenë të certifikuar në lidhje me saldimit dhe kjo certifikatë nuk ka asnjë llojë lidhje me objektin e prokurimit e cila sjell zvogëlim shumë të ndjeshëm të konkurrencës.

-Certifikata **ISO 50001:2011**, e cila është e paargumentuar nga AK. ISO 50001: 2011 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është t'i lejojë një ndërmarje të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumin. ISO 50001: 2011 specifikon kërkesat e zbatueshme për përdorimin dhe konsumin e energjisë, duke përfshirë matjen, dokumentacionin dhe raportimin, hartimin dhe praktikën e prokurimit për pajisje, sisteme, procese dhe personel që kontribuojnë në performancën e energjisë.

Pra, sic shikohet kjo certifikatë nuk ka asnjë llojë lidhje me objektin e prokurimit, pasi OE do rikonstrukttojë dhe do vendosi paisjet e përcaktuara në specifikimet teknike dhe termave të referencës dhe kjo certifikatë i nevojitet IMK për menaxhimin e energjisë dhe jo OE. Kjo certifikatë ka krijuar konfuzion dhe zvogëlim shumë të ndjeshëm të konkurrencës, pasi objekti nuk ka asnjë llojë lidhje me menaxhimin e energjisë dhe kjo certifikatë në mënyrë absolute nuk i nevojitet.

2.3.20 Për materialet elektrike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për materialet elektrike.*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

2.3.21 Për materialet Elektrike: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën e Konformitetit CE, IEC60898-1 ose ekuivalente dhe ICE 60947-2 ose ekuivalente. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën e aprovimit të raporteve të testimit, raportet e testimit të cilët duhet të jenë lëshuar *nga laboratorë testues të certifikuar me ISO*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

17025:2005 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike.

Lidhur me kërkesat **2.3.20 dhe 2.3.21**, nga AK janë vendosur kërkesa referuar dokumenteve standarde për mallra, ku AK e kërkon për operatorëve ekonomik restaurues. Kërkesat e mësipërme mbi certifikimet e mallrave janë të parashikuara në legjislacionin e disiplinimit të punimeve, ku OE do i dorëzojë certifikatat dhe testet para dhe gjatë realizimit të punës dhe jo në fazën prokuruese. Kërkesa që Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikaten e aprovimit të raporteve të testimit, raportet e testimit të cilët duhet të jenë lëshuar nga laboratorë testues të certifikuar me ISO 17025:2005, vendos përsëri ngushtime konkurrence duke përcaktuar edhe kushte kualifikuese për laboratorët certifikues, veprime të cilat të cojnë deri diku në paracaktimin e OE fitues.

Pra, kërkesat e mësipërme nuk janë argumentuar nga NJP, ku pjesa më e madhe e tyre zvogëlojnë në mënyrë shumë të ndjeshme konkurrencën. Kriteret e vendosura mbi specialistët përkatës krijojnë paqartësi dhe ngushtim të konkurimit. Nga auditimi konstatohet se NJP ka kërkuar trajnime dhe certifikata të ndryshme që kanë bërë stafi i operatorit ekonomik, duke i ndarë me kërkesa kualifikuese teknike, e cila përbën deri diku paracaktimin e operatorit ekonomik fitues, duke mos arsyetuar vendosjen tyre, me volumin e punës që ka secili prej kërkesave të vendosura.

Nga sa më sipër konstatohet:

Kriteret Kualifikuese, kanë zvogëluar në mënyrë shumë të ndjeshme konkurrencën, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **neni 1**, ku përcaktohet: të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 2 i LPP, *Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me parime të përgjithshme, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe transparencë në procedurat e prokurimit.*

Neni 41, pika 1 e LPP citon se *autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.*

Neni 46, pika 3 e LPP citon se *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.*

Në kundërshtim VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” **neni 61** “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe **nenin 26** “Kontrata për punë publike” pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Për shkeljet të dispozitave ligjore mban përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga A Z, L D, G T.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Pranë Ak kanë bërë kërkesë për terheqje dokumentacioni tenderi 3 kompani. Me procesverbali e hapjes së ofertave nr. 1592/3 prot. Datë 13.08.2019 në procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	S'kualifikuar/Kualifikuar
1	“R C”shpk	24,706,032	Kualifikuar
2	“T” shpk	24,829,416	S’Kualifikuar
3	“B” shpk	24,906,690	S’Kualifikuar

Me procesverbalin e shqyrtimit të ofertave nr. 1592/4 prot. Datë 15.08.2019, kryet vlerësimi si më poshtë:

I. Njësia e Vlerësimit lexoi zarfin e subjektit “**T**” shpk. Zarfi i shoqërisë është protokolluar me nr. 1702, datë 13.08.2019.

- Shoqëria “T” shpk, për plotësuar kriterin e punëve të ngjashme ka dorëzuar një kontratë të realizuar me Bashkinë Ura Vajgurore, të cilën e vërteton me dokumentat: kontratë, formulari i vlerësimit, akt kolaudimi dhe situacion përfundimtar por nuk ka disponon faturën siç kërkohet në DSR.

- Shoqëria “T” shpk, nuk plotëson kushtin 2.2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar. Nuk ka dorëzuar dokument Çertifikatë të gjëndjes financiare të lëshuar nga një ose më shumë banka me vlerë jo më të ulët se 10% e fondit, lëshuar jo më parë se 10 ditë nga data e hapjes së kërkesave.

- Shoqëria “T” shpk, nuk plotëson kushtin 2.2.4 Për Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të matura të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Shoqëria ka dorëzuar vërtetimin Nr. 648 Prot., datë 20.05.2019 (të noterizuar) në të cilin citohet se *...T shpk nuk ka detyrime për faturat e nergjisë elektrike deri në datën 20.05.2019, pa përfshirë faturën koherente muajit Maj 2019.* Shoqëria “T” shpk, nuk plotëson kushtin 2.2.4, nuk disponon një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, pra përfshirë muajin Maj dhe Qershor 2019.

- Shoqëria “T” shpk, nuk plotëson kushtin 2.3.4, nuk disponon Licencë Profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës, “CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”, në rastin e bashkimit të shoqërisë të paktën njëri prej anëtarëve të bashkimit të shoqërisë duhet të zotërojë licensën e sipërpërmendur.

- Shoqëria “T” shpk, nuk plotëson kushtin 2.3.5, Drejtuesi teknik / restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. – “A Z/3. Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së parë dhe të dytë”.

- Shoqëria “T” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për specialistës e fushës 1 (një) **Inxhinier Elektrik** dhe 1 (një) **Arkitekt**, përkatësisht mungon kontratë pune dhe 1 (një) një dokument (diplomë, certifikate niveli III e arsimit profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

- Shoqëria “T” shpk nuk disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës, për periudhën Janar-Qershor 2019, i cili duhet të jetë jo më pak se 50 punonjës.

- Shoqëria “T” shpk nuk disponon dokumentacion për personelin si më poshtë vijon:

1 (një) punonjës Teknik ndërtimi (Y H dëshmia e kualifikimit është e grupit II dhe jo grupit III siç kërkohet në DSR;

1 (një) punonjës Elektroteknikë, nuk disponon asnjë nga dokumentacioni i kërkuar, kontratën individuale të punës; një dokument (diplomë, certifikate niveli III e arsimit profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;

Punonjës Elektriçistë: për 1 (një) punonjës (A H) dëshmia e kualifikimit është e grupit II dhe jo grupit III siç kërkohet në DSR. Ndërsa për 1 (një) punonjës Elektriçist nuk disponon asnjë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

nga dokumentacioni i kërkuar, kontratën individuale të punës; një dokument (diplomë, certifikate niveli III e arsimit profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;

Në DSR kërkohen 3 (tre) punonjës elektrikistë të vërtetuar me dokumentacion por Shoqëria “T” shpk ka dorëzuar dokumentacion vetëm për 2 (dy) elektrikistë, nga të cilët njëri nuk plotëson kriterin e Dëshmisë se Kualifikimit duhet e nivelit III.

Në DSR kërkohen 3 (tre) punonjës hidraulike, të vërtetuar me dokumentacion por Shoqëria “T” shpk ka dorëzuar dokumentacion vetëm për 1 (një) hidraulik, I cili njëri nuk plotëson kriterin e Dëshmisë se Kualifikimit duhet e nivelit III.

- Shoqëria “T” shpk, nuk plotëson kushtin 2.3.17, nuk disponon Liçensë profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi 1.2.A.për Mbrojtjen nga Zjarri dhe as kushtin 2.3.18 Liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeje Urbane”.

- Shoqëria “T” shpk, ka dorëzuar certifikatën ISO 3834-2:2006 (Kërkesat e cilësisë për saldim me shkrirje të materialeve metalike) jo të vlefshme (mbaron afati datë 15.06.2019)

- Shoqëria “T” shpk, nuk disponon asnjë nga dokumentacioni i kërkuar në pikën 2.3.20 dhe 2.3.21 për materialet elektrike. Shoqëria “T” shpk nuk i plotëson kriteret e pikës 2.3.20 dhe 2.3.21.

- Shoqëria “T” shpk, nuk disponon dokumentacioni e kërkuar në pikën 2.3.23 dhe 2.3.24.

- Shoqëria “T” shpk, nuk disponon Sigurimin e Ofertës.

Referuar VKM nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licënuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij Vendimi, Njësia e Vlerësimit **vendosi të refuzojë** ofertën e shoqërisë “T” shpk.

II. Njësia e Vlerësimit për subjektin “**B SHPK**”. Zarf i shoqërisë është protokolluar me nr. 1703 prot., datë 13.08.2019.

- Shoqëria “B-93” shpk, nuk plotëson kushtin 2.2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar. Nuk ka dorëzuar asnjë dokument Çertifikatë të gjëndjes financiare të lëshuar nga një ose më shumë banka me vlerë jo më të ulët se 10% e fondit, lëshuar jo më parë se 10 ditë nga data e hapjes së kërkesave.

- Shoqëria “B” shpk, nuk plotëson kushtin 2.2.4, nuk disponon një vertetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.

- Shoqëria “B” shpk, nuk plotëson kushtin 2.3.4, nuk disponon Licencë Profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të arkitekturës, “CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”, ne rastin e bashkimit të shoqërisë të paktën njëri prej anëtarëve të bashkimit të shoqërisë duhet të zotërojë licensën e sipërpërmendur”.

- Shoqëria “B” shpk, nuk plotëson kushtin 2.3.5, Drejtuesi teknik / restauratori duhet të zotërojë licencë profesionale personale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorinë AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. “A Z/3. Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së parë dhe të dytë”.

- Shoqëria “B” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për specialistin e fushës 1 (një) Arkitekt, përkatësisht mungon kontratë pune dhe 1 (një) një dokument (diplomë, certifikate niveli III e arsimit profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional.

- Shoqëria “B” shpk nuk disponon dokumentacion për personelin si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- 1 (një) punonjës Teknik Ndërtimi dëshmia e kualifikimit është e grupit II dhe jo grupit III siç kërkohet në DSR;
- 1 (një) punonjës Elektroteknikë, nuk disponon asnjë nga dokumentacioni i kërkuar, kontratën individuale të punës; një dokument (diplomë, certifikate niveli III e arsimit profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- 3 (tre) Punonjës Elektriçistë: shqëria disponon dokumentacion për 3 (tre) punonjës elektrikist por vetëm njëri plotëson kriteret e vendosur në DSR, 2 (dy) punonjësit e tjerë disponojnë dëshmi e kualifikimit të grupit II dhe jo grupit III siç kërkohet në DSR.
- Në DSR kërkohen 3 (tre) punonjës hidraulike, të vërtetuar me dokumentacion por Shoqëria “B” shpk ka dorëzuar dokumentacion vetëm për 1 (një) hidraulik, i cili njëri nuk plotëson kriterin e Dëshmisë së Kualifikimit (është niveli I) duhet e nivelit III.
- Në DSR kërkohen 1 (një) punonjës mekanik, të vërtetuar me dokumentacion por Shoqëria “B” shpk ka disponon dokumentacionin e kërkuar në DSR.
- Shoqëria “B” shpk, nuk plotëson kushtin 2.3.17, nuk disponon Liçensë profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi 1.2.A.për Mbrojtjen nga Zjarri dhe as kushtin 2.3.18 Liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”.
- Shoqëria “B” shpk, nuk ka dorëzuar çertifikatat: ISO 27001:2013 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit), ISO 3834-2:2006 (Kërkesat e cilësisë për saldim me shkrirje të materialeve metalike) ISO 50001:2011 (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë) ose ekuivalente ISO 50001:2018.
- Shoqëria “B” shpk, nuk disponon asnjë nga dokumentacioni i kërkuar në pikën 2.3.20 dhe 2.3.21 për materialet elektrike. Shoqëria “B” shpk nuk i plotëson kriteret e pikës 2.3.20 dhe 2.3.21.
- Shoqëria “B” shpk, nuk disponon të gjithë mjetet dhe pajisjet e kërkuara në pikën 2.3.22.
- Shoqëria “B” shpk, nuk disponon dokumentacioni e kërkuar në pikën 2.3.23 dhe 2.3.24.
- Shoqëria “B” shpk, nuk disponon asnjë nga Deklaratat e kërkuara në DSR si dhe nuk disponon vërtetimet e kërkuara në DSR, përkatësisht:
Vërtetim nga gjykata që subjekti nuk është në proces gjyqësor që lidhet me aktivitetin e tij
Vërtetim nga prokuroria që subjekti nuk është në proces penal që lidhet me aktivitetin e tij.
Njësia e Vlerësimit vendosi të **skualifikojë** ofertën e paraqitur nga shoqëria “B” sh.p.k.
- Me procesverbalin nr. 1592/6 prot. Datë 15.08.2019 për vlerësimin të ofertës për klasifikimin përfundimtar renditen pikët si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta pa TVSH	Pikët nga oferta më e ulët	Pikët nga vlerësimi KVO	Pikët Total
“R C”shpk	24,706,032 lekë	85	15	100
“T” shpk	Skualifikuar	0	0	0
“B” shpk	Skualifikuar	0	0	0

Si përfundim me raportin përmbledhës nr. 1592/7 prot. Datë 21.08.2019 miratohet përfundimi i procedurës ku shpallet fitues shoqëria “R C”shpk me vlerë 24,706,032 pa TVSH. Me urdhërin nr. 1592/8 prot. Datë 21.08.2019 të Drejtorit Përgjithshëm A D, shpallet fituesi dhe urdhërohet publikimi i tij. Me shkresën nr. 1592/9 prot. Datë 21.08.2019 drejtuar APP, njoftohet fituesi i restaurimit.

c. Mbi zbatimin e Restaurimit.

Me vendimin nr. 233 datë 05.07.2019 miratohet projekt-preventivi i restaurimit. Kontrata e restaurimit për “Restaurim i Objektivit “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” nënshkruhet me nr. 1762 prot. Datë 26.08.2019, midis Institutit Monumenteve të Kulturë përfaqësuar nga Drejtori znj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

A D dhe operatorit ekonomik “R C”shpk, përfaqësuar nga administratori z. R P. Vlera e kontratës është 24,706,032 lekë pa TVSH me afat zbatimit 90 ditë ditë nga lidhja e kontratës. Lloji i kontratës është kontratë me çmim njësie të bazuar në çmimet e njësisë, të shprehura në preventivin në njësi, bazuar nën 10 të kontratës.

- Për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës bazuar në nenin 8 të kontratës “*Drejtuesi – Mbikëqyrësi i Projektit*” përcaktohet se drejtuesi i projektit është mbikëqyrësi i punimeve të restaurimit i autorizuar me shkrim nga IMK. Drejtuesi i projektit (mbikëqyrësi) do të vendos çështjet e kontratës midis kontraktuesit dhe AK, i cili mban korrespondencë të datuar me shkrim.

Referuar nenit 12 ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit teknikoekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.*

- Me shkresën nr. 1764 prot. Datë 26.08.2019, caktohen personat përgjegjës për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, si më poshtë:

F Q, si mbikëqyrës i punimeve të restaurimit (Nuk disponon licensë)

A V, si mbikëqyrës i punimeve të restaurimit (Nuk disponon licensë)

Xh M, si kolaudator i punimeve të restaurimit. (Nuk disponon licensë)

Me kontratën e shërbimit nr. 2158/4 prot. IMK, Datë 12.11.2019 dhe nr. 1646/2 prot. UPT datë 12.11.2019, nënshkruhet kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve elektrike dhe mekanike.

Në zbatim të ligjit 27/2018 "Për trashëgimime kulturore dhe muzete" Neni 72 Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja, kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse

1. Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim ose institucionet shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e pasurive të trashëgimisë kulturore.

2. Zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre u nënshtrohen vetëm parashikimeve të këtij ligji dhe për aq sa është e mundur, legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

3. Projektimi, zbatimi i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30, pika 10 “Kompetencat e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i po këtij ligji, parashikon si kompetencë Kryerjen e kontrollin teknik, mbikëqyr dhe kolaudon punimet në pasuritë kulturore material. Pojektaktet për rregullimin e kësaj veprimtarie nuk janë miratuar ende nga Instutucionet përgjegjëse.

"Regullorja mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit", miratuar me Vendim KKR nr. 75 date 3.4.2015 dhe ndryshuar me Vendim KKR nr. 58 date 10.1.2018, përcakton kriteret dhe llojet e licencave vetëm në projektim dhe zbatim. Pra nuk përcaktohet mbi mbikëqyrjen dhe kolaudimin e restaurimit.

Në nenin 83 Llojet e licencave përcaktohet se Licencat për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë licencat për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim. Këto licenca miratohen me vendim të KKTKM-së për subjektet që plotësojnë kushtet dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

kriteret e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, të parashikuar në pikën 4, të nenit 82, të këtij ligji.

Ndërkohë, mbikëqyrësit dhe kolaudatori i punimeve nuk disponon licensën përkatëse të restaurimit, cka do të thotë se mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të restaurimit nuk është në përputhje me legjislacionin e disiplinimit të ndërtimit dhe trashëgimisë kulturore.

Bazuar në Ligjin 27/2018 "Per trashëgimime kulturore dhe muzete" neni 278 "Shfuqizime", pika 3 dhe 4 citon se Aktet nënligjore të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, "Për muzetë", të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, **do të zbatohen** derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, "Për muzetë", **mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore**, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Vlen të theksohet se në IMK ka të punësuar specialist të cilët disponojnë licensa përkatëse të restaurimit si Z L, A S, por që nuk janë përcaktuar për kolaudim të objektit, të cilët nuk janë shfrytëzuar për kapacitetet e tyre.

- NJOftimi i fillimit të punimeve, procesverbali i fillimit të punimeve, nga sipërmarrësi dhe është realizuar me shkresën nr. 1765 datë 26.08.2019. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar më datë 26.08.2019.

- Me shkresat e OE nr. 1862 prot. Datë 12.09.2019 dhe nr. 1862/1 datë 10.10.2019, është kërkuar vazhdimisht plotësimi i projektit për:

a. Instalimet elektrike dhe ndricimi total i objektit brenda dhe jashtë

b. Vendosja e pajisjeve të ventilimit-ajrimit-kondicionimit (HVAC)

c. Vendosja e pajisjeve për mbrojtjen nga zjarri (MNZ).

Me vendimin nr. 325 datë 10.10.2019 të KKR, miratohet projekti për instalimet elektrike, mekanike dhe mbrojtjes nga zjarrit.

- Me shkresën e mbikëqyrësve nr. 192/1 prot. Datë 27.09.2019, drejtuar titullarit IMK, kërkohet studim i detajuar i strukturës mbajtëse të objektit, pasi grupi i specialistëve i ngritur nga IMK, konstatoi se gjatë zbatimit të punimeve restauruese u evidentuan elementë të panjohur e të paparashikuar.

- Me urdhin e titullarit nr. 2082 datë 14.10.2019, ngrihet grupi i punës për testimin e tregut dhe përllogaritjen e cmimeve të rinj, i përbërë nga A Z, L D, G T.

- Me shkresat e grupit të punës nr. 2084 prot. Datë 15.10.2019, nr. 2085 prot. Datë 15.10.2019 dhe nr. 2086 prot. Datë 15.10.2019, i kërkohet ftesë për ofertë shoqërive "R C"shpk, "M"shpk dhe "S-C"shp.k. Ofertat ekonomike të shoqërive janë pathuasje të njëjta me diferenca shumë të vogla, ku nga grupi i punës *nuk argumentohet gjetja dhe përzgjedhja e këtyre kompanive për të dhënë ofertë.* Me procesverbalin nr. 2148 prot. Datë 21.10.2019, konstatohet se pas shqyrtimit të ofertave dhe pas negociimeve me sipërmarrësin u ra dakord për preventivin me cmimet njësi.

- Me shkresën e sipërmarrësit nr. 2388 prot. Datë 18.11.2019, kërkohet shtyrje e afatit të punimeve, pasi u përforcuar struktura mbajtëse me objektë metalikë dhe vonesat e ardhura për shkak të vendimit nr. 325 datë 10.10.2019, për miratimin projektit elektrik e mekanik. Për këto arsye sipërmarrësi kërkon shtyrje të afatit për 30 ditë, e cila merret në konsideratë dhe miratohet nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Sipërmarrësi ka njoftuar përfundimin e punimeve me shkresën nr. 2581 prot. 06.12.2019. Procesverbali i përfundimit të punimeve mbahet midis palëve datë 06.12.2019. Akt kolaudimi realizohet më 11.12.2019 dhe certifikata marrjes përkohshme në dorëzim realizohet më datë 12.12.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Nga auditimi situacionit përfundimtar të kontratës, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave konstatohet disa pasaktësi si më poshtë vijon:

1. Në kapitullin e sistemeve të ngrohjes dhe ventilimit (aksesorët e montimit) në preventivin e rishikuar, zëri nr. 4 “V. Montimi i pajisjeve të brendshme F-c dysHEME, kaseta bashkë me termostatin dhe sistemin e komandimit”, sasia 10 copë, me cmimin njësi 4,550 lekë/copa, në total 45,500 lekë, konstatohet se është zë pune i mbivendosur pasi:

Në kapitullin e pajisjeve dhe terminaleve të 3 tipet e pajisjeve F-C në total 10 copë, kanë të përfshirë në cmimin njësi F.V “Furnizim dhe vendosje”, rrjedhimisht vendosja ose montimi i F-C është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi në vlerën **45,500 lekë pa TVSH**.

2. Në kapitullin e sistemeve të ngrohjes dhe ventilimit (aksesorët e montimit) në preventivin e rishikuar, zëri nr. 5 “V. Montimi i pompës së nxehtësisë”, sasia 1 copë, me cmimin njësi 17,300 lekë/copa, në total 17,300 lekë, konstatohet se është zë pune i mbivendosur pasi:

Në kapitullin e pajisjeve dhe terminaleve, Pompa e Nxehtësisë, ka të përfshirë në cmimin njësi F.V “Furnizim dhe vendosje”, rrjedhimisht vendosja ose montimi Montimi i pompës së nxehtësisë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi në vlerën **17,300 lekë pa TVSH**.

Sa më sipër, vlera këtyre zërave prej 62,800 lekë pa TVSH ose 75,360 lekë me TVSH, përbën dëm ekonomik i përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

-Në lidhje me observacionin e procedurës së konkurrimit Publik me objekt: “Restaurim i objektit “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skënderbeut)” Lezhë”, ku sqarohet se kërkesat për kualifikim dhe kriteret për vlerësim janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve Nr. 446, datë 05.07.2007 “Për miratimin e dokumentave standarte të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës” Vendimit Nr. 259, datë 13.12.2017 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe shoqëri private,

merren në konsideratë. Licensa profesionale AZ/1 është kërkuar sepse objekti ka rrënoja dhe ndodhet brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “A” të qytetit të Lezhës si dhe AZ/2 pasi objekti i përket periudhës Antiko-Mesjetare.

-Në lidhje me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve të të gjitha kontratave, ku sqarohet se: zbatimi i punimeve të restaurimit të monumenteve të kulturës, mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre nuk i nënshtrohen Ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. Në përcaktimet e Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, neni 17 pika 3, 4, 5 dhe 7: Këshilli Kombëtar i Restaurimit (KKR) miraton kriteret për licencimin e subjekteve e të personave fizikë a juridikë në fushën e projektimit apo të restaurimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, merren pjesërisht në konsideratë pasi, aktualisht nuk ekziston ende asnjë licence ne mbikëqyrje dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale, kjo deri në miratimin e akteve nënligjore të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Në lidhje me situacionin përfundimtar të kontratës, tabelën e lëvizjes së volumeve, librezën e masave, mbi pasaktësitë e volumeve nuk merren në konsideratë, pasi parimi kryesor është mirëpërdorimi i fondeve publike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

-Në lidhje me procedurat e prokurimi publik të gjitha restaurimeve, ku sqarohet se procedura është e zhvilluar në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM Nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës”, të ndryshuar me VKM Nr. 480 datë 01.08.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 216, datë 18.04.2007”, Udhëzimin e Ministrisë të Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve Nr. 446, datë 05.07.2007 “Për miratimin e dokumentave standarte të konkurimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, të cilat nuk nënshtrohen ligjit të prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku bie ndesh me Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM Nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës”, të ndryshuar me VKM Nr. 480 datë 01.08.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 216, datë 18.04.2007”, merren pjesërisht në konsideratë, ku IMK duhet të ketë kryesisht parasysh zhvillimet e procedurave në mbështetje të LPP dhe parimeve të prokurimit publik.

- Në lidhje me vlerësimin e ofertave, ku sqarohet se kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e subjekteve private për Restaurimin e Monumenteve të Kulturës mbështeten në VKM Nr. 216, datë 18.04.2007 “Për procedurat e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës”, të ndryshuar dhe në pikën 3, të Udhëzimit të Ministrisë të Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve Nr. 446, datë 05.07.2007 “Për miratimin e dokumentave standarte të konkurimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës”, merren pjesërisht në konsideratë, pasi në pikën 17 të Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave, citohet se Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave do të bëhet pas kualifikimit ligjor dhe në bazë të kriterëve të vlerësimit, siç përcaktohet në dokumentat standarte të restaurimit, të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara.

-Në lidhje me procedurën e Konkurimit Publik me objekt: “Restaurim i Objektivit “Mësonjëtorja e Parë Shqipe”, për sa i përket kërkesave, ku çdo kriter është vendosur në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e vendosura kanë patur në vëmendje stimulimin për pjesëmarrje të biznesit të vogël dhe të mesëm, nuk merren në konsideratë, pasi nuk përputheshim me volumin e objektivit. Në lidhje me situacionin përfundimtar të kontratës, librezën e masave, mbi pasaktësitë e volumeve nuk merren në konsideratë, pasi parimi kryesor është mirëpërdorimi i fondeve publike.

Gjetje 1. Kontratat e restaurimit për objektet: “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)” Lezhë”, “Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër”, “Restaurim i Objektivit “Mësonjëtorja e Parë Shqipe”, etj, janë caktuar punjonjës për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin, të cilët një pjesë e tyre nuk disponojnë licensën përkatëse të restaurimit, cka do të thotë se mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të restaurimit nuk është në përputhje me legjislacionin e disiplinimit të ndërtimit dhe trashëgimisë kulturore. Veprimi është në kundërshtim me në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 nenin 7 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar dhe të ligjit 27/2018 “Për trashëgimime kulturore dhe muzete” Neni 72 Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja, kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse, ku projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licensuara për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

këtë qëllim ose institucionet shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e pasurive të trashëgimisë kulturore. IMK ka të punësuar specialist të cilët disponojnë licenca përkatëse të restaurimit, por që nuk janë shfrytëzuar për kapacitetet e tyre.

Ndikimi/Efekti: Moszbatim i punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore, ku mbikëqyrja dhe kolaudimi i tyre u nënshtrohen vetëm parashikimeve të ligjit dhe për për trashëgimine kulturore aq sa është e mundur dhe legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

Rëndësia: I Lartë

Gjetje 2. Institutit të Monumenteve të Kulturës, për procedurat e prokurimit publik nuk ka ndjekur apo respektuar Vendimin Nr. 45 datë 21.01.2009 të KM “Për kryerjen e procedurave në mënyrë elektronike”, pika 1, ku vendoset që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen me mjete elektronike. Sistemi elektronik u përdor në mënyrë të suksesshme nga Ministritë dhe gjatë vitit 2008 u organizuan trajnime për të gjitha njësitë e qeverisjes. Agjencia e Prokurimit Publik ndër vite ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë trajnime apo vendime të konflikteve ligjore. APP-ja ka nxjerrë vazhdimisht udhëzime për realizimin e procedurave në formë elektronike. Zhvillimi i procedurave në mënyrë elektronike do të garantonte transparencën në përdorimin e fondeve publike, ku nga IMK nuk është zbatuar, apo të jetë kërkuar interpretim nga APP apo KPP realizimin e procedurave prokuruese.

- Prokurimet janë realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese nga AK hartohen bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret të vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Nga procedurat e realizuara për vitin 2018 dhe 1 procedurë e realizuar në vitin 2019. Konstatohet se pjesëmarrja ndarja e kontratave është e përqëndruar në një grup të vogël shoqërisht, të cilat konkurojnë në procedurat restauruese.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 date 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës“. Vlerësimi i Ofertës më të mirë ekonomike konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë 85 pikë, ku ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës dhe Eksperiencia e subjekteve konkurrues, që mund të jenë, shoqëri restauruese, shoqëri ndërtimi, me nënkontraktorë restaurator, individë restaurues do të vlerësohet deri në 15 pikë.

Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, sipas legjislacionit lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale parashikohen në dokumentet standarde të konkurimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

shkallës së vështirësisë së projektit. Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e para më shumë se një ofertë, njësia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit.

- Referuar sistemit të pikëzimit nga KVO, konstatohen interpretime në kundërshtime me parimet e barazisë në tendera dhe trajtime jo të njëjta në garë.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit, rezulton një sistem vlerësimi i pabarabartë dhe jo i drejtë pasi pikët maximale fitohen nga OE që ka paraqitur kontratën e ngjashme me vlerë më të madhe, më shumë certifikata (të pakërkua), më shumë vërtetime (të pakërkua), më shumë trajnime (të pakërkua), duke diskriminuar OE pjesëmarrës, në kundërshtim me të gjitha parimet e transparencës dhe ligjeve të prokurimit publik. Vlen të theksohet se trajtimi i barabartë krijohet nga interpretime të KVO, ku në asnjë një faqe të DST, nuk përmendet sistemi i vlerësimit dhe lloji i kushtit të garimit.

- Cdo konkurent sipas LPP vlerësohet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga enti prokurues ose enti publik për të cilat është i detyruar ti plotësojë ose jo dhe në asnjë rast nuk mund të bëhet vlerësim mbi kriteret të cilat asnjëherë nuk janë kërkuar dhe aq më pak nuk janë bërë publike për të gjithë konkurentët duke shkelur parimin e barazisë në konkurim dhe vendosjen në kushte të njëjta konkurrimi dhe jo diskriminues për konkurentët e mundshëm.

- Paraqitja e një dokumenti ekstra të pakërkuar nga Enti Prokurues nuk e ndalon konkurentin ti paraqesë ato, por nuk përbën kriter favorizimi për të.

- Vlerësimi me pikë i kryer dhe raporti i pikëzimit bazuar në kriteret të pakërkua dhe të vlerësuara maksimalisht, cili për rrjedhojë ka sjellë renditje jo të drejtë të konkurentëve jo vetëm nuk ka asnjë mbështetje ligjore Udhëzimin MTKRS, Nr. 446, datë 05.07.2007, por ka bërë që të ketë dhe efekte ekonomike në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit.

Ndikimi/Efekti: Vlerësimi i pabarabartë dhe jo i drejtë, duke diskriminuar OE, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe ligjeve të prokurimit publik.

Rëndësia: I Lartë

5. AUDITIM I OBJEKTIT TË VEPRIMTARISË FUNKSIONALE LIGJORE TË IMK-S :

a.Zbatimi i legjislacionit, për mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rijetëzimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Detyra themelore e IKTK-së, është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Në funksion të përmbushjes së Misionit të tij, IKTK merr të gjitha masat që sigurojnë gjurmimin, evidentimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK, aktivitetin e tij e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e tij. Bazuar në Ligjin nr. 9048/2003 i ndryshuar, në nën 17 pika 2 dhe Rregullores për Organizimin dhe funksionimin e KKR, miratuar me Urdher të Ministrit të Kulturës, nr. 8 datë 14.1.2014, nën 5, përcaktohet se mbledhjet e KKR thirren nga Kryetari jo më pak se 1 mbledhje në dy muaj. Në raste të vecanta, me kërkesë të Kryetarit mbledhjet brenda një afati prej 48 orësh pasi projekti të jetë shqyrtuar me pare në Këshillin shkencor të IMK. Afati i trajtimit të kërkesave për miratim në KKR dhe shpeshësia e mbledhjeve të KKR lidhet ngushtë me numrin e kërkesave të paraqitura për shqyrtim.

Për këtë arsye në praktiken e zhvillimit të veprimtarisë së KKR mbledhjet janë më të shpeshta se një herë në dy muaj.

Bazuar në Ligjin 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nën 80, Lidhur me Procedurën e Lejes për Ndërhyrje, përcaktohet: KKTKM-ja shprehet me vendim brenda afatit 45 ditor nga paraqitja e kërkesës, në bazë të relacionit teknik të IKTK-së, nëse është e nevojshme të bëhen verifikime të natyrës teknike pezullohet afati, por në çdo rast, jo më shumë se 60 ditë.

Aplikimi paraqitet në Sportelin unik - Regjistrin dhe mban regjistrin për kërkesat/ aplikimet e paraqitura - brenda ditës, kalon dosjen përkatëse Sekretarisë Teknike për procedim të mëtejshëm.; Sekretaria Teknike (brenda dy diteve) - nëse kërkesa e paraqitur nuk përmban të gjithë të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në ligj ose në akt nënligjor, nëpunësi i sekretarisë teknike njofton kërkuesin dhe i cakton atij një afat 10 ditor për plotësimin e të metave të kërkesës. Nëse kërkuesi nuk i plotëson të metat brenda afatit të caktuar, e kthen dosjen “pa veprim”.

Nëse aplikimi përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në ligj sekretaria administron dosjen dhe në përputhje me këtë rregullore ia përcjell për shqyrtim të mëtejshëm Sektorëve të përmbytjes në IKTK dhe DRTK. Sektorët e përmbytjes në IKTK bëjnë kontrollin e përputhshmërisë dhe në bashkërendim me Sekretarinë Teknike hartojnë relacionin brenda 5 diteve; Sekretaria Teknike ia përcjelle ceshtjen, shoqëruar me relacionin përkatës, për shqyrtim të mëtejshëm Këshillit teknik. Këshilli teknik thirret nga Kryetari dhe njoftimi përcillet nga Sekretaria Teknike të pakten 3 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje. Njoftimi përmban vendin, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe relacionin e sekretarisë teknike. KKTKM mbledhet jo më pak se 2 here në muaj.

Për të vlerësuar rregullshmërinë e aktivitetit dhe përmbushjes së detyrave funksionale të IKTK(ish-IMK), në rolin e Sekretariatit Teknik të KKR në funksion të misionit për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, u auditua procesi i vendimarrjes për miratimin dhe shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth nga ku rezultoi se:

Në zbatim të detyrave themelore që Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, e cila është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë, IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit, u konstatua se për **shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth, përgjatë vitëve 2017 dhe 2018 janë miratuar dy VKM të cilat vijnë në kohë pothuaj**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

mbas 18 vitesh sipas VKM –s nr.180,e cila daton, dt.13.04.2000, kjo VKM ka bërë shpalljen Ansambël Monument kulture i aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës, duke specifikuar qartësisht konturet e zonës historike për Qytetin e Tiranës, sipas planimetrisë dhe emërtesave të rrugëve dhe shesheve të indentifikuara në VKM .

Për miratimin e VKM Nr. 325, datë 12.4.2017 rezulton se nuk ka asnjë mbledhje të KKR apo diskutim lidhur me projekt-vendimin për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga IKKT, grupi i auditimit konstatoi se kjo VKM është miratuar bazuar :

- nisur nga kërkesa e Bashkisë së Tiranës sipas shkresës nr. Prot 1028 datë 27.02.2017 për rishikimin e Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Tiranës e cila thekson nevojat për ndryshimin e kufirit të ansamblit muzeal ;
- për saktësimin e koordinatave dhe mospërputhjeve të gjurmës së kufirit;
- edhe si nevojë e pershtatjes së terminologjisë bazuar në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar) dhe në VKM Nr. 426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”, ku dhe është rishikuar VKM me nr.180, dt.13.04.2000 “Shpallja Ansambël Monument kulture i aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës”.

Megjithëse nga IKKT që prej vitit 2014 ka pas një proces të inicuar për përditësimin e listës së monumenteve të kulturës që ndodhen në të gjithë territorin e Shqipërisë, i cili ka kaluar nëpër disa etapa të domosdoshme për të bërë të mundur përmbushjen e këtij projekti. I gjithë ky proces është realizuar mbi bazën e vendimeve të KKR.

Ku përditësimi i kartelave - Si proces në vazhdimësi, pas analizës së hollësishme të dhënave të marra në terren për çdo monument është bërë përditësimi i kartelave të monumenteve nga DRKK përkatëse si dhe verifikimi i tyre nga IMK.

Gjithashtu, paralelisht nisi dhe procesi i rishikimit të listës së monumenteve pasi kishte pasaktësi të mbartura prej vitesh, si për sa i përket problemeve gjuhësore, ashtu edhe mangësive në emërtesat e monumenteve, etj.

Nderkohe, edhe pas ndarjes së re territoriale, lista e monumenteve u ristrukturua në përputhje me këtë ndarje.

Kështu IMK nisur nga kërkesa e Bashkisë së Tiranës sipas shkresës nr. Prot 1028 datë 27.02.2017 për rishikimin e Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Tiranës;

si dhe me argumentimin për saktësimin e koordinatave dhe mospërputhjeve të gjurmës së kufirit, si dhe nevojën e pershtatjes së terminologjisë bazuar në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar) dhe në VKM Nr. 426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”, është rishikuar VKM me nr.180, dt.13.04.2000 “Shpallja Ansambël Monument kulture i aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës” ka përgatitur relacionin përkatës dhe me shkresë nr.503 prot datë 20.03.2017 I është drejtuar Ministres së Kulturës ka përcjellë dokumentacionin për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe zonës së mbrojtur të saj si dhe rregulloren e administrimit shoqëruar me hartën e zonifikimit.

Ku sipas relacionit kufiri i saj është saktësuar dhe zhvilluar duke rikonceptuar dhe racionalizuar përdorimet e truallit të lirë, hapësira të cilat nuk përfaqësojnë vlera të veçanta dhe nuk janë pjesë përbërëse e qendrës historike në vetvete, por nëpërmjet rihvillimit të tyre kompletojnë dhe pasurojnë atë.

Projekt-rregullorja është hartuar mbështetur në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar) dhe në VKM Nr. 426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Kartës Shqiptare të Restaurimit” dhe ka përcaktuar detyrimet dhe mënyrat për administrimin e vlerave historiko - kulturore të Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Tiranës. Ansamblet e Qendrës Historike rrethohen nga një zonë e mbrojtur, e cila krijon një hapësirë ndërmjet Qendrës Historike dhe pjesës tjetër të qytetit, të nevojshme për vlerësimin e Qendrës Historike.

Në përputhje me vlerat e çdo zone janë përcaktuar kriteret për ndërhyrjet konservuese dhe restauruese. Po kështu është evidentuar kategorizimi i monumenteve sipas kategorive që ndodhen në ansamblet e Qendrës Historike, zonës së mbrojtur, apo në pjesët e tjera të qytetit dhe kriteret për ndërhyrjet në to.

Propozimi i ri respekton dhe thekson hapësirat me vlerë në fushën e trashëgimisë kulturore, zonën arkeologjike “A” të Kalasë së Tiranës, e cila qëndron brenda kufijve të propozuar të zonës së mbrojtur të qytetit.

Projekt-rregullorja përcakton dhe mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të specializuara të MK me Bashkinë e qytetit, si dhe me institucionet, organizatat dhe subjektet e ndryshme për një mbrojtje më efektive të vlerave kulturore të qytetit.

Pra procesi i miratimit dhe propozimit të ardhur nga Bashkia Tiranë nuk ka kaluar për mendim në KKR, nuk rezultojnë se mbi çfarë dokumentacioni të cilësuar është kryer një vendimarrje e tillë, duke krijuar një proces artificial i cili heq ose përfshinose zgjeron kufijtë e një zone e cila në fakt si proces dhe kompetencë i përket KKR përbërja e të cilit lejon mendimin profesional për ndryshime të tilla.

Në vitin vitin 2018 është miratuar me VKM nr. Nr. 582, datë 03.10.2018 qendra historike e qytetit të Tiranës, përcaktimi i zonës mbrojtëse të saj dhe miratimi I planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e cila ka ndryshuar sërisht, me Vendimin e KKR nr.423, datë 26.9.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve është miratuar propozimi për deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin ku në relacionin bashkëngjitur i cili mban emrin e ish Ministres së Kulturës, për projekt- vendimin për deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin, relatohet se Ligji Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” është miratuar në datën 17.5.2018 dhe sollli një qasje të re ndaj ruajtjes dhe mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore, terminologji të re në kategorizimin dhe tipologjitë e pasurive kulturore, klasifikimit i tyre, etj. Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, miratuar në datën 17.5.2018, në funksion të përmbushjes së Misionit të tij, IKTK ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore.

Për sa më lart, VKM Nr. 325, datë 12.4.2017 “Për shpalljen e Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës dhe miratimin e Rregullores për administrimin e saj e të Zonës së Mbrojtur përreth” duhej rishikuar në përshtatje me ligjin e ri.

Rishikimi është përqendruar në:

- saktësimin e terminologjisë dhe të koncepteve bazuar në ligjin e ri;
- pasqyrimin e kriterëve të diversifikuara të mbrojtjes dhe ruajtjes të qendrave historike dhe zonave mbrojtëse të tyre, referuar vlerave kulturore specifike për të cilat ato janë deklaruar.

Ai bazohet në ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeve”:

- gërmat “a” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 9;

3. Këshilli i Ministrave:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

a. miraton plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore të paluajshme;
ç) deklaron pasuritë kulturore të paluajshme, të grupuara sipas parashikimeve të këtij ligji;

- pikës 3 të nenit 62,

3. Deklarimi i pasurisë kulturore miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me përjashtim të deklarimit të pasurive kulturore të paluajshme të grupuara, sipas përkufizimeve dhe klasifikimit të parashikuar në këtë ligj, e cila kryhet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Nëse procedura është për grupim objektsh të paluajshme, komunikimi i dërgohet edhe njësisë së vetëqeverisjes vendore.

- pikës 1 të nenit 96

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në lidhje me pasurinë kulturore të paluajshme, si dhe Këshilli i Ministrave, për grupimin e pasurive kulturore të paluajshme, kanë kompetencë të përcaktojnë zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajshme, veçmas ose të grupuara, perspektivën, dritën, kushtet mjedisore dhe peizazhin.

Por realisht kjo VKM ka ndryshuar kufijtë e qendrës historike, në të cilën po ti referohemi hartës së zonimit, pra justifikimi i objektit të ndryshimit për shkak të terminologjisë me ndryshimet e propozuara kanë sjellë ndryshime thelbësore të këtyre kufijve ku vërtet janë përfshirë objekte të reja si Piramida, Presidencia, Parku Rinia Parku në Krah të Presidencës, Hotel Rogneri etj, Pallati i Kongreseve objekte të viteve 50-80 për të cilat nuk ka një relacion mbështetës se pse këto objekte konsiderohen me vlerë historike dhe duhen përfshirë, një relacion mungon një gjë e tillë.

Në relacion e miratuar nga KKR të datës 26.09.2018, konstatohet se nuk është shprehur qartësisht se cilat objekte hiqen nga qendra historike dhe arsyeimi përkatës për to, ndërkohë që nuk rezulton të kemi shprehje të Këshillit Shkencor të IMK apo cilësim të opinionit të tyre lidhur me këto çështje. Nuk evidentohet pse ndryshojnë kordinatat e zonës së mbrojtur Z 82-Z-83-Z80 ne kufijtë e Universitetit të Tiranës dhe Liqenit artificial, nuk spjegohet pse në qendrën e Tiranës janë shtyrë kufijtë e qendrës historike në zonën T83-T81 apo T27-T28, etj. *(qartësisht të dallueshme vetëm duke krahasuar hartën e zonimit të miratuar në vitin 2017 krahasuar me hartën e zonimit të vitit 2018 dhe kordinatat e saj)*

Në vendimin e KKR theksojmë se është bërë shqyrtimi në një mbledhje nga anëtarët e KSh të kësaj çështjeje por për që mendimi i KSH nuk pasqyrohet në relacion argumentimi dhe selektimi i ndryshimit të këtyre kufijëve.

Për sa mësipër konstatojmë se procesi i miratimit apo dhe nevoja e ndryshimit apo përcaktimit të kufijëve sipas kordinatave nuk rezulton të jetë i plotë me argumenta të qarta nga institucionet e përfshira në proces, si Këshilli Shkencor, Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, Ministrin e Kulturës që është njëkohësisht dhe Kryetar i KKR vetë KKR duke mos përmbushur funksionet institucionale dhe specifikat profesionale të tyre, vendimarrjet e të cilëve në fakt janë përdorur si fasadë për të justifikuar veprimet e institucioneve (strukturave) që nuk kanë kapacitetet dhe njohuritë për vendimarrje që prekin trashëgiminë kulturore dhe memorjen historike të shqiptarëve në këtë rast Bashkia e Tiranës apo dhe KM.

b. Zbatimi i drejtimit dhe organizimit të veprimtarisë së Institucionit, në përputhje me legjislacionin e trashëgimisë kulturore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

1. Auditim mbi aplikimet për pajisje me licencë në fushën e restaurimit

Për periudhën e auditimit nga viti 2017-2019 pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës janë administruar kërkesa për pajisje me licencë individuale në restaurim për herë të parë, për licencë për shoqëri, rinovim licence dhe heqje të saj. Në mbështetje të rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e Licencave të Ushtrimit të Profesionit të Restauratorit”, gjatë viteve 2017-2019 janë miratuar gjithësej 27 licenca, nga të cilat 12 janë licenca individuale, 14 për shoqëri dhe një heqje licence për shoqëri. Bazuar në Ligjin 27/2018 “Për Trashegiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 82, pika 4, “Kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave, procedurat për dhënien, pezullimin ose revokimin e licencave si dhe kuotizacioni vjetor i licencave, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Ministria e Kulturës ka hartuar dhe është në proces miratimi të: Projekt vendimit mbi Miratimin e kushteve dhe kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin dhe revokimin e licencës si dhe kuotizacionin vjetor të licencave për veprimtari ndërhyrëse ;

Projekt vendimit mbi Miratimin e kushteve të posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat e shqyrtimit dhe revokimit të licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore. Gjithashtu, neni 82, pika 4, “Brenda 3 viteve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, subjektet e licencuara përpara miratimit të tij kanë detyrimin të marrin kreditet sipas një programi formimi intensiv vazhdues, miratuar me urdhër të titullarit të IKTK-së. Mospërmbushja e këtij detyrimi sjell revokimin e licencës”. Bazuar në kete parashikim, të gjitha subjektet e licencuara do të nenshtrohen formimit intensiv vazhdues dhe vleresimit të vazhdueshëm. Për sa me sipër, nisur nga parashikimet e ligjit dhe akteve nenligjore, ndryshimeve thelbësore në: Përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe dokumentet shoqëruese për t’u pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale për personin fizik dhe juridik; Nënkategoritë e licencave për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, Procedurat për dhënien, pezullimin dhe revokimin e licencave për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Të drejtat që kanë personat fizik dhe juridik për t’u pajisur me licencë në kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale; Detyrimet dhe kufizimet që kanë personat fizik dhe juridik, si dhe masat administrative, për rastet e veprimeve në kundërshtim me dispozitat në fuqi, gjatë ushtrimit të aktivitetit;

Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Restaurimit më datë 27.07.2018, është vendosur në fokus aplikimet për pajisje me licencë restaurimi për individë dhe shoqëri në fushën e restaurimit, u dakortësia nga anëtarët e KKR që të pezullohet pajisja me licencë individuale në restaurim për herë të parë pa mbaruar gjithë procedurën e akteve nenligjore që kanë të bëjnë konkretisht me licencat.

Pas kesaj periudhe janë trajtuar vetëm kërkesat për pajisje me licencë për shoqëri, rinovim licence dhe heqje të saj. Me Vendim të KKR nr.58 datë 10.01.2018 është miratuar, Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e Licencave të Ushtrimit të Profesionit të Restauratorit”; Projekt vendim Mbi Miratimin e kushteve dhe kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin dhe revokimin e licencës si dhe kuotizacionin vjetor të licencave për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale; Projekt vendim Mbi Miratimin e kushteve të posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, si dhe procedurat e shqyrtimit dhe revokimit të licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Pavarsisht fakteve të mësipërmedhe procesit në miratim të akteve ligjore theksojmë se ku dhënia e licencave është pezulluar për shkak të ndryshimit të legjislacionit në vitin 2018, afatet e parashikuara për nxjerrjen e akteve normative janë tejkaluar dhe duhet të kishte rifilluar si proces. Këto akte nuk janë miratuar edhe pse janë hartuar, procesi qëndron i bllokuar duke sjell “mbyllje” të tregut me shoqëri të reja në këtë fushë, dhe persona të licensuar. Në muajin Shkurt pas evidentimit nga ana jonë janë përgatitur por ende janë pa miratuar aktet ligjore që rregullojnë procesin e parashikuar në Ligjin për trashëgimin dhe muset’.

Gjatë viti 2017 Këshillit Shkencor i IMK ka zhvilluar 20 mbledhje ku janë marrë 3 vendime, ndërsa Këshilli Kombëtar i Restaurimit është mbledhur 11 herë dhe ka marrë 365 vendime.

Janë miratuar:

NR	EMËRTIMI	TOTALI 2017
1	PROJEKTE RESTAURIMI HARTUAR NGA IMK	36
2	PROJEKTE RESTAURIMI, HARTUAR NGA DRKK	59
3	PROJEKTE NË MONUMENTE OSE NE ZONA TE MBROJTURA HARTUAR NGA OJF DHE TE TRETË	37
4	PROJEKTE RESTAURIMI TË HARTUAR NGA PRIVAT TË LICENSUAR.	65
5	PROJEKTE RIKONSTRUKSIONI DHE REHABILITIMI NË QENDER HISTORIKE OSE ZONA TE MBROJTURA	19
6	PROJEKTE INFRASTRUKTURE	78
	TOTALI PROJEKTE TË MIRATUAR NË KKR	294
7	RREGULLORE TË MIRATUARA	3
8	SHPALLJE MONUMENT KULTURE KAT E I DHE E DYTE	5
9	ZONE E MBROJTUR E MONUMENTIT	18
10	SHPALLJE NE MBROJTJE PARAPRAKE	2
11	PROPOZIME PËR ZGJERIM TË PARQËVE ARKEOLOGJIKE	0

Për vitin 2018 në mbledhjet e KKR janë miratuar 529 projekte ku cilësojmë

NR	EMËRTIMI	TOTALI 2018
1	PROJEKTE RESTAURIMI, HARTUAR NGA IMK	72
2	PROJEKTE RESTAURIMI, HARTUAR NGA DRKK	71
3	PROJEKTE NË MONUMENTE OSE NË ZONA TË MBROJTURA HARTUAR NGA OJF DHE TË TRETË	42
4	PROJEKTE RESTAURIMI TË HARTUARA NGA PRIVATË TË LICENCUAR.	69



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

5	PROJEKTE RIKONSTRUKSIONI DHE REHABILITIMI NË QENDRA HISTORIKE OSE ZONA TE MBROJTURA	22
6	PROJEKTE INFRASTRUKTURE	161
	TOTALI PROJEKTE TË MIRATUAR NË KKR	437
7	RREGULLORE TË MIRATUARA	8
8	SHPALLJE MONUMENT KULTURE KAT. E PARË DHE E DYTË	1
9	ZONE E MBROJTUR E MONUMENTIT	-
10	SHPALLJE NË MBROJTJE PARAPRAKE	1
11	PROPOZIME PËR ZGJERIM TË PARQEVE ARKEOLOGJIKE	-
12	SAKTESIM I NJOLLËS SË MONUMENTIT	2
13	PROPOZIME PËR SHPALLJE QENDRA HISTORIKE	6
14	LICENCA NË RESTAURIM PERSONAL/SHOQËRI	3
15	KËRKESAT E LEGALIZIMEVE	69
16	PROPOZIM PËR HEQJE STATUSI MONUMENT KULTURE	1
17	PROJEKTE/KËRKESA TË PAMIRATUARA	1
	TOTALI TË TJERA TË MIRATUARA NË KKR	92
	TOTALI	529

A.Nga auditimi rezultoi se për vitin 2017 nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve janë paraqitur dhe miratuar 25 kërkesa për legalizim objektsh kryesisht banesa, për vitin 2018 janë miratuar 69 kërkesa dhe për vitin 2019, 27 kërkesa të cilat janë kryesisht në qytetet Tiranë dhe Korçë.

Nga auditimi me zgjedhje i këtyre procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga nga Sekretaria Teknike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, ku miratimi i legalizimit është bërë nga KKMT kryesuar nga ish-Ministrja e Kulturës dhe IMK në rolin e Sekretariatit teknik bazuar në relacionin e Drejtorisë Rajonale Korçë, rezultoi se:

Kërkimet për legalizime janë përcjellë nga Drejtoritë rajonale të Aluizni-t Korçë dhe Tiranë bazuar në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku neni 39 përcakton kategoritë e përjashtimit nga legalizimi të ndërtimeve paleje të cilat çënojnë integritetin e monumenteve të kulturës nuk legalizohen. Si dhe në zbatim të nenit të sipërcituar VKM nr.280 datë 01.04.2015 në seksionin II. Kriteret për legalizimin në zonat informale të miratuar, pika 2.d e tij përjashton nga legalizimi ndërtimin informal kur: është ngritur brenda zonës mbrojtëse të objekteve të trashëgimisë kulturore të shpallura me ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 të ndryshuar sipas kategorive:

i) monument culture I kategorisë së I;

ii) zonë muze, ansambël muze, qendër historike dhe park arkeologjik;

iii) zonë arkeologjike “A”;

dh) çënon vëllimin ose pamjen e jashtëme të monumentit të kulturës, të kategorisë II sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003” për Trashëgiminë kulturore dhe muzet’ ku në nenin 29 pika 1,2 dhe 3 të tij ku ligj shprehet qartësisht se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

2. Në këto kategori objektesh **është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri**, me përjashtim të rrejtit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Gjithashtu Neni 32 i po këtij ligji në pikën 2 të tij shprehet qartësisht dhe për zonat e mbrojtura dhe “në këtë zonë ndalohet çdo lloj ndërhyrje me karakter ndërtimor.

Për sa mësipër drejtoritë rajonale krahas kërkesës së mësipërme kanë përcjellë një dosje në të cilën jepet planimetria foto të ndërtimit dhe raport të inxhinjerit të cilat janë trajtuar më poshtë, duhet të theksojmë se në dosje bazuar në Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit” ku citohet “1. **Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.06.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.**” dhe nenin 3, gërma a ku citohet “**Ndërtim pa leje**” është objekti, për të cilin është përfunduar karabinaja, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera, (si, për shembull, social-kulturor, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin e territorit.”;

Nuk ka të dhëna mbi kohën në të cilën është kryer ndërtimi pasi specifikisht ligji zbatohet për ndërtime deri më 27.06.2014, duke fshehur kështu kohën në të cilën ato janë ndërtuar në kundërshtim me sa më sipër të cituar,

-VKM nr.589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”, pika 3 ku përcaktohet “Verifikimi i ndërtimeve informale, brenda periudhave kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhet nëpërmjet të paktën njëres prej formave të mëposhtme:

a) Përdorimit të produktit të fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë, për periudhën kohore që ai mbulon.

b) Imazheve satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese.

c) Përdorimit të planrilevimeve në kuadër të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, të administruara nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

ç) Vërtetimit me mënyra alternative, nëpërmjet çdo dokumenti tjetër, juridikisht të vlefshëm, që provon ekzistencën e ndërtimit informal në momentin kohor të dhënë (në një datë dhe vend të caktuar).

Dokumentacioni, i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit.”

Duke ju referuar dhe rregulloreve të administrimit të këtyre qendrave sidomos ajo e qytetit të Korcës e cila ka pas të miratuar rregullore administrimi dhe shpalljen qëndër historike dhe ansambël urbanistik arkitektonik tradicional qysh në vitin 2005 me vendimin nr.455 datë 23.06.2005 dhe në nenin 3 të saj për qendrat historike përcakton se në këtë zonë mund të lejohen vetëm rikonstruksione dhe restaurime të ndërtimeve ekzistuese, të cilat konsiderohen të domosdoshme për jetën e e qëndrës historike dhe përcakton qartë se këto projekte apo çdo ndërhyrje tjetër në monumente Brenda qendrës hartohen dhe miratohen nga IMK,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Dhe me rregulloren e miratuar me VKM nr.238 datë 23.03.2011 në nenin 7 parashikon ndërhyrje restauruse dhe konservuese ku ritrajtimet dhe rikonstruksionet duhet të integrohen me tërësinë e arkitekture të ansamblit. Gjithashtu dhe VKM nr.207 datë 15.03.2017 në nenin 8 ndërhyrjet në Qendrën Historike pika 6 “ ndalohen ndërtimet e reja në qendrën historike me përjashtim të rrjetit inxhinjrik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të cilat duhet të integrohen me tërësinë arkitektonike të ansamblit apo zonës historike apo të mbrojtur.

Për sa më sipër në referencë të kushteve ligjore të cituara KKR nuk duhet të merrte në trajtim procedurat për objektet për legalizim dhe as ti miratonte duke vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të cilin këto institucione janë të detyruar ta zbatojnë.

Miratimi i legalizimit është bërë nga KKMT kryesuar nga ish-Ministrja e Kulturës dhe IMK në rolin e Sekretariatit teknik bazuar në relacionin e Drejtorisë Rajonale Korçë.

B.Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të sipërcituar si edhe nga konstatimet në terren të objekteve të legalizuara përmes kësaj procedure në zonën historike dhe zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, në prezencë të arkitektes së Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, Ark. M Gj, rezulton se:

Miratimet e legalizimeve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretaria Teknike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, marrë mbi bazën e diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, si dhe mendimet institucionale të dhëna për këto objekte nga Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë, janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2;

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale,arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

*2. Në këto kategori objektesh **është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri**, me përjashtim të rrjetit inxhinjrik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.*

Asnjë prej vendimeve të KKR-së dhe mendimeve institucionale të DRKK Korçë nuk është bazuar në Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth” duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet, detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Korçës.

Në asnjë rast nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet e VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar si dhe përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë e Rregullores së tij, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 7, datë 08.02.2017.

Në 4 prej rasteve të miratimit të legalizimeve të audituara, konkretisht “shtesë kati mbi objektin ekzistues 3 kate me pronar T L I Z”, “objekti i kombinuar 4 kate + podrum në pronësi të Dh M Sh” miratuar me vendim të KKR nr. 116, datë 20.02.2018 , “objekt 4 kate me pronar S B” miratuar me vendim të KKR nr. 160, datë 21.03.2018 objekti “L G H” rezulton se janë objekte 4 kate të miratuar brenda zonës së mbrojtur së qytetit të Korçës, pavarësisht se objekti zotëron leje ndërtimi të miratuar me vendim nr 22/9 datë 11.06.2010 të KKR Korçë për ndërtimin e godinës 3-4 kate, në kundërshtim me përcaktimet e Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë e Rregullores së tij ku përcaktohet qartë se: *Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve në zonën e mbrojtur, përveç rasteve kur për to ka studime të vecanta, **nuk duhet t'i kalojë 3 katet.***



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”



Foto të objektit “L G HI”

Vendim i KKR-së nr. 114, datë 20.02.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. K D.

Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ka dërguar pranë ALUIZNI-t Korçë mendimin mbi objektin e z. K D që ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, ku citohet **se objekti nuk:**

d) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës së kategorisë I, ose është ngritur brenda zonës mbrojtëse të tij sipas parashikimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

dh) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës të kategorisë II, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

e) Cenon integritetin e objekteve në grup të trashëgimisë kulturore, të shpallura sipas kategorisë zonë e mbrojtur.

Me shkresën nr. 273 prot., datë 15.01.2018 Drejtorja e ALUIZNI-t Korçë ka bërë kërkesën për miratimin e legalizimit të objektit “Godinë 3 kate dhe podrum”, në pronësi të z. K D, pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë.

Mbi bazën e mendimit institucional të DRKK Korçë dhe pas diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka marrë vendimin nr. 114, datë 20.02.2018 mbi legalizimin e objektit “Godinë 3 kate dhe podrum”, në pronësi të z. K D, me projektues KNM Studio, ing. K M.

Nga auditimi i praktikës rezulton se veprimet e mësipërme të DRKK Korçë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2;

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objekte në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

2. Në këto kategori objekte është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri, me përjashtim të rrejtit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Si dhe në kundërshtim me Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 10, pasi:

- Objekti nuk plotëson kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, nuk ruan kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, forma e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

hapësirave të dritareve e dyerve nuk ndjek modelet tradicionale, ku lartësia është më e madhe se gjerësia, ndërsa ballkonet në kontrast të plotë me karakterin arkitekturor të banesave tradicionale të Korçës janë ndërtuar gjatë gjithë gjatësisë së fasadës. Konsoli del jashtë pronës dhe më shumë se gjerësia e trotuarit.

- Lartësia maksimale e ndërtimit i kalon 3 katet pasi kati podrum është 1.26 metër mbi nivelin e kuotës së sistemit dhe referuar VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar neni 37.

b) Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe "Bodrum", është vëllimi i ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dyshemenë e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemit të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të struktures.

Në kundërshtim me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 7, datë 08.02.2017, neni 75, pika 3 dhe 4, gjurma e ndërtimit është më e madhe se 150 m² dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit e intensiteti i ndërtimit i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar prej 75% dhe intensitet 2.8.

3. Gjurma e ndërtimit në zonën e mbrojtur nuk duhet të jetë asnjëherë më shumë se 150 m².

4. Koeficienti i shfrytëzimit të territorit dhe intensiteti i ndërtimit për ndërtimet në njësitë e ansamblit urban llogariten mbi bazën e parcelës së pronësisë dhe për parcela 150 m²-200 m² nuk duhet të tejkalojë 75% koeficient shfrytëzimi dhe 2.8 intensitet ndërtimi.

Në këto kushte mendimi institucional i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë dhe vendimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve për miratimin e legalizimit të objektit “Godinë 3 kate dhe podrum”, në pronësi të z. K D është i kundraligjshëm.



Foto të objektit “Godinë 3 kate dhe podrum”, në pronësi të z. K D

Vendim i KKR-së nr. 49, datë 10.01.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. V Dh S.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Me shkresë nr. 411 prot., datë 20.11.2017, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ka dërguar pranë ALUIZNI-t Korçë mendimin mbi objektin e z. V Dh S që ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, ku citohet **se objekti nuk:**

d) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës së kategorisë I, ose është ngritur brenda zonës mbrojtëse të tij sipas parashikimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

dh) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës të kategorisë II, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

e) Cenon integritetin e objekteve në grup të trashëgimisë kulturore, të shpallura sipas kategorisë zonë e mbrojtur.

Me shkresën nr. 6413 prot., datë 01.12.2017 Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë ka bërë kërkesën për miratimin e legalizimit të objektit “Banesë 3 kate + podrum”, në pronësi të z. V Dh S, pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë.

Mbi bazën e mendimit institucional të DRKK Korçë dhe pas diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka marrë vendimin nr. 49, datë 10.01.2018 mbi legalizimin e objektit “Banesë 3 kate + podrum” me projektues Arkitekt A P me licencë nr. RP 20, objekt i cili ndodhet brenda zonës së mbrojtur të qytetit, në pronësi të z. V Dh S.

Nga auditimi i praktikës rezulton se veprimet e mësipërme të DRKK Korçë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2;

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

*2. Në këto kategori objektesh **është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri**, me përjashtim të rrejtit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.*

Si dhe në kundërshtim me Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 10, pasi:

- Objekti nuk plotëson kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansambllit, pasi ndërtimi nuk ruan kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, forma e hapësirave të dritareve e dyerve nuk ndjek modelet tradicionale, ku lartësia është më e madhe se gjerësia, ndërsa ballkonet në kontrast të plotë me karakterin arkitektonik të banesave tradicionale të Korçës janë ndërtuar gjatë gjithë gjatësisë së fasadës.
- Lartësia maksimale e ndërtimit i kalon 3 katet pasi kati podrum është 2 metër mbi nivelin e kuotës së sistemimit dhe referuar VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar neni 37.

b) Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe “Bodrum”, është vëllimi i ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dyshemenë e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemuar të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të struktues.

- Objekti nuk i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale pasi në të nuk janë përdorur element stilizues tradicional, dyert e dritaret janë duralumin dhe me ngjyra të ndryshme, nuk janë përdorur elemente tradicionale si guri, korniza e portikë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”



Foto të objektit “Banesë 3 kate + podrum”, në pronësi të z. V Dh S

Vendim i KKR-së nr. __, datë __.__.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. M Dh B.

Me shkresën nr. 314 prot., datë 14.06.2018, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ka dërguar pranë ALUIZNI-t Korçë mendimin mbi objektin e z. M Dh B që ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, ku citohet **se objekti nuk cënëon integritetin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Zonën e Mbrojtur.**

Me shkresë nr. 4448 prot., datë 20.06.2018 Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë ka bërë kërkesën për miratimin e legalizimit të objektit “Shtesë anësore tre kate dhe shtesë në lartësi 1 kat në godinën ekzistuese 2 kate”, në pronësi të z. M Dh B, pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë.

Mbi bazën e mendimit institucional të DRKK Korçë dhe pas diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka marrë vendimin nr. __, datë __.__.2018 mbi legalizimin e objektit “Shtesë anësore tre kate dhe shtesë në lartësi 1 kat në godinën ekzistuese 2 kate”, në pronësi të z. M Dh B, me projektues Arkitekt A P me liçencë nr. RP 20.

(Për shkak të shpalljes së Gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Shqipërisë nuk u mundësua aksesimi në dokumentin e vendimit të miratimit, por rasti është audituar në terren dhe është i paraqitur në listën e objekteve të miratuara nga KKR.)

Nga auditimi i praktikës rezultojnë se veprimet e mësipërme të DRKK Korçë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2;

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

2. Në këto kategori objektesh është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri, me përjashtim të rrejtë inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Si dhe në kundërshtim me Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 10, pasi siç paraqitet edhe në foto shtesa e këtij objekti:

- Nuk plotëson kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, pasi ndërtimi nuk ruan kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, forma, stili, e materialet e përdorura janë plotësisht në kundërshtim me modelet tradicionale.
- Objekti është tërësisht në kundërshtim me karakterin arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale duke cënuar qartazi harmoninë dhe integritetin e zonës së mbrojtur të qytetit të Korçës.



Foto të objektit “Shtesë anësore tre kate dhe shtesë në lartësi 1 kat në godinën ekzistuese 2 kate”, në pronësi të z. M D B

Vendim i KKR-së nr. 215, datë 18.04.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues znj. A Ç

Me shkresë nr. 119 prot., datë 12.04.2018, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ka dërguar pranë ALUIZNI-t Korçë mendimin mbi objektin e znj. A Ç që ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, ku citohet **se objekti nuk cënon integritetin e objekteve në**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

grup të trashëgimisë kulturore. Me shkresën nr. 2498 prot., datë 16.04.2018 Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë ka bërë kërkesën për miratimin e legalizimit të objektit “Banesë 3 kate”, në pronësi të znj. A Ç, pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë. Mbi bazën e mendimit institucional të DRKK Korçë dhe pas diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka marrë vendimin nr. 215, datë 18.04.2018 mbi legalizimin e objektit “Banesë 3 kate”, në pronësi të znj. A Ç, me projektues ark. P S me liçencë nr. A- 0803. Nga auditimi i praktikës rezulton se veprimet e mësipërme të DRKK Korçë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2; **1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektivash në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore. 2. Në këto kategori objektivash është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri, me përjashtim të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve. Si dhe në ku ndërshtim me Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 10, pasi: Objekti nuk plotëson kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansambllit, pasi ndërtimi nuk ruan kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth. Çatia e tij është me një pjerrësi dhe nuk ndjek modelet e ndërtimeve ekzistuese përreth, që kanë dy ose katër plane rënieje. Lartësia maksimale e ndërtimit i kalon 3 katet pasi lartësia e çatisë e lejon shfrytëzimin e hapsirës nën të dhe referuar VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar neni 37.**

d) Në ndërtimet me çati, **hapësira nën çati vlerësohet si një kat kur, pjerrësia e saj lejon shfrytëzimin e të paktën 50% të sipërfaqes së përgjithshme të banimit të katit që mbulohet. Kur shfrytëzimi i hapësirës nën çati është të paktën 30% dhe më pak se 50%, kjo hapësirë vlerësohet si gjysmë kati.**

- Objekti nuk i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale pasi në të nuk janë përdorur element stilizues tradicional, si guri, korniza e portikë.



Foto të objektit “Banesë 3 kate”, në pronësi të znj. Anila Çomi

Vendim i KKR-së nr. 161, datë 21.03.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. Xh G



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Me shkresën nr. 63 prot., datë 19.02.2018, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ka dërguar pranë ALUIZNI-t Korçë mendimin mbi objektin e z. Xh G që ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, ku citohet **se objekti nuk cënëon integritetin e objekteve në grup të trashëgimisë kulturore në Zonën e Mbrojtur.**

Me shkresë nr. 1277 prot., datë 22.02.2018 Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë ka bërë kërkesën për miratimin e legalizimit të objektit “Godinë ekzistuese 2 kate me një shtesë në lartësi 1 kat”, në pronësi të z. Xh G, pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë.

Mbi bazën e mendimit institucional të DRKK Korçë dhe pas diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka marrë vendimin nr. 161, datë 21.03.2018 mbi legalizimin e “Godinë ekzistuese 2 kate me një shtesë në lartësi 1 kat”, në pronësi të z. Xh G, me projektues Arkitekt A P me liçencë nr. RP 20.

Nga auditimi i praktikës rezulton se veprimet e mësipërme të DRKK Korçë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2;

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objketesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

2. Në këto kategori objketesh është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri, me përjashtim të rrejtit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Si dhe në ku ndërshtim me Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 10, pasi siç paraqitet edhe në foto shtesa e këtij objekti:

- Nuk plotëson kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, pasi ndërtimi nuk ruan kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, forma e hapësirave të dritareve e dyerve nuk ndjek modelet tradicionale, ku lartësia është më e madhe se gjerësia, ndërsa ballkonet në kontrast të plotë me karakterin arkitektonik të banesave tradicionale të Korçës janë ndërtuar gjatë gjithë gjatësisë së fasadës.
- Objekti nuk është i përfunduar, nuk i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale pasi në të nuk janë përdorur element stilizues tradicional tradicional si guri, korniza e portikë.



Foto të objektit “Godinë ekzistuese 2 kate me një shtesë në lartësi 1 kat”, në pronësi të z. Xh G



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Vendim i KKR-së nr. 165, datë 21.03.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. A K L.

Me shkresën nr. 52 prot., datë 16.02.2018, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ka dërguar pranë ALUIZNI-t Korçë mendimin mbi objektin e z. A K L që ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, ku citohet **se objekti nuk cënëon integritetin e objekteve në grup të trashëgimisë kulturore në Zonën e Mbrojtur.**

Me shkresë nr. 1202 prot., datë 19.02.2018 Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë ka bërë kërkesën për miratimin e legalizimit të objektit “Shtesë në lartësi 1 kat në godinë ekzistuese 2 kate”, në pronësi të z. A K L pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë.

Mbi bazën e mendimit institucional të DRKK Korçë dhe pas diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka marrë vendimin nr. 165, datë 21.03.2018 mbi legalizimin e “Shtesë në lartësi 1 kat në godinë ekzistuese 2 kate”, në pronësi të z. A K L, me projektues Arkitekt A P me licencë nr. RP 20.

Nga auditimi i praktikës rezulton se veprimet e mësipërme të DRKK Korçë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2;

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

*2. Në këto kategori objektesh **është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri**, me përjashtim të rrejtë inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.*

Si dhe në ku ndërshtim me Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 10, pasi siç paraqitet edhe në foto shtesa e këtij objekti:

- Nuk plotëson kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, nuk ruan kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, forma e hapësirave të dritareve e dyerve nuk ndjek modelet tradicionale, ku lartësia është më e madhe se gjerësia, ndërsa ballkonet në kontrast të plotë me karakterin arkitektonik të banesave tradicionale të Korçës janë ndërtuar gjatë gjithë gjatësisë së fasadës. Konsoli del jashtë pronës dhe më shumë se gjerësia e trotuarit.
- Objekti nuk i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale pasi në të nuk janë përdorur element stilizues tradicional. Elementët e përdorur janë të rastësishëm dhe paraqesin mungesë identiteti arkitektonik pasi variojnë nga përdorimi i dyerve e dritareve duralumin, tulla xhami, qepenë metalike, lloje të ndryshme kangjellash, veshje gur i latuar në pjesën e xokolit, mbulim ballkoni me konstruksion druri, etj., duke bërë që objekti dhe shtesa në të, të mos jetë në harmoni me vetëveten dhe aq më pak me karakterin arkitektonik të objekteve të zonës së mbrojtur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”



Foto të objektit “Shtesë në lartësi 1 kat në godinë ekzistuese 2 kate”, në pronësi të z. A K L

Vendim i KKR-së nr. 109, datë 20.02.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. V Ç

Me shkresën nr. __ prot., datë __.__.2018 (në shkresë nuk arrihet të lexohen nr. i protokollit dhe data), Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ka dërguar pranë ALUIZNI-t Korçë mendimin mbi objektin e z. V Ç që ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, ku citohet ku citohet **se objekti nuk:**

d) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës së kategorisë I, ose është ngritur brenda zonës mbrojtëse të tij sipas parashikimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

dh) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës të kategorisë II, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

e) Cënon integritetin e objekteve në grup të trashëgimisë kulturore, të shpallura sipas kategorisë zonë e mbrojtur.

Me shkresë nr. 274 prot., datë 15.01.2018 Drejtorja e ALUIZNI-t Korçë ka bërë kërkesën për miratimin e legalizimit të objektit “B 3 kate”, në pronësi të z. V Ç, pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë.

Mbi bazën e mendimit institucional të DRKK Korçë dhe pas diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka marrë vendimin nr. 165, datë 21.03.2018 mbi legalizimin e “B 3 kate”, në pronësi të z. VÇ, me projektues Arkitekt K K me licencë nr. A0950.

Nga auditimi i praktikës rezulton se veprimet e mësipërme të DRKK Korçë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2;

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

*2. Në këto kategori objektesh **është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri**, me përjashtim të rrejtit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.*

Si dhe në ku ndërshtim me Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 10, pasi siç paraqitet edhe në foton e këtij objekti:

- Nuk plotëson kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, nuk ruan kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, forma e hapësirave të dritareve e dyerve nuk ndjek modelet tradicionale, ku lartësia është më e madhe se gjerësia, ndërsa ballkonet në kontrast të plotë me karakterin arkitektonik të banesave tradicionale të Korçës janë ndërtuar gjatë gjithë gjatësisë së fasadës.
- Objekti nuk i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale pasi në të nuk janë përdorur element stilizues tradicional. Elementët e përdorur janë të paraqesin mungesë identiteti arkitektonik pasi variojnë nga përdorimi i dyerve e dritareve duralumin, veshje guri, veshje tulle e kuqe, veshje tullë okër, dyer metalike, balastra, etj., duke bërë që objekti, të mos jetë në harmoni me vetëveten dhe aq më pak me karakterin arkitektonik të objekteve të zonës së mbrojtur.



Foto të objektit “Banesë 3 kate”, në pronësi të z. V Ç

Vendim i KKR-së nr. __, datë __.__.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues znj. V B.

Me shkresën nr. 131 prot., datë 18.12.2017, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ka dërguar pranë ALUIZNI-t Korçë mendimin mbi objektin e znj. V Bqë ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës, ku citohet ku citohet **se objekti nuk:**

d) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës së kategorisë I, ose është ngritur brenda zonës mbrojtëse të tij sipas parashikimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

dh) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës të kategorisë II, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

e) **Cënon integritetin e objekteve në grup të trashëgimisë kulturore, të shpallura sipas kategorisë zonë e mbrojtur.**

Me shkresë nr. 6982 prot., datë 18.12.2017 Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë ka bërë kërkesën për miratimin e legalizimit të objektit “Godinë e kombinuar 3 kate + podrum”, në pronësi të znj. V B, pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë.

Mbi bazën e mendimit institucional të DRKK Korçë dhe pas diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka marrë vendimin nr. __, datë __. __.2018 mbi legalizimin e “Godinë e kombinuar 3 kate + podrum”, në pronësi të znj. V B me projektues Arkitekt A P me licencë nr. RP 20.

(Për shkak të shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme në Republikën e Shqipërisë nuk u mundësua aksesimi në dokumentin e vendimit të miratimit, por rasti është i paraqitur në listën e objekteve të miratuara nga KKR.)

Nga auditimi i praktikës rezulton se veprimet e mësipërme të DRKK Korçë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2;

1. Zonat-muze, ansamblet-muze, qendrat historike, parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore.

2. Në këto kategori objektesh është e ndaluar çdo lloj ndërtimi i ri, me përjashtim të rrejtit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksionit. Në rastin e rikonstruksioneve, projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Si dhe në ku ndërshtim me Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 10, pasi siç paraqitet edhe në foton e këtij objekti:

- Nuk plotëson kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansambllit, nuk ruan kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, forma e hapësirave të dritareve e dyerve nuk ndjek modelet tradicionale, ku lartësia është më e madhe se gjerësia, ndërsa ballkonet në kontrast të plotë me karakterin arkitektonik të banesave tradicionale të Korçës janë ndërtuar gjatë gjithë gjatësisë së fasadës.
- Objekti nuk i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale pasi në të nuk janë përdorur element stilizues tradicional. Elementët e përdorur paraqesin mungesë identiteti arkitektonik pasi variojnë nga përdorimi i dyerve e dritareve duralumin, veshje tulle e kuqe, dyer xhami, balaustra, mbulim i konsolit me dru etj., duke bërë që objekti, të mos jetë në harmoni me vetëveten dhe aq më pak me karakterin arkitektonik të objekteve të zonës së mbrojtur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”



Foto të objektit “Godinë e kombinuar 3 kate + podrum”, në pronësi të znj. V B

Vendim i KKR-së nr. 372, datë 27._07_.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit një kat Rr “Donika Kastrioti” në Tiranë me subjekt aplikues z. F Y

Me shkresën nr. 4100 prot., datë 24.07.2018, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana Jug ka nisur kërkesën për konfirmim mbi objektin në emër të H of Art njësia Administrative nr.5 që ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit të Tiranës, ku citohet ku citohet se në kuptim të pikës 13/1 të VKM nr. 280 datë 01.04.2015 për teritorret ose sipërfaqet e tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione”

Për s amës ipër kërkohet miratimi për të vazhduar procedurat e legalizimit.

Më datë 26.07.2018 nga Drejtoria Rajonale Kombëtare Durrës sektori Tiranë është pregatitur nga sektori Tiranë z.Gj Gj dhe L N ku shprehen se objekti ndodhet në zonën e mbrojtur të qytetit Tiranë dhe vendimin janë lënë në kompetencë KKR, pa dhënë asnjë lloj mendimi mbi ligjshmërinë po vlersimin arkitektonik të objektit me ansamblin e ndërtimeve. Nëse :

d) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës së kategorisë I, ose është ngritur brenda zonës mbrojtëse të tij sipas parashikimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

dh) Cenon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës të kategorisë II, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

e) Cënon integritetin e objekteve në grup të trashëgimisë kulturore, të shpallura sipas kategorisë zonë e mbrojtur.

Nga auditimi i praktikës rezulton se krahas kërkesës së mësipërme kanë përcjellë një dosje ku janë paraqitur një fragment imazhi satelitor që tregon vendodhjen e objektit, një vetdeklarim I subjektit F Y ku deklaron ndërtimin në vitin 2006, porn ë seksionin e pronësisë se kujt I



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

përket trualli në pronësi të kujt është. Gjithashtu në dosje është një planimetri objekti kati I parë dhe kat përdhe si dhe tre formate ku jepet vendodhja në lidhje me qëndrën historike, ku objekti ndodhet në zonë të mbrojtur të gjitha fotokopje, duhet të theksojmë se në dosje bazuar në Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 2 “Fusha e zbatimit” ku citohet “1. **Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.06.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.**” dhe nenin 3, gërma a ku citohet “**Ndërtim pa leje është objekti, për të cilin është përfunduar karabinaja, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera, (si, për shembull, social-kulturore, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin e territorit.**”;

-VKM nr.589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”, pika 3 ku përcaktohet “**Verifikimi i ndërtimeve informale, brenda periudhave kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhet nëpërmjet të paktën njëres prej formave të mëposhtme:**

a) Përdorimit të produktit të fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë, për periudhën kohore që ai mbulon.

b) Imazheve satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese.

c) Përdorimit të planrilevimeve në kuadër të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, të administruara nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

ç) Vërtetimit me mënyra alternative, nëpërmjet çdo dokumenti tjetër, juridikisht të vlefshëm, që provon ekzistencën e ndërtimit informal në momentin kohor të dhënë (në një datë dhe vend të caktuar).

Dokumentacioni, i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit.”

Për sa më sipër në referencë të kushteve ligjore të cituara KKR nuk duhet të merrte në trajtim procedurat për objektet për legalizim dhe as ti miratonte duke vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të cilin këto institucione janë të detyruar ta zbatojnë.

Veprimet e mësipërme të DRKK Tiranë dhe të KKR janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 32 pika 1 dhe 2;

1. Per monumentet e kulturës përcaktohet një sipërfaqe toke ose trualli përreth si zonë mbrojtëse, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike me rrethinën dhe me rrethanat ekologjike.

2. përmasat e zonës mbrojtëse përcaktohen nga organi që shpall monumentin sipas studimit të bërë nga IMK .Në këtë zonë ndalohet cdo lloj ndërhyrje me karakter ndërtimor.

Si dhe në kuadër të vendimit nr. 325, datë 12.4.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 9 pika 1, dhe neni 10 pika 5 dhe 6 të tij.

Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1) Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- 2) Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”;
- 3) VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar.
- 4) Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë e Rregullores së tij, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 7, datë 08.02.2017.
- 5) Vendimin nr. 325, datë 12.4.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, neni 9 pika 1, dhe neni 10 pika 5 dhe 6 të tij.

Për s atrajtuar më sipër është mbajtur akt konstatimi me :

- 1) Kryetare e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, dhe anëtarët e këtij këshilli, në cilësinë e organit miratues të legalizimeve të jashtëligjshme në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës;
- 2) Anëtarët e Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e shqyrtuesve të projekteve për legalizim;
- 3) Znj. A D, drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së;
- 4) Z. E K, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, në cilësinë e drejtuesit të institucionit që ka shqyrtuar rastet në terren dhe dhënies së mendimit institucional lidhur me to në kundërshtim me përcaktimet ligjore;
- 5) Ing. Xh A dhe Ark. M Gj, në cilësinë e specialisteve në DRKK Korçë, për dhënien e mendimit institucional në kundërshtim me përcaktimet ligjore.
- 6) A P me liçencë nr. RP 20, KNM Studio, ing. K M dhe K K me liçencë nr. A0950, në cilësinë e projektuesve të objekteve në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Titulli i Gjetjes: Miratimet e legalizimeve të objekteve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretaria Teknike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, marrë mbi bazën e diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, si dhe mendimet institucionale të dhëna për këto objekte nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë **kanë cënuar detyrimet për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Korçës.**

Situata: Për të gjithë rastet e audituara (paraqitur në aneksin nr. 1), rezulton se miratimet e legalizimeve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretaria Teknike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, marrë mbi bazën e diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, si dhe mendimet institucionale të dhëna për këto objekte nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë, janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2 **ku përcaktohet se në këto zona është i ndaluar ç’do lloj ndërtimi i ri;**

Të gjitha vendimet e audituara të miratimeve të legalizimeve nga KKR dhe mendimet institucionale të DRKK Korçë, janë dhënë për objekte të cilat nuk plotësojnë kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, nuk ruajn kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, nuk i përshtaten karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale. Objektet paraqesin mungesë identiteti arkitektonik duke mos qenë në harmoni me vetëveten dhe aq më pak me karakterin e objekteve të zonës së mbrojtur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN
E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Në 4 prej rasteve të miratimit të legalizimeve të audituara, konkretisht “shtesë kati mbi objektin ekzistues 3 kate me pronar T L I Z”, “objekti i kombinuar 4 kate + podrum në pronësi të Dh M Sh” miratuar me vendim të KKR nr. 116, datë 20.02.2018 , “objekt 4 kate me pronar S B” miratuar me vendim të KKR nr. 160, datë 21.03.2018 dhe objekti “L G H” **rezulton se janë bërë miratime për objekte 4 kate** brenda zonës së mbrojtur së qytetit të Korçës, në kundërshtim me përcaktimet e Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë e Rregullores së tij ku përcaktohet qartë se: *Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve në zonën e mbrojtur, përveç rasteve kur për to ka studime të vecanta, **nuk duhet t’i kalojë 3 katet.***

Në tre raste përkatësisht Vendim i KKR-së nr. 114, datë 20.02.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. K D; Vendim i KKR-së nr. 49, datë 10.01.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. V Dh S dhe Vendim i KKR-së nr. 215, datë 18.04.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues znj. A Ç, rezulton se lartësia maksimale e ndërtimit i kalon 3 katet pasi kati podrum është më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemit dhe lartësia e çatisë e lejon shfrytëzimin e hapsirës nën të duke bërë që ajo të vlerësohet si një kat.

Ne një rast, përkatësisht Vendim i KKR-së nr. 114, datë 20.02.2018 për miratimin e kërkesës për objektin e legalizimit në Korçë me subjekt aplikues z. K D, rezulton se në kundërshtim me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 7, datë 08.02.2017, neni 75, pika 3 dhe 4, gjurma e ndërtimit është më e madhe se 150 m² dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit e intensiteti i ndërtimit i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar prej 75% dhe intensitetet 2.8.

Kriteri: Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”; VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë e Rregullores së tij, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 7, datë 08.02.2017.

Ndikimi/Efekti: Miratimet e legalizimeve të objekteve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretaria Teknike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, marrë mbi bazën e diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, si dhe mendimet institucionale të dhëna për këto objekte nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë **kanë cënuar integritetin e objekteve në grup të trashëgimisë kulturore, të shpallura sipas kategorisë zonë e mbrojtur.**

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore të shprehura në Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, Vendimin nr. 207, datë 15.3.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”; VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë e Rregullores së tij, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 7, datë 08.02.2017.

Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara që bien në kundërshtim me përcaktimet e mësipërme ligjore ngarkohet me përgjegjësi, Kryetare e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

dhe anëtarët e këtij këshilli, në cilësinë e organit miratues të legalizimeve të jashtëligjshme në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës; Anëtarët e Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e shqyrtuesve të projekteve për legalizim; Znj. A D, drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së; Z. E K, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, në cilësinë e drejtuesit të institucionit që ka shqyrtuar rastet në terren dhe dhënies së mendimit institucional lidhur me to në kundërshtim me përcaktimet ligjore; Ing. Xh A dhe Ark. M Gj, në cilësinë e specialisteve në DRKK Korçë, për dhënien e mendimit institucional në kundërshtim me përcaktimet ligjore. A P me liçencë nr. RP 20, KNM Studio, ing. K M dhe K K me liçencë nr. A0950, në cilësinë e projektuesve të objekteve në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

C.Në kuadër të auditimit mbi zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rijetëzimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit mbi auditimin e veprimtarisë funksionale ligjore të IMK-së, u shqyrtua dokumentacioni i kërkesave të miratimit të projekteve zhvillimore për ndërtime hidrocentralesh në bazë të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore” i ndryshuar dhe Ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, projektet e tyre si dhe vendimet e miratimit të projekteve zhvillimore nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve pas diskutimit paraprak në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2017 nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve janë miratuar 24 kërkesa për ndërtime hidrocentralesh, për vitin 2018 janë miratuar 86 kërkesa dhe për vitin 2019, 38 kërkesa.

Nga këto u audituan me zgjedhje përkatësisht 6 procedura për vitin 2017, 10 procedura për vitin 2018 dhe 4 procedura për vitin 2019 nga ku rezultoi se:

Asnjë nga aplikimet për leje zhvillimi për hidrocentrale nuk bazohet në një instrument planifikimi në fuqi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve si dhe vendimet miratuese të marra nga ky i fundit, nuk janë bazuar në detyrimin e përputhshmërisë së projekteve të hidrocentraleve me dokumentat e planifikimit në fuqi.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore pasi në këtë rast aplikimet për leje zhvillimi duhet të bëheshin vetëm bazuar në një Plan Kombëtar Sektorial i cili referuar VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” seksioni 4, neni 22 hartohen nga ministritë me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve sipas fushave të kompetencës, si: siguria kombëtare, energjia, industria, transporti, infrastruktura, turizmi, zonat ekonomike, arsimit, sporti, trashëgimia kulturore dhe natyrore, burimet natyrore, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura e ujit etj.

Gjithëashtu referuar Ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar neni 38, pika 2. **Leja e zhvillimit është e nevojshme për çdo parcelë dhe jepet me miratimin e planit të detajuar vendor.** Në rastin e parcelave, për të cilat nuk parashikohet hartimi i një plani të detajuar vendor, leja e zhvillimit jepet me miratimin e **planit të përgjithshëm vendor.**

Pra në ç’do rast autoriteti që shqyrton kërkesat për leje zhvillimi Bazuar në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, neni 10/1 ka detyrimin që të shprehet, nëse projektideja është hartuar në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe rregullat e projektimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Në të gjitha vendimet e audituara të miratimit të projekteve zhvillimore të HEC-eve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në pikën 1 është lënë detyrimi që subjektet aplikuese të kontribuojnë për restaurimin e objekteve monument kulture që ndodhen në afërsi HEC-eve.

Për shkak të shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme në Republikën e Shqipërisë gjatë kohës së zhvillimit të auditimit, nuk u bë i mundur auditimi i dokumentacionit lidhur me zbatimet e detyrimeve të përcaktuara në këto vendime lidhur me kontributet për restaurimin e objekteve monument kulture, mënyrës së kontribuimit si dhe pagesat.

Nga auditimi rezultoi se vetëm në 2 raste ka Monumente Kulture në afërsi të tillë që monumentet apo zonat e mbrojtura rreth tyre mund të çënohen nga ndërtimi i HEC-eve, konkretisht:

Projekti i ndërtimit të hidrocentralit Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3 në Qarkun Berat, me subjekt zhvillues V E shpk, ku janë evidentuar dy monumente kulture të kategorisë së parë në afërsi të projektit. Ura e Vokopolës në një distancë prej 172m nga vendi ku është parashikuar të ndërtohet HEC-i dhe Ura e Plasecit në një distancë prej 2.54 km. Për të dy këto monumente u verifikuan kartelat përkatëse nga ku rezulton se për asnjërin prej tyre nuk ka zonë mbrojtëse të miratuar përreth monumentit ku të ndalohen ndërhyrjet me karakter ndërtimor.

Shoqëria “Sh H shpk” me shkresë nr. 966 prot., datë 09.05.2019 ka aplikuar për miratimin e projektit zhvillimor “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës” pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Me email-in e datës 22.05.2019 Sekretaria e Teknikës e KKR-së ka njoftuar aplikuesin se HEC-et që do të ndërtohen pranë fshatrave Drashovicë, Kotë dhe Gjorm nuk çënojnë asnjë monument të kulturës apo zonat e mbrojtura të tyre, ndërsa HEC-i që do të ndërtohet pranë fshatit Brataj paraqet problem pasi kanali apo tubi i derivacionit të Vepërmarrjes kalon brenda zonës së mbrojtur të Urës së Bratit duke e çënuar atë.

Në dosjen e aplikimit të projektit nuk ka një shkresë nga ana e shoqërisë lidhur me rishikimin e këtij projekti, por vetëm një fletë ku paraqitet devijimi i tubacionit jashtë zonës së mbrojtur. Me vendim nr. 195, datë 06.06.2019 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretariati Teknik, Instituti i Monumenteve të Kulturës pas diskutimit paraprak në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, ka miratuar projektin “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Shushica hydropoëer shpk”.

Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se ky zhvillim, “Ndërtimi i Kaskadës së Hidrocentraleve mbi lumin Shushicë” **nuk është e bazuar në një instrument planifikimi në fuqi**, Plan Kombëtar Sektorial, Plan të Përgjithshëm Vendor apo Plan të Detajuar Vendor.

Nga verifikimi i përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, si instrumenti më i lartë i planifikimit të territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë, rezulton se në lumin Shushicë nuk është parashikuar ndërtim hidrocentralesh.

Sa më sipër miratimi i këtij projekti nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve është në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar.

Në miratimin e këtij projekti Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe Këshilli Shkencor i Institutit të Monumenteve të Kulturës kanë vepruar në kundërshtim dhe me Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” pika 67 si dhe masave të mbrojtjes indirekte, të përcaktuara në nenin 96, pasi projekti i ndërtimit të këtij HEC-i **çënon perspektivën**,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit.

67. “Zonë mbrojtëse” është një territor i përcaktuar me kufij të qartë, jashtë qendrës historike, ansamblit arkitektonik/urban, kompleksit arkitektonik dhe monumentit të kulturës, roli i së cilës është mbrojtja e vlerave të këtyre pasurive kulturore dhe **sigurimi i dritës, perspektivës, peizazhit kulturor, shikimit, shijimit dhe përdorimit nga publiku.**

Neni 96

5. Masat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, të miratuara dhe njoftuara sipas parashikimeve të neneve 61, 97 e 98, të këtij ligji, janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga organet kompetente qendrore e vendore në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit dhe pronarët e poseduesit e këtyre pasurive.

6. Moszbatimi i masave të mbrojtjes indirekte përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas këtij ligji.

Për veprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

5) Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

6) Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;

7) VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”;

8) VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar.

Për sa më sipër është mbajtur akti I konstatimit me:

7) Kryetare e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, dhe anëtarët e këtij këshilli, në cilësinë e organit miratues të lejeve zhvillimore të HEC-eve në kundërshtim me përcaktimet ligjore;

8) Anëtarët e Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e shqyrtuesve të këtyre projekteve;

9) Znj. A Ddrejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknikë të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së;

Nga Instituti i Monumenteve të Kulturës është dërguar observacioni me nr. 1441/14 prot., datë 30.04.2020 nga ana znj. Arta Dollani pretendohet se:

V.K.M. Nr. 207, datë 15.3.2017, ky legjislacion i posaçëm nuk ka të specifikuar lartësinë e kateve, lartësinë e xokolaturës apo të podrumit mbi nivelin e tokës si dhe lartësinë e çatisëe. Pra nuk është i specifikuar lartësia maksimale e një objekti (lartësi e shprehur në njësi matëse).

Në gjykimin për procedurat e legalizimit është marrë në konsideratë numri i kateve, pra 3 kate (pa njësi matëse) sipas legjislacionit të posaçëm.

Në rastet e objekteve me leje në të dy kufijtë zonifikues, janë marrë në konsideratë kondicionet urbane të miratuara në lejen e ndërtimit. Në rastin kur nën çatinë e një objekti 3 katësh është zhvilluar një sipërfaqe ndërtimi pa cënuar lartësinë maksimale në njësi të miratuar në lejen e ndërtimit dhe numrin e kateve 3, pra zhvillimi i sipërfaqes së ndërtimit është realizuar brenda



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

hapësirës së dritës të zvillimit të çatisë, mendimi është dhënë mbi lejen e ndërtimit (lartësisë dhe numrit të kateve të miratuar në të).

Gjithashtu, në aktin e konstatimit gjykimi mbi objektet informale është bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendim Nr. 7, datë 08.02.2017, neni 75, pika 3 dhe 4:

Sipas pikës 5 të Nenit 75 të këtij akti normativ, kondicionet urbane për objektet e reja në zonën e mbrojtur përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm i trashëgimisë kulturore. Bazuar në këtë legjislacion, nuk ka të dhëna lidhur me kondicione urbane (siç e përmendëm edhe më lart), pra koeficient shfrytëzimi, intensitet, etj. Kjo për faktin që objektet e ndërtuara në fashën e të dy kufijve, nuk kanë një uniformitet kondicionesh, pra ka shume tipologji objektesh duke filluar nga objekte 1 kat + podrum, 2 kate + podrum, 3 kate + podrum dhe 3 kate + podrum + çati e shfrytëzuar si dhe objekte që kanë shfrytëzuar truallin në raport 50 – 100 %. Për këtë arsye nuk është specifikuar në legjislacionin e posaçëm kriteret e kondicioneve urbane.

Nga sa më lart gjykimi për objektet e ndërtuara pa leje është kryer vetëm në raport me numrin e kateve sipas akteve normative në fuqi dhe për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi sipas kondicioneve urbane të miratuar në të.

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH^{-së}:

Instituti i Monumenteve të Kulturës si edhe Drejtoritë Rajonale janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fuqi duke përfshirë këtu VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar si edhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë korçë ku janë të përcaktuara qartë kriteret për ndërtimet dhe zhvillimet e reja në zonën e mbrojtur të qytetit. Sa më sipër pretendimi se IMK dhe Drejtoria Rajonale kanë zbatuar detyrimin e lartësisë deri në 3 kate nuk qëndron pasi të paktën në 4 raste të evidentuara lartësia e objekteve për të cialt është miratuar legalizimi nga ana juaj ka qenë 4 kate, pra mbi 3. Për rastet e tjera të evidentuara theksojmë se legjislacioni shqiptar ka përcaktime të qarta mbi atë se çfarë konsiderohet kat. Nuk përbën arsyetim dhe as justifikim fakti se sipas jush numri i kateve nuk ka njësi matëse, pasi me këtë llogjikë mund të konsiderohej si 3 kate edhe një objekt i cili për nga lartësia mund të klasifikohet si 6 apo më shumë kate. Qëllimi i V.K.M. Nr. 207, datë 15.3.2017 në përcaktimin e kufizimit të numrit të kateve në 3 është bërë pikërisht për të ruajtur harmoninë arkitetkonike e urbanistike të ansambllit, e cila në këtë rast është cënuar nga miratimet tuaja për objekte të cialt e kalojnë këtë lartësi .

Për sa më sipër argumentet e dhëna nga ana Juaj nuk merren në konsideratë.

Zona e mbrojtur e qytetit të Korçës nuk ka një karakter arkitektonik e urbanistik si ansambël, sikundër është zona e Pazarit të vjetër të Korçës.

Ndërtimet në këtë zonë nuk kanë një karakter të përcaktuar në trajtimin e rifiniturave, siç mund të jenë dritaret, dyert, komponentet dekorativë në fasadë, etj. Kjo për vetë faktin që objektet e ndërtuara në këtë zonë i përkasin jo të njëjtës periudhë kohore të ndërtimit, stileve të ndryshme dhe janë ndërtuar jo nga të njëjtët zanatçinjtë (për këtë të fundit janë kryer edhe studime lidhur me grupe individësh që kanë kontribuar me eksperiencën e tyre në stilimin e objekteve). Në studimet e kryera nga ana e profesionistëve të fushës së monumenteve të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

kulturës, është vërejtur që dy objekte fqinje kanë tipologji të ndryshme, madje edhe në një kuartall rrugor ka konfiguracione të ndryshme trajtimore.

Ky problem është një çështje e rëndësishme studimore e cila akoma dhe sot pengon përcaktimin e një manuali kompozicional për ndërhyrjet në këto zona.

Nisur nga kjo, nuk mund të përcaktohet harmonizimi i objekteve të reja me ato ekzistuese në një larmi karakteresh arkitektonike.

Gjatë procesit të legalizimit, është marrë në konsideratë trajtimi i fasadës sipas gjendjes aktuale, dhe në rastet kur ka qenë e nevojshme, për objekte të cilat kanë qenë të varfëra në këtë aspekt, është lënë rekomandim që të realizohet ndërhyrje integruese për përshtatje me ndonjë objekt tipik me vlerë historike – kulturore në afërsi të tij.

Pra në mungesë të një manuali kompozicional referues ku të paraqitet tipologjia e ndërtimeve sipas zonave, nuk mund të gjykojmë lidhur me integritetin e ndërtimeve pa leje në zonat ku ato bëjnë pjesë.

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH^{-së}:

Pretendimi i subjektit të audituar se zona e mbrojtur e qytetit të Korçës nuk ka një karakter arkitektonik e urbanistik si ansambël bie në kundërshtim të hapur me përcaktimet ligjore të zonës së mbrojtur. Neni 10 i Vendimit nr. 207, datë 15.3.2017 përcakton **detyrimin që ndërhyrjet në zonën e mbrojtur të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit**. Pra ligji këtë zonë e konsideron si zonë me kartakter të përcaktuar arkitektonik e urbanistik si ansambël. Për sa më sipër institucioni juaj ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore duke miratuar legalisime të cilat kanë cënuar në mënyrë flagrante harmoninë dhe karakterin e ansamblit. Jeni përsëri ju si institucion që në bashkëpunim me Ministrinë e linjës keni detyrimin të studioni e përcaktoni kriteret të qarta që duhet të plotësojnë objektet lidhur me harmoninë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, ruajtjen e kompozimit volumor në përputhje me objektet përreth, si dhe përshtatjen e karakterit arkitektonik e dekorativ me arkitekturën tradicionale, në mënyrë që të eliminohen praktikatat e deritanishme joligjore, abusive dhe subjektive të legalizimeve të objekteve në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës.

Për sa më sipër argumentet e dhëna nga ana juaj nuk merren në konsideratë.

Zona e mbrojtur e qytetit të Korçës nuk ka një karakter arkitektonik e urbanistik si ansambël, sikundër është zona e Pazarit të vjetër të Korçës.

Ndërtimet në këtë zonë nuk kanë një karakter të përcaktuar në trajtimin e rifiniturave, siç mund të jenë dritaret, dyert, komponentet dekorative në fasadë, etj. Kjo për vetë faktin që objektet e ndërtuara në këtë zonë i përkasin jo të njëjtës periudhë kohore të ndërtimit, stileve të ndryshme dhe janë ndërtuar jo nga të njëjtët zanatçinj (për këtë të fundit janë kryer edhe studime lidhur me grupe individësh që kanë kontribuar me eksperiencën e tyre në stilimin e objekteve). Në studimet e kryera nga ana e profesionistëve të fushës së monumenteve të kulturës, është vërejtur që dy objekte fqinje kanë tipologji të ndryshme, madje edhe në një kuartall rrugor ka konfiguracione të ndryshme trajtimore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Ky problem është një çështje e rëndësishme studimore e cila akoma dhe sot pengon përcaktimin e një manuali kompozicional për ndërhyrjet në këto zona.

Nisur nga kjo, nuk mund të përcaktohet harmonizimi i objekteve të reja me ato ekzistuese në një larmi karakteresh arkitektonike.

Gjatë procesit të legalizimit, është marrë në konsideratë trajtimi i fasadës sipas gjendjes aktuale, dhe në rastet kur ka qenë e nevojshme, për objekte të cilat kanë qenë të varfëra në këtë aspekt, është lënë rekomandim që të realizohet ndërhyrje integrale për përshtatje me ndonjë objekt tipik me vlerë historike – kulturore në afërsi të tij.

Pra në mungesë të një manuali kompozicional referues ku të paraqitet tipologjia e ndërtimeve sipas zonave, nuk mund të gjykojmë lidhur me integritetin e ndërtimeve pa leje në zonat ku ato bëjnë pjesë.

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH^{-së}:

Pretendimi i subjektit të audituar se zona e mbrojtur e qytetit të Korçës nuk ka një karakter arkitektonik e urbanistik si ansambël bie në kundërshtim të hapur me përcaktimet ligjore të zonës së mbrojtur. Neni 10 i Vendimit nr. 207, datë 15.3.2017 përcakton **detyrimin që ndërhyrjet në zonën e mbrojtur të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit**. Pra ligji këtë zonë e konsideron si zonë me kartakter të përcaktuar arkitektonik e urbanistik si ansambël. Për sa më sipër institucioni juaj ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore duke miratuar legalisime të cilat kanë cënuar në mënyrë flagrante harmoninë dhe karakterin e ansamblit. Jeni përsëri ju si institucion që në bashkëpunim me Ministrinë e linjës keni detyrimin të studioni e përcaktoni kriteret të qarta që duhet të plotësojnë objektet lidhur me harmoninë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, ruajtjen e kompozimit volumor në përputhje me objektet përreth, si dhe përshtatjen e karakterit arkitektonik e dekorativ me arkitekturën tradicionale, në mënyrë që të eliminohen praktikatat e deritanishme joligjore, abusive dhe subjektive të legalizimeve të objekteve në zonën e mbrojtur të qytetit të Korçës.

Për sa më sipër argumentet e dhëna nga ana Juaj nuk merren në konsideratë.

Nga Instituti i Monumenteve të Kulturës është dërguar observacioni me nr. 1441/14 prot., datë 30.04.2020 nga ana znj. A Di pretendohet se:

IMK (sot IKTK) ka si mision gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale. Pra, shqyrtimi në KKR është vetëm brenda fushës së trashëgimisë kulturore dhe jep miratimin vetëm në lidhje me misionin dhe përgjegjësitë e saj funksionale.

Për më tej objekti kalon në disa institucione të tjera sipas fushave që mbulojnë derisa finalizohet me shqyrtimin në KKT.

Projekti i miratuar në KKR, parashikon kalimin e tubacionit jashtë zonës së mbrojtur të urës së Bratit. Diga e Hecit ndodhet rreth 300m larg zonës së mbrojtur të urës së Bratit, ndërkohë që reja e vete zonës së mbrojtur është 200m. Pra, distance e kaskades nga vete ura e Bratajt është 500m, distance që duke pasur parasysh relieving dhe terrenin, nuk cënon perspektivën,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

peisazhin, shikimin dhe shijimin e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit. Mbi këto kushte kanë gjykuar anëtarët e KKR.

Për këtë, gjykojmë se nuk ka asnje baze ligjore për anulimin e vendimit.

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH-së:

Fakti se shqyrtimi në KKR për miratimin e projekteve të HEC-eve është vetëm brenda fushës së trashëgimisë kulturore nuk justifikon apo argumenton dhënien e lejeve në kundërshtim me instrumentat e planifikimit në fuqi apo me Planin e Përgjithshëm Kombëtar.

Vizualisht i gjithë peisazhi i mbrojtur i monumentit Ura e Bratit çenohet nga zhvillimi i HEC-it Brataj, pasi cilido visitor që do të shohë këtë monument do të përballet me kaskadën e hidrocentralit dhe tubat e hidrocentralit të cilat janë plotësisht të dukshme për distancën dhe pozicionin ku janë parashikuar të ndërtohen. Për nga vetë mënyra se si parashikohet të funksionojë HEC-i Brataj, do të ketë impakt negativ në zonën e mbrojtur të monumentit dhe vetë monumnetin pasi do të minimizojë rrjedhën e lumit që kalon nën urë dhe që përbën elementin thelbësor të peisazhit dhe atraksionit të zonës, pjesë e vlerave që mbrohen me ligj. Nga ana tjetër pozicionimi i veprës së marrjes së HEC-it përveç impaktit visual mbart riskun që në çdo rast avarie të mundshme uji i akumuluar nga HEC-i, të vërshojë drejt monumentit duke shkaktuar dëme të pariparueshme në këtë të fundit.

Sa më sipër gjykimi i anëtarëve të KKR-së për miratimin e këtij HEC-i është dhënë në kundërshtim me parimet ligjore të mbrojtjes së vlerave të pasurisë kulturore, pasi perspektiva, peisazhi, shikimi dhe shijimi i publikut janë të gjithë element të zonës së mbrojtur të monumentit që çenohen nga ndërtimi i HEC-it. Për këtë argumentet e dhëna nga ana Juaj nuk merren në konsideratë.

Titulli i Gjetjes: Aplikimet për leje zhvillimi për hidrocentrale nuk bazohen në një instrument planifikimi në fuqi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve si dhe vendimet miratuese të marra nga ky i fundit, nuk janë bazuar në detyrimin përputhshmërisë së projekteve të hidrocentraleve me dokumentat e planifikimit.

Situata: Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve për leje zhvillimi për hidrocentrale si dhe vendimet miratuese të marra nga ky i fundit, nuk janë bazuar në detyrimin përputhshmërisë së projekteve të hidrocentraleve me dokumentat e planifikimit në fuqi ku në këtë rast aplikimet për leje zhvillimi duhet të bëheshin vetëm bazuar në një Plan Kombëtar Sektorial i cili referuar VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” seksioni 4, neni 22 hartohen nga ministrinë me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve sipas fushave të kompetencës, si: siguria kombëtare, energjia, industria, transporti, infrastruktura, turizmi, zonat ekonomike, arsimit, sporti, trashëgimia kulturore dhe natyrore, burimet natyrore, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura e ujit etj.

Gjithëashtu referuar Ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar neni 38, pika 2. **Leja e zhvillimit është e nevojshme për çdo parcelë dhe jepet me miratimin e planit të detajuar vendor.** Në rastin e parcelave, për të cilat nuk parashikohet hartimi i një plani të detajuar vendor, leja e zhvillimit jepet me miratimin e **planit të përgjithshëm vendor.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Pra në ç’do rast autoriteti që **shqyrton kërkesat për leje zhvillimi** Bazuar në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, neni 10/1 ka detyrimin që të shprehet, **nëse projektideja është hartuar në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe rregullat e projektimit.**

Në të gjitha vendimet e audituara të miratimit të projekteve zhvillimore të HEC-eve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në pikën 1 është lënë detyrimi që subjektet aplikuese të kontribuojnë për restaurimin e objekteve monument kulture që ndodhen në afërsi HEC-eve.

Për shkak të shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme në Republikën e Shqipërisë gjatë kohës së zhvillimit të auditimit, nuk u bë i mundur auditimi i dokumentacionit lidhur me zbatimet e detyrimeve të përcaktuara në këto vendime lidhur me kontributet për restaurimin e objekteve monument kulture, mënyrës së kontribuimit si dhe pagesat.

Kriteri: Sa më sipër miratimi i këtyre projekteve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve është në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Miratimet e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve për leje zhvillimi për hidrocentrale, nuk janë bazuar në detyrimin e përputhshmërisë së projekteve të hidrocentraleve me dokumentat e planifikimit në fuqi, duke bërë që këto leje të jenë dhënë në kushtet e mungesës së zonave të përcaktuara të zhvillimit të sektorit.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore të shprehura në Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar.

Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara që bien në kundërshtim me përcaktimet e mësipërme ligjore ngarkohet me përgjegjësi Kryetare e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, dhe anëtarët e këtij këshilli, në cilësinë e organit miratues të lejeve zhvillimore të HEC-eve në kundërshtim me përcaktimet ligjore; Anëtarët e Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e shqyrtuesve të këtyre projekteve; Znj. A Ddrejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së;

Titulli i Gjetjes: Vendimi nr. 195, datë 06.06.2019 i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve i asistuar nga Sekretariati Teknik, Instituti i Monumenteve të Kulturës pas diskutimit paraprak në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, për miratimin e projektit “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Sh h shpk” nuk është e bazuar në një instrument planifikimi në fuqi, është në kundërshtim me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe cënon perspektivën, peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit.

Situata: Nga auditimi rezultoi se vetëm në 2 raste ka Monumente Kulture në afërsi të tillë që monumentet apo zonat e mbrojtura rreth tyre mund të çënohen nga ndërtimi i HEC-eve, konkretisht:

Projekti i ndërtimit të hidrocentralit V1, V 2 dhe V 3 në Qarkun Berat, me subjekt zhvillues V E shpk, ku janë evidentuar dy monumente kulture të kategorisë së parë në afërsi të projektit. Ura e Vokopolës në një distancë prej 172m nga vendi ku është parashikuar të ndërtohet HEC-i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

dhe Ura e Plasecit në një distancë prej 2.54 km. Për të dy këto monumente u verifikuan kartelat përkatëse nga ku rezulton se për asnjërin prej tyre nuk ka zonë mbrojtëse të miratuar përreth monumentit ku të ndalohen ndërhyrjet me karakter ndërtimor.

Shoqëria “Sh H shpk” me shkresë nr. 966 prot., datë 09.05.2019 ka aplikuar për miratimin e projektit zhvillimor “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës” pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Me email-in e datës 22.05.2019 Sekretaria e Teknikës e KKR-së ka njoftuar aplikuesin se HEC-et që do të ndërtohen pranë fshatrave Drashovicë, Kotë dhe Gjorm nuk çenojnë asnjë monument të kulturës apo zonat e mbrojtura të tyre, ndërsa HEC-i që do të ndërtohet pranë fshatit Brataj paraqet problem pasi kanali apo tubi i derivacionit të Vepërmarrjes kalon brenda zonës së mbrojtur të Urës së Bratit duke e cënuar atë.

Në dosjen e aplikimit të projektit nuk ka një shkresë nga ana e shoqërisë lidhur me rishikimin e këtij projekti, por vetëm një fletë ku paraqitet devijimi i tubacionit jashtë zonës së mbrojtur.

Me vendim nr. 195, datë 06.06.2019 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretariati Teknik, Instituti i Monumenteve të Kulturës pas diskutimit paraprak në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, ka miratuar projektin “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Shushica hydropoëer shpk”.

Rezulton se ky zhvillim, “Ndërtimi i Kaskadës së Hidrocentraleve mbi lumin Shushicë” **nuk është e bazuar në një instrument planifikimi në fuqi**, Plan Kombëtar Sektorial, Plan të Përgjithshëm Vendor apo Plan të Detajuar Vendor.

Nga verifikimi i përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, si instrumenti më i lartë i planifikimit të territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë, rezulton se në lumin Shushicë nuk është parashikuar ndërtim hidrocentralesh.

Në miratimin e këtij projekti Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe Këshilli Shkencor i Institutit të Monumenteve të Kulturës kanë vepruar në kundërshtim dhe me Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” pika 67 si dhe masave të mbrojtjes indirekte, të përcaktuara në nenin 96, pasi projekti i ndërtimit të këtij HEC-i **cënon perspektivën, peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit.**

Kriteri: Sa më sipër miratimi i këtij projekti nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve është në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar si dhe Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

67. “Zonë mbrojtëse” është një territor i përcaktuar me kufij të qartë, jashtë qendrës historike, ansamblit arkitektonik/urban, kompleksit arkitektonik dhe monumentit të kulturës, roli i së cilës është mbrojtja e vlerave të këtyre pasurive kulturore dhe **sigurimi i dritës, perspektivës, peisazhit kulturor, shikimit, shijimit dhe përdorimit nga publiku.**

Neni 96

5. Masat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, të miratuara dhe njoftuara sipas parashikimeve të neneve 61, 97 e 98, të këtij ligji, janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga organet kompetente qendrore e vendore në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit dhe pronarët e poseduesit e këtyre pasurive.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

6. *Moszbatimi i masave të mbrojtjes indirekte përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi, sipas*

këtij ligji.

Ndikimi/Efekt: Vendimi nr. 195, datë 06.06.2019 i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve i asistuar nga Sekretariati Teknik, Instituti i Monumenteve të Kulturës pas diskutimit paraprak në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, për miratimin e projektit “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Sh h shpk” cënon perspektivën, peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore të shprehura në Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshua dhe Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara që bien në kundërshtim me përcaktimet e mësipërme ligjore ngarkohet me përgjegjësi Kryetare e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, dhe anëtarët e këtij këshilli, në cilësinë e organit miratues të lejes zhvillimore të projektit “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Sh h shpk” në kundërshtim me përcaktimet ligjore; Anëtarët e Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e shqyrtuesit të këtij projekti; Znj. A D, drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së;

6. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME.

Me shkresën Nr. 870/7 Prot datë 31.12.2016 është përcjellë në IMK vendimi I Kryetarit Nr. 189 , datë 31/12/2016 lidhur me Raportin Përfundimtar të Auditimit: “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” të ushtruar në Institutin e Monumenteve të Kulturës “G S” Tiranë, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.08.2016 të veprimtarisë së këtij institucioni. ku janë rekomanduar masa për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe organizativ të veprimtarisë së institucionit ku nga auditimi i zbatimit të tyre trajtohet hollësisht në Aneksin II bashkangjitur këtij Projektraport auditimi.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si **më poshtë:**

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Gjetje nga auditimi:Për të vlerësuar rregullshmërinë e aktivitetit dhe përmbushjes së detyrave funksionale të IKTK(ish-IMK), në rolin e Sekretariat Teknik të KKR në funksion të misionit për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, u auditua procesi i vendimarrjes për miratimin dhe shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth nga ku rezultoi se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth, përgjatë viteve 2017 dhe 2018 janë miratuar dy VKM të cilat vijnë në kohë pothuaj mbas 18 vitesh sipas VKM –s nr.180,e cila daton, dt.13.04.2000, kjo VKM ka bërë shpalljen Ansambël Monument kulture i aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës, duke specifikuar qartësisht konturet e zonës historike për Qytetin e Tiranës, sipas planimetrisë dhe emërtesave të rrugëve dhe shesheve të indentifikuara në VKM .

Për miratimin e VKM Nr. 325, datë 12.4.2017 rezulton se nuk ka asnjë mbledhje të KKR apo diskutim lidhur me projekt-vendimin për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga IKKT, grupi i auditimit konstatoi se kjo VKM është miratuar bazuar :

- nisur nga kërkesa e Bashkisë së Tiranës sipas shkresës nr. Prot 1028 datë 27.02.2017 për rishikimin e Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Tiranës e cila thekson nevojat për ndryshimin e kufirit të ansamblit muzeal ;
- për saktësimin e koordinatave dhe mospërputhjeve të gjurmes se kufirit;
- edhe si nevojë e pershtatjes së terminologjisë bazuar në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar) dhe në VKM Nr. 426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”, ku dhe është rishikuar VKM me nr.180, dt.13.04.2000 “Shpallja Ansambël Monument kulture i aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës”.

Kështu IMK nisur nga kërkesa e Bashkisë së Tiranës sipas shkresës nr. Prot 1028 datë 27.02.2017 për rishikimin e Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Tiranës;

si dhe me argumentimin për saktësimin e koordinatave dhe mospërputhjeve të gjurmes se kufirit, si dhe nevojën e pershtatjes së terminologjisë bazuar në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar) dhe në VKM Nr. 426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”, është rishikuar VKM me nr.180, dt.13.04.2000 “Shpallja Ansambël Monument kulture i aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës” ka përgatitur relacionin përkatës dhe me shkresë nr.503 prot datë 20.03.2017 i është drejtuar Ministres së Kulturës ku ka përcjellë dokumentacionin për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe zonës së mbrojtur të saj si dhe rregulloren e administrimit shoqëruar me hartën e zonifikimit.

Ku sipas relacionit kufiri i saj është saktësuar dhe zhvilluar duke rikonceptuar dhe racionalizuar përdorimet e truallit të lirë, hapesira te cilat nuk përfaqësojnë vlera të veçanta dhe nuk janë pjesë përbërëse e qendrës historike në vetvete, por nëpërmjet rizhvillimit të tyre kompletojnë dhe pasurojnë atë.

Projekt-rregullorja është hartuar mbështetur në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar) dhe në VKM Nr. 426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit” dhe ka përcaktuar detyrimet dhe mënyrat për administrimin e vlerave historiko - kulturore të Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Tiranës. Ansamblet e Qendrës Historike rrethohen nga një zonë e mbrojtur, e cila krijon një hapësirë ndërmjet Qendrës Historike dhe pjesës tjetër të qytetit, të nevojshme për vlerësimin e Qendrës Historike.

Propozimi i ri respekton dhe thekson hapësirat me vlerë në fushën e trashëgimisë kulturore, zonën arkeologjike “A” të Kalasë së Tiranës, e cila qëndron brenda kufijve të propozuar të zonës së mbrojtur të qytetit.

Projekt-rregullorja përcakton dhe mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të specializuara të MK me Bashkinë e qytetit, si dhe me institucionet, organizatat dhe subjektet e ndryshme për një mbrojtje më efektive të vlerave kulturore të qytetit.

Pra procesi i miratimit dhe propozimit të ardhur nga Bashkia Tiranë nuk ka kaluar për mendim në KKR, nuk rezulton se mbi çfarë dokumentacioni të cilësuar është kryer një vendimarrje e tillë, duke krijuar një proces artificial i cili heq ose përfshin ose zgjeron kufijtë e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

një zone e cila në fakt si proces dhe kompetencë i përket KKR përbërja e të cilit lejon mendimin profesional për ndryshime të tilla.

Në vitin vitin 2018 është miratuar me VKM nr. Nr. 582, datë 03.10.2018 qendra historike e qytetit të Tiranës, përcaktimi i zonës mbrojtëse të saj dhe miratimi i planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e cila ka ndryshuar sërish, me Vendimin e KKR nr.423, datë 26.9.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve është miratuar propozimi për deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin ku në relacionin bashkëngjitur i cili mban emrin e ish Ministres së Kulturës, për projekt- vendimin për deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin, relatohet se Ligji Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” është miratuar në datën 17.5.2018 dhe solli një qasjë të re ndaj ruajtjes dhe mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore, terminologji të re në kategorizimin dhe tipologjitë e pasurive kulturore, klasifikimit i tyre, etj. Në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, miratuar në datën 17.5.2018, në funksion të përmbushjes së Misionit të tij, IKTK ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore.

Për sa më lart, VKM Nr. 325, datë 12.4.2017 “Për shpalljen e Qendrës Historike të Qytetit të Tiranës dhe miratimin e Rregullores për administrimin e saj e të Zonës së Mbrojtur përreth” duhej rishikuar në përshtatje me ligjin e ri.

Por realisht kjo VKM ka ndryshuar kufijtë e qendrës historike, në të cilën po ti referohemi hartës së zonimit, pra justifikimi i objektit të ndryshimit për shkak të terminologjisë me ndryshimet e propozuara kanë sjellë ndryshime thelbësore të këtyre kufijve ku vërtet janë përfshirë objekte të reja si Piramida, Presidenca, Parku Rinia Parku në Krah të Presidencës, Hotel Rogneri etj, Pallati i Kongreseve objekte të viteve 50-80 për të cilat nuk ka një relacion mbështetës se pse këto objekte konsiderohen me vlerë historike dhe duhen përfshirë, një relacion mungon një gjë e tillë.

Në relacion e miratuar nga KKR të datës 26.09.2018, konstatohet se nuk është shprehur qartësisht se cilat objekte hiqen nga qendra historike dhe arsyeja përkatës për to, ndërkohë që nuk rezulton të kemi shprehje të Këshillit Shkencor të IMK apo cilësim të opinionit të tyre lidhur me këto çështje. Nuk evidentohet pse ndryshojnë kordinatat e zonës së mbrojtur Z 82-Z-83-Z80 ne kufijtë e Universitetit të Tiranës dhe Liqenit artificial, nuk spjegohet pse në qendrën e Tiranës janë shtyrë kufijtë e qendrës historike në zonën T83-T81 apo T27-T28, etj. (qartësisht të dallueshme vetem duke krahasuar hartën e zonimit të miratuar në vitin 2017 krahasuar me hartën e zonimit të vitit 2018 dhe kordinatat e saj)

Në vendimin e KKR theksojmë se është bërë shqyrtimi në një mbledhje nga anëtarët e KSH të kësaj çështjeje por për që mendimi i KSH nuk pasqyrohet në relacion argumentimi dhe selektimi i ndryshimit të këtyre kufijëve.

Për sa më sipër konstatohet se procesi i miratimit apo dhe nevoja e ndryshimit apo përcaktimit të kufijëve sipas kordinatave nuk rezulton të jetë i plotë me argumenta të qarta nga institucionet e përfshira në proces, si Këshilli Shkencor, Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, Ministrin e Kulturës që është njëkohësisht dhe Kryetar i KKR vetë KKR duke mos përmbushur funksionet institucionale dhe specifikat profesionale të tyre, vendimarrjet e të cilëve në fakt janë përdorur si fasadë për të justifikuar veprimet e institucioneve (strukturave) që nuk kanë kapacitetet dhe njohuritë për vendimarrje që prekin trashëgiminë kulturore dhe memorjen historike të shqiptarëve në këtë rast Bashkia e Tiranës apo dhe KM. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 113-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

1.1.Rekomandimi:Nga ana e IKTK(ish- IMK) në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të merren masat për ndryshimin e ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeve”: gërmat “a” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 9; ku miratimi për miratimin e planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore të paluajtshme dhe deklarimi për pasuritë kulturore të paluajtshme, të grupuara sipas parashikimeve të këtij ligji të bëhet me propozim nga Këshilli i Ministrave dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë me Ligj të vecantë.

Për ndryshimin e pikës 1 të nenit 96 të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeve”, ku Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në lidhje me pasurinë kulturore të paluajtshme, si dhe Këshilli i Ministrave, për grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme, kanë kompetencë të përcaktojnë zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, veçmas ose të grupuara, perspektivën, dritën, kushtet mjedisore dhe peizazhin por miratimi i tyre të bëhet në Kuvendin e Shqipërisë me Ligj të veçant.

Menjëherë

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, IKTK aktualisht përfshin dy institucionet e ristrukturuara (IMK dhe ASHA) gjendet në ambientet e godinës së Ministrinë e Kulturës, në strukturën e saj ka të përfshirë në funksionet mbështetëse 11 nga 58 punonjës pra rreth 20% të personelit gjithsej. Përfshirja në strukturë e një numri të lartë pozicionesh si roje, punonjës pastrimi, punonjës mirëmbajtje, nëpunës informacioni më vete, veç atyre të Ministrisë së Kulturës e cila ndodhet po në të njëjtën godinë, nuk paraqet skenarin më të mirë për menaxhimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike. Me një qasje më të kujdesshme nga ana e instancave përkatëse gjatë procesit të ristrukturimit rreth ½ e këtyre pozicioneve pune mund të të konvertoheshin në funksionet bazë çka dhe është dhe objektivi kryesor i institucionit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: IKTK në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të rishikoj strukturën organizative, me qëllim shmangjen e mbivendosjeve për konvertimin e funksioneve mbështetëse të panevojshme në funksione bazë duke mundësuar përmbushjen sa më të plotë të objektivave institucional.

Brenda datës 30.06.2020

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën nën auditim Janar 2017 - Dhjetor 2019 janë kryer rreth 15 emërimet nga ana e institucionit. Në të gjitha rastet për procedurat e ndjekura në rekrutimin e punonjësve nuk është dërguar njoftim për shpalljen e vendeve vakantë dhe botimin e shpalljes në buletin dhe njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Njoftimet nuk rezultojnë të publikuara as në portalin e institucionit, çka evidenton një proces rekrutimi plotësisht të mbyllur dhe me mungesë të theksuar transparence. Rregullisht institucioni duhet të dërgonte pranë APP njoftimin përkatës dhe të zhvillonte procedurat e rregullta të konkurimit mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, gjë e cila nuk rezulton. Mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr. 176, datë 29.3.2006 “Për Botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike” pika 1 dhe 2 e tij. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

2.1 Rekomandimi: IKTK, të marrë nismat e nevojshme administrative duke përcaktuar dhe modalitetet e publikimit në aktet e brendshme rregullativë në mënyrë që kjo problematikë të mos jetë prezente në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në muajin Nëntor 2017, me urdhrin nr. 737 datë 15.11.2017 Ministri i Kulturës, ka emëruar Drejtorin e Përgjithshëm të IMK si dhe ka shfuqizuar urdhrin mbi delegimin e kompetencave nr. 413/1 datë 30.12.2016. Vendimmarrja për emërimin e drejtuesit të IMK është arsyetuar me domosdoshmërinë në vlerësim të eksperiencës dhe profesionalizmit. Rikthimi i drejtuesit sërish në rolin e drejtuesit të IMK, nga i cili ishte larguar për rreth 11 muaj më parë, dhe ri-emërimi në pozicionin e drejtuesit të IMK rezultoi të jetë kryer në mungesë të një procesi të hapur dhe publik ku të përcaktoheshin kriteret e vendit të punës dhe të mundësonin përfshirjen e kandidatëve të tjerë në garë. Procesi i përzgjedhjes përbën një hap mbrapa me mënyrën e përzgjedhjes me garë të ndjekur në muajin Nëntor 2013 në të cilin ishte përzgjedhur ky drejtues si dhe bie ndesh me përcaktimet e VKM nr.173, date 07.03.2003 “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Keshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit” pika 1, 2 dhe 4 e tij. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës, të vlerësojë situatën dhe të marrë masat e nevojshme administrative për riparimin e kësaj mangësie.

Brenda datës 30.06.2020

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Rregullja e Brendshme mbi të cilën është bazuar veprimtaria e IMK është hartuar nga vet institucioni ndërkohë që miratimi është bërë nga Drejtuesi i tij. Ky dokument është mbështetur në nenin 11 pika 3 të Statutit të IMK miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017.

Pavarësisht referimit në dispozitat e statutit, miratimi i rregullores nga vet institucioni bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. Nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” pika 2 e tij. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale nga vet institucioni përbën në parim një “konflikt interesi” i cili ka ndikuar ose mund të ketë ndikuar edhe në paanshmërinë ose objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës zyrtare referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9131, date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” por jo vetëm.

-Deri në hartimin e këtij materiali auditimi institucioni nuk disponon ende Statutin dhe Rregulloren e re referuar ndryshimeve të fundit ligjore, të cilët megjithëse janë hartuar prej IKTK dhe dërguar në Ministrinë e Kulturës me shkresën nr. 142 datë 17.01.2019, nuk janë miratuar ende prej saj, vonesë e cila veç aspekteve ligjore ngre pikëpyetje për vet projektin e ristrukturimit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr15 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës, të vlerësojë situatën dhe të marrë masat e nevojshme administrative për miratimin e akteve të reja rregullativ duke verifikuar me kujdes përputhshmërinë e tyre me aktet më të larta në hierarkinë ligjore, ndarjen e qartë dhe të drejtë të kompetencave për çdo funksion, për të garantuar ecurinë e veprimtarisë institucionale si dhe funksionimin efikas të sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesin e ristrukturimit të kryer gjatë vitit 2019 referuar VKM nr. 364 datë 29.05.2019, i cili ka ri-organizuar Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK) dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) nën një institucion të vetëm Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) rezultoi se,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

-Me urdhrin e Ministrit nr. 629 datë 29.10.2019 është ngritur komisioni për mbikëqyrjen e procesit të ristrukturimit në të cilin janë caktuar 5 anëtarë, i cili drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës.

-Me Urdhrin e Ministrit nr. 6673 prot, datë 11.11.2019 “Për lirim dhe emërim në detyrë” është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i IKTK, i cili më parë ushtronte funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të IMK.

-Në vijim, Drejtori i Përgjithshëm i IKTK, me shkresën nr. 2495 prot, datë 03.12.2019 ka përcjell për zbatim pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse strukturën organike për secilin pozicion pune por në këtë dokument të hartuar nuk përfshihet asnjë bazë administrative/ligjore ku mbështetet kjo vendimmarrje në kundërshtim me VKM nr. 364, në pjesën e IV “Dispozita Kalimtare” pika 2 e tij.

Sa më sipër evidentohet se, nuk është ngritur komisioni i parashikuar në VKM nr. 364, lidhur me pozicionimin e punonjësve të dy institucioneve, i cili obligon drejtuesit e institucioneve aktuale që ristrukturohen në funksion të Ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore”, me urdhër të përbashkët, krijojnë një komision për realizimin e procesit të ristrukturimit dhe të riorganizimit të punonjësve aktualë të IMK dhe ASHA, sipas strukturës dhe organikës së re. Ky proces duhet të udhëhiqej nga drejtues të lartë të Ministrisë së Kulturës, nën mbikëqyrjen e Ministrit të Kulturës. Ky proces është ndjekur i njëanshëm, vetëm nga Drejtori i ri i IKTK në kundërshtim me përcaktimet e mëspërme çka tregon për veprime të cunguara në përmbylljen e këtij procesi. Mangësitë nuk rezultojnë të jenë evidentuar e më pas korrigjuar as prej komisionit të posaçëm për mbikëqyrjen e procesit të ristrukturimit dhe riorganizimit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr15 -29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

5.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës, nëpërmjet një grupi pune të vlerësorë situatën dhe të marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për përmbushjen e plotë të përcaktimeve të VKM nr.364 duke përmbyllur plotësisht procesin me objektivitet dhe transparencë.

Brenda datës 30.12.2020

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar në PF për vitin ushtrimor 2018 rezultoi se, vlera në Aktiv e llog. 231 “Shpenzime proces per rritjen e AQT” dhe kundërpartia në pasiv llog. 14 “Të tjera” në po të njëjtën vlerë përfaqësojnë vlera riparimesh/restaurimesh të kryera në objektet monument kulture të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të IMK por për këto objekte institucioni ka zhvilluar procedurat prokuruese, mbikëqyrëse dhe marrjes në dorëzim të punimeve.

Vlera “*e mbetur*” në PF të institucionit prej rreth **199.1 milionë lekë** rregullisht duhet të ishte transferuar drejt institucionit përgjegjës, i cili zotëron gjithashtu administrimin e aktivitetit. Çdo riparim apo mirëmbajtje e aktivitetit i cili e përmirëson gjendjen e tij rregullisht duhet të regjistrohej në kartelën përkatëse të aktivitetit e cila nuk zotërohet prej IMK sot IKTK.

Aktualisht vlerat e riparimeve paraqiten nga IKTK, gjë e cila jo vetëm denatyrton treguesit e saj financiar por ndikon negativisht në pasqyrimin e ecurisë historike mbi secilin monument edhe shpenzimeve financiare të bëra për restaurimin e tyre përgjatë periudhave. Aktualisht institucioni gjendet në mungesë të akteve rregullativë mbi këtë problematikë çka kërkon një vëmendje të shtuar nga Ministria e Kulturës si institucion epror. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 29-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

6.1 Rekomandimi: IKTK në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të ndërmarrin hapat e nevojshëm administrative për ezaurimin e kësaj problematike e cila denatyrton treguesit financiar të institucionit.

Brenda datës 30.06.2020

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, institucioni llogaritjen dhe mbajtjen e tarifave në dhënie e licencave në fushën e restaurimit të monumenteve për periudhën nën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

auditim vitet 2017-2019 e ka kryer referuar urdhrin të Ministrit të Kulturës nr. 426 datë 01.12.2015. Ky urdhër bie në kundërshtim me VKM nr. 432 datë 28.06.2006 i cili përcakton qartë hartimin e një udhëzimi të përbashkët me Ministrin e Financave për caktimin e tarifave dhe kategorizimin e tyre. Gjithashtu në vet dispozitat ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e IMK dhe konkretisht statutin e institucionit miratuar po me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 9 datë 23.01.2017, Neni 15 “Të ardhurat buxhetore”, pika 4 e tij përcaktohet se, të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga I.M.K-ja sipas legjislacionit në fuqi, VKM nr. 432, datë 28.06.2006 si dhe Udhëzimit të Ministrit të Kulturës dhe Ministrit të Financës, gjë e cila nuk rezulton.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore në nenin 29 pika 10 të tij përcakton detyrimin e IKTK, pra institucionit të ri për mbledhjen e tarifave sipas parashikimeve të udhëzimit të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat. Udhëzimi i përbashkët ende nuk është miratuar megjithëse ai duhet të ishte bërë efektiv brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pra prej muajit qershor 2019. Vet institucioni e ka evidentuar boshllëkun e krijuar dhe ka kërkuar plotësimin e bazës ligjore. Megjithatë, prej rreth 8 muajsh ky udhëzim mungon, duke mospërmbushur dukshëm kërkesat e përcaktuara nga ligjvënësi. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr29 -42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

7.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës, të ndërmarrin hapat e nevojshëm administrativ për miratimin e udhëzimit mbi tarifën dhe sjelljen e procesit në legjitimitet.

Brenda datës 30.06.2020

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nën auditim menaxhimi i burimeve njerëzore nuk gjendej si pozicion i dedikuar në strukturën e mëparshme të institucionit, referuar kjo VKM nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabinete vendimëse, të organizimit të brendshëm të institucione vetë administratës shtetërore,...” e cila në pikën 8 të saj përcakton se,

Në institucionet, që kanë të paktën 30(tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore. Në varësi të madhësisë së institucionit ky pozicion mund të jetë i dedikuar ose të ketë përgjegjësinë edhe për kryerjen e funksioneve të tjera.

Pavarësisht kësaj mangësie në strukturë, dokumenti “Përshkrimet e punës” pjesë e Rregullores së Brendshme, detyrat e këtij funksioni ja ka ngarkuar Përgjegjësit të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i cili është caktuar njëkohësisht edhe “Nëpunësi Zbatues” i institucionit për këtë periudhë çka bie ndesh me përcaktimet ligjore përkatësisht Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 21 datë 25.10.2016 pika 2.3 e tij, Ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) neni 12 pika 3/ç, e tij.

Caktimi i punonjësit i cili duhet të kryente detyrën e burimeve njerëzore të institucionit sipas dispozitave të lartpërmendura nuk duhet të ishte pjesë e stafit të financës e aq më pak e nëpunësit zbatues i cili ka funksion mbikëqyrës dhe jo hartuesi si në rastin konkret. Sa më lartë tregon që institucioni për periudhën nën auditim nuk ka patur një ndarje të detyra të drejtë të detyrave dhe sistemi i kontrollit të brendshëm paraqitet me mangësi. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

8.1 Rekomandimi: IKTK në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të ndërmarrin hapat e nevojshëm administrativ dhe ligjore për dedikimin e funksionit të burimeve njerëzore referuar VKM nr. 893, datë 17.12.2014.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, institucioni për vitet 2017 dhe 2018 ka kryer procedurën e inventarizimit të aktiveve, ndërsa për vitin 2019 megjithëse është nxjerrë urdhri nga titullari i institucionit nr. 2605 prot, datë 12.12.2019 procesi deri në këtë fazë të auditimit ende nuk ka përfunduar. Kjo edhe për shkak të mungesës të një afati të shkruar për përfundimin e procesit. Për inventarizimet e mbyllura për vitet 2017-2018 komisionet përkatës nuk rezultojnë të kenë mbajtur procesverbal për verifikimet e kryera si dhe raport të shkruar mbi inventarizimin fizik të aktiveve në kundërshtim me pikën 85/a,b të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Vlerat përmbledhëse të kartelave të inventarizuara dhe firmosura nuk përkojnë me vlerat totale të pasqyruara në kontabilitet, çka tregon mangësi në përfundimin e plotë të këtij procesi. Të meta në dokumentacion evidentohen edhe në regjistrimin e aktiveve të hyra pa pagesë si dhe marrjen në dorëzim të tyre nga institucioni për të cilat kërkohet një vëmendje më e madhe nga institucioni. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 29-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

9.1. Rekomandimi: IKTK të përfundojë inventarizimin e plotë të aktiveve për të dy institucionet e riorganizuar konform përcaktimeve të UMF nr.30 datë 27.12.2011, i ndryshuar dhe kuadrimit e treguesve të llogarive të aktiveve me Pasqyrat Financiare të konsoliduara të vitit 2019.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Miratimet e legalizimeve të objekteve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretaria Teknike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, marrë mbi bazën e diskutimeve në Këshillin Shkencor të IMK-së, si dhe mendimet institucionale të dhëna për këto objekte nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë kanë cënuar detyrimet për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Korçës, pasi për të gjithë rastet e audituara rezultojnë se miratimet e legalizimeve janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 9084, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, neni 29 pika 1 dhe 2 ku përcaktohet se në këto zona është i ndaluar ç’do lloj ndërtimi i ri;

Të gjitha vendimet e audituara të miratimeve të legalizimeve nga KKR dhe mendimet institucionale të DRKK Korçë, janë dhënë për objekte të cilat nuk plotësojnë kushtin e harmonisë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, nuk ruajnë kompozimin volumor në përputhje me objektet përreth, nuk i përshtaten karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale. Objektet paraqesin mungesë identiteti arkitektonik duke mos qenë në harmoni me vetëveten dhe aq më pak me karakterin e objekteve të zonës së mbrojtur.

Në 4 prej rasteve të miratimit të legalizimeve të audituara, rezultojnë se janë bërë miratime për objekte 4 kate brenda zonës së mbrojtur të qytetit të Korçës, në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit nr. 207, datë 15.3.2017 dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë e Rregullores së tij ku përcaktohet qartë se lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve në zonën e mbrojtur, përveç rasteve kur për to ka studime të vecanta, nuk duhet t’i kalojë 3 katet.

Në tre raste rezultojnë se lartësia maksimale e ndërtimit i kalon 3 katet pasi kati podrum është më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemimit dhe lartësia e çatisë e lejon shfrytëzimin e hapsirës nën të duke bërë që ajo të vlerësohet si një kat.

Ne një rast, rezultojnë se në kundërshtim me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 7, datë 08.02.2017, neni 75, pika 3 dhe 4, gjurma e ndërtimit është më e madhe se 150 m² dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit e intensiteti i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

ndërtimit i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar prej 75% dhe intensitet 2.8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 113-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Ministri i Kulturës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve si dhe Znj. A D, drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së të marrin masa për të mos miratuar legalizime të objekteve që çenojnë detyrimet për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10.2 Rekomandimi: Ministri i Kulturës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve si dhe Znj. A D, drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së të marrin masa që për të gjithë rastet e zonave të mbrojtura ku lejohen ndërtime të reja, të hartojnë rregullore mbi kriteret e projektimit për rikonstruksione, adaptime e ndërtime të reja në ansamblin urbanistik, arkitektonik, tradicional ku të përcaktohen qartë kushtet që duhet të plotësojnë objektet lidhur me harmoninë me karakterin arkitektonik dhe urbanistik të ansamblit, ruajtjen e kompozimit volumor në përputhje me objektet përreth, si dhe përshtatjen e karakterit arkitektonik e dekorativ me arkitekturën tradicionale.

Në vazhdimësi

10.3 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, të marrë masa për ndalimin e dhënies së opinionëve të pabazuara për rastet e legalizimeve të ndërtimeve në Zonën e Mbrojtur të qytetit të Korçës dhe hartimin e një rregulloreje mbi shqyrtimin e rasteve në përputhje me kriteret e projektimit për rikonstruksione, adaptime e ndërtime të reja në ansamblin urbanistik, arkitektonik, tradicional.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Aplikimet për leje zhvillimi për hidrocentrale nuk bazohen në një instrument planifikimi në fuqi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve si dhe vendimet miratuese të marra nga ky i fundit, nuk janë bazuar në detyrimin e përputhshmërisë së projekteve të hidrocentraleve me dokumentat e planifikimit ku në këtë rast aplikimet për leje zhvillimi duhet të bëheshin vetëm bazuar në një Plan Kombëtar Sektorial referuar VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” seksioni 4, neni 22.

Pasi në ç’do rast autoriteti që shqyrton kërkesat për leje zhvillimi Bazuar në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, neni 10/1 ka detyrimin që të shprehet, nëse projektideja është hartuar në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe rregullat e projektimit.

Sa më sipër miratimi i këtyre projekteve nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve është në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, duke bërë që këto leje të jenë dhënë në kushtet e mungesës së zonave të përcaktuara të zhvillimit të sektorit. *Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 113-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

11.1 Rekomandime: Ministri i Kulturës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve si dhe Znj. A D, drejtuese e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në cilësinë e Sekretarisë Teknike të KKR-së dhe kryetares së Këshillit Shkencor të IMK-së të marrin masa për të mos miratuar leje zhvillimi për hidrocentrale, në kushtet e mungesës së instrumenteve të planifikimit ku të jenë të përcaktuara zonat kryesore të zhvillimit të sektorit, plani i shërbimeve dhe infrastrukturave të sektorit si dhe plani i mbrojtjes së mjedisit dhe rregullat për ruajtjen e mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore dhe objekteve të trashëgimisë kulturore.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Me vendim nr. 195, datë 06.06.2019 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i asistuar nga Sekretariati Teknik, Instituti i Monumenteve të Kulturës pas diskutimit paraprak në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, ka miratuar projektin “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Sh hr shpk”.

Nga auditimi rezulton se kjo leje nuk është e bazuar në një instrument planifikimi në fuqi, Plan Kombëtar Sektorial, Plan të Përgjithshëm Vendor apo Plan të Detajuar Vendor, në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” dhe Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar

Nga verifikimi i përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, si instrumenti më i lartë i planifikimit të territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë, rezulton se në lumin Shushicë nuk është parashikuar ndërtim hidrocentralesh.

Në miratimin e këtij projekti Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe Këshilli Shkencor i Institutit të Monumenteve të Kulturës kanë vepruar në kundërshtim dhe me Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” pika 67 si dhe masave të mbrojtjes indirekte, të përcaktuara në nenin 96, pasi projekti i ndërtimit të këtij HEC-i cënon perspektivën, peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 113-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandime: Ministri i Kulturës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve dhe Këshillit Shkencor të IMK-së të marrin masa për të anuluar Vendimin nr. 195, datë 06.06.2019, për miratimin e projektit “Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë në Qarkun e Vlorës me aplikuas “Sh h shpk” si një vendim i dhënë në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe që cënon perspektivën, peisazhin, shikimin dhe shijim e përdorimit nga publiku të monumentit të kulturës Ura e Bratit.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Kontratat e restaurimit për objektet: “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)” Lezhë”, “Kisha “Shën Mërisë” Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër”, “Restaurim i Objektivit “Mësonjëtorja e Parë Shqipe”, etj, janë caktuar punjonjës për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin, të cilët një pjesë e tyre nuk disponojnë licensën përkatëse të restaurimit, cka do të thotë se mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të restaurimit nuk është në përputhje me lagjislacionin e disiplinimit të ndërtimit dhe trashëgimisë kulturore. Veprimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

është në kundërshtim me në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 nenin 7 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar dhe të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzete” Neni 72 Projektimi, zbatimi, mbikëqyrja, kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse, ku projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse të pasurive kulturore materiale kryhet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim ose institucionet shtetërore të specializuara dhe të ngarkuara me ligj për mbrojtjen, ruajtjen dhe studimin e pasurive të trashëgimisë kulturore. IMK ka të punësuar specialist të cilët disponojnë licensa përkatëse të restaurimit, por që nuk janë shfrytëzuar për kapacitetet e tyre. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 42-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

13.1 Rekomandime: Nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, sektori i investimeve, të merren masa që në projektet e restaurimeve, të përcaktohen e të shfrytëzohen punonjës të cilët disponojnë licensat përkatëse për mbikëqyrje dhe kolaudime të objekteve restauruese.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Institutit të Monumenteve të Kulturës, për procedurat e prokurimit publik nuk ka ndjekur apo respektuar Vendimin Nr. 45 datë 21.01.2009 të KM “Për kryerjen e procedurave në mënyrë elektronike”, pika 1, ku vendoset që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen me mjete elektronike. Sistemi elektronik u përdor në mënyrë të suksesshme nga Ministritë dhe gjatë vitit 2008 u organizuan trajnime për të gjitha njësitë e qeverisjes. Agjencia e Prokurimit Publik ndër vite ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë trajnime apo vendime të konflikteve ligjore. APP-ja ka nxjerrë vazhdimisht udhëzime për realizimin e procedurave në formë elektronike. Zhvillimi i procedurave në mënyrë elektronike do të garantonte transparencën në përdorimin e fondeve publike, ku nga IMK nuk është zbatuar, apo të jetë kërkuar interpretim nga APP apo KPP realizimin e procedurave prokuruese.

- Prokurimet janë realizuar në mbështetje të ligjit nr. 9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar, VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007. Një pjesë të Kriteret e vecanta kualifikuese nga AK hartohen bazuar LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 dhe një pjesë të kriteret të vecanta kualifikuese janë vendosur bazuar VKM nr. 216 datë 18.04.2007 “Për procedura e konkurimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licensuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës” të ndryshuar me VKM nr. 480 datë 01.08.2007 dhe Udhëzimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinis dhe Sporteve.

- Nga procedurat e realizuara për vitin 2018 dhe 1 procedurë e realizuar në vitin 2019. Konstatohet se pjesëmarrja ndarja e kontratave është e përqëndruar në një grup të vogël shoqërisht, të cilat konkurojnë në procedurat restauruese.

- Mbi kriteret e vlerësimit njësia e vlerësimit bazohet në udhëzimin MTKRS nr. 446 date 5.7.2007 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës“. Vlerësimi i Ofertës më të mirë ekonomike konsiderohet, ajo e cila merr numrin më të madh të pikëve, vlerësuar me vlerën më të ulët të ofruar do të marrë 85 pikë, ku ofertat ekonomike pasardhëse ulen me nga 5 pikë secila, sipas rendit zbritës dhe Eksperienca e subjekteve konkurrues, që mund të jenë, shoqëri restauruese, shoqëri ndërtimi, me nënkontraktorë restaurator, individë restaurues do të vlerësohet deri në 15 pikë.

Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, sipas legjislacionit lidhur me eksperiencën dhe të dhënat tekniko-profesionale parashikohen në dokumentet standarde të konkurrimit, në varësi të objektit që do të restaurohet, madhësisë së fondit të vënë në dispozicion, shkallës së vështirësisë së projektit. Nëse me të njëjtën sasi pikësh rendit e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

para më shumë se një ofertë, njësia e vlerësimit vendos me shumicë votash, për ofertën më të mirë ekonomike të ofruar, mbështetur në kriteret e vlerësimit.

- Referuar sistemit të pikëzimit nga KVO, konstatohen interpretime në kundërshtime me parimet e barazisë në tendera dhe trajtime jo të njëjta në garë.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit, rezulton një sistem vlerësimi i pabarabartë dhe jo i drejtë pasi pikët maximale fitohen nga OE që ka paraqitur kontratën e ngjashme me vlerë më të madhe, më shumë certifikata (të pakërkua), më shumë vërtetime (të pakërkua), më shumë trajnime (të pakërkua), duke diskriminuar OE pjesëmarrës, në kundërshtim me të gjitha parimet e transparencës dhe rregullave të prokurimit publik. Vlen të theksohet se trajtimi i barabartë krijohet nga interpretimet e KVO, ku në asnjë një faqe të DST, nuk përmendet sistemi i vlerësimit dhe lloji i kushtit të garimit.

- Cdo konkurent sipas LPP vlerësohet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga enti prokurues ose enti publik për të cilat është i detyruar ti plotësojë ose jo dhe në asnjë rast nuk mund të bëhet vlerësim mbi kriteret të cilat asnjëherë nuk janë kërkuar dhe aq më pak nuk janë bërë publike për të gjithë konkurentët duke shkelur parimin e barazisë në konkurim dhe vendosjen në kushte të njëjta konkurrimi dhe jo diskriminues për konkurentët e mundshëm.

- Paraqitja e një dokumenti ekstra të pakërkuar nga Enti Prokurues nuk e ndalon konkurentin ti paraqesë ato, por nuk përbën kriter favorizimi për të.

- Vlerësimi me pikë i kryer dhe raporti i pikëzimit bazuar në kriteret të pakërkua dhe të vlerësuara maksimalisht, cili për rrjedhojë ka sjellë renditje jo të drejtë të konkurentëve jo vetëm nuk ka asnjë mbështetje ligjore Udhëzimin MTKRS, Nr. 446, datë 05.07.2007, por ka bërë që të ketë dhe efekte ekonomike në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 42- 113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

14.1.Rekomandimi:

- Nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, të merren masa të menjëhershme që prokurimet publike të restaurimeve, të realizohen në mënyrë elektronike, duke rritur ndjeshëm transparencën, duke siguruar konkurrencë të lartë, transparencë e garantuar dhe kursim fondesh me parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit.

- Nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, për cdo procedurë prokurimit të udhëhiqet nga parimi ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me çmimi më i ulët dhe kursyer fonde buxhetore.

- Nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, njësia e vlerësimit të ofertave, të vlerësojë OE në bazë të kriterëve të përcaktuara në DSR dhe në asnjë rast mos të realizojë vlerësim mbi kriteret të cilat nuk janë kërkuar në DSR, të cilat nuk bëhen publike për të gjithë konkurentët duke mos shkelur parimin e barazisë në konkurim dhe vendosjen në kushte të njëjta konkurrimi dhe jo diskriminues për konkurentët e mundshëm

Në vijimësi

D.MASE SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi:Kontrata e restaurimit për "Restaurim i Objektivit “Kisha e Shën Nikollit (Vendvarrimi i Skëndërbeut)” Lezhë”, midis IMK dhe operatorit ekonomik K.A.E.XH shpk, me vlerë kontrate 27,700,539 lekë pa TVSH. Afati zbatimit 180 ditë nga lidhja e kontratës dhe Lloji i kontratës është kontratë me çmim njësie të bazuar në çmimet e njësisë, të shprehura në preventivin në njësi. Nga auditimi situacionit përfundimtar të kontratës, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave konstatohet disa pasaktësi në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

llogaritjet e volumeve me vlerë **621,909 lekë** më tepër, e cila përbën dëm ekonomik e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr.42 -113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1.Rekomandimi: Instituti i Monumenteve të Kulturës të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar llogaritjet e dokumentacionit teknik me punën e kryer ne fakt, për pasojë vlera **621,909 lekë** më tepër e përfituar nga sipërmarrësi dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi, nga sipërmarrësi i punimeve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Kontrata e restaurimit për “Restaurim i Objektivit "Mësonjëtorja e Parë Shqipe”, midis IMK dhe operatorit ekonomik “R C”shpk, me vlerë të kontratës 24,706,032 lekë pa TVSH. Afat zbatimit 90 ditë ditë nga lidhja e kontratës dhe Lloji i kontratës është kontratë me çmim njësie të bazuar në çmimet e njësisë, të shprehura në preventivin në njësi. Nga auditimi situacionit përfundimtare të kontratës, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave konstatohet disa pasaktësi me vlerë **75,360 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr.42 -113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1.Rekomandimi: Instituti i Monumenteve të Kulturës të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar llogaritjet e dokumentacionit teknik me punën e kryer ne fakt, për pasojë vlera **75,360 lekë** më tepër e përfituar nga sipërmarrësi dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi, nga sipërmarrësi i punimeve.

Në vijimësi

E. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën nën auditim Janar 2017-Dhjetor 2019 institucioni ka paguar për vendime gjyqësore për largim të padrejtë nga puna, të cilat thuajse në të gjitha rastet janë fituar nga punonjësit e dhe përkatësisht:

Për tre vendime të formës së prerë të dhëna nga gjykatat për vitin 2017 dhe tre vendime të paguara gjatë këtij viti por që përkasin vendimeve të shpalluar gjatë vitit 2016 vlera financiare kap shumën 5,355,502 lekë. Për vitet 2018 dhe 2019 rezulton vetëm një vendim gjyqësor i formës së prerë dhe është zbatuar prej institucionit. Vlera financiare e paguar për këto vendime paraqitet 1,295,885 lekë. Aktualisht, institucioni ndodhet në proces edhe për një tjetër çështje gjyqësore, paraqitur në tabelën. Largimet e padrejta i përkasin në një rast vitit 2013 dhe në gjithë rastet e tjera vitit 2014.

Vlera financiare gjithsej, e paguar si rrjedhojë e largimeve të padrejta nga puna ka rënduar financat publike për vitet 2017-2019 në shumën **6,651,387 lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: IKTK, të respektoj rigorozisht kriteret e punësimit të parashikuara në Kodin Punës dhe kontratën individuale për punonjësit në mënyrë që në të ardhmen të mos kryhen largime të padrejta nga puna të cilat shkaktojnë kosto shtesë të panevojshme në buxhetin e shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pagesat e kryera nga institucioni për periudhën nën auditim vitet 2017-2019 rezultoi se, gjatë kësaj periudhë janë paguar shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve informatikë W G, sistem i cili përdoret për inventarizimin dhe paraqitjen në hartë të monumenteve të kulturës.

-Referuar ndryshimeve ligjore të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, nga ana e IMK dhe AKSHI-t është ngritur grupi i përbashkët i punës regjistruar në IMK nr. 408 prot. datë 20.02.2019, për kalimin kapital të sistemit pranë AKSHI. Me urdhrin e brendshëm të IMK nr. 408/1 datë 20.02.2019, është përcaktuar komisioni për dorëzimin e aktiveve. Vonesat në fillimin dhe përfundimin e procedurës së dorëzimit të sistemit si dhe vonesat në reflektimin e ndryshimeve të kontratës së mirëmbajtjes lidhur midis IMK dhe operatorit ekonomik fitues referuar pikës 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar, për shpenzimet e mirëmbajtjes së sisteme IT në vlerën **360,000 lekë** nuk është në përputhje me parimet e efektivitetit dhe efikasitetit duke e ekspozuar institucionin drejt shpenzimeve të panevojshme. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 29-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

2.1 Rekomandimi: IKTK, të respektoj rigorozisht kriteret e VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar duke eliminuar kostot shtesë të panevojshme në buxhetin e shtetit.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për "Restaurim Kisha "Shën Mërisë" Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër" 2018, konstatohet se nga sistemi i vlerësimit të pikëve nga KVO, janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomik, ku Oferta e "J" sh.p.k", me vlerë 16,654,279 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për IMK, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit, interpretimet e sistemit të pikëzimit nuk janë në përputhje Udhëzimin MTKRS, Nr. 446, datë 05.07.2007, duke i trajtuar jo në mënyrë të barabartë OE.Sistemi i vlerësimit ka krijuar efekte financiare negative, në vlerë prej **1,001,924 lekë me TVSH** (17,489,216 lekë - 16,654,279 lekë = 834,937 lekë x 20% TVSH), midis ofertës së "J" sh.p.k", " shpk dhe ofertën e Operatorit Ekonomik "AD-Star" shpk, të shkaktuar nga vlerësimi i ofertave me sistemin e pikëzimit e cilat nuk janë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 42- 113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.a.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën " Restaurim Kisha "Shën Thanasi", Leshnicë, Sarandë ", konstatohet se OE "M/s" shpk, duhej të skualifikohej pasi ka paraqitur në të njëjtën kohë të njëjtin dokumentacion për stafin teknik (restaurator etj), të njëjtat mjete me të cilat do të kryheshin punimet në kontrata të tjera, me shpërndarje gjeografike të largët nga njëra-tjetra dhe me të njëjtë grafik punimesh.

Ofertat e "J" sh.p.k", me vlerë 8,332,190 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për IMK, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit. Pra sistemi i prokurimit, dhe vlerësimi i ofertave, ka krijuar **efekte negative financiare** midis diferencës së vlerës prej **114,519 lekë me TVSH** (8,427,623 lekë - 8,332,190 lekë = 95,433 lekë x 20% TVSH), midis ofertës së "J" sh.p.k", " shpk dhe ofertën e Operatorit Ekonomik "M/S" shpk. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr.42 – 113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

3.b.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për në procedurën e restaurimit për “Restaurim i Objektivit Ura e Kollorcës 4 Km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat u konstatua se :vlerësimi me pikë i kryer dhe raporti i pikëzimit bazuar në kriteret të pakërkuara dhe të vlerësuar maksimalisht, cili për rrjedhojë ka sjellë renditje jo të drejtë të konkurrentëve jo vetëm nuk ka asnjë mbështetje ligjore Udhëzimin MTKRS, Nr. 446, datë 05.07.2007.

Si përfundim me raportin përmbledhës nr. 1196 prot. Datë 06.06.2018 miratohet përfundimi i procedurës ku shpallet fitues shoqëria “A-S” & “M/S” me vlerë 4,995,049 pa TVSH, ku me prokurën e posacme puna përfaqësohet nga shoqëria “M/S, duke skualifikuar ofertën e “J” sh.p.k”, me vlerë 3,918,359 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për IMK, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, interpretimet e sistemit të pikëzimit kanë cuar në trajtim jo të barabartë të OE.Sistemi i vlerësimit ka krijuar efekte financiare negative,në vlerë prej **277,969 lekë me TVSH** (4,150,000 lekë - 3,918,359 lekë = 231,641 lekë x 20% TVSH), midis ofertës së “J” sh.p.k", " shpk dhe ofertën e Operatorit Ekonomik "M/S" shpk, të cilat nuk janë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr.42-113 të Raportit Pwrfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: IKTK, të respektoj rigorozisht kriteret e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit duke eliminuar efektet financiare negative të panevojshme në buxhetin e shtetit dhe përfituar oferta më të mira nga ana finaciare.

Në vijimësi

V. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e Raportit të Auditimit janë edhe Aneksi nr.I dhe Aneksi nr.II.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Pwrfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

M. LL (Përgj. Grupi)

K XH

A K

E S

KONTROLLI I LARTW I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

ANEKSI I
QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Gjatë fazës së planifikimit nga ana e grupit të auditimit u vlerësua risku dhe metoda e auditimit sa i përket.

Riskut i zbulimit:

Duke qenë se KLSH konsideron *Riskun e Auditimit* në masën **5%** duke konsideruar një siguri auditimi prej 95% , *Risku i zbulimit* i përcaktuar mbi modelin e sigurisë vlerësohet si vijon:

Zonat e auditimit të marra në shqyrtim	Rrisku i brendshëm (IR) (0,6 deri ne 1)		Rrisku i kontrollit të brendshëm (CR) (0,15 - 0,25 -1)			Rrisku i zbulimit (DR)		Niveli i besueshme rise (1-DR) (1-DR) Ne perqindje	Metoda E Auditimit
	I Ulët	I Lartë	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	DR = AR/ (IR x CR)	DR ne (%)		
1 Monitorimi i zbatimit të kontratave dhe mbikëqyrja e monumenteve të rashëgimisë kulturore.	0,75				0,60	0.04	4%	96%	Me përzgjedhje mbi bazë Risku
2 Miratimin e projekteve dhe miratimi I objekteve per legalizim	0,75			0.25		0,02	2%	98%	Me përzgjedhje mbi bazë Risku
3 Dhënia e lejeve dhe licencave për restaurim.	0,75			0.25		0,02	2%	98%	Me përzgjedhje mbi bazë Risku
4 Shlyerja e detyrimeve ndaj ish punonjësve.	0,75				0.60	0.04	4%	96%	Me përzgjedhje mbi bazë Risku
5 Marrëdhëniet me organet tatimore për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore..	0,75				0.50	0.04	4%	96%	Me përzgjedhje mbi bazë Risku
6 Marrëdhëniet me Ministrinë e kulturës dhe DRajonale për ruajtjen dhe zhvillimin e objekteve të trashëgimise kulturore.	0,75			0.25		0,02	2%	98%	Me përzgjedhje mbi bazë Risku

Materialiteti



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Përcaktimi i materialitetit nga *ana sasiore* përfshin gjykimin mbi nivelin maksimal të pranueshëm të shmangies së përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret. Ky materialiteti vlerësohet deri në 2% në nivel grupi dhe llogarie.

Përcaktimi i materialitetit nga *ana cilësore* “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose nëvarësi të kontekstit të tyre” të cilat do të lidhen me përputhshmërinë e veprimtarisë së IMK vlerësohen materiale nga ana cilësore për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike të cilin ka veprimtaria e kësaj agjencie në montorimin e veprave të trashëgimisë Kulturor

Nisur nga gjykimi dhe natyra e veprimtarisë së subjektit të audituar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për zonat e llogarisë numerike të planifikuara për t’u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të subjektit, prapun e materialitetit gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të moderuar deri në të lartë. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti si dhe dokumentacionin shoqërues dhe verifikimin e tyre. Konkretisht, mbi të dhënat e disponuara u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm; dhe
- teste të detajeve.

Sipas drejtimeve u përdorën kriteret si vijon:

Drejtimi të programit të auditimit për prokurimet publike u përzgjedhën 10 kontrata të cilat kishin përfunduar punimet dhe ishin likuaduar.

-Kriteri i përdorur është : Risku në monitorimin dhe llogaritjen 2%.

-Masa e mbulimit nga auditimi: U audituan 10 nga 10. të tillë ose rreth 100%.

Drejtimi të programit të auditimit për miratimin e projekteve u audituar sipas të dhënave u ndanë në dy nëngrupe:

-Periudha 2017

-Periudha 2018- 2019

Periudha	Nr.projektesh
2017	10
2018	12
2019	9
Shuma	31 projekte

-Kriteri i përdorur: Risku në plotësinw e dokumentacionin ligjor

-Masa e mbulimit nga auditimi: Rreth 60%.

Drejtimi i programit të auditimit për dhënien e lejeve dhe licencave për ndërhyrje në objekte të trashëgimisë kulturore, bazuar në faktin se subjekti i audituar pajis me leje shoqëritë për ndërhyrje në veprë,masa e mbulimit i referohet gjithashtu kriterëve të tyre.

Drejtimi i të programit të auditimit për shlyerjen e detyrimeve ngaproceset gjyqësore ,mbi bazën e të dhënave u përdor kriteri



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

-Kriteri i përdorur: Risku në mbajtjen e sasive të energjisë në kontratë për hecet e kaluar plotësisht në prodhim me diferencë pozitive.

-Masa e mbulimit nga auditimi: 10 vendime nga 15 ose rreth 59%.

ANEKS II.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Me shkresën Nr. 870/7 Prot datë 31.12.2016 është përcjellë në IMK vendimi I Kryetarit Nr. 189 , datë 31/12/2016 lidhur me Raportin Përfundimtar të Auditimit: “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” të ushtruar në Institutin e Monumenteve të Kulturës “G S” Tiranë, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.08.2016 të veprimtarisë së këtij institucioni.ku janë rekomanduar masa për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe organizativ të veprimtarisë së institucionit ku nga auditimi i zbatimit të tyre trajtohet hollësisht në Aneksin 1 bashkangjit këtij Projektraport auditimi.

A. MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

Gjetja 1. Për përcaktimin e kompetencave e riorganizimin e DRKK-ve ka vepruar VKM nr. 989 datë 10.11.2010 “ Për përcaktimin e kompetencave të IMK dhe riorganizimin e disa institucioneve të trashëgimisë kulturore” kjo VKM është shfuqizuar me VKM nr. 1003 datë 13.11.2013 gjë që ka bërë që DRKK të mos kenë një rregullim si të varësisë ashtu dhe të organizimit e funksionimit të qartë e të bazuar në legjisllacion.

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga ana e IMK në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të merren masat për hartimin e akteve ligjore e nënligjore të nevojshme dhe për paraqitjen e tyre për miratim nga institucionet kompetente, me qëllim përcaktimin e qartë të varësisë administrative dhe organizimit e funksionimit të Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare në Rrethe.

Menjëherë

Situata e zbatimit të rekomandimit; Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM Nr. 364 datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhrit të Kryeministrit Nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”

Gjetja 2. Megjithëse në mungesë të një procesi të rregullt programimi buxhetor, gjatë vitit 2015, janë realizuar përmes procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, shërbimi me objekt “Rindërtim arkeologjik 3-D i Teatrit Tomak të Qyetit Antik të Butrintit pasuri Botërore e UNESCO-s”, me fonde të siguruar nga UNESCO, si dhe shërbimi me objekt “Inventarizimi dhe hartëzimi i Monumenteve të Kulturës në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet hartës GIS”. Nga auditimi i procedurës me objekt “Rindërtim arkeologjik 3-D i Teatrit Tomak të Qyetit Antik të Butrintit pasuri Botërore e UNESCO-s”, me fond limit 2,003,564 lekë dhe me afat të zbatimit të kontratës 40 ditë nga lidhja e kontratës, u konstatua se autoriteti kontraktor ka zgjedhur dhe përdorur procedurën e prokurimit: “Shërbimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Konsulencës” për arsye se është konsideruar shërbim i një natyre intelektuale dhe këshilluese si dhe në bazë të vlerës së kontratës nën kufirin e ulët monetar.

Në kërkesat për specifikime teknike konstatohet se është kërkuar në pikën 2.3.c. Kritere të veçanta-Licenca profesionale e shoqërisë për projektim në kategoritë 2d (projektim pejzazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberuara, lulishte e parqe), kriter që në gjykimin tonë nuk ka asnjë lidhje me kërkesat për shërbimet e kërkuara. Këto punime-shërbime mund të ishin përfshirë në kategoritë e projektimit “2a” (projektim arkitektonik) dhe “8a” Bazamente gjeodezike – rilevime në të gjitha shkallët dhe 8.b Projektim fotogrametrik – hartografik – topografik të përcaktuara sipas VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e studim projektimit...”, licenca që nuk rezultojnë të vendosura në DST. Vlen të theksohet se rilevimi topografik i terrenit-objekteve dhe pasqyrimi i gjithë informacionit gjeografik ekzistues të gjeoreferencuar në gjeodatabase zë një pjesë të konsiderueshme të shërbimit të kërkuar, të përcaktuar në termat e referencës, i cili duhet të realizohet nga subjektet me licencën përkatëse. Mbi bazë të kriterëve të përcaktuar, në tender nuk u realizua të sigurohet interesimi i operatorëve ekonomik dhe procesi dështoi dy herë për mungesë të konkurrencës. Megjithëse janë anuluar dy procedura prokurimi për mungesë të konkurrencës, AK nuk ka bërë ndryshime të specifikimeve teknike ose kriterëve të kualifikimit në mënyrë që të zgjerohet konkurrenca dhe të kishin mundësi të hynin në prokurim operatorë ekonomik veprim ky në kundërshtim me nenin 73, Mungesa e Konkurrencës, pika 2 të VKM datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet “Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon: Shkaqet që shkaktojnë dështimin e procedurës dhe i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës”. Në observimet e subjektit cilësohet mungesa e kapaciteteve të duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin e prokurimit, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në këto kushte, subjekti gjykon se njësisia e prokurimit nuk mban përgjegjësi për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës, preventivit të kostos, grafikun e punimeve dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, në rastin kur kjo detyrë i është caktuar një strukture të veçantë, dhe nga ana tjetër kjo situatë e bën të pamundur ndërhyrjen apo rishikimin e kriterëve të vendosura paraprakisht.

Procedura ka vijuar si “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, dhe konstatohet se vetëm një operator ekonomik ka shprehur interes për këtë procedurë prokurimi, A 4 sh.p.k. Në përfundim të procedurës ky operator është shpallur fitues me vlerë kontrate të negociuar 2,000,000 lekë pa t.v.sh dhe afat të zbatimit të kontratës 40 ditë. *Trajtuar më hollësisht në faqen 77-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj: Agjensia e Prokurimit Publik, të marrë masa për të plotësuar bazën ligjore me rregulla të qarta mbi të cilat duhet të realizohen procedurat e prokurimit për shërbimet grafike-animacione dixhitale-spote, duke e shoqëruar edhe me një udhëzues për llogaritjen e saktë të kostos së këtyre detyrave të projektimit për efekte të përcaktimit të fondit limit, kjo duke patur parasysh kërkesat në rritje që mund të vinë për këto lloj projektimesh

Menjëherë

Situata e zbatimit të rekomandimit :IMK ka dërguar shkresën Nr.13/1, datë 24.01.2017 drejtuar APP-së, mbi gjetjen e konstatuar nga KLSH por asgjë nuk ka ndryshuar, konsiderohet I porealizuar , vazhdon e njëjta situatë.

B. MASA ORGANIZATIVE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Gjetja 1. Nga auditimi mbi programimin dhe zbatimin e fondeve buxhetore u konstatuan diferenca të mëdha ndërmjet PBA dhe çeljes së buxhetit fillestar e atij përfundimtar të miratuar me ndryshimet përkatëse, të cilat dëshmojnë për mungesën e saktë të planifikimit të kërkesave buxhetore. Një nga problematikat kryesore është ajo për klasifikimin e gabuar të fondeve buxhetore shkaktuar nga mungesa e planifikimit për investime që në fillim të vitit. Çelja dhe alokimi i fondeve bëhet jo mbi bazë projektesh, në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Diferencat e realizimeve dëshmojnë për mosplanifikim të saktë nga ana e institucionit të IMK, kështu rezultoi se janë realizuar shpenzime të cilat ose nuk kanë qenë planifikuar fare ose kanë një realizim më të lartë se planifikimi fillestar si në rastin e investimit dixhital në lidhje me **W G**, për të cilin është përdorur një llogari transfertash buxhetore dhe jo një llogari investimi sipas natyrës ekonomike. Nga fondet e planifikuara për platformën **W G** prej 6,200,000 lekë, janë përdorur 4,755,600 lekë, referuar aktrakordimeve përfundimtare me thesarin. Planifikim jo i saktë i kërkesave buxhetore për realizimin e projekteve sjell tjetërsimin e fondeve në aktivitete të paplanifikuara. Në vitin 2015 fondet e kursyera nga procedura e prokurimit për investimin e mësipërm përdoren për financimin e aktiviteteve si përkthimi apo publikimi i librave, aktivitete, të cilat nuk kanë qenë të planifikuara në projektbuxhetin e vitit. *Trajtuar më hollësisht në pikën 21-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.* **Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga strukturat menaxhuese të Ministrisë së Kulturës dhe strukturat menaxhuese të këtij institucioni të përmirësohet procesi i planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, në përputhje me ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, duke shmangur përdorimin e fondeve në artikuj të paprogramuar, e sidomos në fondet e investimeve.

Të merren masa për të shmangur financimin e projekteve gjatë vitit, të cilat nuk kanë qenë të planifikuara në fillim të vitit. Insitucioni të përdorë fondet buxhetore vetëm në aktivitete të planifikuara dhe në artikujt sipas natyrës ekonomike të tyre. Procesi i planifikimit të kërkesave buxhetore të realizohet në përmbushje të kërkesave reale të institucionit. **Në vijimësi**

Situata e zbatimit të rekomandimit :IMK ka përgatitur kërkesat reale për fondet buxhetore, të cilat janë dërguar sipas shkresë së Ministrisë së Kulturës, si Institucion Qëndror në lidhje me “Përgatitjen e Projekt Buxhetit, të vitit përkatës” në dy faza, sipas shkresave përkatës të Ministrisë së Kulturës. Përkatësisht Faza e Parë Strategjike dhe Faza e Dytë Teknike. Fondet e çelura janë duke respektuar artikujt buxhetor përkatës.

Gjetja 2. Për të vlerësuar rregullshmërinë e aktivitetit dhe përmbushjes së detyrave funksionale të IMK por dhe të KKR e Ministrisë së Kulturës në funksion të misionit për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, u auditua procesi i vendimarrjes për prishjen e rindërtimin e Stadiumit “Q S” nga ku rezultoi se:

Sipas procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Shkencor të IMK të datës 25.05.2016 (dokumentacioni i dosjeve) përsa i përket çështjes së Stadiumit gjendet një paragraf me këtë përmbajtje: *Stadiumi Tiranë, kjo pikë vazhdon në KKR e orës 12.30 për tu diskutuar në një tavolinë të përbashkët midis KSH (Këshillit Shkencor) dhe KKR.*

Në protokollin e mbledhjes së KKR të datës 25.05.2016, konstatohet se është diskutuar dhe çështja e Stadiumit duke vendosur për heqjen pjesërisht të statusit të monumentit duke lënë si monument vetëm Fasadën, ndërkohë që nuk rezultoi të kemi shprehje të Këshillit Shkencor të IMK apo cilësim të opinionit të tyre lidhur me këtë çështje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve të datës 01.07.2016 (me pjesëmarrje të vetë Kryeministri) është vendosur për aprovimin e statusit të stadiumit.

Në lidhje me këtë çështje të trajtuar dhe në Projekt Raportin e Auditimit është dërguar nga titullarja e IMK (njëkohësisht mbajtëse e detyrës së Sekretares së KKR) znj. A D observacioni me shkresën nr.1970/1 prot. datë 23.12.2016, ku cilësohet fakti se

Këshilli shkencor (KSH) i IMK nuk ka bërë ndonjë mbledhje të posaçme ku të jetë diskutuar e vendosur për qëndrimin që do të mbante për këtë çështje duke ja parashtruar KKR. Në momentin kur ky projekt do diskutohej në Këshillin Shkencor, nga Kryetari i këtij Këshilli u propozua që të shqyrtohej në një tryezë të përbashkët ndërmjet KSH dhe KKR. Observuesja citon se: *Procesverbali i mbledhjes së KSH dt.25.5.2016 është nënshkruar rregullisht nga anëtarët e pranishëm, fakt ky që tregon dakortësinë dhe prezencën e tyre në mbledhjen e KKR, pasi menjëherë pas përfundimit të mbledhjes së KSH filloj mbledhja e KKR. Mbledhja u zhvillua në të njëjtën sallë, dhe anëtarët e KSH nuk janë larguar nga salla. Nëse do të ishte propozim dhe do të ishte vendosur e kundërta në një hipotezë atëherë mbledhja e KKR nuk mund të zhvillohej.*

Gjithashtu ajo sjell në vëmendje pjesë të procesverbalit të mbledhjes në KKR, kështu

4.Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, dt.25.5.2016 ora 12.30, filloi me diskutimin e këtij projekti.

5.Anëtarët e KSh,kanë qenë të pranishëm në këtë mbledhje dhe nuk janë shprehur me ndonjë opinion në lidhje me këtë çështje.

6.Procesverbali i kësaj mbledhjeje është nënshkruar rregullisht nga anëtarët e pranishëm të KKR, në mbështetje të nenit 10 të Rregullore së KKR.

Duke cilësuar gjithashtu se; *Nënshkrimi i këtij akti vetëm nga anëtarët e KKR nuk lidhet me faktin se anëtarët e KSH nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen e përbashkët, por lidhet me faktin se nuk legjitimohen për të nënshkruar këtë akt, pasi këtë detyrim e kanë vetëm anëtarët e KKR, që kanë të drejtë vote në këtë vendimmarrje.*

Pra, theksojmë se jemi duke referuar të njëjtin fakt, mos bërja e një shqyrtimi në një mbledhje nga anëtarët e KSh të kësaj çështjeje ka bërë që Këshilli Shkencor, **i quajtur jo rastësisht kështu**, nuk ka patur asnjë mundësi për të shprehur e votuar me përgjegjshmëri qëndrimin shkencor. Pjesëmarrja ose jo në një mbledhje të KKR kur nuk kanë as të drejtë votimi pasi nuk legjitimohen nuk i ngarkon ata (anëtarët e Këshillit) me asnjë përgjegjësi administrative.

Në vijim të observimeve cilësojmë *“Në Vendimin nr.127 dt. 25.5.2016 të KKR, është vendosur se duhet të ruhet vetëm fasada kryesore (përfundimtare) me statusin monument kulture i kategorisë së II-të.”*, pra vendimi mban datën 25.05.2016, ndërkohë që në vijim të observimeve referojmë

Ndërsa sipas paragrafëve 9; 10; 11 dhe 12 citohet:

9. Në vijim të mbledhjes së KKR të lartë përmendur, në mbledhjen e zhvilluar në datë 01.07.2016, u diskutua mbi projektin përfundimtar të Stadiumit “Q S”

10. Me Urdhër të posaçëm të Ministrit të Kulturës, (në cilësinë e Kryetarit të KKR) është kërkuar të ish-in të pranishëm edhe anëtarët të KSH, pa të drejtë vote.

11. Në këtë rast, procesverbali i mbledhjes është nënshkruar rregullisht nga të gjithë anëtarët, përfshirë edhe anëtarët e KSH të caktuar me urdhër të posaçëm.

12. Kjo mbledhje është zgjedhur të zhvillohet në ambientet e Stadiumit për të parë më nga afër gjendjen e degraduar të objektit.

Konstatohet thjeshtë se: **Vendimi është marrë më datë 25.05.2016** nga KKR dhe se me Urdhër të posaçëm të Ministrit të Kulturës, (në cilësinë e Kryetarit të KKR) është kërkuar të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

ishin të pranishëm **në mbledhjen vijuese të datës 01.07.2016 edhe anëtarë të KSh, pa të drejtë vote.**

Pra mund të themi se në fakt Këshilli Shkencor nuk ka ekzistuar si një strukturë për të diskutuar e marrë vendim në mënyrë të pavarur e në mënyrë të përgjegjshme për këtë çështje. Për këtë Vendimmarrje ngarkohen me përgjegjësi znj. A D në cilësinë e Drejtores së Përgjithshme të IMK dhe në cilësinë e Sekretares së Këshillit Kombëtar të Restaurimeve të cilët kanë qenë dhe objekt auditimi, por pa anashkaluar përgjegjësinë që vazhdon vertikalisht me Ministrin e Kulturës që është njëkohësisht dhe Kryetar i KKR vetë KKR.

Rezultati është i thjeshtë funksionet institucionale nuk janë përmbushur, dhe ndodhemi përpara institucioneve të dobëta dhe drejtuesisht akoma më të dobët si profesionalisht dhe institucionalisht, vendimmarrjet e të cilëve janë si fasadë e veprimeve të institucioneve (strukturave) që nuk kanë kapacitetet dhe njohuritë për vendimmarrje që prekin trashëgiminë kulturore dhe memorijen historike të shqiptarëve. Gjuha e drejtpërdrejtë e përdorur në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH konsiderohet nga ana e saj si një mjet shtesë me qëllim kërkimin e ndryshimit të gjendjes në këto institucione dhe jo vetëm konstatimin e saj (gjendjes). *Trajtuar më hollësisht në faqen 92-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj: Këshilli Shkencor të ushtrojë funksionet për të cilën është krijuar duke shërbyer si oponentë e fortë për të gjitha institucionet të cilat me vendimmarrjet e tyre afatshkurtra prekin rëndë memorien kombëtare dhe ndikojnë në shkatërrimin e trashëgimisë kulturore. Vlerat dhe ndjenja kombëtare duhet të jetë gjuha me të cilën duhet të flas ky institucion i rëndësishëm. Transparenca e misionit të këtij këshilli do shtojë vetëm vlerë dhe do rrisë përgjegjshmërinë institucionale dhe shtetërore në këtë drejtim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Situata e zbatimit të rekomandimit : Këshilli shkencor, i cili ka funksionuar deri në muajin dhjetor 2019 ka vepruar duke respektuar Rregulloren e funksionimit të tij, sipas parashikimeve të nenit 12-13 të Statutit të IMK, miratuar me Urdhrin Nr. 9 dt. 23.01.2017 të Ministrisë të Kulturës. Ky rekomandim është paraqitur në çdo plan vjetor veprimi të Institucionit.

Gjetja 3. Gjatë auditimit të procesit të inventarizimit u konstatua se Qendra Rajonale e Restaurimit me urdhër në 2013 i ka kalur në organikë IMK, situatë që nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të 2013, 2014 dhe 2015. Gjatë 2015 institucioni ka marrë masa për vlerësimin e aktiveve në përbërje të kësaj strukture që më parë kishte funksionuar si një njësi më vete me kontabilitet të veçantë, por nuk u konstatua të jenë bërë veprimet e regjistrimit të inventarit dhe konvertimi në monedhën vendase duke mos reflektuar shtesat e inventarit. Mos inventarizimi në kohë ka sjellë problematikën e mosevidentimit të përgjegjësive në lidhje me këto aktive dhe mos kryerjen e inventarizimeve për të mbrojtur aktivet nga risqet potencialë. Urdhri fillestar për inventarizimin si pasojë e kalimit në përgjegjësi të IMK është në 26.12.2014. Ky urdhër rezulton të jetë zbatuar nga komisioni duke rezultuar me diferenca gjatë inventarizimit për marrjen në dorëzim për vlerën 5606 Euro (krahasimi i vlerave sipas faturave me gjendjen fizike), në mungesë të një regjistri kontabël për aktivet e marra në dorëzim. Nga auditimi konkludojmë që nuk është bërë hyrje i gjithë inventari i marrë në dorëzim në fund të vitit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku përcaktohet përgjegjësia për paraqitjen inventarizim e pasurisë së institucioneve publike. *Trajtuar më hollësisht në faqen 75-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Për sa më sipër rekomandoj: Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për të saktësuar vlerën e aktiveve, duke përfshirë në pasqyrat financiare të vitit 2016 vlerën e aktiveve të cilat kanë kaluar në pronësi të tij. Të regjistrohen të gjitha aktivet duke pasqyruar si koston historike dhe amortizimin e akumuluar për rastet kur klasifikohen si aktive afatgjata.

Në pasqyrat financiare të datës 31.12.2016

Situata e zbatimit të rekomandimit :Me Urdhërin e Titullarit Nr.2099Prot, datë 22.12.2016 është ngritur Komisioni i Inventarizimit, të Vlerave Materiale, në lidhje me përcaktimin e vlerave të aktiveve dhe janë paraqitur në pronësi të IMK, në pasqyrat financiare të datës 31.12.2016.

Gjetje 4.Gjatë auditimit të mbajtjes së kontabilitetit u konstatua se mbajtja e regjistrimeve është jo e rregullt dhe programi përdoret vetëm për disa transaksione, ndërsa transaksionet e tjera mbahen (regjistrohen) në mënyrë manuale. Gjithashtu janë konstatuar probleme të shumta në lidhje me ngritjen e sistemit të kontabilitetit duke filluar që nga procesi i regjistrimit të veprimeve kontabël, mbartja në librat e llogarive dhe deri te kryerja e veprimeve rregulluese në fund të vitit (situatë e verifikuar si për vitin 2014 dhe vitin 2015). Konstatuam se gjendja e llogarive paraqitur në pasqyrat financiare të raportuara dhe atyre në programin e kontabilitetit të aplikuar, kishte diferenca në disa llogari. Në shumë raste shtesat apo pakësimet e aktiveve nuk reflektohen në pasqyrën e ndryshimeve të Aktiveve të Qendrushme dhe në pasqyrën e shpenzimeve të lidhura me investimet, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Kujdesi në mbylljen e llogarive vjetore do të shmangte mungesën e informacionit në kohë reale dhe nga ana tjetër do të përmirësonte konsistencën dhe krahasueshmërinë e tij. *Trajtuar më hollësisht në faqen 35-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:Sektor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të shmangë mbajtjen e regjistrimeve jashtë këtij programi dhe mbylljen e llogarive vjetore në mënyrë ekstrakontabël, pra jashtë sistemit të informatizuar të kontabilitetit. Veprimet të mbahen sipas ciklit të plotë kontabël duke filluar që me identifikimin e transaksionit, regjistrimin në ditar, mbartjen në librin e madh dhe kryerjen e veprimeve rregulluese e mbyllëse në fund të vitit.

Menjëherë

Situata e zbatimit të rekomandimit :Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2017 është bërë në mbështetje të nenit 104, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 62 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 6 I Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe në vijim të pikës 260 të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarte të Zbatimit të Buxhetit” si dhe Udhëzimi Nr.23, datë 22.12.2017 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2017”, si dhe për mbylljen e pasqyrave financiare për vitin 2018 është zbatuar edhe Udhëzimi Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Gjetje 5.Gjatë auditimit të zonave të llogarive u konstatua se në vitin 2015 është bërë hyrje një automjet nga Ministria e Kulturës me vlerën 1 lekë. Instituti i Monumenteve të Kulturës ka marrë masat për përcaktimin e vlerës së tij nëpërmjet vlerësimit të jashtëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe vlera është caktuar në 600,000 lekë. Gjatë periudhës së auditimit u evidentua që nuk ishin reflektuar ende ndryshimet në kontabilitet në lidhje me pasqyrimin e vlerës reale në datën e vlerësimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në lidhje me automjetin, duke ndikuar në fillimin e amortizimit të tij, në kundërshtim me VKM Nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”.Nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

auditimi i llogarive të aktiveve të qëndrueshme u konstatua se trajtimi kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimit të makinave është në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14 datë 28/12/2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qëndrore, organet e pushtetit vendor, dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, pasi është debituar llogaria e grantit kapital të brendshëm në natyrë, gjithashtu nuk është pakësuar fondi bazë në fund të vitit në lidhje me këtë transaksion. *Trajtuar më hollësisht në faqen 41-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të regjistrojë artikujt kontabël korrigjues për të shmangur efektin e llogarisë negative në sistemin e kontabilitetit të informatizuar. Rregullimet dhe sistemit kontabël të bëhen në retrospektivë, në momentin më të hershëm të lëvizjes së aktiveve. Të përmirësohet procesi i veprimeve të mbylljes së pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kërkesat e udhëzimit të paraqitur më sipër.Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që të bëjë saktësimin e vlerës së automjetit nëpërmjet shtimit të vlerës së tij për diferencën e vlerësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me datë transaksioni atë të vlerësimit të pavarur.

Në pasqyrat financiare të datës 31.12.2016

Situata e zbatimit të rekomandimit: **Llogaria 215** “Mjete Transportit” është rritur për diferencën në vlerën prej 599.999 lekë nga rivlersimi mbi saktësimin e vlerës së automjetit, nëpërmjet shtimit të vlerës për diferencë, sipas vlerësimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për automjetin tip furgon Benz me targë [REDAKTUAR] U. Kjo është reflektuar në pasqyrat financiare të datës 31.12.2016.

Gjetje 6.Nga auditimi i aktiveve të qëndrueshme u konstatua se në vitin 2014 vlera e ndërtesave është rritur me 7,152,144 lekë, shtesë që vjen si pasojë e përfundimit të procesit të investimit kapital të nisur në vitet e mëparshme (ndërrhyrja dhe restaurimi i ambjentëve të ushtrimit të veprimtarisë së institucionit). Regjistrimi i shtesës në vitin 2014, ndërkohë që referuar transaksioneve të thesarit në lidhje me çlirimin e garancisë së ndërtesës pas përfundimit të afatit të garancisë, likuidimi për shumën totale 1,039,561 lekë është bërë në vitin 2014, reflekton pasaktësi të momentit të njohjes së shtesës së aktivitetit në kontabilitet. Kjo pasaktësi kohore sjell si pasojë nënvlerësimin apo deformimin e amortizimit të këtij aktivi, si dhe bie në kundërshtim me ligjin nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2015 u konstatuan shtesa në zërin e ndërtesave dhe konstruksioneve, për të njëjtën vlerë të rritjes si edhe në vitin 2014. Në relacionin shoqëruar të pasqyrave financiare argumentimi i kësaj llogarie është i njëjtë me atë që jepet për vitin 2014, pra investimi në laboratorët e sektorit të artit. Ky fakt tregon se shtesa ishte pasojë e një gabimi gjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2015, duke evidentuar përsëri problematikën e mungesës së kujdesit në përgatitjen e tyre. *Trajtuar më hollësisht në faqen 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të pasqyrojë në kontabilitet rregullimet e nevojshme në lidhje me amortizimin e akumuluar të zërit “Ndërtesë” duke marrë si datë fillestare të hyrjes së aktivitetit datën e pagesës së situacionit përfundimtar. Të saktësohet vlera në çeljen e vitit 2016, për llogarinë “Ndërtesë”.

Në pasqyrat financiare të datës 31.12.2016

Gjetje 7.Nga auditimi i zonave të llogarive u konstatua se për vitin 2015 është kryer një pagesë prej 376,428 lekë e cila ka pakësuar vlerën e kreditorëve për mjete në ruajtje me 101,766 lekë dhe llogarinë e 231 me 274,662 lekë. Kjo është një trajtim jo i saktë kontabël, në kundërshtim me VKM Nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, sipas të cilës përcaktohet mënyra e debitimit apo kreditimit të të llogarive në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

funksion të transaskionit kontabël. Llogaria 231 nuk është e njohur në fillim të vitit në pasqyrat financiare me këtë tepricë në mënyrë që të bëhet pakësimi i saj. Nga analiza e urdhër shpenzimeve për krijimin e saj u konstatua që ajo vazhdimisht është krijuar në llogarinë 466 sipas zbritjeve në bazë të situacionit përkatës sipas secilës fazë të përmbushjes së punimeve. Për vitin 2015 vlera prej 274,662 lekë pakëson një llogari të panjohur më parë në pasqyrat financiare, atë të 231 që nuk është raportuar në pasyrat financiare. *Trajtuar më hollësisht në faqen 47-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj: Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse gjatë regjistrimit në kontabilitet të transaksioneve, të shmangë gabime në regjistrimin fillestar dhe pagesën e detyrimeve drejt të tretëve, duke klasifikuar veprimet ekonomike në llogaritë e duhura që shprehin natyrën e secilit veprim. **Në vijimësi**

Situata e zbatimit të rekomandimit :Gjatë hartimit të pasqyrave financiare të 31.12.2016 janë llogaritur amortizimet dhe Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” është sistemuar duke u korrigjuar për veprimet e kryera në mbylljen e Bilancit të Vitit 2016, për shumën 7.152.144 lekë, si dhe është llogaritur amortizimi për sistemin në shumë prej 123.196 lek, mbështetur mbi Rekomandimet e KLSH-së.

Gjetje 8. Nga analiza e shpenzimeve për energjinë sipas muajve dhe mungesës së normalitetit në shpërndarjen e tyre u evidentua që aktualisht IMK rëndohet në pagesën për këtë llogari të shpenzimeve edhe për energjinë që harxhojnë Ministria e Kulturës e institucione të tjera në varësi të MK që ushtrojnë aktivitetin në të njëjtën godinë me IMK. Mungesa e një kontrate dhe linje të veçantë bëhet shkak për mungesa në zërin e këtij shpenzimi e evidentuar edhe me rishpërndarjet e fondeve drejt kësaj llogarie për përmbushjen e këtyre detyrimeve që realisht nuk përmbajnë rezultatin nga veprimtaria e tij sipas përcaktimit klasik të shpenzimit në kontabilitet për një dalje të burimeve ekonomike që lidhen ekskluzivisht me njësinë. Kjo tregon që kjo shifër e paraqitur në pasqyrën financiare të 2015 për IMK nuk i përket këtij institucioni duke cënuar pohimin e përkatësisë. Megjithatë në pamundësi për një ndarje të energjisë së harxhuar në KËH për secilën njësi, nuk mund të saktësohet vlera e saktë e shpenzimeve për energjinë për 2015, në kundërshtim me VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël” ku përcaktohen kriteret për njohjen e shpenzimeve. *Trajtuar më hollësisht në faqen 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandojmë: Ministria e Kulturës dhe institucioni të marrin masa për të bërë ndarjen e duhur të energjisë së konsumuar duke ju drejtuar autoritetit përkatës që ka kompetencën për ndryshimin dhe bërjen të mundur të klasifikimit të sasisë së konsumuar realisht që rrjedhimisht do të pasqyrojë edhe shpenzimin real që ajo shkakton në pasyrat financiare.

Situata e zbatimit të rekomandimit ;Me shkresën Nr.108Prot, datë 20.01.2017, drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për dijeni MK-së është kërkuar ndarja e energjisë së konsumuar për llogari të IMK-së. Nga ana e Ministrisë së Kulturës u është kërkuar Institucioneve të varësisë me shkresën Nr.596, dt.03.02.2017 “Kërkesë për ndarjen e energjisë elektrike” drejtuar Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, për të marrë masat për zgjidhjen e problematikës. Me shkresën Nr.596/1, dt.06.07.17 “Kërkesë për informacion” nga MK, u është kërkuar informacion Institucioneve të mëipërm, në lidhje me këtë procedurë, ku ASHA me shkresën Nr.923, datë 10.07.17 ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me IMK. Ndërkohë Ministria e Kulturës ka çelur fondet përkatës, për IMK për të përballuar këto shpenzime të energjisë elektrike. Në lidhje me pajisjen e këtyre Institucioneve me kontratave të reja është një proces, i cili kërkon një lloj shpenzimi paraprak të konsiderueshme, e cila duke mosditur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

të saktë kohën e qendrimit të këtyre Institucioneve pranë këtyre ambjenteve është e vështirë për të realizuar. Këto kërkesa drejtuar Ministrisë së Kulturës janë ripërsëritur çdo vit.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” u bënë objekt i ristrukturimit disa institucione në varësi të Ministrisë së Kulturës.

Në mbështetje të VKM Nr. 364, datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” u krijua Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) nga bashkimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

Funksionet dhe kompetencat e tyre i kanë kaluar Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore në zbatim të shkresës së Ministrisë së Kulturës me Nr 6407 Prot., datë 29.10.2019 “Për njohje dhe zbatim” të Urdhërit të Kryeministrit Nr.137 datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”.

Gjetje 9.Gjatë auditimit të zonave të llogarive në pasqyrën e shpenzimeve për vitin 2014, u konstatua që në llogarinë 604 është paraqitur vlera prej 3,411,674 lekë dhe nuk ka një bazë dokumentare për provueshmërinë e ekzistencës së saj, referuar edhe situacionit të rakordimit me Degën e Thesarit për vitin 2014, ndërkohë që në akt rakordimin me thesarin në fund të vitit kjo shumë nuk paraqitet e çelur në llogarinë 604. Nga auditimi i zonave të llogarive u konstatua se në vitin 2015 investimet e realizuara nga institucioni përsa i përket krijimit të hartës elektronike të monumenteve në kuadër të EëbGis janë kaluar në shpenzim në formën e transferimit të njesitë e tjera qeverisëse (604). Ky është një trajtim kontabël i gabuar nga ana e institucionit pasi e trajton transaksionin si një tranferim drejt të tretëve dhe që reflektohet në grupin e llogarive 604 në pasqyrën e performancës financiare. Projektet e ndërtimit të hartave të informatizuara dhe projektimi elektronik janë dy investime të realizuara nga institucioni që i shërbejnë qëllimit të ekzistencës së tij dhe në periudhë afatgjatë, pra nuk është një shpenzim që i shërben aktivitetit vetëm të vitit 2015. Referuar edhe IPSAS për aktivet jomateriale në pronësi të enteve publike kategorizimi i këtyre investimeve duhet të bëhet në pasqyrën e pozicionit financiar në grupin e AQ të patrupëzuara dhe nuk do të amortizohen e do të klasifikohen si AQ të patrupëzuara me jetë të pafundme. Kjo sepse me kalimin e kohës nuk pritet konsumimi i këtyre aseteve të cilat janë në format elektronik. Në akt rakordimin me thesarin në fund të vitit kjo shumë paraqitet e çelur në 604 sipas klasifikimit nga MK. Konstatimi i mësipërm është mbështetur në VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël” dhe VKM nr.248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr.248, datë 10.04.1998”. Projekti i parë është financuar me fonde nga ana e buxhetit të shtetit ndërkohë që projekti i dytë në formën e një granti rrjedhës të huaj nga UNESCO. *Trajtuar më hollësisht në faqen 52-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të bëjë sistemimet përkatëse duke hequr në pasqyrën e shpenzimeve sipas formatit 3/1 vlerën e paraqitur që nuk rezulton si shpenzim në këtë llogari referuar aktrakordimit të thesarit.Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të pasqyrojë të dy këto projekte në pasqyrat financiare në llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara. Gjithashtu në të ardhmen të mos përdoren llogari të rezultatit për të realizuar investimet dhe të tregohet kujdes që në klasifikimin e fondeve të kërkuara në fillim të viti.Në **pasqyrat financiare të datës 31.12.2016.**

Situata e zbatimit të rekomandimit ;Në mbylljen e pasqyrave financiare të datës 31.12.2016 llogaritë e aktiveve të qëndrueshme kanë pësuar ndryshime dhe janë marrë parasysh Rekomandimet e KLSH dhe kanë pësuar rritje si mëposhtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 2.400.000lekë, “Rindërtim arkeologjik 3-D i Teatrit Tomak të Qytetit Antik të Butrintit pasuri Botërore e UNESCO-s”, me fonde të siguruar nga UNESCO, mbështetur mbi Rekomandimet e KLSH-së, sipas Gjetjes Nr.9.
- Llogaria 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera të ngjashme” në vlerën 4.056.000lekë, shërbimi me objekt “Inventarizimi dhe hartëzimi i Monumenteve të Kulturës në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet hartës GIS”, mbështetur mbi Rekomandimet e KLSH-së, sipas Gjetjes Nr.9.

Gjetje 10.Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se vlera e kreditorëve të ndryshëm në 2014 është pakësuar për 5,214,954 lekë ndërkohë që pagesa është reflektuar si shpenzim në shpenzimet e vitit 2014, duke ndikuar rezultatin ekonomik. Gjatë auditimit janë konstatuar pagesa në llogarinë e shpenzimeve për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna në vlerën 6,159,052 lekë nga të cilat 1,173,049 lekë janë për procesin gjyqësor në lidhje me një shoqëri tregtare dhe pjesa tjetër prej 4,986,003 lekë janë për vendime gjyqësore për largim nga puna të viteve të 2009-2012 mbi bazën e urdhrave për ekzekutim të detyrueshëm të përmbaruesve. Shpenzimi në lidhje me këtë transaksion në bazë të kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara është njohur në periudhat e mëparshme duke qenë se kreditorët janë të evidentuar në pasqyrën e pozicionit financiar ndërkohë që në këtë periudhë është duke u ekzekutuar vetëm pagesa, veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr.9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet se njohja e shpenzimeve buxhetore dhe kapitale ndodh në vitin buxhetor pavarësisht nga data e pagesës së tyre. *Trajtuar më hollësisht në faqen 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:Nga sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të realizohet ndarja e qartë në trajtimin e kontabilitetit me bazë monetare dhe atij të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara gjatë regjistrimit të transaksioneve kontabël. **Në vijimësi** *Situata e zbatimit të rekomandimit:* Në mbylljen e pasqyrave financiare është realizuar paraqitja e detyrimeve, duke kryer ndarjen e qartë në trajtimin e kontabilitetit me bazë monetare dhe atij të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara gjatë regjistrimit të transaksioneve kontabël.

Gjetje 11.Gjatë auditimit u konstatua që IMK nuk ka një regjistër të aktiveve që ka në zotërim. Mungesa e këtij regjistri është në kundërshtim me udhëzimin nr.30 të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 e tij. Aktivitet sipas llogarive përkatëse afatgjata dhe afatshkurtra janë të evidentuara në kartelat e punonjësve për asetet që u janë shpërndarë atyre ku në çdo rast është saktësuar përgjegjësi material. *Trajtuar më hollësisht në faqen 72-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:Strukturat drejtuese dhe menaxhuese të institucionit të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve duke shfrytëzuar informacionin e marrë nga fletëhyrjet e magazinës për ato aktive të cilat i përkasin periudhave të mëparshme. **Menjëherë** *Situata e zbatimit të rekomandimit* ;Strukturat drejtuese dhe menaxhuese të institucionit kanë marrë masat për hartimin e regjistrit të aktiveve duke shfrytëzuar informacionin e marrë nga fletëhyrjet e magazinës për ato aktive të cilat i përkasin periudhave të mëparshme.

Gjetje 12.Nga auditimi i realizimit të procesit të inventarizimit është konstatuar se analiza e fletëve të inventarizimit për 2014 dhe 2015 dhe krahasimi në lidhje me gjendjen e llogarive në kontabilitet reflektojnë mungesa në shumën 79,050 lekë për objektet e inventarit në vitin 2014 dhe në vitin 2015 në shumën 67,348 lekë në po të njëjtën llogari, për të cilat institucioni nuk ka nxjerrë përgjegjësinë materiale. Këto mungesa janë përgjegjësi e nënpunësit zbatues i ngarkuar për hartimin e listës së aktiveve për inventarizim.

Gjatë auditimit të procesit të inventarizimit janë evidentuar shtesa të bibliotekës në krahasim me inventarizimin e vitit 2015, shtesë që reflekton diferencën midis librave që mungojnë dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

atyre të rifutur në inventarin e bibliotekës sipas regjistrimit themeltar, në shumën 110,631 lekë, kjo praktikë bie në kundërshti me kërkesat e udhëzimit nr. 30, të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” referuar diferencave që rezultojnë gjatë procesit të inventarizimit fizik.

Rezultoi se librat që zotëron njësi publike janë në inventar të bibliotekës, por nga ana kontabile janë të regjistruara në 3 llogari të ndryshme, konkretisht në llogaritë 312, 327, dhe 218. Referuar parimeve bazë të kontabilitetit në lidhje me klasifikimin e elementëve në pasyrat financiare, standarteve kombëtare të kontabilitetit dhe praktikës më të mirë ndërkombëtare sipas IPSAS, librat dhe publikimet profesionale e përshkruar edhe sipas planit tonë publik kontabël, janë të klasifikuara në grupin e inventarëve, përveç atyre librave të cilat janë në bibliotekë dhe që priten të përdoren në më shumë se një periudhë. Pra trajtimi kontabël për librat të cilat institucioni ka në bibliotekë duhet të jetë në një llogari analitike të 218, ndërkohë që për ato materiale të publikuara për shpërndarjen dhe promovimin e punës së institucionit, të tilla si revistat, klasifikimi kontabël duhet të jetë në formën e një llogarie të inventarit, pra llogarinë 312, kjo sipas kuadrit konceptual për përgatitjen e pasqyrave financiare, Standarti Kombëtar i Kontabilitetit 5, IPSAS 17. *Trajtuar më hollësisht në faqen 73-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.* **Për sa më sipër rekomandoj:** Nga sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të bëhen rakordimet dhe sistemimet e nevojshme në mënyrë që inventarizimi fizik të jetë në përputhje me kërkesat ligjore. Rregullimet të bëhen në llogarinë e ndryshimit të gjendjes dhe në këtë mënyrë të pasqyrohen në llogarinë e materialeve në të cilën janë identifikuar problematikat.

Nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse gjatë inventarizimit të vitit 2016 për mbylljen e pasqyrave financiare të këtij viti, të bëhen rregullimet për shtesën në regjistrin e bibliotekës të librave dhe të eliminohen vlerat e paraqitura në kontabilitet të monedhave të huaja apo librat me vlerë zero. Për librat e rifutur në inventar të përcaktohet vlera në bazë të fletëhyrjeve. **Në pasqyrat financiare të datës 31.12.2016** Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa të klasifikojë të gjitha librat si AAGJ në llogarinë 218 duke shmangur keqinterpretimet dhe shpërndarjet në llogari të ndryshme për shkak të klasifikimit buxhetor.

Situata e zbatimit të rekomandimit: Në mbylljen e pasqyrave financiare të datës 31.12.2016, janë pasqyruar rritje në Llogarinë 218 “Inventari ekonomik”, në vlerat:

- 138.640 lekë nga kontabilizimi dhe vlersimi i librave të bëra hyrje në Bibliotekën e IMK-së nga Donator të ndryshëm, ndër vite, sipas Gjetjes Nr.12.
- 102.459 lekë nga kontabilizimi i riklasifikuar i librave të blera në vitin 2015, sipas Gjetjes Nr.12.

Gjetje 13. Gjatë auditimit të inventarëve u konstatua mos evidentim i mungesave në inventar për aktivet e pa dorëzuar nga dy punonjës të larguar të cilët kanë pasur në zotërim aktive në vlerën prej 99,023 lekë dhe 549,717 lekë. Ky konstatim i takon ngjarjeve përpara periudhës së auditimit, por nga institucioni gjatë inventarizimeve të 2014 dhe 2015 nuk janë marrë masa për pasqyrimin e kësaj ngjarje ekonomike në pasqyrat financiare. Në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor, dhe njësi që varen prej tyre si dhe të njësi të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, si dhe Udhëzimin nr.30 të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” trajtohen hapat për sistemimin e diferencave dhe evidentimin e përgjegjësive në rastin e mungesave. Mos evidentimi si debitorë ka sjellë mungesë veprimi nga ana e sektorit juridik të hapave të mëtejshëm ligjorë për arkëtimin e tyre ose kthimin e aktiveve. *Trajtuar më hollësisht në faqen 75-76 të Raportit*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Përfundimtar të Auditimit. Për sa më sipër rekomandoj: Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse gjatë hartimit të pasyrave financiare të vitit 2016 të evidentojë këto punonjës si debitorë dhe të çregjistrohen aktivet që ato kanë pasur në ngarkim duke qenë se ato nuk janë realisht më në institucion. Sektori juridik të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë duke nxjerrë titujt ekzekutiv që rrjedhin nga mungesa e inventarit dhe të arkëtojnë shumat përkatëse.

Në pasqyrat financiare të datës 31.12.2016

Situata e zbatimit të rekomandimit ; Në vijim të masave të marra janë kryer njoftimet për personat të cilët janë larguar pa kryer dorëzimet paraprake dhe për të cilat janë mbajtur librezat. Në mbështetje të njoftimeve të kryera përkatësisht me shkresën Nr.175.Prot datë 30.01.17, për z.A N dhe shkresën Nr.175/1Prot, datë 30.01.17, për z.Z M, është mundësuar kontaktimi me personat debitorë, të cilët janë paraqitur për të kryer procedurat përkatëse. Këta persona kanë dorëzuar materialet në ngarkim pranë IMK-së.

Gjetje 14. Nga auditimi konstatohet se menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Institutin e Monumenteve të Kulturës nuk ka funksionuar, pasi ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, ndërsa punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit **nuk kanë mundur të bëjnë** siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion. Nga auditimi mbi vlerësimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se institucioni prej vitit 2014 e në vijim ushtron aktivitetin e tij mbështetur mbi një bazë ligjore të pamiruar. Vlen të theksohet se janë marr masa për shmangien e këtij problemi nga ana e institucionit duke i dërguar kërkesën për miratim të saj Ministrisë së linjës por ende nuk ka ndryshim në gjendje dhe vazhdohet të operohet mbi dokumenta që nuk gëzojnë të drejtën e të qënurit zyrtar. Grupi i auditimit konstatoi se për vitin 2014 dhe 2015, IMK nuk ka depozituar asnjë deklaratë apo raporti vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm së bashku me pyetëtorin e vetëvlerësimit në kundërshtim me aktin ligjor të lartpërmendur.

Po ashtu u konstatua se lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, **nuk kanë rregulla të brendshme** të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre dhe së dyti në lidhje me trajnimet nga ana e institucionit u vu re se nuk kishte një plan vjetor, por bashkëpunohet me ASPA-n për tu trajnuar në fushat e kompetencave të tyre si dhe në bazë të nevojave specifike të institucionit. Gjithashtu u konstatua se sektori i financës mban një pjesë të llogarive në mënyrë manuale dhe pjesën tjetër me anë të programit, sepse stafi nuk ishte plotësisht i trajnuar për përdorimin e tij. *Trajtuar më hollësisht në faqen 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.* **Për sa më sipër rekomandoj:** Titullari i institucionit, për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Nga ana e IMK të bashkëpunohet me Ministrinë e linjës në mënyrë që të përshpejtohen procedurat për miratimin e draft rregullores duke qenë se çdo veprim juridik me këtë rregullore është nul. Titullari i institucionit të marrë masa për hartimin e deklaratës mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për aktivitetin e IMK, dhe depozitim në Ministrinë e Financës në përputhje me neni 18 i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar citon se “Nëpunësi autorizues i cdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”. **Menjëherë**

Situata e zbatimit të rekomandimit :Statuti i IMK-së është miratuar me *Urdhërin e Ministres së Kulturës Nr.9, datë 23.01.2017.*

Rregullorja e Brendshme e IMK-së është miratuar me *Urdhërin Nr.128, datë 24.01.2017.*

Në lidhje me menaxhimi e riskut, për vitet 2017, 2018 dhe 2019 me Urdhërin Titullari është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili ka miratuar Rregjistrin e Riskut dhe Planin e Veprimit.

Në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Kulturës, mbi plotësimin e pyetësorit të vetëvlersimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar, kemi dërguar “Pyetësorin e vetëvlersimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Deklaratën e cilësisë, Raportin vjetor dhe Planin e Veprimit për Institutin e Monumenteve të Kulturës”.

Nga ana e IMK të marren masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Gjithashtu duke patur parasysh natyrën specifike të punës që kryhet prej IMK-së rekomandohet hartimi i një plani trajnimesh mbi baza të nevojave prioritare të institucionit, me qëllim ngritjen profesionale të kuadrit egzistues dhe sidomos në ato fusha që janë me karakter tepër delikat dhe të veçantë. **Në vijimësi**

Situata e zbatimit të rekomandimit :Në lidhje me trajnimet për stafin, nga ana e IMK-së në pamundësi për të organizuar dhe mbështetur trajnimet i kemi kërkuar Ministrisë së Kulturës, si Institucion Qendror, shkresa me lëndën “Kërkesë për trajnime”. Nga ana e MK na janë ofruar informacion mbi trajnimet e ndryshme të ofruara kryesisht nga ASPA dhe janë përcaktuar punonjësit, të cilët do të marrin pjesë në këto trajnime. Gjithashtu janë realizuar aplikime të ndryshme për projekte në lidhje me rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, nga “Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim për Evropën Jug-Lindore” pranë IMK-së.

Gjatë vitit 2017 është realizuar kursit i trajnimit kombëtare mbi forcimin e kapaciteteve në fushën e trashëgimisë kulturore me temë “**Analizë Strukturore dhe Metoda Përforcuese si dhe Teknika të Muraturave në Ndërtesat Historike**”, të sponsorizuar nga UNESCO dhe të organizuar nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me IMK, të koordinuar nga “Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim për Evropën Jug-Lindore”, për periudhën 30 Shtator,2017 – 10 Nëntor,2017.Gjatë vitit 2018 është realizuar "Kursit i trajnimit rajonal mbi ndërhyrje emergjente në trashëgiminë kulturore në rrezik" - "Regional training course on emergency response to cultural heritage at risk E - 2018", organizuar nga IMK dhe bashkëfinancuar nga UNESCO dhe Ministria e Kulturës, në kuadër të Asistencës Ndërkombëtare të miratuar Nr.2890, Gjirokastrë 4-15 korrik, 2018. Projekti i cili përfshiu 15 pjesëmarrës nga Shqipëria dhe rajoni i Evropës Juglindore të certifikuar. Projekti ishte i certifikuar në kuadër të Vitit Evropian për trashëgiminë kulturore - EYCH 2018.Vazhdojnë aplikime të ndryshme nga “Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim për Evropën Jug-Lindore”, pranë IMK-së. Këto aplikime pranë UNESCO-s, për projekte fokusohen në lidhje me rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Gjetje 15.Nga auditimi është konstatuar se në këtë institucion mungon regjistri dhe strategjia e risqeve në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke mos evidentuar kështu risqet që që vënë në rrezik arritjen e objektivave të përcaktuara për këtë njësi të qeverisjes publike pra nuk është hartuar një



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

regjistër i identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi. Mungesa e regjistrit dhe strategjisë së rrisqeve, siç dhe është sipërcituar, rrishton të pengoj arritjen e objektivave të përcaktuara për njësinë dhe për pasojë mos realizimin e veprimeve të duhura dhe në kohën e duhur për minimizimin e tyre. Ndërgjegjësimi në lidhje me menaxhimin e riskut është i ulët për sa kohë ende institucioni nuk e ka të miratuar strategjinë. Po ashtu kjo sjell një mungesë koordinimi të përgjithshëm institucional në lidhje me problematikën e rrisqeve, shtuar me faktin që kjo praktikë është në kundërshtim me Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” specifikisht nenin 21 të tij. *Trajtuar më hollësisht në faqen 62-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.* **Për sa më sipër rekomandoj:** Nevojitet ndërtimi i një regjistri risku, i cili të përmbajë listën e monumenteve më të rrezikuara, si dhe të azhurnojë atë në vazhdimësi, pas çdo ndërhyrje. Institucionit i nevojiten trajnime në fushën e menaxhimit të riskut. Për sa lart IMK duhet të përcaktojë qartë një sistem menaxhimi për monumentet, të cilit t’i përmbahet me rigorozitet, sipas rradhës: Identifikimi, Planifikimi, Menaxhimi, Monitorimi dhe Raportimi. Kjo rradhë, të shoqërohet me plane strategjike, identifikim prioritetesh dhe përcaktim të qartë objektivash. Gjithashtu, të merren masa që IMK të planifikojë një hartë risku, e cila të përmbajë listën e monumenteve më të rrezikuara, si dhe ta përditësojë atë në vazhdimësi, pas çdo ndërhyrjeje. **Menjëherë**

Situata e zbatimit të rekomandimit: IMK ka ndërtuar hartën e riskut të monumenteve mbi bazën e të cilës organizon politikën e veprimtrisë së institucionit dhe përcakton prioritetet për planifikimin e projekteve që do të hartohen. Lista e riskut është ndërtuar mbi bazën e të dhënave të marra nga Drejtoritë Rajonale, inspektimet e vazhdueshme të stafit të IMK në objektet me status monument kulture që sipas raportimit të DRKK janë në gjendje më të rrezikuara. Siapis prioritetëve të përcaktuara nga harta e riskut IMK (sot IKTK) harton projektet e restaurimit, konsolidimit dhe konservimit të monumenteve dhe i bën kërkesë MK apo donatorëve të ndryshëm me të cilët bashkëpunon për financim. Harta e riskut azhurnohet në vazhdimësi objekte të cilave u është hartuar projekti dhe janë gati për financim apo me objektet që janë financuar realisht dhe kanë dalë nga risku. Ndërkohë harta shtohet me objekte që evidentohen si objektet të rrezikuara për arsye madhore.

Gjetje 16. Nga auditimi i kryer pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës u konstatua se, institucioni nuk ka Plan Strategjik dhe as Plan Veprimi për vitet 2014-2016 dhe po ashtu nuk ka gjurmë nëpërmjet urdhrave të brendshëm të miratimit të këtyre dy dokumenteve strategjike. Funkcioni parësor i IMK, ka të bëjë me evidentimin, gjurmimin, studimin, konservimin, dhe restaurimin e veprave të artit dhe monumenteve të tjera të TK, *por mungesa e planit strategjik institucional* bën që të mos ketë një identifikim prioritetesh dhe përcaktim të qartë objektivash, por të pritët indicie prej DRKK (Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare) për të nis veprimin IMK. *Trajtuar më hollësisht në faqen 59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.* **Për sa më në sipër rekomandoj:** IMK duhet të marrë masa në mënyrë që të përcaktojë qartë një sistem menaxhimi për monumentet, të cilit t’i përmbahet me rigorozitet, sipas rradhës: Identifikimi, Planifikimi, Menaxhimi, Monitorimi dhe Raportimi. Kjo rradhë, të shoqërohet me plane strategjike, identifikim prioritetesh dhe përcaktim të qartë objektivash. Gjithashtu, të merren masa që IMK të planifikojë një hartë risku, e cila të përmbajë listën e monumenteve më të rrezikuara, si dhe ta përditësojë atë në vazhdimësi, pas çdo ndërhyrjeje. **Në vijimësi**

Situata e zbatimit të rekomandimit: IMK (IKTK) ka të përcaktuar qartë në funksionin e vet sistemin e menaxhimit të punës në lidhje me monumentet, që fillon me identifikimin e monumenteve, azhurnimin e hartës së riskut, hartimin mbi këtë bazë të planeve strategjike të veprimit afatgjatë apo afat shkurtër sipas prioritetëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Gjetje 17. Nuk janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emërtuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësi, nuk janë identifikuar me emërtimin “Lista e proceseve të punës”, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme, por në shpjegimet e pyetësorit të vlerësimit është cilësuar “Masat për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm do të jenë objekt për periudhën në vazhdim, duke rishikuar strukturën shtimin e stafit etj”. *Trajtuar më hollësisht në faqen 63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj: Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

Situata e zbatimit të rekomandimit: Janë hartuar dhe miratuar “Lista e proceseve të punës”, që nevojiten për arritjen e objektivave, sipas detyrave funksionale të sektorëve të ndryshëm.

Gjetje 18. Në procedurën e prokurimit “Rindërtim arkeologjik 3-D i Teatrit Tomak të Qytetit Antik të Butrintit pasuri Botërore e UNESCO-s” u konstatua se sipas kërkesave të grupit të punës për specifikimet teknike dhe termat e referencës janë përcaktuar kriteret e veçanta në dokumentet standarde të tenderit, ku është kërkuar në pikën 2.3.c. Kriteret e veçanta-Licenca profesionale e shoqërisë për projektim në kategoritë: 2d (projektim pejzazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberuara, lulishte e parqe)

Duke konsideruar specifikimet teknike dhe termat e referencës të hartuara nga grupi i punës ku kërkohet b) rievim topografik, c) përpunim grafik 2d dhe 3d, e) krijimi i skenës për animacion, nga auditimi konstatohet se, kriteri në DST për licencë profesionale “2d” për projektim pejzazhi dhe sipërfaqe të gjelbërta, nuk ka asnjë lidhje me kërkesat e grupit të punës për shërbimet e kërkuara. Këto punime-shërbime mund të ishin përfshirë në kategoritë e projektimit “2a” (projektim arkitektonik) dhe “8a” Bazamente gjeodezike – rievime në të gjitha shkallët dhe 8.b Projektim fotogrametrik – hartografik – topografik të përcaktuara sipas VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit projektimit...”, licenca që nuk rezultojnë të vendosura në DST. Vlen të theksohet se rievimi topografik i terrenit-objekteve dhe pasqyrimi i gjithë informacionit gjeografik ekzistues të gjeoreferencuar në gjeodatabase zë një pjesë të konsiderueshme të shërbimit të kërkuar, të përcaktuar në termat e referencës, i cili duhet të realizohet nga subjektet me licencën përkatëse. *Trajtuar më hollësisht në faqen 77-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj: Instituti i Monumenteve të Kulturës gjatë hartimit të termave të referencës, për objekte të kësaj kategorie, në të ardhmen të kërkojnë në dokumentet e tenderit, licenca profesionale që janë të lidhur ngushtë me kërkesat e projekteve dhe qëllimet e objektit të prokurimit.

Gjetje 19: Në procedurën e prokurimit “Inventarizimi dhe hartëzimi i Monumenteve të Kulturës në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet hartës G” u konstatua se janë vendosur kriteret për operatorët ekonomik, ku duhet të kenë realizuar të paktën dy aplikime të ngjashme të sistemeve W-G në platformën Open Source dhe tre implementimeve të aplikimeve të bazuara në teknologjinë Eëb. Nga ana e grupit të auditimit konsiderohen se janë kriteret të tepërta dhe nuk janë në përputhje me kriterin e vendosur më sipër nga AK sipas Nenit 28, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të ketë realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera në tre vitet e fundit, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës. Ky kusht (i vendosur nga vet AK), ku afati kohor dhe vlera e tij janë të përcaktuar qartë, është i mjaftueshëm dhe njëkohësisht seleksionues në favor të konkurrencës, dhe garanton që OE konkurrues duhet të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

ketë përvojë të mëparshme në këtë fushë. Nga auditimi konstatohet se është e tepërt që shtimi nga AK i kriterëve të tjera shtesë si psh: 2 aplikime dhe 3 implementime të aplikimeve.

Gjithashtu u konstatua se janë vendosur kriterë operatorët ekonomik, ku kërkohet që Administratori i Projektit i diplomuar në Gjeodezi me eksperiencë pune në fushat e G prej të paktën 15 vjetësh, Administratori duhet të ketë udhëhequr në pesë vitet e fundit të paktën 3 projekte të ngjashme EëbGIS. Këto kriterë janë të tepërta dhe përjashtuese sepse sipas Ligjit nr.9643 dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimet Publike”, afatet kohore për përvoja të ngjashme i refererohen maksimumi 3 viteve të mëparshme, dhe është e panevojshme që të kërkohet një afat 15 vjeçar eksperience pune. Gjithashtu kriteri që Administratori i Projektit të ketë udhëhequr në pesë vitet e fundit 3 projekte të ngjashme W-G është i tepërt, sepse sipas konceptit të Ligjit nr.9643 dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimet Publike”, mjafton 1 eksperiencë e ngjashme për të vërtetuar atësinë teknike të një OE, i cili ka në përbërjen e tij edhe stafin teknik përkatës.

Ndërsa kriteri për Drejtuesin Funkcional dhe zhvillues W- G me eksperiencë 5 vjeçare në GIS dhe dy eksperiencia implementimi të ngjashme 5 vitet e fundit, nuk kuptohet pse është vendosur dhe ku ndahet detyra e tij me detyrën e Administratorit të Projektit. Eksperiencia e mëparshme e operatorit ekonomik ose administratorit është kusht i mjaftueshëm për të vërtetuar aftësinë teknike të OE. Ndërsa eksperiencia e punës e Drejtuesit Funkcional prej 5 vitesh në fushat e GIS është jo në përputhje me interpretimin kërkesave ligjore të Ligjit Nr.9643 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për afatet kohore të përvojës së ngjashme. *Trajtuar më hollësisht në faqen 80-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Instituti i Monumenteve të Kulturës në procedurat e prokurimit për shërbime, përkatësisht në DST-Kriteret e veçanta të kualifikimit, të kërkojë përvoja të ngjashme në përputhje me Nenin 28 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”. Ndërsa për tu siguruar për anën cilësore të realizimit të kontratës të kërkohet formulari vlerësimit të kontratës/përvojës së paraqitur, dhënë nga autoriteti kontraktor përkatës. Gjithashtu IMK për të orientuar operatorët ekonomik për llojin e kontratave/përvojave të ngjashme që duhet të paraqesin, mund të vendos kriterë orientues për llojin e kontratës/përvojës së mëparshme, por kursesi të vendos kriterë për numër të caktuar implementimesh dhe aplikimesh të realizuara.

Instituti i Monumenteve të Kulturës në procedurat e prokurimit, përkatësisht në DST-Kriteret e veçanta, mos të përcaktojnë afate kohore për eksperiencën e stafit të ofertuesve/operatorëve ekonomik të cilat e kalojnë afatin 3 vjeçar nga momenti i publikimit të njoftimit të tenderit, në koherencë edhe me Nenin 28, pika 3, “Për përvojat e ngjashme” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu IMK nuk duhet të kërkojë eksperiencia të ngjashme të implementuara nga stafi përbërës i operatorëve ekonomike, sepse këtë kusht e përmbush kriteri për përvoja të ngjashme drejtuar operatorëve ekonomik.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Situata e zbatimit të rekomandimit :edhe pse nuk ka pasur prokurime të ngjashme, kërkesat në procedurat e projekteve konstatohen të tepërta dhe të panevojshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Gjetje 20. Nga KLSH realizua verifikimi i problematikës së ngritur në ankesën e paraqitur në KLSH nga një Arkitekt Restaurator mbi Projektin e ndërhyrjeve në monumentin: “Kisha e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit” Bashkia Libohovë.

Lidhur me pretendimin se: *Projekti për ndërhyrjet ndaj monumentit është tepër i dëmshëm dhe për këtë arsye i është bërë një oponencë teknike, e cila evidenton teknikisht të gjitha problemet*, nga auditimi u konstatua se në mbledhjen e datës 25.05.2016 të Këshillit Shkencor të IMK është diskutuar ndër të tjera dhe Projekti: “Ndërhyrje restauruese në kishën “Fjetja e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit” Gjirokastër. Në këtë procesverbal (*ndryshe sa pretendohet në ankesë*) nuk gjendet ndonjë oponencë e projektit por vetëm një diskutim mbi ndërhyrjet restauruese në lidhje me problematikat që ka shfaqur ky objekt, si për lagështirën që vazhdon në hajat megjithë ndërhyrjet gjatë vitit 2014, çarje në muraturë, degradim shkallësh etj.

Në lidhje me pretendimin *se në datë 05.08.2016 Bashkia Libohovë ka shpallur prokurimin e “Rehabilitimit dhe rikonstruksionin e Rrugës Kthesa e Labovës – Labovë e Kryqit” ku brenda dokumenteve gjendet dhe procedura e prokurimit për restaurimin në Kishën e Labovës. Tender i cili ka pasur datën e hapjes më datë 05.09.2016. Për të cilin ankimesi vazhdon se kemi të bëjmë me një projekt i cili është thellësisht i gabuar, me pasoja të rënda për vlerat e një kishë të shek. X-XI pas.kr. dhe që është e përgatitur nga Ministria e kulturës dhe IMK duke e futur kontrabandë për ta realizuar nëpërmjet një tenderi që ka objekt tjetër për tjetër. Kjo kishë sipas projektit në fjalë do të betonohet në themele do të injektohen me çimento siparfaqet ku ndollet afresku dhe do të trajtohet si të ishte një nga objektet inxhinjerie të aksit rrugor i cili prokurohet, nga auditimi u konstatua se ky projekt ka një preventiv të miratuar me punime restaurimi dhe elektrike në vlerën prej: 24,075,161 lekë pa tvsh si dhe vlerë totale përfshirë edhe 20% fond rezervë prej 34,668,232 lekë me tvsh.*

Me VKM nr.31, datë 13.06.2016 “Për shpërndarjen e financimit për projekte të Grantit” “Infrastruktura vendore dhe Rajonale”, Programi “Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale”, Shtylla I, Thirrja II, për vitin 2016, është financuar nga FZHR sipas programit ndër të tjera dhe Projekti me numrin 22 sipas tabelës 1 për Bashkinë Libohovë “Rehabilitimi si dhe rikonstruksioni i rrugës “Kthesa e Labovës- Labovë e kryqit”. Vlera e këtij financimi parashikohet në 6,191,448,793 lekë dhe e ndarë për financim për vitin 2016 në 3,095,724,397 lekë dhe po aq për vitin 2017. Në pikën 5 te shënimet në fund të kësaj table nr.1 (të VKM) citohet: Për projektin nr.22 “Rehabilitimi si dhe rikonstruksioni i rrugës “Kthesa e Labovës – Labovë e kryqit”, me autoritet kontraktues Bashkinë Libohovë ku do të ndërhyhet në zona me rëndësi për trashëgimin kulturore, autoritetet kontraktuese do të zbatojnë projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, IMK në përputhje me parashikimet në ligjin nr.9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”. Ky projekt ka kaluar në prokurim dhe do të financohet për dy vjet nga FZHR 2016 dhe 2017. Ky financim nuk është i ndarë përsa i përket rehabilitimit por përfshin si **rehabilitimin** e objektit (Projekti i hartuar e miratuar nga IMK dhe KKR) ashtu dhe Rikonstruksionin e Rrugës (projekt i hartuar nga Bashkia Libohovë). Të dy objektet janë financuar me VKM dhe me Autoritet Kontraktues Bashkinë Libohovë. Pra rehabilitimi i kishës është një projekt krejt më vehte dhe rikonstruksioni i rrugës një projekt më vehte. Gjithashtu u konstatua se në preventivin e projektit “Restaurimi i Kishës së Shën Mërisë në Labovën e Kryqit” është vendosur zëri punimeve, “Rehabilitim i instalimeve elektrike 10%” në vlerën 2,188,651 lekë, vlerë e cila i përket 10% te vlerës së gjithë zërave të preventivit. Ky zë punimesh nuk ndodhet në manualin e çmimeve të restaurimit të vitit 2015 dhe nuk është i detajuar. Gjithashtu në preventivin e projektit konstatohen zëra të ndryshëm, në analizë të të cilëve janë përfshirë zëra të cilat nuk ndodhen as në manualin e restaurimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

as ne manualin e çmimeve të ndërtimit, por çmimet e tyre janë vendosur apriori. *Trajtuar më hollësisht në faqen 86-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj: Në manualin e ardhshëm të çmimeve të restaurimeve, të përfshihen edhe zëra të cilët përfshijnë punime elektrike, apo dhe zëra të tjera sipas fushave të caktuara të nevojshme në projekte restaurimi që hartohen nga IMK-ja.

Nga IMK të merren masa që në projektet dhe preventivat e hartuara apo miratuara prej saj, të përfshihen në mënyrë të detajuar analizat e çmimeve për çdo zë dhe nën zë punimi, duke përfshirë nëse është e nevojshme edhe specialist të fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Situata e zbatimit të rekomandimit :Realizuar azhurnimi i manualit teknik të restaurimit me çmimet aktuale dhe zërat e rinjë të punimeve por ende ka zëra të cilat nuk janë në këto manuale .

Nga IMK të merren masa për kryerjen në mënyrë sa më korrekte të punës së mbikëqyrësit në punimet restauruese që do të realizohen në objektin monument kulture “Kisha e Shën Mërisë-Labovë e Kryqit”.**Menjëherë**

Situata e zbatimit të rekomandimit ;Me Urdhërin Nr.1000/2, datë 20.10.2016, janë përcaktuar punonjësit e IMK-së, të cilët kanë kryer punën e supervizimit dhe të kolaudatorit në punimet restauruese u realizuan në objektin monument kulture “Kisha e Shën Mërisë-Labovë e Kryqit”.

C. SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EFICENCËS, EFEKTIVITETIT DHE EKONOMICITETIT.

Në procedurën me objekt “Inventarizimi dhe hartëzimi i Monumenteve të Kulturës në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet hartës GIS”, me afat të zbatimit të kontratës 60 ditë nga lidhja e kontratës dhe fond limit në vlerën 4,812,000 lekë pa tvsh, fond i përlogaritur mbi bazë të ofertave të operatorëve ekonomik IkubINFO – 5,900,000 lekë me t.v.sh, InfoSoft – 5,700,000 lekë me t.v.sh, Divitech – 6,200,000 lekë me t.v.sh dhe Pragmatic Softëare – 5,300,000 leke me t.v.sh. Njësia e Prokurimit në hartimin e dokumenteve të tenderit ka përcaktuar kapacitetin teknik të nevojshëm për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në prokurim duke theksuar nevojën për të provuar përvojën e mëparshme në tyre në aplikime të bazuara në Ëeb. Kështu është kërkuar realizimi i suksesshëm i **dy aplikime të ngjashme** të sistemeve Ë-G në platformën Open Source dhe tre implementime të aplikimeve të bazuara në teknologjinë Ëeb të dokumentuara nëpërmjet kontratave dhe vërtetimeve.

Ndërkohë që ka kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë të paktën një Administrator Projekti, diplomuar në Gjeodezi dhe me eksperiencë pune në fushat e G **prej të paktën 15 vjetësh**. Administratori i projektit duhet të jetë i certifikuar në zotërimin e GIS. Administratori duhet të ketë udhëhequr në pesë vitet e fundit, **të paktën 3 projekte të ngjashme Ëeb-GIS**. Operatori ekonomik duhet të paraqesë CV e Administratorit si dhe diplomën dhe certifikata/tituj në fushën e GIS. Një Drejtues funksional dhe zhvillues Ëeb-GIS, i diplomuar në Gjeodezi dhe **eksperiencë pune të paktën 5 vjetë në fushat e GIS**. Ai duhet të zotërojë **të paktën dy eksperiencë implementimi të ngjashme gjatë 5 viteve të fundit**.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit fitues ikubINFO, rezulton se kërkesat: *Një Administrator Projekti, i diplomuar në Gjeodezi dhe me eksperiencë pune në fushat e GIS prej të paktën 15 vjetësh. Administratori i projektit duhet të jetë i certifikuar në zotërimin e GIS. Administratori duhet të ketë udhëhequr në pesë vitet e fundit, të paktën 3 projekte të ngjashme Ëeb-GIS. Operatori ekonomik duhet të paraqesë CV e Administratorit si dhe diplomën dhe certifikata/tituj në fushën e G.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në “INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Një Drejtues funksional dhe zhvillues W-G, i diplomuar në Gjeodezi dhe eksperiencë pune të paktën 5 vjeçare në fushat e G. Ai duhet të zotërojë të paktën dy eksperiencë implementimi të ngjashme gjatë 5 viteve të fundit.

Nuk janë të plotësuara, sepse nuk është e faktuar që Administratori z.Bujar Drishti, ka një eksperiencë punë prej 15 vjetësh në fushat e GIS , ku titujt master (viti 2008) dhe doktoraturë (viti 2013) i ka marrë përpara 7 vitesh nga zhvillimi i tenderit. Gjithashtu edhe eksperiencë e ngjashme megjithëse mund të jetë paraqitur në CV, ajo nuk është e faktuar me ndonjë dokument. Ndërsa drejtues funksional dhe zhvillues Eeb-Gis nuk rezulton që kompania të ketë përcaktuar ndonjë punonjës të saj dhe të ketë eksperiencë 5 vjeçare në fushat e GIS.

Për këtë arsye komisioni vlerësimit të ofertave duhet të kishte skualifikuar të gjithë operatorët ekonomik dhe procedura e tenderit duhej të anullohej.

Në këto kushte përcaktimi i fituesit në kundërshti me rregullat e prokurimit publik, e bën këtë fond prej 4,812,000 lekë pa tvsh, të prokuruar jo në përputhje me parimet mbi të cilat realizohen shpenzimet buxhetore, duke ngarkuar me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave. *Trajtuar më hollësisht në faqen 80-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj: Nga institucioni të merren masa që në procedurat e prokurimit, të eliminohen praktikët e ngjashme të përzgjedhjes së operatorëve fitues, në mungesë të plotësisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Menjëherë

Situata e zbatimit të rekomandimit :konstatohen raste me elemente të ndjekjes së procedurave të njëjta .

E. MASA DISIPLINORE:

Për personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit i rekomandohet titullarit të institucionit të IMK për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore sipas përgjegjësisë individuale të personave konkret nga vërejtje deri në largim nga puna.

Situata e zbatimit të rekomandimit :nuk na u paraqit dokumentacion lidhur me këtë rekoandim.